

## Kapitulli 1. Hyrje në Punë Sociale

### Pyetja 1

Cili është qëllimi kryesor i profesionit të punës sociale?

- A) Të ndihmojë vetëm grupet në nevojë.
- B) Të përmirësojë funksionimin shoqëror dhe kushtet mjedisore.
- C) Të promovojë politikat ekonomike të qeverisë.
- D) Të trajtojë sëmundjet mendore të individëve.

### Pyetja 2

Cili është roli i punonjësve socialë në përmirësimin e standardeve të profesionit?

- A) Të ndjekin vetëm praktikën e vjetra
- B) Të shmangin çdo përfshirje në diskutimet profesionale
- C) Të kontribuojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e standardeve profesionale
- D) Të refuzojnë çdo formë të inovacionit profesional

### Pyetja 3

Cili është dallimi kryesor midis mirëqenies sociale dhe punës sociale?

- A) Mirëqenia sociale përqendrohet te politikat qeveritare, ndërsa puna sociale te individët.
- B) Mirëqenia sociale përfshin punën sociale dhe aktivitete të tjera, ndërsa puna sociale është një komponent i saj.
- C) Mirëqenia sociale është një term i ngushtë, ndërsa puna sociale mbulon të gjitha aspektet shoqërore.
- D) Mirëqenia sociale merret vetëm me ndihmën financiare.

### Pyetja 4

Cila është një mënyrë etike për të promovuar profesionin e punës sociale?

- A) Të punojnë vetëm me klientë të privilegjuar
- B) Të nxisin ndershmërinë dhe transparencën në ushtrimin e profesionit
- C) Të përfitojnë nga klientët për përfitime financiare
- D) Të shmangin ndihmën ndaj klientëve në nevojë

### Pyetja 5

Sipas teorisë së ndërveprimit social, çfarë përbën bazën e praktikës së punës sociale?

- A) Ndihma financiare për të varfërit.
- B) Ndërtimi i marrëdhënieve të qëndrueshme midis individëve dhe mjedisit.
- C) Përdorimi i teknologjisë për përmirësimin e shërbimeve.
- D) Implementimi i reformave administrative.

### Pyetja 6

Cili është roli i decentralizimit në përmirësimin e politikave sociale?

- A) Përqendrimi i shërbimeve sociale në një nivel kombëtar.
- B) Kufizimi i burimeve për shërbimet sociale në nivel lokal.
- C) Përqendrimi i burimeve financiare vetëm në komunitetet urbane.
- D) Shpërndarja e përgjegjësisë për zbatimin e shërbimeve sociale midis qeverisë qendrore dhe asaj lokale.

Pyetja 7

Si ndikon teoria e ndërveprimit të vazhdueshëm në punën sociale me grupet?

- A) Duke inkurajuar bashkëpunimin dhe ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme.
- B) Duke përqendruar ndërhyrjet vetëm në individë të veçantë.
- C) Duke ndarë grupet sipas përkatësisë ekonomike.
- D) Duke krijuar modele të centralizuara të ndërhyrjes.

Pyetja 8

Cili institucion ka qenë ndër të parët që ka përfshirë punonjësit socialë në Shqipëri?

- A) Ministria e Arsimit.
- B) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Dikur, Ministria e Punës, Përkrahjes Sociale dhe Emigracionit).
- C) Ministria e Shëndetësisë.
- D) Ministria e Drejtësisë.

Pyetja 9

Si e përkufizon Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë (NASË) profesionin e punës sociale ?

- A) Një profesion që ndihmon vetëm individët në kushte të rënda ekonomike.
- B) Një profesion që fokusohet tek familjet dhe grupet shoqërore.
- C) Një profesion i cili synon rritjen e mirëqenies individuale dhe kolektive.
- D) Një profesion që zhvillon vetëm praktika të nivelit të lartë shkencor.

Pyetja 10

Cila është rëndësia e kodit të etikës në punën sociale?

- A) Për të siguruar standarde të larta morale dhe profesionale në praktikë.
- B) Për të kufizuar kompetencat e punonjësve socialë.
- C) Për të ndjekur direktivat e dhëna nga institucionet ndërkombëtare.
- D) Për të vendosur marrëdhënie të forta me klientët.

Pyetja 11

Cili nga këto elementë konsiderohet pjesë thelbësore e vlerave profesionale të punonjësit social?

- A) Monitorimi.
- B) Trajnimi teknik.
- C) Konfidencialiteti.
- D) Marrëdhëniet institucionale.

Pyetja 12

Në cilin aspekt punonjësit socialë dhe psikiatrit kanë një rol të ndryshëm?

- A) Përqendrimi te patologjia dhe trajtimi.
- B) Menaxhimi i marrëdhënieve njerëzore dhe sociale.
- C) Zhvillimi i strategjive të reformës.
- D) Përfshirja në terapi alternative.

Pyetja 13

Cili është roli i punonjësve socialë në institucionet arsimore?

- A) Të mbështesin mësuesit në zbatimin e programeve edukative.
- B) Të ndihmojnë nxënësit të përballojnë probleme sociale dhe emocionale.
- C) Të kryejnë vetëm vlerësime për sjelljen e nxënësve.
- D) Të menaxhojnë burimet financiare të shkollës.

#### Pyetja 14

Çfarë synon parandalimi në praktikën e punës sociale?

- A) Të krijojë strategji për rritjen e fondeve.
- B) Të zbulojë dhe eliminojë faktorët që mund të dëmtojnë funksionimin shoqëror.
- C) Të mbështesë vetëm grupet e marginalizuara.
- D) Të ndjekë vetëm direktivat e institucioneve.

#### Pyetja 15

Cila është lidhja midis punës sociale dhe mirëqenies ekonomike në komunitet?

- A) Puna sociale ndihmon vetëm në rastet e emergjencave ekonomike.
- B) Puna sociale promovon ndërjegjësimin dhe zhvillimin e aftësive për të përmirësuar standardet e jetesës.
- C) Puna sociale kufizohet në ndihmën financiare për familjet e varfra.
- D) Puna sociale adreson vetëm problemet individuale pa lidhje me ekonominë.

#### Pyetja 16

Cili është ndikimi i shërbimeve komunitare në zëvendësimin e strukturave rezidenciale?

- A) Ndihmon në integrimin më të mirë të individëve në komunitet.
- B) Redukton cilësinë e shërbimeve për shkak të mungesës së infrastrukturës.
- C) Kufizon aksesin e individëve në ndihmën shoqërore.
- D) Përqendron shërbimet vetëm në qytetet kryesore.

#### Pyetja 17

Si ndihmojnë teoritë e modernizimit në punën sociale për të moshuarit?

- A) Duke promovuar ndërveprimet shoqërore dhe fuqizimin e rolit të tyre në komunitet.
- B) Duke i inkurajuar ata të tërhiqen nga aktivitetet sociale.
- C) Duke i transferuar në institucione rezidenciale afatgjata.
- D) Duke kufizuar qasjen në shërbime të komunitetit.

#### Pyetja 18

Cila është rëndësia e organizimit komunitar në zgjidhjen e konflikteve lokale?

- A) Ndihmon në mobilizimin e burimeve dhe bashkëpunimin për zgjidhjen e konflikteve.
- B) Lehtëson zbatimin e politikave qendrore pa konsultim me komunitetin.
- C) Redukton ndërveprimet midis grupeve të ndryshme sociale.
- D) Krijon një sistem të ri institucional për të adresuar konfliktet.

#### Pyetja 19

Si ndikon mirëqenia sociale në adresimin e problemeve të diskriminimit racor?

- A) Duke organizuar aktivitete kulturore.
- B) Duke kufizuar shërbimet në komunitetet e diskriminuara.
- C) Duke promovuar vetëm mbështetjen ekonomike.
- D) Duke krijuar politika që përkrahin barazinë dhe përfshirjen sociale.

Pyetja 20

Cili është roli kryesor i kërkimit shkencor në punën sociale?

- A) Zëvendësimi i praktikave tradicionale.
- B) Zhvillimi i metodave të reja dhe përmirësimi i strategjive të ndërhyrjes.
- C) Kufizimi i fushës së punës sociale në studime akademike.
- D) Përdorimi i metodave vetëm për raportime administrative.

Pyetja 21

Si ndikon përdorimi i teorisë së komunikimit në ndërhyrjet sociale?

- A) Lehtëson ndërtimin e marrëdhënieve më efektive midis punonjësit social dhe klientit.
- B) Kufizon ndërveprimet me grupet vulnerabël.
- C) Përqendron ndërhyrjet në problematikat ekonomike.
- D) Ul nevojën për vlerësime të rastit.

Pyetja 22

Cila nga pohime është një sfidë për punonjësit socialë në institucionet arsimore?

- A) Monitorimi i performancës akademike të nxënësve.
- B) Adresimi i bullizmit dhe konflikteve ndërmjet nxënësve.
- C) Përfshirja në zhvillimin e kurrikulave arsimore.
- D) Hartimi i raporteve financiare për shkollat.

Pyetja 23

Cili është roli i avokatisë në punën sociale?

- A) Përfaqësimi i interesave të klientëve dhe mbrojtja e të drejtave të tyre.
- B) Hartimi i politikave publike pa përfshirjen e komunitetit.
- C) Kufizimi i rolit të klientëve në procesin vendimmarrës.
- D) Ndjekja e detyrave administrative.

Pyetja 24

Çfarë përfshin koncepti i mirëqenies sociale si institucion?

- A) Vetëm aktivitetet e organizuara nga agjencitë qeveritare.
- B) Politikat dhe programet që mbështeten vetëm nga donatorët e huaj.
- C) Të gjitha aktivitetet e organizuara për parandalimin dhe zgjidhjen e problemeve sociale.
- D) Vetëm reformat në fushën e shëndetit publik.

Pyetja 25

Cili është detyrimi kryesor i punonjësve socialë ndaj integritetit të profesionit?

- A) Të ndjekin vetëm rregullat e agjencisë së tyre
- B) Të respektojnë dhe të ruajnë integritetin e profesionit përmes praktikës etike
- C) Të promovojnë interesat personale mbi ato profesionale
- D) Të shmangin çdo raportim për sjelljet joetike

Pyetja 26

Cila është shtylla kryesore që ndihmon punonjës social në punën e tij?

- A) Njohuritë, shprehjet praktike dhe vlerat profesionale.
- B) Teoritë e modernizmit dhe metodat klinike.
- C) Metodat psikologjike dhe raportet sociologjike.

D) Kërkimet ndërkombëtare dhe statistikat.

Pyetja 27

Cila nga këto pohime përshkruan më saktë praktikën e sotme të punës sociale?

- A) Fokusimi ekskluziv në ndihmën individuale.
- B) Përmirësimi i ndërveprimit njerëzor dhe reduktimi i problemeve sociale.
- C) Përdorimi i metodave tradicionale pa përfshirë teknika të reja.
- D) Fokusimi në përmbushjen e objektivave qeveritare.

Pyetja 28

Cili nga këto alternativa nuk është një nga rolet e punonjësit social?

- A) Ndërmjetësimi.
- B) Advokacia
- C) Promovimi i shëndetit mendor.
- D) Mbrojtja e konsumatorit.

Pyetja 29

Cila është lidhja midis punës sociale dhe mirëqenies sociale?

- A) Puna sociale është një komponent i mirëqenies sociale.
- B) Mirëqenia sociale është më e kufizuar në fushëveprim.
- C) Puna sociale është e pavarur nga mirëqenia sociale.
- D) Mirëqenia sociale përqendrohet vetëm në politikat ekonomike.

Pyetja 30

Cilat janë tri fushat kryesore të ndërhyrjes së punës sociale?

- A) Psikologjia, sociologjia dhe antropologjia.
- B) Riaftësimi, rehabilitimi dhe ndihma ekonomike.
- C) Individët, grupet dhe komunitetet.
- D) Kujdesi shëndetësor, mirëqenia ekonomike dhe drejtësia sociale.

Pyetja 31

Si përcaktohet mirëqenia sociale si institucion?

- A) Një sistem i organizuar i aktiviteteve për parandalimin dhe zgjidhjen e problemeve sociale.
- B) Një grup aktiviteteve spontane që ndihmojnë njerëzit në nevojë.
- C) Një disiplinë akademike që ofron vetëm njohuri teorike.
- D) Një grup i vogël shërbimesh për familjet në nevojë.

Pyetja 32

Cila nga alternative përshkruan më saktë rolin e punonjësit social si agjent ndryshimi?

- A) Zbatimi i rregullave ligjore pa marrë parasysh kontekstin.
- B) Ndihma për individët dhe grupet për të zhvilluar kapacitetet e tyre dhe për t'u përshtatur me ndryshimet.
- C) Organizimi i aktiviteteve kulturore për komunitetet.
- D) Mbledhja e fondeve për qëllime bamirësie.

Pyetja 33

Cilat janë disa nga parimet kryesore të Kodit të Etikës për punonjësit socialë?

- A) Vetëpërcaktimi, respektimi i dinjitetit dhe avokatësia.
- B) Disiplina e rreptë dhe ndjekja strikte e rregullave qeveritare.
- C) Asistenca financiare dhe monitorimi i vazhdueshëm.
- D) Marrëdhëniet e ngushta me institucionet fetare.

Pyetja 34

Cila është një nga metodat kryesore të punës sociale në nivel komunitar?

- A) Terapia me ilaçe.
- B) Organizimi komunitar.
- C) Monitorimi i sjelljes individuale.
- D) Asistenca ligjore.

Pyetja 35

Sipas teorisë së zhvillimit të komunitetit, çfarë është një nga funksionet kryesore të punonjësit social?

- A) Parandalimi i konflikteve politike.
- B) Koordinimi dhe organizimi i burimeve për zgjidhjen e problemeve.
- C) Analiza ekonomike e tregut të punës.
- D) Hartimi i raporteve statistikore.

Pyetja 36

Cili është qëllimi i punës sociale në shëndetësi?

- A) Të zëvendësojë psikiatrinë në trajtimin e çrregullimeve mendore.
- B) Të sigurojë shërbime për mirëqenien e përgjithshme dhe të mbështesë pacientët në adaptimin me sfidat shëndetësore.
- C) Të monitorojë ndihmën mjekësore të dhënë nga stafi shëndetësor.
- D) Të trajtojë sëmundjet infektive në nivel komunitar.

Pyetja 37

Cili është roli kryesor i një punonjësi social në menaxhimin e rasteve?

- A) Të ofrojë asistencë financiare.
- B) Të përgatisë raporte statistikore për institucionet qeveritare.
- C) Të vlerësojë nevojat e klientit dhe të koordinojë burimet e duhura.
- D) Të ndjekë trajnime profesionale.

Pyetja 38

Cili është ndikimi i decentralizimit në shërbimet sociale?

- A) Reduktimi i kompetencave të qeverisë qendrore.
- B) Përshtatja e shërbimeve ndaj nevojave specifike të komuniteteve lokale.
- C) Kufizimi i burimeve financiare për institucionet lokale.
- D) Ulja e numrit të profesionistëve në shërbimet sociale.

Pyetja 39

Cila është lidhja midis punës sociale dhe shëndetit mendor?

- A) Puna sociale ofron vetëm asistencë logjistike.

- B) Punonjësit socialë përdorin lidhjet dhe marrëdhëniet për të mbështetur individët me shqetësime mendore.
- C) Puna sociale dhe psikiatria ndajnë të njëjtën qasje terapeutike.
- D) Puna sociale përqendrohet vetëm në pacientët kronikë.

#### Pyetja 40

Cili është një nga avantazhet kryesore të transformimit të shërbimeve rezidenciale në komunitare?

- A) Reduktimi i kostove administrative.
- B) Përshtatja më e mirë e shërbimeve me nevojat individuale.
- C) Kufizimi i aksesit në shërbime për grupet vulnerabël.
- D) Zëvendësimi i plotë i strukturave tradicionale.

#### Pyetja 41

Cilat janë avantazhet e de-institucionalizimit të shërbimeve sociale?

- A) Kufizimi i aksesit për grupet vulnerabël.
- B) Integrimi më i mirë i individëve në komunitet.
- C) Rritja e numrit të institucioneve tradicionale.
- D) Centralizimi i ofrimit të shërbimeve.

#### Pyetja 42

Cila është një nga sfidat kryesore të punës sociale në shoqëritë moderne?

- A) Zhvillimi i strukturave të centralizuara.
- B) Rritja e numrit të institucioneve qeveritare.
- C) Adaptimi me ndryshimet shoqërore dhe nevojat e komunitetit.
- D) Fokusimi vetëm në reformat ekonomike.

#### Pyetja 43

Si ndihmon mobilizimi i burimeve lokale në punën sociale?

- A) Redukton varësinë nga ndihmat ndërkombëtare.
- B) Përqendron ndihmën vetëm në grupet vulnerabël.
- C) Rrit përfshirjen e organizatave private në shërbime.
- D) Zëvendëson nevojën për standardizim të shërbimeve.

#### Pyetja 44

Cila është rëndësia e ndërveprimit të vazhdueshëm në punën sociale me fëmijët?

- A) Mbikëqyrja e vazhdueshme pa përfshirje aktive të fëmijës.
- B) Sigurimi i një mjedisi të qëndrueshëm për zhvillim dhe mirëqenie.
- C) Kufizimi i ndërveprimeve në një nivel minimal.
- D) Përdorimi i metodave tradicionale për monitorim.

#### Pyetja 45

Cila është rëndësia e metodës së menaxhimit të rasteve në punën sociale?

- A) Kufizimi i ndërveprimeve midis klientëve dhe punonjësve socialë.
- B) Përqendrimi vetëm në ndihmën financiare për klientët.
- C) Eliminimi i nevojës për planifikim të personalizuar.
- D) Ofrimi i një qasjeje të integruar për trajtimin e nevojave të klientit.

Pyetja 46

Cili është ndikimi i avokatisë në politikëbërjen sociale?

- A) Kufizon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje.
- B) Ndhmon në hartimin e politikave që reflektojnë nevojat e grupeve vulnerabël.
- C) Përqendron vendimmarrjen në nivel qendror.
- D) Mbështetet vetëm në donatorët ndërkombëtarë.

Pyetja 47

Cili është roli i teorisë së sistemeve në punën sociale?

- A) Analiza e ndërveprimit të individit me sistemet e tij mbështetëse për të zhvilluar ndërhyrje efektive
- B) Përqendrimi në problemet individuale pa marrë parasysh mjedisin social.
- C) Përdorimi i metodave tradicionale për trajtimin e problemeve.
- D) Kufizimi i ndërveprimeve vetëm në kontekstin familjar.

Pyetja 48

Si ndihmon puna sociale në promovimin e drejtësisë sociale?

- A) Përqendrimi vetëm te ndihma ekonomike.
- B) Kufizimi i qasjes për grupet vulnerabël.
- C) Ndërtimi i një mjedisi gjithëpërfshirës që mbron të drejtat e grupeve të marginalizuara.
- D) Zhvillimi i programeve për përmirësimin ekonomik të komuniteteve urbane.

Pyetja 49

Cila nga këto pohime është një nga sfidat kryesore në përdorimin e teorisë moderne në punën sociale?

- A) Reduktimi i burimeve financiare për shërbime.
- B) Përdorimi ekskluziv i teorisë tradicionale.
- C) Ndjekja e metodave të vjetruara pa përfshirje teknologjike.
- D) Rezistenca ndaj ndryshimeve nga ana e komuniteteve lokale.

Pyetja 50

Cili nga këto pohime nuk është një aspekt i mirëqenies sociale?

- A) Të gjejë strehim për fëmijët pa prindër.
- B) Të ndihmojë njerëzit që jetojnë me HIV/AIDS.
- C) Të zhvillojë teknologji për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore.
- D) Të trajtojë problemet emocionale të të moshuarve.

Pyetja 51

Cili është një nga funksionet e mirëqenies sociale si disiplinë akademike?

- A) Të ndihmojë vetëm individët në vështirësi ekonomike.
- B) Të trajtojë punonjës socialë për shërbimet sociale.
- C) Të zbatojë direktiva të organizatave ndërkombëtare.
- D) Të krijojë politika për shërbime fetare.

Pyetja 52

Cili nga pohimet e mëposhtme është një nga dallimet kryesore midis sociologjisë dhe punës sociale?



- A) Sociologjia fokusohet në diagnozë, ndërsa puna sociale në terapi.
- B) Sociologjia studion ndërveprimet njerëzore, ndërsa puna sociale ndihmon në zgjidhjen e problemeve.
- C) Sociologjia merret me mjekësinë, ndërsa puna sociale me mirëqenien ekonomike.
- D) Sociologjia adreson vetëm individët, ndërsa puna sociale vetëm komunitetet.

#### Pyetja 53

Cila nga pohimet e mëposhtme është një nga vlerat themelore të punës sociale?

- A) Respekti për dinjitetin dhe të drejtat e çdo individi.
- B) Disiplina dhe rendi në institucionet sociale.
- C) Ndjekja e rregullave administrative pa kompromis.
- D) Promovimi i interesave fetare dhe kulturore.

#### Pyetja 54

Cila nga alternativat nuk është një nga tre funksionet kryesore të punës sociale?

- A) Parandalimi i disfiksioneve shoqërore.
- B) Vitalizimi i burimeve individuale dhe shoqërore.
- C) Krijimi i institucioneve ekonomike.
- D) Riaftësimi i kapaciteteve të dobësuara.

#### Pyetja 55

Cilat janë disa nga rolet kyçe të punonjësit social në komunitet?

- A) Organizator, ndërmjetësues dhe edukues.
- B) Inspektor, administrator dhe mësues.
- C) Konsulent, ligjvënës dhe avokat.
- D) Mbikëqyrës, financier dhe planifikues.

#### Pyetja 56

Cili është qëllimi kryesor i ndërhyrjes klinike në punën sociale?

- A) Ndërtimi i marrëdhënieve me institucionet mjekësore.
- B) Trajtimi i drejtpërdrejtë i problemeve emocionale dhe sociale të individit.
- C) Krijimi i një rrjeti shërbimesh për grupet e marginalizuara.
- D) Monitorimi i zhvillimit të politikave shoqërore.

#### Pyetja 57

Cili nga opsionet përfshihet në funksionet e shërbimeve sociale për të moshuarit?

- A) Zhvillimi i programeve për të rinjtë.
- B) Organizimi i aktiviteteve sportive.
- C) Përcaktimi i politikave arsimore.
- D) Mbështetja në institucionet e kujdesit afatgjatë.

#### Pyetja 58

Cili është roli i organizatave ndërkombëtare në zhvillimin e profesionit të punës sociale në Shqipëri?

- A) Promovimi i vlerave tradicionale kombëtare.
- B) Hartimi i politikave sociale për qeverinë shqiptare.
- C) Mbështetja me trajnime dhe standarde profesionale për punonjësit socialë.

D) Financimi ekskluziv i projekteve qeveritare.

Pyetja 59

Si ndikon kodi i etikës në marrëdhëniet midis punonjësve socialë dhe klientëve?

- A) E kufizon komunikimin midis palëve.
- B) E përqendron marrëdhënien në ndihmën financiare.
- C) Kufizon të drejtën e klientit për vetëpërcaktim.
- D) Siguron konfidencialitet dhe respekt për të drejtat e klientëve.

Pyetja 60

Cilat janë disa nga parimet bazë të organizimit komunitar?

- A) Menaxhimi financiar dhe krijimi i rrjeteve ndërkombëtare.
- B) Planifikimi, koordinimi dhe përdorimi i burimeve për zgjidhjen e problemeve.
- C) Ndjekja e politikave administrative qendrore.
- D) Kufizimi i veprimtarive në një nivel lokal.

Pyetja 61

Cilat prej alternativave të mëposhtme përbën kategori kryesore të shërbimeve humane?

- A) Edukimi, shëndeti dhe infrastruktura.
- B) Shërbimet personale, mbrojtëse, informative dhe të mirëmbajtjes.
- C) Politikat sociale, ndërhyrjet klinike dhe reformat ekonomike.
- D) Programet arsimore dhe asistencë ligjore.

Pyetja 62

Cili nga këto parime është thelbësor për një punonjës social sipas Kodit të Etikës?

- A) Neutraliteti politik.
- B) Përfshirja në projekte ekonomike.
- C) Respekti për vetëpërcaktimin e klientit.
- D) Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit.

Pyetja 63

Cila nga këto pohime përfshin organizimin komunitar në punën sociale?

- A) Planifikimi dhe mobilizimi i burimeve për përmirësimin e komunitetit.
- B) Zhvillimi i strategjive mjekësore për trajtimin e pacientëve.
- C) Mbledhja e të dhënave statistikore për qëllime administrative.
- D) Sigurimi i ndihmës financiare për individë në nevojë.

Pyetja 64

Si ndikon integrimi i metodave inovative në praktikat e punës sociale?

- A) Kufizon përfshirjen e praktikave tradicionale.
- B) Përqendrohet vetëm në zhvillimin e politikave institucionale.
- C) Zvogëlon mundësitë për personalizimin e shërbimeve.
- D) Rrit efikasitetin dhe përmirëson rezultatet për klientët.

Pyetja 65

Cili është roli i strategjive të parandalimit në adresimin e krizave sociale?

- A) Kufizon burimet për shërbimet emergjente.

- B) Përqendron ndihmën vetëm në komunitetet e prekura nga kriza.
- C) Redukton ndikimin e krizave përmes identifikimit të hershëm të rreziqeve
- D) Rrit varësinë nga ndihmat ndërkombëtare.

Pyetja 66

Si ndikon dokumentimi profesional në cilësinë e punës sociale?

- A) Kufizon kreativitetin e punonjësve socialë.
- B) Përqendron përpjekjet në aspektet administrative.
- C) Siguron transparencë, gjurmueshmëri dhe vlerësim të praktikave.
- D) E redukton kohën e shpenzuar për klientët.

Pyetja 67

Cili është roli edukativ që luan puna sociale për grupet vulnerabël?

- A) Të kufizojë qasjen e tyre në mundësi të barabarta.
- B) Të ofrojë mjete dhe njohuri për fuqizim dhe zhvillim personal.
- C) Të zvogëlojë ndërveprimet midis individëve dhe komunitetit.
- D) Të përqendrojë ndihmën vetëm në aspektin financiar.

Pyetja 68

Si ndikon fuqizimi i individëve në efektivitetin e ndërhyrjeve të punës sociale?

- A) E rrit varësinë e klientëve nga shërbimet sociale.
- B) Kufizon ndërhyrjet e punonjësve socialë në zgjidhjen e problemeve.
- C) Ndihmon individët të marrin kontroll mbi jetën e tyre dhe të përmirësojnë mirëqenien.
- D) Përqendrohet vetëm në ofrimin e ndihmës ekonomike.

Pyetja 69

Cili është ndikimi i fuqizimit ekonomik të grave në punën sociale?

- A) Redukton varësinë e tyre ekonomike dhe përmirëson mirëqenien familjare.
- B) Kufizon pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës.
- C) Ndihmon vetëm në nivel lokal.
- D) Përqendron ndihmën vetëm në projekte ndërkombëtare.

Pyetja 70

Si mund të përmirësohet cilësia e shërbimeve sociale përmes mbikëqyrjes profesionale?

- A) Kufizimi i ndërveprimeve të punonjësve socialë me klientët.
- B) Zhvillimi i aftësive profesionale dhe monitorimi i vazhdueshëm i praktikës.
- C) Përqendrimi vetëm në aspektet administrative.
- D) Mbështetja vetëm në raportet institucionale.

Pyetja 71

Cila është rëndësia e një qasjeje gjithëpërfshirëse në punën sociale?

- A) Adreson vetëm problemet individuale.
- B) Merr parasysh faktorët personalë, shoqërorë dhe ekonomikë për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme.
- C) Kufizon shtrirjen e shërbimeve sociale.
- D) Përqendron ndihmën vetëm në qytetet e mëdha.

Pyetja 72

Cili është ndikimi i një kornize etike në punën sociale?

- A) Kufizon fleksibilitetin në ofrimin e shërbimeve.
- B) Përqendron vendimet vetëm te punonjësit e institucioneve.
- C) Siguron standarde të larta profesionale dhe ndihmon në mbrojtjen e të drejtave të klientëve.
- D) Redukton ndërveprimet me komunitetet vulnerabël.

Pyetja 73

Si ndikon integrimi i teknologjisë në shërbimet sociale?

- A) Përmirëson eficiencën dhe aksesin në shërbime.
- B) Redukton ndjeshmërinë sociale të punonjësve.
- C) Kufizon qasjen e grupeve vulnerabël në ndihma.
- D) Përqendrohet vetëm në mbledhjen e të dhënave statistikore.

Pyetja 74

Cili është roli i mobilizimit të komunitetit në punën sociale?

- A) Ndihmon në zgjidhjen e problemeve lokale përmes angazhimit aktiv të komunitetit.
- B) Kufizon ndërveprimet midis individëve dhe institucioneve.
- C) Përqendron ndihmën vetëm në grupet vulnerabël.
- D) Shpërndan përgjegjësitë për adresimin e problemeve midis organizatave ndërkombëtare.

Pyetja 75

Si ndikon planifikimi strategjik në zhvillimin e shërbimeve sociale?

- A) Eliminon fleksibilitetin në zbatimin e shërbimeve.
- C) Kufizon përfshirjen e organizatave joqeveritare.
- D) Centralizon vendimmarrjen në nivel kombëtar.
- B) Ndihmon në identifikimin e prioriteteve dhe ndarjen efektive të burimeve.

Pyetja 76

Cili është roli i studimeve empirike në përmirësimin e praktikave të punës sociale?

- A) Siguron baza shkencore për ndërhyrje dhe zhvillimin e strategjive të reja.
- B) Kufizon ndërveprimet ndërmjet profesionistëve dhe klientëve.
- C) Përqendrohet vetëm në raportimet administrative.
- D) Redukton nevojën për analiza teorike.

Pyetja 77

Si ndikon teoria e konfliktit në punën sociale?

- A) Ndihmon në identifikimin dhe adresimin e strukturave të pabarabarta që krijojnë shtypje.
- B) Promovon ndarjen midis grupeve sociale.
- C) Kufizon ndërveprimet me grupet vulnerabël.
- D) Përqendron ndihmën vetëm në nevojat ekonomike.

Pyetja 78

Si ndikon decentralizimi në përmirësimin e shërbimeve sociale për komunitetet rurale?

- A) Redukton aksesin e komuniteteve në shërbime.

- B) Shkurton burimet financiare për shërbimet sociale.
- C) Përqendron shërbimet në rajonet urbane.
- D) Fuqizon vendimmarrjen lokale dhe përshtat shërbimet me nevojat specifike.

Pyetja 79

Cili është një nga faktorët që kontribuon në përmirësimin e ndërhyrjeve komunitare në punën sociale?

- A) Pjesëmarrja aktive e komunitetit në planifikimin dhe zbatimin e shërbimeve.
- B) Fokusimi në përmirësimin e infrastrukturës teknologjike.
- C) Reduktimi i përfshirjes së organizatave joqeveritare.
- D) Centralizimi i të gjitha vendimeve në nivel kombëtar.

Pyetja 80

Cila është rëndësia e punës sociale në kontekstin e shërbimeve të shëndetit mendor?

- A) Ndhurma në zhvillimin e kapaciteteve të vetë-menaxhimit dhe funksionimit shoqëror.
- B) Menaxhimi i fondeve për pacientët.
- C) Ofrimi i diagnostikimit mjekësor.
- D) Monitorimi i përdorimit të barnave nga pacientët.

Pyetja 81

Si ndikon standardizimi i shërbimeve sociale në cilësinë e tyre?

- A) Siguron një bazë të njëtrajtshme për ofrimin e shërbimeve.
- B) Redukton fleksibilitetin për të adresuar nevojat lokale.
- C) Ndhmon në uljen e kostove financiare të programeve sociale.
- D) Rrit varësinë nga mbështetja ndërkombëtare.

Pyetja 82

Cili është funksioni kryesor i teorisë së qëllimeve shëruese në punën sociale?

- A) Organizimi i burimeve komunitare për projekte sociale.
- B) Menaxhimi i konflikteve në grupe të mëdha.
- C) Trajnimi i stafit për ndërhyrje profesionale.
- D) Ndhurma për individët në zgjidhjen e çështjeve personale dhe emocionale.

Pyetja 83

Cili është një nga objektivat kryesorë të shërbimeve sociale për fëmijët?

- A) Përshtatja e tyre në institucione rezidenciale afatgjata.
- B) Kufizimi i ndërveprimeve me familjet biologjike.
- C) Rritja e varësisë nga ndihmat financiare.
- D) Ndhurma për të arritur standarde të kënaqshme jetese dhe edukimi.

Pyetja 84

Çfarë nënkupton përgjegjësia e punonjësit social për të ruajtur emrin e mirë të profesionit?

- A) Të veprojë në mënyrë të ndershme dhe të përgjegjshme në çdo situatë profesionale
- B) Të ndjekë interesat personale mbi ato profesionale
- C) Të shmangë çdo lloj përgjegjësie për veprimet e tij
- D) Të bashkëpunojë në fshehjen e praktikave të pandershme

Pyetja 85

Cili është ndikimi i transformimit të shërbimeve rezidenciale në Shqipëri?

- A) Përdorimi më efektiv i burimeve lokale.
- B) Reduktimi i aksesit në shërbime.
- C) Rritja e numrit të institucioneve tradicionale.
- D) Mbështetja më e mirë për personat vulnerabël brenda komunitetit.

Pyetja 86

Cila është mënyra më e mirë për të promovuar vlerat e punës sociale në publik?

- A) Shmangia e kontakteve me publikun
- B) Të vepruarit vetëm në interes të agjencisë
- C) Të ndjekurit e vetëm udhëzimeve të institucioneve lokale
- D) Të edukuarit të publikut mbi rëndësinë e drejtësisë sociale dhe ndihmës ndaj grupeve vulnerabël

Pyetja 87

Si ndikon përdorimi i metodave tradicionale në praktikën e punës sociale sot?

- A) Redukton efektivitetin e shërbimeve.
- B) Kufizon ndihmën në çështjet e lidhura me varfërinë.
- C) Ndihton në mbajtjen e standardeve profesionale.
- D) Siguron një qasje të plotë për të gjitha grupet shoqërore.

Pyetja 88

Cila është sfida kryesore për punonjësit socialë në sistemin e shëndetit mendor?

- A) Përdorimi efektiv i lidhjeve sociale dhe komunitare për mbështetjen e klientëve.
- B) Monitorimi i trajtimit mjekësor.
- C) Hartimi i politikave mjekësore për pacientët kronikë.
- D) Menaxhimi i emergjencave financiare të pacientëve.

Pyetja 89

Si ndikon puna sociale në shërbimet shëndetësore?

- A) Përqendrohet në administrimin e institucioneve shëndetësore.
- B) Ofron vetëm mbështetje logjistike për stafin mjekësor.
- C) Kufizon aksesin në shërbime për grupet vulnerabël.
- D) Adreson problemet sociale dhe emocionale të pacientëve dhe familjeve të tyre.

Pyetja 90

Cili është roli i punonjësve socialë në përballimin e pasojave të varfërisë?

- A) Hartimi i programeve për trajtimin e nevojave ekonomike dhe shoqërore.
- B) Ndjekja e politikave të miratuara nga qeveria.
- C) Monitorimi i situatave emergjente pa ndërhyrje të drejtpërdrejtë.
- D) Kufizimi i ndihmës vetëm për individët në nevojë.

Pyetja 91

Si ndikon procesi i planifikimit në punën sociale komunitare?

- A) Kufizon zhvillimin e projekteve të reja.
- B) E përqendron ndihmën vetëm te grupet vulnerabël.

- C) Përcakton prioritete për përdorimin efektiv të burimeve.
- D) Përjashton pjesëmarrjen e organizatave private.

Pyetja 92

Cili është ndikimi kryesor i programeve të mirëqenies sociale në Shqipëri?

- A) Centralizimi i burimeve për shërbimet publike.
- B) Reduktimi i varfërisë dhe përmirësimi i standardeve të jetesës.
- C) Rritja e burokracisë në institucionet publike.
- D) Reduktimi i numrit të organizatave private.

Pyetja 93

Cili është detyrimi kryesor i një punonjësi social ndaj shoqërisë?

- A) Të përmbushë vetëm interesat e tij personale
- B) Të ndjekë vetëm interesat e klientëve të tij
- C) Të mbështesë mirëqenien sociale dhe të promovojë drejtësinë sociale
- D) Të shmangë përfshirjen në çështje sociale

Pyetja 94

Cili nga faktorët përmendet si sfidë kryesore për zhvillimin e mirëqenies sociale?

- A) Kultura tradicionale në vendet rurale.
- B) Shtrirja e gjerë e institucioneve fetare.
- C) Urbanizimi dhe dobësimi i lidhjeve farefisnore.
- D) Prania e organizatave ndërkombëtare.

Pyetja 95

Cili është një nga elementët kryesorë të praktikës së sotme të punës sociale?

- A) Rritja e cilësisë së jetës përmes përmirësimit të marrëdhënieve shoqërore.
- B) Përdorimi i vetëm metodave tradicionale.
- C) Fokusimi në zhvillimin ekonomik të komunitetit.
- D) Reduktimi i ndërveprimeve sociale.

Pyetja 96

Çfarë duhet të bëjë një punonjës social gjatë një emergjence publike?

- A) Të përqendrohet vetëm tek klientët aktualë
- B) Të shmangë çdo ndërveprim me komunitetin
- C) Të angazhohet në mbrojtjen dhe përmirësimin e mirëqenies së shoqërisë
- D) Të ndjekë vetëm udhëzimet e institucioneve qeveritare

Pyetja 97

Cili është një detyrim etik i punonjësve socialë ndaj pjesëmarrjes publike ?

- A) Të shmangin pjesëmarrjen në diskutimet publike
- B) Të kontribuojnë në debatet publike që përmirësojnë mirëqenien sociale
- C) Të kufizohen vetëm në komunikimin me kolegët
- D) Të ndjekin vetëm interesat personale në pjesëmarrjen publike

Pyetja 98

Si mund të përdoret procesi i vlerësimit në punën sociale për përmirësimin e shërbimeve?

- A) Vetëm për të identifikuar klientët në nevojë.
- B) Për të zëvendësuar politikat sociale ekzistuese.
- C) Për të hartuar plane ndërhyrjeje të personalizuara dhe për të monitoruar progresin.
- D) Për të reduktuar numrin e rasteve të trajtuara.

Pyetja 99

Cila nga metodat e ndërhyrjes sociale konsiderohet më efektive në adresimin e varfërisë?

- A) Asistenca e drejtpërdrejtë financiare.
- B) Rritja e fondeve për institucionet rezidenciale.
- C) Përdorimi i ndihmave ndërkombëtare pa strategji afatgjata.
- D) Edukimi dhe fuqizimi ekonomik i komuniteteve vulnerabël.

## **Kapitulli 2. Procese Individuale dhe të Grupit**

Pyetja 1

Çfarë përfshin psikologjia sociale në studimin e saj?

- A) Sjelljen dhe ndikimin shoqëror
- B) Analizën e organizmave biologjikë
- C) Studimin e zhvillimit fizik të individit
- D) Kërkimin për terapi individuale

Pyetja 2

Cili është fokusi kryesor i psikologjisë sociale?

- A) Roli i faktorëve gjenetikë në sjelljen shoqërore
- B) Ndikimi i mendimit dhe ndërveprimit të individëve në sjelljen e tyre
- C) Studimi i organizmave mikroskopikë
- D) Shpjegimi i zakoneve kulturore

Pyetja 3

Cila prej të mëposhtmeve është një metodë kryesore e përdorur në psikologjinë sociale?

- A) Analiza biomjekësore
- B) Terapia e sjelljes
- C) Studimi i kafshëve
- D) Eksperimenti shkencor

Pyetja 4

Si e përcakton Gordon Allport psikologjinë sociale?

- A) Si një shkencë që studion strukturën e mendjes
- B) Si një shkencë që analizon ndërveprimet e individëve me mjedisin social
- C) Si një përpjekje për të kuptuar se si mendimi, ndjenja dhe sjellja ndikohen nga prania e të tjerëve
- D) Si një proces i vetë-reflektimit për ndërgjegjësimin social

Pyetja 5

Cila është një veçori që e dallon psikologjinë sociale nga degët e tjera të psikologjisë?

- A) Fokusimi në aspektet biologjike të sjelljes



- B) Analiza e ndikimeve sociale në sjelljen individuale
- C) Përdorimi i metodës korrelative si mjet primar kërkimor
- D) Studimi i sjelljes njerëzore në mënyrë klinike

Pyetja 6

Në eksperimentin e Stanley Milgram, çfarë përqindje e pjesëmarrësve iu bindën autoritetit?

- A) 50%
- B) 65%
- C) 75%
- D) 80%

Pyetja 7

Ku ndryshon psikologjia sociale nga sociologjia?

- A) Psikologjia sociale fokusohet në grupe, ndërsa sociologjia fokusohet tek individët
- B) Psikologjia sociale përdor më pak metoda shkencore krahasuar me sociologjinë
- C) Psikologjia sociale analizon sjelljen individuale në kontekst social, ndërsa sociologjia analizon sjelljen kolektive
- D) Psikologjia sociale trajton më shumë aspektet kulturore të sjelljes

Pyetja 8

Çfarë përfaqëson koncepti i "disonancës njohëse" në psikologjinë sociale?

- A) Mospërputhjen midis qëndrimeve dhe veprimeve të një individi
- B) Ndikimin e perceptimeve sociale në sjellje
- C) Rregullimin e emocioneve në situata të ndërlikuara sociale
- D) Studimin e faktorëve biologjikë në sjelljen sociale

Pyetja 9

Cili prej pohimeve të mëposhtme është një shembull i paradigmës eksperimentale në psikologjinë sociale?

- A) Vëzhgimi i një grupi fëmijësh në mjedisin e tyre natyror
- B) Manipulimi i kushteve sociale për të matur ndikimin mbi sjelljen e individëve
- C) Përdorimi i analizave statistikore për studimet retrospektive
- D) Intervistimi i pjesëmarrësve për perceptimet e tyre mbi marrëdhëniet sociale

Pyetja 10

Pse eksperimentet konsiderohen të rëndësishme në psikologjinë sociale?

- A) Sepse lejojnë matjen e ndikimeve biologjike në sjellje
- B) Sepse përqendrohen ekskluzivisht në sjelljen individuale
- C) Sepse eliminojnë çdo lloj ndikimi të mjedisit social
- D) Sepse ndihmojnë në analizimin e lidhjes midis variablave të pavarur dhe të varur

Pyetja 11

Çfarë është vetja sociale?

- A) Një analizë e marrëdhënieve shoqërore
- B) Perceptimi i individit për veten e tij në raport me të tjerët
- C) Një teori mbi grupet sociale
- D) Përceptimi i mjedisit fizik nga individi

Pyetja 12

Cili prej pohimeve të mëposhtme është një komponent i vetëkonceptit?

- A) Vetëdija financiare
- B) Kujtesa autobiografike
- C) Vetëshqyrtimi (introspeksioni)
- D) Sjelljet grupore

Pyetja 13

Çfarë janë vetëskemat?

- A) Strukturat që individët përdorin për të organizuar informacionin mbi veten e tyre
- B) Teori mbi sjelljen e grupeve të mëdha
- C) Kujtime kolektive të grupeve sociale
- D) Modele të sjelljes biologjike

Pyetja 14

Cili prej faktorëve ndikon në vetëkonceptin?

- A) Natyra biologjike e individit
- B) Gjendja ekonomike e shoqërisë
- C) Zhvillimi teknologjik
- D) Marrëdhëniet ndërpersonale

Pyetja 15

Si ndikon kultura në vetëkoncept?

- A) Kultura përcakton vetëm vetëdijen individuale
- B) Kultura kolektivistike fokusohet në marrëdhëniet shoqërore, ndërsa individualiste në autonominë personale
- C) Kultura nuk ka ndikim mbi vetëkonceptin
- D) Kultura ndikon vetëm në mënyrën se si individët perceptojnë të tjerët

Pyetja 16

Cili prej pohimeve të mëposhtme përshkruan introspeksionin?

- A) Procesi i analizës së sjelljeve të të tjerëve
- B) Studimi i sjelljeve në grupe
- C) Procesi i reflektimit mbi mendimet dhe emocionet personale
- D) Ndikimi i mendimeve grupore në perceptimin individual

Pyetja 17

Si ndikon kujtesa autobiografike në vetëkoncept?

- A) Duke ofruar një përmbledhje të përvojave personale që formojnë vetëdijen
- B) Duke reduktuar nevojën për reflektim të brendshëm
- C) Duke analizuar sjelljen kolektive në mjedise sociale
- D) Duke kontrolluar mendimet dhe perceptimet mbi të tjerët

Pyetja 18

Çfarë përfaqëson "egocentrizmi" në kontekstin e vetëperceptimit?

- A) Tendencën për të fokusuar perceptimet tek vetja dhe për të mbivlerësuar ndikimin personal

- B) Tendencën për të minimizuar rëndësinë e vetes në marrëdhëniet shoqërore
- C) Një proces i perceptimit të përvojave të grupit
- D) Një analizë e sjelljeve të të tjerëve

Pyetja 19

Ku ndryshojnë vetëskemat nga skemat shoqërore?

- A) Vetëskemat fokusohen te perceptimi i grupeve, ndërsa skemat shoqërore te individi
- B) Vetëskemat janë më komplekse se skemat shoqërore
- C) Vetëskemat përshkruajnë informacionin mbi vetveten, ndërsa skemat shoqërore për të tjerët dhe marrëdhëniet
- D) Nuk ka ndryshime midis tyre

Pyetja 20

Çfarë përfshin perceptimi social?

- A) Studimin e organizmave biologjikë
- B) Procesin e interpretimit të informacionit mbi të tjerët dhe marrëdhëniet shoqërore
- C) Rolin e emocioneve në marrëdhëniet personale
- D) Analizën e ndikimit kulturor në qëndrimet personale

Pyetja 21

Cila është një formë e perceptimit social?

- A) Analiza statistikore
- B) Perceptimi gjenetik
- C) Mendimi kritik
- D) Perceptimi kategorik

Pyetja 22

Cili prej të mëposhtme është një aspekt i perceptimit joverbal?

- A) Shprehjet e fytyrës
- B) Përmbajtja e mesazheve verbale
- C) Kujtesa autobiografike
- D) Analiza shkencore

Pyetja 23

Çfarë nënkupton teoria e kategorisë sociale në perceptim?

- A) Perceptimi social ndodh vetëm në prani të kontakteve direkte
- B) Individët kanë tendencë të grupojnë të tjerët sipas kategorive të përgjithshme
- C) Perceptimi social është një proces automatik i pavetëdijshëm
- D) Sjellja sociale përcaktohet nga gjendja emocionale e individit

Pyetja 24

Si ndikojnë stereotipat në perceptimin social?

- A) Rrisin ndjeshmërinë ndaj të gjitha karakteristikave individuale
- B) Formojnë paragjykime që mund të ndikojnë perceptimin e sjelljes së të tjerëve
- C) Eleminojnë plotësisht subjektivitetin nga procesi i perceptimit
- D) Janë gjithmonë të bazuara në të dhëna objektive

Pyetja 25

Çfarë roli luan gjuha e trupit në perceptimin joverbal?

- A) Është një nga format më pak të rëndësishme të perceptimit
- B) Është gjithmonë një tregues i besueshëm i mendimeve të brendshme
- C) Zëvendëson tërësisht komunikimin verbal në të gjitha rastet
- D) Jep informacione të rëndësishme mbi emocionet dhe qëllimet e individëve

Pyetja 26

Çfarë përfaqëson efekti i vetë-plotësimit në perceptimin social?

- A) Tendencën për të kategorizuar informacionin bazuar në perceptime subjektive
- B) Një proces ku pritshmëritë tona ndikojnë sjelljen e të tjerëve, duke e bërë atë të përputhet me këto pritshmëri
- C) Një metodë e ndërgjegjshme për të manipuluar mendimet e të tjerëve
- D) Një fenomen ku perceptimi nuk ndikohet nga mjedisi i jashtëm

Pyetja 27

Cili është një shembull i mashtrimit në perceptimin joverbal?

- A) Shprehja e një buzëqeshjeje të rreme për të maskuar emocionet negative
- B) Shprehja autentike e emocioneve përmes lëvizjeve të trupit
- C) Përdorimi i kategorive sociale për të formuar përshtypje të menjëhershme
- D) Zhvillimi i paragjyqimeve përmes perceptimeve të ndërsjella

Pyetja 28

Si ndikon ndjeshmëria kulturore në perceptimin social?

- A) Ul efektet e kategorive sociale në perceptim
- B) Parandalon çdo formë të ndikimit të stereotipave
- C) Ndihmon në interpretimin më të saktë të komunikimit joverbal në kultura të ndryshme
- D) Është i pandryshueshëm në kontekstet ndërkulturore

Pyetja 29

Çfarë tregon teoria e "priming-ut" në perceptimin social?

- A) Informacioni i mëparshëm i paraqitur mund të ndikojë në mënyrën se si perceptojmë dhe interpretojmë informacionin e ardhshëm
- B) Perceptimi është gjithmonë një proces logjik dhe i ndërgjegjshëm
- C) Kujtesa autobiografike është burimi kryesor i perceptimeve sociale
- D) Perceptimi joverbal është i pandikuar nga proceset mendore të mëparshme

Pyetja 30

Çfarë është atribuimi në psikologjinë sociale?

- A) Procesi i nxjerrjes së informacionit për sjelljen e kafshëve
- B) Procesi i caktimit të shkaqeve për sjelljet e vetes dhe të të tjerëve
- C) Një metodë statistikore për analizimin e të dhënave sociale
- D) Procesi i krijimit të marrëdhënieve sociale

Pyetja 31

Cilat janë dy llojet kryesore të atribuimeve?

- A) Primare dhe sekondare

- B) Objektive dhe subjektive
- C) Dispozicionale dhe situative
- D) Pozitive dhe negative

Pyetja 32

Cili prej të mëposhtme është një shembull i atribuimit situativ?

- A) "Ai është vonë sepse është dembel."
- B) "Ajo ka kaluar testin sepse ka studiuar shumë."
- C) "Automobili u prish për shkak të rrugës së keqe."
- D) "Ai është gjithmonë vonë sepse nuk i intereson koha."

Pyetja 33

Çfarë përfaqëson gabimi atribuues themelor?

- A) Tendencën për të mbivlerësuar ndikimin e faktorëve situativë dhe për të nënvlerësuar ato dispozicionale
- B) Tendencën për të mbivlerësuar ndikimin e faktorëve dispozicionale dhe për të nënvlerësuar ato situativë
- C) Tendencën për të interpretuar sjelljen pa marrë parasysh rrethanat sociale
- D) Një metodë për të analizuar sjelljen e të tjerëve në mënyrë objektive

Pyetja 34

Çfarë tregon dallimi aktor-vëzhgues në atribuime?

- A) Individët priren të shohin shkaqet e sjelljes së tyre të faktorët situativë dhe të tjerëve të faktorët dispozicionale
- B) Individët gjithmonë shohin shkaqet e sjelljeve të faktorët situativë
- C) Aktorët janë më pak të prirur të bëjnë atribuime sesa vëzhguesit
- D) Vëzhguesit janë më objektivë se aktorët në interpretimin e sjelljeve

Pyetja 35

Cila teori shpjegon se njerëzit bëjnë atribuime bazuar të krahasimi i sjelljeve me disa modele standarde?

- A) Teoria e kovariacionit
- B) Teoria e vetëperceptimit
- C) Teoria e disonancës njohëse
- D) Teoria e disonancës dispozicionale

Pyetja 36

Çfarë sugjeron teoria e kovariacionit e Harold Kelley?

- A) Sjellja është gjithmonë një funksion i qëndrimeve personale
- B) Individët bazohen vetëm të informacioni i menjëhershëm për të bërë atribuime
- C) Sjellja e tjetrit përcaktohet vetëm nga faktorët dispozicionale
- D) Njerëzit analizojnë konsistencën, dallueshmërinë dhe konsensusin për të bërë atribuime

Pyetja 37

Çfarë nënkupton "vetë-shërbimi" në atribuime?

- A) Prirjen për të marrë përgjegjësi për sukseset dhe për të fajësuar faktorët e jashtëm për dështimet

- B) Prirjen për të interpretuar sjelljen në mënyrë objektive
- C) Një metodë për të zvogëluar ndikimin e emocioneve në atribuime
- D) Tendencën për të bërë atribuime të pasakta për të tjerët

Pyetja 38

Çfarë nënkupton atribuimi shkakësor?

- A) Caktimin e përgjegjësisë për sjelljen bazuar në normat sociale
- B) Vendosjen e shkaqeve për një sjellje bazuar në ngjarjet paraardhëse
- C) Përdorimin e perceptimeve individuale për të krijuar kategori sociale
- D) Eliminimin e faktorëve situativë gjatë analizës së sjelljes

Pyetja 39

Cili është një shembull i gabimit të nënvlerësimit të faktorëve situativë?

- A) Mendimi se një koleg është vonë sepse ka ngecur në trafik
- B) Supozimi se një shofer është i paedukuar sepse kalon shpejt pranë një këmbësori
- C) Justifikimi i sjelljes së një miku me shkaqe situative
- D) Përfundimi se një nxënës është i dobët në mësimet për shkak të mungesës së inteligjencës

Pyetja 40

Çfarë përfaqëson intuicioni në procesin e njohjes?

- A) Një mendim logjik dhe racional
- B) Një përfundim i nxjerrë pa analiza të ndërgjegjshme
- C) Një metodë kërkimore në psikologjinë sociale
- D) Një përvojë emocionale e bazuar në kujtesë

Pyetja 41

Çfarë janë heuristikat në psikologjinë sociale?

- A) Rregulla të thjeshta mendore që ndihmojnë në marrjen e vendimeve
- B) Teori të sofistikuara mbi perceptimin social
- C) Prova laboratorike mbi sjelljen njerëzore
- D) Përpunimi i detajuar i informacionit kompleks

Pyetja 42

Cili prej pohimeve të mëposhtmeve është një shembull i mendimit iluziv?

- A) Të besosh se dy ngjarje të pavarura janë të lidhura
- B) Përdorimi i një qasjeje logjike për të zgjidhur një problem
- C) Të kujtosh ngjarje të shkuara me saktësi të plotë
- D) Të vendosësh bazuar në të dhëna empirike

Pyetja 43

Çfarë tregon heuristika e përfaqësimit?

- A) Një tendencë për të nënvlerësuar shkaqet e jashtme
- B) Një rregull mendor për të analizuar mendimin kritik
- C) Një metodë për të përmirësuar kujtesën afatgjatë
- D) Individët përdorin stereotipa për të gjykuar mundësinë e një ngjarjeje

Pyetja 44

Çfarë ndikon në përdorimin e heuristikës së aksesueshmërisë?

- A) Vendosja bazuar në të dhëna statistikore
- B) Mësimi përmes përvojës personale
- C) Sa lehtë mund të kujtojmë informacionin e mëparshëm
- D) Niveli i saktësisë së informacionit të perceptuar

Pyetja 45

Si ndikon gjendja shpirtërore në gjykimin tonë?

- A) Ndikon pozitivisht vetëm në gjykime logjike
- B) Gjendja pozitive çon në një mendim më të relaksuar, ndërsa gjendja negative nxit analiza më të thelluara
- C) Nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrje
- D) Gjendja shpirtërore nxit vetëm mendimet e vetëdijshme

Pyetja 46

Çfarë është një lidhje e rreme në procesin e mendimit?

- A) Një fenomen ku njerëzit shohin një marrëdhënie midis dy ngjarjeve të pavarura
- B) Një metodë e përdorur për të analizuar sjelljen sociale
- C) Një teori mbi interpretimin e informacionit statistikor
- D) Një mënyrë për të justifikuar perceptimet subjektive

Pyetja 47

Si ndikon "mbi-sigurimi" (overconfidence) në procesin e vendimmarrjes?

- A) Përmirëson saktësinë e gjykimeve tona
- B) Shpie në gabime për shkak të një besimi të tepruar në aftësitë tona
- C) Ul mundësinë për të marrë vendime të gabuara
- D) Nuk ndikon në mënyrën e analizës së informacionit

Pyetja 48

Si ndikon mendimi intuitiv në gjykimin social?

- A) Është gjithmonë më i saktë se analiza logjike
- B) Shpejton procesin e vendimmarrjes duke përdorur eksperiencën e mëparshme
- C) E bën perceptimin social më objektiv
- D) Redukton ndikimin e stereotipave në vendimet tona

Pyetja 49

Cili është një shembull i heuristikës së ankorimit?

- A) Përdorimi i mendimit racional për të justifikuar sjelljet
- B) Bazimi në të dhëna statistikore për të marrë vendime objektive
- C) Injorimi i informacionit të mëparshëm për të gjykuar situata të reja
- D) Përdorimi i një vlere fillestare për të ndikuar vendimin përfundimtar

Pyetja 50

Cili është një nga problemet kryesore të sjelljes të lidhura me njohjen sociale?

- A) Depresioni
- B) Përmirësimi i kujtesës

- C) Zhvillimi i aftësive motorike
- D) Ndërtimi i marrëdhënieve profesionale

Pyetja 51

Çfarë përfshin vetmia si problem i sjelljes?

- A) Ndjenja e kënaqësisë në mjedise të mëdha sociale
- B) Ndjenja e izolimit dhe mungesës së lidhjeve kuptimplotë
- C) Ndikimi pozitiv i ndërveprimeve sociale
- D) Mungesa e përfshirjes në aktivitete rekreative

Pyetja 52

Si ndikon ankthi në njohjen sociale?

- A) Përmirëson perceptimin social
- B) Nxit krijimin e marrëdhënieve të reja
- C) Eleminon plotësisht ndikimin e mendimeve negative
- D) Redukton ndërveprimet shoqërore

Pyetja 53

Si lidhet depresioni me proceset njohëse?

- A) Ndikon në interpretimin më optimist të ngjarjeve sociale
- B) Rrit ndërgjegjësimin për emocionet pozitive
- C) Nxit përqendrimin vetëm te informacionet negative
- D) Përmirëson kujtesën për ngjarjet e këndshme

Pyetja 54

Cili është një nga ndikimet e vetmisë në sjelljen sociale?

- A) Ndihmon në përforcimin e lidhjeve sociale
- B) Çon në izolim dhe reduktim të aftësive ndërpersonale
- C) Rrit aftësinë për të ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme
- D) Nuk ka ndikim në proceset njohëse

Pyetja 55

Si ndikojnë sëmundjet fizike në perceptimin social?

- A) Shpesh ndikojnë negativisht në mënyrën se si individi percepton mbështetjen sociale
- B) Rrisin ndjeshmërinë ndaj emocioneve të tjerëve
- C) Përmirësojnë aftësinë për të krijuar marrëdhënie
- D) Nuk ndikojnë aspak në proceset sociale

Pyetja 56

Cila është lidhja midis ankthit dhe procesit të vlerësimit të situatave sociale?

- A) Ankthi ul ndjeshmërinë ndaj kërcënimeve sociale
- B) Ankthi nuk ndikon në proceset e njohjes sociale
- C) Ankthi ndihmon në përpunimin më të shpejtë të informacionit social
- D) Ankthi rrit perceptimin e kërcënimeve në situata sociale

Pyetja 57

Si ndikon gjendja shpirtërore e ulët në ndërtimin e marrëdhënieve sociale?



- A) Rrit aftësinë për të ndërmarrë hapa të guximshëm në marrëdhënie
- B) Nxhit izolimin dhe zvogëlon dëshirën për ndërveprim
- C) Nuk ndikon në sjelljen sociale
- D) Përmirëson aftësinë për të kuptuar të tjerët

Pyetja 58

Çfarë është fenomeni i "vetë-përmbushjes" në kontekstin e depresionit?

- A) Përmbushja e pritshmërive negative për veten për shkak të mendimeve negative
- B) Prirja për të kërkuar situata pozitive
- C) Procesi i tejkalimit të sfidave emocionale
- D) Ndërtimi i një qëndrimi optimist ndaj jetës

Pyetja 59

Cili është një nga faktorët që ndihmon në tejkalimin e problemeve të njohjes sociale?

- A) Mbështetja sociale nga miqtë dhe familja
- B) Vetmia e qëllimshme
- C) Izolimi i zgjatur
- D) Fokusimi vetëm te mendimet negative

Pyetja 60

Çfarë përfshin koncepti i qëndrimeve?

- C) Rritja e efikasitetit profesional.
- D) Zhvillimi i aftësive të reja për menaxhimin e stresit.

Pyetja 93

Cila është rëndësia e përfshirjes së diversitetit në supervizim?

- A) Ignorimi i sfidave kulturore dhe gjinore.
- B) Sigurimi i qasjeve që respektojnë dhe përfshijnë të gjithë punonjësit.
- C) Kufizimi i mbështetjes vetëm për raste të veçanta.
- D) Fokusimi vetëm në një qasje standarde.

Pyetja 94

Cila është një nga mënyrat për të menaxhuar lodhjen emocionale?

- A) Ignorimi i shenjave të stresit.
- B) Krijimi i strategjive për t'u përballur me presionin dhe për të kërkuar mbështetje.
- C) Shmangia e bashkëpunimit me kolegët.
- D) Reduktimi i angazhimit profesional.

Pyetja 95

Cili është një nga qëllimet kryesore të mbajtjes së shënimeve në praktikën e punës sociale?

- A) Për të kufizuar transparencën në proces.
- B) Për të dokumentuar progresin dhe ndërhyrjet në mënyrë të organizuar.
- C) Për të shmangur analizën e detajuar të rasteve.
- D) Për të kufizuar komunikimin me klientët.

Pyetja 96

Cila është një nga sfidat e zgjidhjes së konflikteve përmes ndërmjetësimit?

- A) Fokusimi vetëm në interesat e njëjës palë.
- B) Gjetja e një zgjidhjeje që përmbush interesat e të gjitha palëve.
- C) Ignorimi i nevojave të përbashkëta të palëve.
- D) Kufizimi i bashkëpunimit mes palëve.

Pyetja 97

Cili është një nga rolet kryesore të supervizorit?

- A) Kufizimi i ndërveprimit me punonjësit socialë.
- B) Mbështetja dhe ndihma për të menaxhuar sfidat dhe për të zhvilluar aftësi.
- C) Fokusimi vetëm në monitorimin administrativ.
- D) Reduktimi i përfshirjes në çështje komplekse.

Pyetja 98

Cili është një nga efektet e diversitetit në zgjidhjen e rasteve?

- A) Kufizimi i aksesit në burime.
- B) Ndërtimi i strategjive gjithëpërfshirëse që adresojnë nevojat individuale.
- C) Fokusimi vetëm në nevojat e një grupi specifik.
- D) Shmangia e analizës së sfidave kulturore.

Pyetja 99

Cila është rëndësia e supervizimit në parandalimin e konsumimit profesional?

- A) Ignorimi i sfidave emocionale të punonjësve socialë.
- B) Sigurimi i mbështetjes dhe ndihmës për të menaxhuar presionin dhe stresin.
- C) Kufizimi i diskutimeve mbi shëndetin emocional.
- D) Fokusimi vetëm në përmbushjen e objektivave teknike.

#### **Kapitulli 4. Metoda dhe Shprehi të Punës me Familjet**

Pyetja 1

Cili është qëllimi kryesor i integritit të modeleve të praktikës?

- A) Të kufizojë qasjet vetëm në një model specifik
- B) Të krijojë një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin aspekte nga modele të ndryshme
- C) Të shmangë përdorimin e teorive ekzistuese
- D) Të eliminojë perspektivat individuale të praktikës

Pyetja 2

Cila është një nga veçoritë kryesore të perspektivës së sistemeve ekologjike?

- A) Ignorimi i ndërveprimeve midis individit dhe mjedisit
- B) Kufizimi i analizës në aspektin ekonomik
- C) Shmangia e faktorëve mjedisorë në analizë
- D) Fokusimi në marrëdhëniet e ndërsjella midis individëve dhe sistemeve

Pyetja 3

Si ndikon teoria e sistemeve në praktikën sociale?

- A) Ndihej në analizimin e ndërlkimeve dhe ndërveprimeve mes sistemeve të ndryshme
- B) Fokuson analizën vetëm te problemet personale
- C) Kufizon ndërveprimin mes individit dhe grupit
- D) Eliminon përdorimin e qasjeve të bazuara në mjedis

Pyetja 4

Cilat janë aplikimet jolineare të teorisë së sistemeve?

- A) Përqendrim vetëm në zgjidhjet afatshkurtra
- B) Strategji që ndjekin një strukturë lineare dhe të parashikueshme
- C) Qasje që pranojnë kompleksitetin dhe ndryshimet dinamike të sistemeve
- D) Ignorimi i marrëdhënieve ndërmjet sistemeve

Pyetja 5

Cila është një nga kufizimet e teorisë së sistemeve?

- A) Aftësia për të analizuar ndërveprimet komplekse.
- B) Fokusimi i tepruar në ndërveprimet pa adresuar individin.
- C) Përfshirja e shumë perspektivave të ndryshme.
- D) Ndhurma për të kuptuar dinamikat e grupeve.

#### Pyetja 6

Cili është ndikimi kryesor i perspektivës ekologjike në punën sociale?

- A) Reduktimi i analizës në kontekstin individual.
- B) Nxitja e kuptimit të ndërveprimeve komplekse mes klientëve dhe mjedisit të tyre.
- C) Ignorimi i faktorëve socialë në planifikimin e ndërhyrjeve.
- D) Përdorimi vetëm i analizave numerike për të trajtuar problemet.

#### Pyetja 7

Si kontribuon integrimi i modeleve në praktikën sociale?

- A) Kufizon përdorimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse
- B) Përqendrohet vetëm te një aspekt i problemit
- C) Ndhmon në zhvillimin e zgjidhjeve që marrin parasysh aspekte të ndryshme të problemeve
- D) Injoron diversitetin e perspektivave teorike

#### Pyetja 8

Cili është një aplikim praktik i teorisë së sistemeve?

- A) Analizimi i lidhjeve ndërmjet grupeve, individëve dhe strukturave më të gjera sociale
- B) Fokusimi te individi pa marrë parasysh mjedisin
- C) Kufizimi i ndërhyrjeve në nivelet mikro
- D) Shmangia e përdorimit të ndërveprimeve si bazë për analizë

#### Pyetja 9

Cila është një nga dobësitë e teorisë së sistemeve?

- A) Mundësia për të krijuar një qasje të personalizuar për klientët
- B) Fokusimi në një perspektivë të vetme teorike
- C) Kompleksiteti i analizimit të ndërlikimeve të sistemeve që mund të jetë sfidues për zbatimin praktik
- D) Kufizimi i përdorimit të teorive ekologjike në analizë

#### Pyetja 10

Cili është roli i aplikimeve jolineare të teorisë së sistemeve në praktikën sociale?

- A) Shmangia e ndërlikimeve në ndërveprimet sociale
- B) Kufizimi i analizave vetëm në nivelet lineare
- C) Fokusimi ekskluzivisht në zgjidhjet e menjëhershme
- D) Pranimi dhe adaptimi ndaj dinamikave të vazhdueshme dhe të paparashikueshme të sistemeve

#### Pyetja 11

Çfarë përfaqëson homeostaza në sistemet familjare?

- A) Një prirje për të shmangur ndryshimin
- B) Një mekanizëm për ruajtjen e ekuilibrit në rast të çrregullimeve

- C) Një strukturë e pandryshueshme e rregullave
- D) Një tendencë për të eliminuar kufijtë familjarë

Pyetja 12

Cilat janë disa nga rregullat disfunkcionale që ndikojnë negativisht në familje?

- A) Krijimi i rregullave të paqarta ose kontradiktore
- B) Mbështetja e hapur e të gjitha ideve të anëtarëve të familjes
- C) Përkrahja e fleksibilitetit dhe ndryshimeve të shëndetshme
- D) Eliminimi i rregullave të ngurta në vendimet familjare

Pyetja 13

Si ndikon fleksibiliteti i rregullave në funksionimin e familjes?

- A) Përmirëson aftësinë për t'u përshtatur me ndryshimet
- B) Krijon konflikte mes anëtarëve të familjes
- C) Kufizon ndërveprimin midis grupeve familjare
- D) Eliminon strukturën e rregullave

Pyetja 14

Cili është qëllimi i një kuadri sistemik për të vlerësuar funksionimin e familjes?

- A) Shmangia e analizës së ndërveprimeve të familjes
- B) Të fokusohet vetëm në aspektet ekonomike të familjes
- C) Të identifikojë dinamikat dhe marrëdhëniet që ndikojnë në funksionimin familjar
- D) Të eliminojë ndërveprimet emocionale

Pyetja 15

Si ndikon struktura e pushtetit në vendimet familjare?

- A) Duke kufizuar përfshirjen e disa anëtarëve
- B) Duke përjashtuar anëtarët e rinj nga proceset vendimmarrëse
- C) Duke minimizuar ndërlikimet e marrëdhënieve
- D) Duke përcaktuar mënyrën se si ndahen përgjegjësitë dhe autoriteti

Pyetja 16

Cilat janë disa nga mënyrat për të ruajtur kufijtë në sistemet familjare?

- A) Duke vendosur kufij të qartë, por fleksibël për ndërveprimet familjare
- B) Duke injoruar nevojat e anëtarëve të ndryshëm
- C) Duke eliminuar kufijtë e tërësishëm në vendimet familjare
- D) Duke kufizuar ndërveprimet vetëm brenda familjes

Pyetja 17

Cila është rëndësia e pikave të forta të familjes në funksionimin e saj?

- A) Për të kufizuar proceset vendimmarrëse
- B) Për të ndihmuar familjen të përballojë sfidat dhe stresuesit
- C) Për të shmangur analizën e funksionimit të sistemit
- D) Për të reduktuar rolin e kufijve të familjes

Pyetja 18

Si ndikon ndërveprimi në nivel përmbajtjeje dhe procesi në dinamikat familjare?

- A) Duke eliminuar nevojën për marrëdhënie të strukturuar

- B) Duke ndihmuar në kuptimin e mesazheve të shprehura dhe të nënkuptuara
- C) Duke kufizuar analizën vetëm në nivel emocional
- D) Duke përjashtuar proceset kognitive në marrëdhënie

Pyetja 19

Çfarë përfaqëson vlerësimi i problemeve duke përdorur modelin sistematik?

- A) Një analizë e kufizuar vetëm në nivelin individual
- B) Një strategji për të shmangur adresimin e problemeve komplekse
- C) Një metodë për të kufizuar ndërveprimet e familjes me mjedisin
- D) Një qasje që fokusohet te ndërveprimet dhe ndërlikimet mes sistemeve të familjes

Pyetja 20

Cilat janë disa nga stilet e komunikimit që ndikojnë në marrëdhëniet familjare?

- A) Komunikimi pasiv dhe shmangës
- B) Mungesa e sinjalizimit të ndjenjave
- C) Komunikimi i qartë dhe i hapur
- D) Injorimi i mesazheve të tërthorta

Pyetja 21

Cili është roli i kufijve të qartë në sistemet familjare?

- A) Për të ndihmuar në ruajtjen e një ekuilibri të shëndetshëm midis afërsisë dhe autonomisë
- B) Për të kufizuar ndërveprimet midis anëtarëve
- C) Për të përjashtuar anëtarët nga proceset familjare
- D) Për të shmangur ndryshimet në strukturën familjare

Pyetja 22

Si ndikon fleksibiliteti i rregullave në adaptimin e familjes ndaj sfidave?

- A) Duke lehtësuar përballimin e situatave të reja dhe të paparashikuara
- B) Duke kufizuar aftësinë për të ndryshuar
- C) Duke eliminuar rolet tradicionale familjare
- D) Duke ndaluar ndërveprimet e anëtarëve gjatë krizave

Pyetja 23

Çfarë përfaqëson ndërveprimi në nivel përmbajtjeje dhe procesi?

- A) Fokusimi vetëm te mesazhet e shprehura
- B) Një prirje për të injoruar kontekstin e ndërveprimeve
- C) Një qasje lineare për vlerësimin e komunikimit
- D) Analiza e mesazheve të shprehura dhe të nënkuptuara që ndihmojnë në kuptimin e marrëdhënieve

Pyetja 24

Cili është një nga dimensionet e vlerësimit të familjes?

- A) Ignorimi i kontekstit kulturor të familjes
- B) Përqendrimi vetëm te problemet individuale të anëtarëve
- C) Analiza e strukturës, funksionimit dhe kufijve të familjes
- D) Mënjanimi i ndikimit të kontekstit shoqëror në familje

Pyetja 25

Cilat janë disa nga mitet që mund të ndikojnë në marrëdhëniet familjare?

- A) Besimet e bazuara në realitet
- B) Besimet e paqarta ose të pasakta që mund të kufizojnë funksionimin e shëndetshëm të familjes
- C) Rregullat që ndihmojnë në ndërtimin e komunikimit të hapur
- D) Traditat që forcojnë marrëdhëniet ndërpersonale

Pyetja 26

Cili është ndikimi i strukturës së pushtetit në funksionimin e familjes?

- A) Përmirëson proceset vendimmarrëse dhe ruan një ekuilibër të shëndetshëm
- B) Eliminon përfshirjen e anëtarëve të vegjël në vendimmarrje
- C) Kufizon autoritetin e anëtarëve kryesorë të familjes
- D) Përqendron gjithë pushtetin vetëm në një individ

Pyetja 27

Cila është rëndësia e analizimit të ciklit jetësor të familjes?

- A) Për të shmangur ndryshimet gjatë tranzicioneve
- B) Për të kuptuar dhe menaxhuar ndryshimet që ndodhin në faza të ndryshme të jetës familjare
- C) Për të injoruar ndikimin e krizave gjatë fazave të ndryshme
- D) Për të reduktuar rëndësinë e ndryshimeve sociale

Pyetja 28

Cilat janë disa nga rolet që mund të krijohen brenda një familjeje?

- A) Rolet që ndihmojnë vetëm në përmbushjen e nevojave individuale
- B) Rolet që përforcojnë funksionimin dhe strukturën familjare
- C) Rolet që eliminojnë bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve të familjes
- D) Rolet që fokusohen vetëm në aspekte ekonomike

Pyetja 29

Cilat janë disa nga sfidat që lidhen me fleksibilitetin e kufijve në familje?

- A) Mbajtja e kufijve shumë të ngurtë që kufizojnë ndërveprimet
- B) Krijimi i kufijve të paqarta që shkaktojnë konflikte
- C) Fokusimi vetëm në një aspekt të marrëdhënieve familjare
- D) Ruajtja e balancës midis hapjes dhe autonomisë

Pyetja 30

Cila është rëndësia e stileve të komunikimit në ruajtjen e marrëdhënieve familjare?

- A) Komunikimi pasiv që shmang konfliktet
- B) Mungesa e komunikimit të rregullt
- C) Përdorimi i komunikimit joefektiv që krijon keqkuptime
- D) Komunikimi i hapur dhe i qartë që përforcon marrëdhëniet

Pyetja 31

Cili është ndikimi i kufijve në sistemet familjare?

- A) Krijimi i strukturave të ngurta që pengojnë ndryshimin

- B) Kufizimi i autonomisë së anëtarëve
- C) Sigurimi i stabilitetit dhe mbrojtja e marrëdhënieve
- D) Rritja e varësisë mes anëtarëve të familjes

Pyetja 32

Çfarë karakterizon një rregull disfunktionale në një familje?

- A) Kufizon mundësitë për zgjedhje dhe zhvillim
- B) Ndhmon anëtarët të përshtaten me mjedisin
- C) Përforcon pikat e forta të familjes
- D) Promovon zgjidhjen e konflikteve

Pyetja 33

Cili është roli i pushtetit në vendimmarrjen familjare?

- A) Rritja e pabarazisë midis anëtarëve të familjes
- B) Sigurimi i udhëheqjes efektive dhe drejtësisë
- C) Kufizimi i komunikimit brenda familjes
- D) Shmangia e konfliktit përmes autoritetit të ngurtë

Pyetja 34

Cili është një shembull i një mjeti sistemik për vlerësimin e familjes?

- A) Genograma dhe ekoharta
- B) Rregullat dhe zakonet kulturore
- C) Mungesa e rregullave të qarta
- D) Përdorimi i miteve tradicionale

Pyetja 35

Çfarë ndihmon në rregullimin e homeostazës familjare?

- A) Ndryshimet e papritura në strukturën familjare
- B) Mekanizmat për ruajtjen e ekuilibrit
- C) Ignorimi i stresorëve të jashtëm
- D) Përjashtimi i anëtarëve që krijojnë konflikte

Pyetja 36

Cila është rëndësia e fleksibilitetit në rregullat familjare?

- A) Përforcon stabilitetin pa ndryshime
- B) Kufizon mundësitë për ndryshime
- C) Ndhmon familjen të përshtatet me situata të reja
- D) Nxiti rezistencën ndaj stresorëve të jashtëm

Pyetja 37

Çfarë përfaqëson një pikë e fortë e një familjeje?

- A) Mbështetja emocionale ndërmjet anëtarëve
- B) Struktura hierarkike e ngurtë
- C) Ruajtja e traditave të papërpunuara
- D) Ndikimi minimal i rrjeteve sociale



Pyetja 38

Çfarë roli luajnë mitet në funksionimin familjar?

- A) Kufizojnë zhvillimin e anëtarëve të rinj
- B) Mbështeten në perceptime të paqarta
- C) Janë thelbësore për zgjidhjen e konflikteve familjare
- D) Përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve

Pyetja 39

Cili është një shembull i përdorimit të teorisë rrethore në vlerësimin familjar?

- A) Fokusimi në një shkak linear të problemit
- B) Ignorimi i ndërveprimeve reciproke
- C) Ndikimi i sjelljeve të një anëtari mbi të gjithë familjen
- D) Shmangia e analizës së kontekstit familjar

Pyetja 40

Cila është një mënyrë për të thyer një rregull disfunktionale familjare?

- A) Përsëritja e rregullave të nënkuptuara
- B) Komunikimi i hapur dhe i drejtpërdrejtë
- C) Ignorimi i sjelljeve të reja
- D) Shmangia e ndërveprimeve

Pyetja 41

Çfarë përfshin një ndërveprim në nivel përmbajtjeje në familje?

- A) Diskutimet për tema të zakonshme si ushqimi ose detyrat
- B) Proceset e lidhura me emocionet dhe marrëdhëniet
- C) Analizën e konflikteve të brendshme familjare
- D) Përshtatjen e rregullave ekzistuese

Pyetja 42

Cili është ndikimi i një sekuence të përsëritur ndërveprimi në familje?

- A) Krijimi i një mjedisi kaotik
- B) Ruajtja e modeleve të njohura të sjelljes
- C) Promovimi i konflikteve të vazhdueshme
- D) Zhvillimi i marrëdhënieve të reja

Pyetja 43

Si ndikon ndërveprimi i sistemeve më të mëdha në funksionimin e familjes?

- A) Rrit autonominë e anëtarëve
- B) Redukton ndikimet e brendshme
- C) Kufizon zhvillimin emocional të familjes
- D) Ofron mbështetje dhe burime për familjen

Pyetja 44

Cili nga këta elementë është një dimension i vlerësimit të familjes?

- A) Shkëputja nga rrjetet sociale
- B) Ignorimi i problemeve të vogla
- C) Shmangia e ndërhyrjeve profesionale
- D) Konteksti kulturor dhe social

Pyetja 45

Cili nga këta është një stresues i zakonshëm familjar?

- A) Zhvillimi i marrëdhënieve të reja brenda familjes
- B) Përdorimi i modeleve të funksionimit të hapur
- C) Kufizimet financiare dhe burimet e pamjaftueshme
- D) Zbatimi i një sistemi të fortë mbështetjeje

Pyetja 46

Si ndihmojnë kufijtë në ruajtjen e një sistemi familjar?

- A) Kufizojnë ndërveprimet brenda familjes
- B) Ofrimin e mbrojtjes nga ndikimet e jashtme
- C) Reduktojnë mundësitë për ndryshim
- D) Përforcojnë strukturat e ngurta

Pyetja 47

Cila është rëndësia e genogramës në vlerësimin familjar?

- A) Analizon ndërveprimet mes anëtarëve
- B) Identifikon modelet historike të familjes
- C) Përjashton ndikimet e jashtme
- D) Kufizon vlerësimin në një periudhë të shkurtër

Pyetja 48

Cili është roli i një rregulli funksionale në një sistem familjar?

- A) Ndihmon familjen të përshtatet me ndryshimet
- B) Kufizon zhvillimin personal të anëtarëve
- C) Promovon konflikte dhe tensione
- D) Redukton mundësitë për eksplorim

Pyetja 49

Cila është rëndësia e përdorimit të një kuadri sistemik në vlerësimin e familjes?

- A) Ignoron ndikimet e sistemeve të tjera
- B) Fokuson vetëm problemet individuale
- C) Eliminon ndërlikimet e ndërveprimeve familjare
- D) Analizon marrëdhëniet brenda dhe jashtë familjes

Pyetja 50

Çfarë përfshin fokusimi tek ndryshimi gjatë seancës fillestare me një familje?

- A) Identifikimin e nevojave për ndihmë ekonomike
- B) Diskutimin e historisë familjare
- C) Ndërtimin e një plani për ndryshim të sjelljeve
- D) Krijimin e një genograme familjare

Pyetja 51

Cili është qëllimi i modifikimit të rregullave familjare disfunktionale?

- A) Ruajtja e status quo-së së familjes
- B) Përmirësimi i fleksibilitetit të sistemit familjar
- C) Mbështetja e sjelljeve të kaluara

D) Ndërtimi i një hierarchie të re në familje

Pyetja 52

Cilat janë strategjitë kryesore për të modifikuar ndërveprimet disfunktionale?

- A) Përdorimi i metakomunikimit
- B) Shmangia e ndërhyrjes në konfliktet familjare
- C) Fokusi vetëm tek anëtarët më të dobët
- D) Shmangia e feedback-ut nga klientët

Pyetja 53

Si ndihmon edukimi mbi feedback-un pozitiv në përmirësimin e marrëdhënieve?

- A) Redukton konfliktet përmes injorimit të problemeve
- B) Forcon komunikimin dhe besimin midis anëtarëve
- C) Ndihmon vetëm në situata të caktuara të krizës
- D) Kufizon hapësirën për gabime në komunikim

Pyetja 54

Si mund të përdoret metakomunikimi për të adresuar konfliktet familjare?

- A) Duke shmangur përfshirjen e të gjithë anëtarëve
- B) Duke përmirësuar ndërveprimet përmes komunikimit të hapur
- C) Duke fokusuar komunikimin vetëm tek lideri i familjes
- D) Duke promovuar rregulla të rrepta dhe të pandryshueshme

Pyetja 55

Cili është roli i modifikimit të keqkuptimeve në familje?

- A) Forcon konfliktet për të nxjerrë në pah problemet
- B) Ndihmon në riorganizimin e strukturës së pushtetit
- C) Nxist reflektimin dhe komunikimin konstruktiv
- D) Redukton bashkëpunimin në zgjidhjen e problemeve

Pyetja 56

Si ndikon ndryshimi i ndërveprimeve disfunktionale komplementare në familje?

- A) Riorganizon grupimet ekzistuese në mënyrë të pakontrolluar
- B) Rrit varësinë ndërmjet anëtarëve të familjes
- C) Përmirëson barazinë dhe fleksibilitetin në marrëdhënie
- D) Forcon strukturat e pushtetit të pabarabartë

Pyetja 57

Cila është mënyra më efektive për të ndihmuar klientët të tërhiqen nga konflikti?

- A) Duke inkurajuar anashkalimin e çështjeve të vështira
- B) Duke detyruar një ndryshim të menjëhershëm në sjellje
- C) Duke reduktuar komunikimin ndërmjet palëve të konfliktuara
- D) Duke lehtësuar shprehjen e ndjenjave në mënyrë të kontrolluar

Pyetja 58

Çfarë nënkupton negocimi i marrëveshjeve për ndryshime reciproke?

- A) Ndërtimin e një sistemi të barabartë për dhënie dhe marrje

- B) Përforcimin e rregullave ekzistuese të ngurta
- C) Shmangien e plotë të konfrontimeve direkte
- D) Injorimin e dallimeve midis anëtarëve të familjes

Pyetja 59

Si ndihmojnë detyrat që forcojnë marrëdhëniet në riorganizimin e grupimeve familjare?

- A) Duke zvogëluar përfshirjen emocionale të anëtarëve
- B) Duke krijuar hapësirë për bashkëpunim dhe ndarje të përgjegjësiave
- C) Duke mbështetur veçanërisht anëtarët më të dobët
- D) Duke promovuar izolimin e anëtarëve problematikë

Pyetja 60

Çfarë përfshin perspektiva e sistemeve ekologjike në vlerësimin e familjeve?

- A) Fokusimi tek individit dhe roli i tij në familje
- B) Analiza e ndërveprimeve midis individit dhe mjedisit të tij
- C) Kufizimi i ndërhyrjeve vetëm tek problemet e brendshme të familjes
- D) Përcaktimi i rregullave të detyrueshme për familjet

Pyetja 61

Cili është një avantazh i madh i perspektivës së sistemeve ekologjike?

- A) Përcaktimi i strukturave të pushtetit në familje
- B) Kufizimi i ndërveprimeve tek familja nukleare
- C) Aftësia për të përfshirë variabla komplekse të ndërveprimit njerëzor
- D) Rritja e autonomisë së anëtarëve të familjes përtej kufijve të sistemit

Pyetja 62

Cila është një pikë e dobët në përdorimin e metateorisë së ekosistemeve?

- A) Kufizimi i analizës në rregullat e jashtme të familjes
- B) Fokusimi vetëm tek marrëdhëniet brenda çiftit
- C) Mospërfshirja e faktorëve kulturorë dhe socialë
- D) Mungesa e një kuadri për ndërhyrje specifike

Pyetja 63

Si aplikohen konceptet e konstruksionizmit social në praktikën me familjet?

- A) Duke vlerësuar mënyrën si familjet ndërtojnë kuptimin e tyre për botën
- B) Duke vendosur rregulla fikse për zgjidhjen e konflikteve
- C) Duke ndarë anëtarët e familjes në role të përcaktuara qartë
- D) Duke eliminuar ndikimet e mjedisit nga analiza

Pyetja 64

Cili është një kufizim i metateorisë së konstruksionizmit social?

- A) Dështimi për të ofruar udhëzime të qarta për ndërhyrje
- B) Ignorimi i ndikimit të historisë dhe kulturës
- C) Mungesa e një qasjeje për të vlerësuar familjet si sisteme të hapura
- D) Fokusimi vetëm tek dinamika e konflikteve

Pyetja 65

Si krahasohen perspektiva e sistemeve ekologjike dhe ajo e konstruksionizmit social?

- A) Të dyja nënvlerësojnë ndikimin e rregullave familjare
- B) Perspektiva ekologjike është më strukturuese, ndërsa konstruksionizmi është më fleksibil
- C) Të dyja fokusohen vetëm në problemet brenda njësisë familjare
- D) Perspektiva e konstruksionizmit social përjashton faktorët mjedisorë

Pyetja 66

Si mund të integrohen metateoritë e ekosistemeve dhe konstruksionizmit social?

- A) Duke përdorur analizën e marrëdhënieve dhe ndikimit të mjedisit në mënyrë të koordinuar
- B) Duke eliminuar çdo ndikim kulturor nga analiza
- C) Duke kufizuar ndërhyrjet tek familjet në nivele të larta të nevojave
- D) Duke përjashtuar përdorimin e genogramës dhe ekohartës në vlerësim

Pyetja 67

Cili është përfitimi i integritit të këtyre dy metateorive në praktikën me familjet?

- A) Nxitja e konflikteve për të nxjerrë problemet në pah
- B) Sigurimi i një kuadri gjithëpërfshirës për vlerësimin dhe ndërhyrjen
- C) Kufizimi i qasjes vetëm në sistemet sociale të mbyllura
- D) Eliminimi i rregullave familjare të nënkuptuara nga analiza

Pyetja 68

Si mund të përfitohet nga fleksibiliteti i konstruksionizmit social në punën me familjet?

- A) Duke shmangur trajtimin e ndikimeve të mjedisit
- B) Duke vlerësuar mënyrën si anëtarët e familjes ndërtojnë realitetin e tyre
- C) Duke vendosur rregulla të ngurta për marrëdhëniet familjare
- D) Duke kufizuar ndërveprimet në çiftet martesorë

Pyetja 69

Cili është një element kritik në përdorimin e teorisë ekologjike për të vlerësuar familjet?

- A) Kufizimi i ndërveprimeve tek individët më të dobët të familjes
- B) Fokusimi vetëm në strukturat formale të familjes
- C) Përcaktimi i të gjitha rregullave si disfunktionale
- D) Analiza e sistemeve që ndërveprojnë me familjen në mjedisin e saj më të gjerë

Pyetja 70

Çfarë karakterizon familjet në Nivelin I të nevojave?

- A) Kanë nevojë për ndërhyrje të avancuara terapeutike
- B) Janë të përfshira në konflikte të thella ndërpersonale
- C) Kanë nevoja bazë dhe kërkojnë mbështetje minimale
- D) Kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme për të shmangur rrezikun

Pyetja 71

Cilat janë nevojat kryesore të familjeve në Nivelin II?

- A) Ndihmë për të adresuar stresin e shkaktuar nga varfëria
- B) Mbështetje për përballimin e traumave të mëdha
- C) Krijimi i lidhjeve me komunitetin dhe burimet lokale
- D) Ndërhyrje për të ndryshuar strukturat e pushtetit brenda familjes

Pyetja 72

Si ndryshojnë familjet në Nivelin III nga ato në Nivelin II?

- A) Familjet në Nivelin III kanë nevoja më të thella emocionale dhe terapeutike
- B) Familjet në Nivelin III kërkojnë më shumë ndihmë ekonomike
- C) Familjet në Nivelin III janë të vetë-mjaftueshme dhe nuk kërkojnë ndërhyrje
- D) Familjet në Nivelin III përballen me rrezik të menjëhershëm për integritetin e tyre

Pyetja 73

Cili është fokusi kryesor i ndërhyrjeve për familjet në Nivelin IV?

- A) Ndihma për të zgjidhur problemet e përditshme
- B) Menaxhimi i krizave që kërcënojnë stabilitetin familjar
- C) Forcimi i marrëdhënieve ndërmjet anëtarëve të familjes
- D) Përdorimi i metodave edukative për zhvillimin e aftësive të reja

Pyetja 74

Cilat kritere duhet të përdoren për të përcaktuar nivelin e ndërhyrjes për një familje?

- A) Numri i anëtarëve të familjes që përfshihen në problem
- B) Gjatësia e kohës që familja ka përjetuar një problem
- C) Thellësia dhe urgjenca e nevojave të familjes
- D) Mbështetja financiare e ofruar nga jashtë

Pyetja 75

Cili është qëllimi kryesor i ndërhyrjeve për familjet në Nivelin II?

- A) Përcaktimi i strategjive afatgjata për zhvillim personal
- B) Lidhja e familjes me burime të reja mbështetëse
- C) Ndryshimi i modeleve të sjelljeve të dëmshme në familje
- D) Ofrimi i trajtimit intensiv terapeutik

Pyetja 76

Si përcaktohet një ndërhyrje e suksesshme për familjet në Nivelin IV?

- A) Kur familja rikthehet në gjendjen e mëparshme të funksionimit
- B) Kur kriza eliminohet dhe sigurohet mbështetje afatgjatë
- C) Kur anëtarët e familjes zhvillojnë aftësi të reja të pavarura
- D) Kur ndërhyrja përfundon pa nevojë për mbështetje shtesë

Pyetja 77

Cila është sfida kryesore në punën me familjet në Nivelin III?

- A) Krijimi i një ambienti të sigurt emocional dhe fizik
- B) Sigurimi i mbështetjes financiare afatgjatë
- C) Menaxhimi i konflikteve ndërmjet anëtarëve të familjes
- D) Reduktimi i varësisë së familjes nga ndërhyrjet institucionale

Pyetja 78

Çfarë përfshihet në kriteret e ndërhyrjes për familjet në Nivelin I?

- A) Ndërhyrje minimale për të përmirësuar funksionimin bazë
- B) Mbështetje e thellë psikologjike dhe emocionale
- C) Ndryshime strukturore në organizimin familjar

D) Përdorimi i qasjeve të bazuara në traumë

Pyetja 79

Cili është objektivi kryesor i ndërhyrjeve për familjet në Nivelin II?

- A) Stabilizimi i funksionimit të përditshëm të familjes
- B) Trajtimi i problematikave të rënda emocionale
- C) Ndryshimi i rregullave disfunktionale në familje
- D) Forcimi i lidhjeve ndërpersonale brenda familjes

Pyetja 80

Cilat janë nevojat tipike të familjeve të Nivelit I?

- A) Mbështetje për zgjidhjen e konflikteve komplekse
- B) Ndihmë për të përmbushur nevojat bazë dhe stabilitet minimal
- C) Ndërhyrje për të menaxhuar traumën e thellë
- D) Përkrahje për përmirësimin e aftësive të prindërimit

Pyetja 81

Cili është qëllimi kryesor i trajtimit për familjet në Nivelin I?

- A) Përmirësimi i strukturës së pushtetit në familje
- B) Sigurimi i nevojave bazë dhe rikthimi i funksionimit minimal
- C) Krijimi i një plani afatgjatë për zhvillimin e familjes
- D) Ndryshimi i perceptimeve dhe keqkuptimeve në familje

Pyetja 82

Çfarë përfshin modeli i trajtimit për familjet e Nivelit I?

- A) Ndërhyrje të thella terapeutike për përmirësimin emocional
- B) Riorganizimi i roleve brenda familjes për barazi
- C) Aplikimi i teknikave për stabilitet minimal dhe lidhje me shërbimet
- D) Përqendrim vetëm tek ndihma financiare

Pyetja 83

Cili është hapi i parë në menaxhimin e rastit për një familje?

- A) Monitorimi i shërbimeve të ofruara
- B) Krijimi i një plani për ndërhyrje terapeutike
- C) Vlerësimi i burimeve financiare të familjes
- D) Ndërtimi i marrëdhënieve midis profesionistit dhe familjes

Pyetja 84

Cili është përfitimi kryesor i plotësimit të një vlerësimi të përgjithshëm të familjes?

- A) Krijimi i një raporti zyrtar për shërbimet sociale
- B) Riorganizimi i roleve brenda strukturës familjare
- C) Ndryshimi i dinamikave të pushtetit në familje
- D) Identifikimi i burimeve dhe nevojave ekzistuese të familjes

Pyetja 85

Cili është qëllimi i lidhjes së klientëve me shërbimet?

- A) Sigurimi i mbështetjes për të zgjidhur problemet afatshkurtra
- B) Zvogëlimi i varësisë së familjes nga shërbimet sociale

- C) Forcimi i pavarësisë dhe krijimi i stabilitetit afatgjatë
- D) Përmirësimi i komunikimit ndërmjet anëtarëve të familjes

Pyetja 86

Cila është roli i advokasisë në menaxhimin e rastit për familjet?

- A) Ofrimi i ndihmës për të adresuar konflikte brenda familjes
- B) Përfaqësimi i interesave të familjes dhe lehtësimi i aksesit në shërbime
- C) Monitorimi i vazhdueshëm i përparimit të familjes
- D) Edukimi i familjes për rregullat dhe normat shoqërore

Pyetja 87

Si mund të vlerësohet efektiviteti i ndërhyrjeve në Nivelin I?

- A) Duke krahasuar rezultatet me qëllimet e vendosura
- B) Duke numëruar sesionet e përfunduara me familjen
- C) Duke përqendruar vëmendjen tek përmirësimet individuale
- D) Duke analizuar vetëm rezultatet afatgjata

Pyetja 88

Cila është një teknikë e rëndësishme për monitorimin e shërbimeve në menaxhimin e rasteve?

- A) Ofrimi i ndihmës së menjëhershme pa krijuar plane afatgjata
- B) Rishikimi i progresit dhe përshtatja e ndërhyrjeve sipas nevojave
- C) Ndryshimi i gjithë strukturës së sistemit social të familjes
- D) Kufizimi i ndërhyrjeve vetëm në problemet emergjente

Pyetja 89

Cila është karakteristika kryesore e një plani të suksesshëm të rastit?

- A) Planifikimi i detyrave të thjeshta për t'u ndjekur
- B) Përdorimi i metodave të njëtrajtshme për të gjitha familjet
- C) Kufizimi i fokusit tek përmbushja e nevojave bazë
- D) Përfshirja e burimeve të brendshme dhe të jashtme të familjes

Pyetja 90

Çfarë karakterizon vlerësimin në nivelin e nevojave të familjes?

- A) Analiza vetëm e sfidave ekonomike të familjes
- B) Fokusi tek dinamika ndërmjet prindërve dhe fëmijëve
- C) Krijimi i një genograme për të identifikuar problemet
- D) Përcaktimi i burimeve dhe kufizimeve të familjes në mënyrë holistike

Pyetja 91

Cili është qëllimi kryesor i trajtimit për familjet në nivelet e ndryshme të nevojave?

- A) Stabilizimi i funksionimit dhe forcimi i pavarësisë së familjes
- B) Përcaktimi i roleve tradicionale për çdo anëtar të familjes
- C) Eliminimi i ndërveprimeve ndërmjet familjes dhe mjedisit të jashtëm
- D) Ndërtimi i një strukture të re autoritare për familjen



Pyetja 92

Si përcaktohet modeli i ndërhyrjes për një familje në Nivelin III?

- A) Me fokus vetëm në nevojat afatgjata të stabilitetit ekonomik
- B) Me një kombinim të trajtimit terapeutik dhe lidhjes me burime mbështetëse
- C) Me ndërhyrje minimale për të lehtësuar problemet emergjente
- D) Me përdorimin e një qasjeje uniforme për të gjitha rastet

Pyetja 93

Cili është një element kyç i vlerësimit në modelin e ndërhyrjes?

- A) Vlerësimi i vetëm një aspekti të jetës së familjes për të kursyer kohë
- B) Analiza e sistemeve të brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në familje
- C) Përcaktimi i rolit të liderit të familjes në zgjidhjen e problemeve
- D) Përqendrimi tek eliminimi i konflikteve ndërmjet brezave

Pyetja 94

Cili është përfitimi kryesor i një modeli integruar të ndërhyrjes?

- A) Rritja e varësisë së familjes ndaj institucioneve mbështetëse
- B) Kufizimi i ndërhyrjeve vetëm në fazën fillestare të krizës
- C) Sigurimi i ndërhyrjeve të personalizuar që përputhen me nivelin e nevojave
- D) Vendosja e rregullave të pandryshueshme për të gjitha familjet

Pyetja 95

Cilat janë nevojat tipike të familjeve në Nivelin III?

- A) Mbështetje për të përmbushur nevojat bazë
- B) Përkrahje për ndryshimin e perceptimeve sociale
- C) Ndërhyrje terapeutike për menaxhimin e konflikteve komplekse
- D) Përcaktimi i burimeve financiare

Pyetja 96

Çfarë përfshin "Pyetja e mrekullisë" në Terapinë e Fokusuar tek Zgjidhja (TFZ)?

- A) Përcaktimi i burimeve për trajtimin ekonomik
- B) Analiza e ndërveprimeve negative brenda familjes
- C) Identifikimi i përgjegjësive të secilit anëtar të familjes
- D) Imagjinimi i një situatë ku problemi nuk ekziston më

Pyetja 97

Cila është rëndësia e qasjes "Gota është gjysmë plot" në TFZ?

- A) Përqendrimi tek burimet dhe pikat e forta të familjes
- B) Fokusi tek zgjidhja e problemeve financiare
- C) Theksimi i nevojës për ndërhyrje të menjëhershme
- D) Analiza e konflikteve ndërpersonale

Pyetja 98

Cila është baza teorike e përdorimit të "Pyetjes së shkallëzimit" në TFZ?

- A) Krijimi i një strukture të ngurtë për familjen
- B) Ndhurma për të identifikuar progresin dhe hapat e mëtejshëm
- C) Përqendrimi tek ndërveprimet brenda familjes nukleare

D) Përjashtimi i elementeve emocionale nga vlerësimi

Pyetja 99

Cili është qëllimi i përdorimit të "Situatave hipnotike" në TFZ?

- A) Reduktimi i stresit përmes qasjeve të bazuara në relaksim
- B) Krijimi i një ndjesie të ndryshimit dhe mundësive të reja
- C) Analiza e ndërveprimeve sociale të familjes
- D) Fokusi tek roli i liderit të familjes

Pyetja 100

Cila është rëndësia e pyetjeve rrethore në vlerësimin e familjeve?

- A) Përqendrimi tek ndërveprimet ndërmjet individëve dhe sistemeve
- B) Identifikimi i problemeve financiare të familjes
- C) Eliminimi i perceptimeve të shtrembëruara
- D) Kufizimi i analizës në marrëdhëniet ndërpersonale

Pyetja 101

Çfarë synon të arrijë teknika "Normalizimi" në TFZ?

- A) Zvogëlimin e ndjenjës së izolimit duke theksuar përvojat e përbashkëta
- B) Kufizimin e qasjes vetëm tek anëtarët më të dobët të familjes
- C) Ndërtimin e një strukture rigoroze për zgjidhjen e konflikteve
- D) Shmangien e çdo ndërhyrjeje emocionale

Pyetja 102

Cila është rëndësia e përdorimit të "Skuadrës" në TFZ?

- A) Përcaktimi i përgjegjësive të liderëve të familjes
- B) Fokusimi tek një anëtar i vetëm për të adresuar problemet
- C) Rritja e koordinimit ndërmjet profesionistëve për zgjidhjen e rastit
- D) Analiza e burimeve financiare të familjes

Pyetja 103

Cila është teknika e përdorimit të "Detyrave formulë" në TFZ?

- A) Krijimi i një strukture të ngurtë për të gjithë familjen
- B) Fokusi tek eliminimi i konflikteve afatshkurtra
- C) Analiza e burimeve financiare dhe logjistike
- D) Ofrimi i udhëzimeve praktike për përmirësimin e situatës

Pyetja 104

Cila është rëndësia e gjuhës në TFZ sipas konceptit "Gjuha ndërton realitetin"?

- A) Përcaktimi i roleve tradicionale të familjes
- B) Ndihma për të krijuar një narrativë pozitive dhe të mundshme
- C) Kufizimi i fokusit tek problemet ekzistuese
- D) Eliminimi i elementeve kulturore nga analizat

Pyetja 105

Cili është thelbi i perspektivës shumëbrezëshe në trajtimin e familjeve?

- A) Fokusimi tek brezi i tanishëm pa analizuar të kaluarën

- B) Analiza e marrëdhënieve financiare midis brezave
- C) Krijimi i një sistemi të izoluar brenda familjes
- D) Identifikimi i modeleve të përsëritura të sjelljeve dhe ndërveprimeve ndër breza

Pyetja 106

Çfarë përfshin koncepti i "diferencimit të vetes"?

- A) Aftësia për të krijuar pavarësi emocionale nga familja e origjinës
- B) Distancimi i plotë nga marrëdhëniet ndërpersonale
- C) Fokusimi vetëm tek zgjidhja e konflikteve të përkohshme
- D) Përqendrimi tek modelet financiare të familjes

Pyetja 107

Cili është roli i trekëndëshave në sistemin emocional të familjes?

- A) Rritja e tensionit duke përfshirë një person të tretë
- B) Krijimi i konflikteve të reja brenda familjes
- C) Stabilizimi i marrëdhënieve përmes ndarjes së tensioneve
- D) Reduktimi i komunikimit midis dy anëtarëve

Pyetja 108

Si ndikon ankthi në funksionimin e sistemit emocional të familjes nukleare?

- A) Zvogëlon ndërveprimet midis anëtarëve të familjes
- B) Përmirëson komunikimin ndërmjet anëtarëve të familjes
- C) Shmang çdo lloj ndërveprimi emocional
- D) Rrit presionin emocional dhe krijon modelet e sjelljeve të pashëndetshme

Pyetja 109

Çfarë nënkupton "projeksioni prindëror"?

- A) Transferimin e konflikteve të prindërve tek njëri-tjetri
- B) Distancimin nga përgjegjësitë familjare
- C) Projektimin e emocioneve dhe konflikteve tek fëmijët
- D) Ndërprejten e komunikimit midis brezave

Pyetja 110

Si ndikon fuzioni emocional në marrëdhëniet familjare?

- A) Përmirëson autonominë dhe pavarësinë e anëtarëve të familjes
- B) Krijon varësi emocionale të pashëndetshme midis anëtarëve
- C) Ndhmon në zgjidhjen e konflikteve ndërpersonale
- D) Shmang ndikimin emocional të anëtarëve të jashtëm

Pyetja 111

Cila është rëndësia e genogramës në trajtimin e familjeve?

- A) Identifikimi i modeleve ndërbrezëshe të ndërveprimeve dhe konflikteve
- B) Kufizimi i analizës tek një brez i vetëm
- C) Reduktimi i ndikimit të marrëdhënieve emocionale
- D) Fokusimi vetëm tek problemet aktuale të familjes nukleare

Pyetja 112

Çfarë është çtrekëndëzimi në marrëdhëniet familjare?

- A) Përfshirja e një anëtari të tretë për të rritur tensionet
- B) Krijimi i distancës për të zvogëluar konfliktet emocionale
- C) Ndërtimi i marrëdhënieve të reja ndërpersonale
- D) Fokusimi tek eliminimi i konflikteve të përkohshme

Pyetja 113

Cili është qëllimi kryesor i ndërhyrjes në bazë të perspektivës shumëbrezëshe?

- A) Krijimi i insajtit dhe aftësisë për të kuptuar modelet e sjelljeve ndërbrezëshe
- B) Shmangia e ndërveprimeve emocionale ndërmjet brezave
- C) Ndryshimi i strukturës financiare të familjes
- D) Krijimi i rregullave të ngurta për marrëdhëniet ndërpersonale

Pyetja 114

Si ndihmon edukimi në përmirësimin e funksionimit familjar?

- A) Duke eliminuar varësinë emocionale brenda familjes
- B) Duke kufizuar ndërveprimet ndërmjet anëtarëve të familjes
- C) Duke ofruar njohuri për të kuptuar modelet emocionale dhe ndërveprimet
- D) Duke përjashtuar përdorimin e genogramës në vlerësim

Pyetja 115

Cili është roli kryesor i ndërhyrjeve narrative tek familjet?

- A) Zgjidhja e problemeve financiare të familjes
- B) Fokusimi vetëm në ndërveprimet e përditshme
- C) Ndihma për të rindërtuar narrativat e tyre përmes një perspektive pozitive
- D) Kufizimi i analizës në marrëdhëniet emocionale brenda familjes

Pyetja 116

Si ndikon kultura në procesin e ndërhyrjeve narrative?

- A) Krijon një pengesë për zbatimin e qasjeve narrative
- B) Eliminon nevojën për të adresuar problemet ndërpersonale
- C) Kufizon perspektivën terapeutike në një sistem të ngurtë
- D) Ndikon në mënyrën si anëtarët e familjes interpretojnë dhe tregojnë historitë e tyre

Pyetja 117

Cila është baza e teorisë së problemeve/nevojave?

- A) Fokusimi tek eliminimi i narrativave të mëparshme
- B) Nxitja e autonomisë për të shmangur narrativat negative
- C) Kufizimi i analizës vetëm tek individi
- D) Analizimi i historive familjare për të identifikuar burimet e problemeve

Pyetja 118

Cili është qëllimi i vlerësimit në ndërhyrjet narrative?

- A) Identifikimi i burimeve të historive negative dhe rindërtimi i tyre
- B) Krijimi i një plani për të kontrolluar marrëdhëniet emocionale
- C) Analiza e faktorëve ekonomikë që ndikojnë në familje
- D) Ndërtimi i narrativave të thjeshta dhe uniforme për çdo rast

Pyetja 119

Si ndihmon teoria e pushtetit dhe shtypjes në trajtimin narrativ të familjeve?

- A) Kufizon përqendrimin tek historitë personale
- B) Ndihmon klientët të kuptojnë ndikimet e shtypjes në narrativat e tyre
- C) Fokuset vetëm tek marrëdhëniet ndërpersonale brenda familjes
- D) Eleminon përdorimin e qasjeve të bazuara në elasticitet

## **Kapitulli 5. Praktikë e Punës Sociale me Grupet dhe Komunitetet**

Pyetja 1

Cili është qëllimi kryesor i fazës fillestare të zhvillimit të një grupi?

- A) Shpërbërja e grupit
- B) Vendosja e objektivave dhe krijimi i kohezionit grupor
- C) Zgjidhja e problemeve të avacuara
- D) Zbatimi i detyrave të avacuara

Pyetja 2

Cili parim është themelor për të krijuar një mjedis të sigurt në një grup?

- A) Marrja e vendimeve vetëm nga lideri
- B) Kufizimi i pjesëmarrjes së anëtarëve
- C) Mosrespektimi i mendimeve të ndryshme të anëtarëve
- D) Konfidencialiteti dhe mbështetja

Pyetja 3

Çfarë është kohezioni në një grup?

- A) Shpërndarja e grupit në fazën e parë
- B) Dominimi i liderit të grupit
- C) Bashkimi dhe ndjenja e përkatësisë mes anëtarëve
- D) Përjashtimi i disa anëtarëve nga aktivitetet

Pyetja 4

Cila është alternativa që paraqet punën që një punonjës social bën për të promovuar bashkëpunimin mes grupeve të ndryshme të një komuniteti ?

- A) Inkurajimi i konkurrencën mes grupeve
- B) Ndërmjetësimi dhe krijimi i mundësive për dialog dhe bashkëpunim
- C) Mbajtja e grupe të ndara për të shmangur konflikte
- D) Mbështetja vetëm për grupet që i japin përfitime të drejtpërdrejta

Pyetja 5

Cila prej alternativave të mëposhtme prezanton kontributin që duhet të japin punonjësit socialë për zhvillimin e kapaciteteve të liderëve lokalë për të adresuar çështje të rëndësishme për komunitetin?

- A) Të punojnë vetëm me individët pa përfshirë liderët lokalë
- B) Të ofrojnë trajnime dhe mundësi për zhvillimin e aftësive të lidërshiptit dhe menaxhimit të çështjeve të komunitetit
- C) Të inkurajojnë lidërshiptin vetëm nga autoritetet shtetërore

D) Të shmangin përfshirjen e liderëve lokalë në vendimmarrje

Pyetja 6

Çfarë nënkupton koncepti i “strukturës” në një grup trajtimi?

- A) Rregullat dhe marrëveshjet që përcaktojnë ndërveprimet e anëtarëve
- D) Ndryshimi i rolit të liderit
- B) Dominimi i një anëtari mbi të tjerët
- C) Kufizimi i anëtarëve të rinj të grupit

Pyetja 7

Cili është një nga sfidat më të mëdha për punonjësit socialë në punën me komunitetet që janë prekur nga kriza ekonomike?

- A) Të ofrojnë vetëm shërbime financiare të përkohshme
- B) Të injorojnë nevojat afatgjata të komunitetit dhe të përqendrohen vetëm në ndihmën emergjente
- C) Të shmangin çdo përfshirje me organizata të tjera
- D) Të sigurojnë mbështetje afatgjatë për zhvillimin e kapaciteteve të komunitetit dhe krijimin e mundësive për punësim

Pyetja 8

Cili është qëllimi kryesor i përdorimit të bazave të pushtetit nga lideri i grupit?

- A) Për të rritur ndikimin e anëtarëve të rinj
- B) Për të kontrolluar të gjithë anëtarët
- C) Për të ndihmuar grupin të arrijë qëllimet e tij në mënyrë etike dhe efektive
- D) Për të kufizuar pjesëmarrjen e anëtarëve

Pyetja 9

Cili është një nga parimet kryesore të “përgjegjësisë etike” në udhëheqjen e grupeve?

- A) Marrja e vendimeve pa konsultim
- B) Mbajtja e informacionit të fshehtë për grupin
- C) Respektimi i autonomisë së anëtarëve dhe mbajtja e një qëndrimi jogjykues
- D) Zbatimi i politikave të agjencisë

Pyetja 10

Cili është roli i "kohezionit" në një grup mbështetës?

- A) Ndihmon në ndërtimin e bashkëpunimit dhe unitetit mes anëtarëve të grupit
- B) Përmirëson rritjen e përfitimeve personale të udhëheqësit
- C) Zvogëlon përfshirjen e anëtarëve të grupit
- D) Lehtëson vendimmarrjen pa ndërhyrje

Pyetja 11

Cili është hapi i parë që duhet të ndërmarrë një punonjës social kur organizon një projekt në komunitet?

- A) Të fillojë projektin pa konsultime paraprake
- B) Të identifikojë dhe të përfshijë aktorët kryesorë të komunitetit
- C) Të veprojë vetëm sipas përvojës së tij
- D) Të shmangë çdo pjesëmarrje të komunitetit në planifikim

Pyetja 12

Cili është roli i punonjësve socialë në përfshirjen e grupeve vulnerabël në aktivitetet e komunitetit?

- A) Të përjashtojnë grupet vulnerabël për të shmangur tensionet
- B) Të ruajnë statusin e grupeve vulnerabël pa ndërhyrje
- C) Të krijojnë mundësi dhe mbështetje për pjesëmarrjen aktive të grupeve vulnerabël
- D) Të fokusohet vetëm në grupe të privileguara

Pyetja 13

Në cilën fazë të zhvillimit të grupit është e rëndësishme të “përcaktohet qëllimi i grupit”?

- A) Në fazën fillestare
- B) Në fazën e vlerësimit paraprak
- C) Në fazën e përparimit
- D) Në fazën përfundimtare

Pyetja 14

Çfarë është “ndjeshmëria kulturore” në drejtimin e një grupi multikulturor?

- A) Përdorimi i një kulture të vetme për të gjithë
- B) Pranimi dhe respektimi i dallimeve kulturore ndërmjet anëtarëve të grupit
- C) Shmangia e të gjitha temave që përfshijnë kultura të ndryshme
- D) Mbështetje vetëm e anëtarëve nga kultura e liderit

Pyetja 15

Cila është detyra e punonjësit social në identifikimin e nevojave të komunitetit?

- A) Të krijojë programe bazuar në perceptimet personale
- B) Të zhvillojë konsultime dhe të mbledhë të dhëna nga anëtarët e komunitetit
- C) Të ndjekë vetëm udhëzimet e punëdhënësit
- D) Të shmangë çdo hulumtim në terren

Pyetja 16

Çfarë nënkupton “intimiteti” në kontekstin e zhvillimit të grupit?

- A) Mungesën e ndërveprimeve të anëtarëve
- B) Shmangien e diskutimeve të ndjeshme
- C) Ndërtimin e marrëdhënieve të ngushta dhe të sigurta ndërmjet anëtarëve
- D) Izolimimin e anëtarëve që nuk kontribuojnë

Pyetja 17

Çfarë përfaqëson një analizë e SËOT-it në vlerësimin e një komuniteti?

- A) Një mjet për të analizuar dobësitë, pikat e forta, mundësitë dhe kërcënimet që ndikojnë komunitetin
- B) Një raport financiar për burimet që komuniteti zotëron
- C) Një plan veprimi për ndërhyrjet e menjëhershme
- D) Një metodë për të përjashtuar grupet më të dobëta nga procesi

Pyetja 18

Cili është qëllimi i fazës përfundimtare të një grupi?

- A) Ndërprerja e komunikimit të anëtarëve
- B) Injorimi i arritjeve të grupit
- C) Vlerësimi dhe përmbyllja e përpjekjeve të grupit
- D) Shpërbërja pa ndonjë përfundim formal

Pyetja 19

Cili është përfitimi kryesor i kohezionit të lartë në një grup?

- A) Zvogëlimi i ndjenjave të përkatësisë
- B) Reduktimi i efektivitetit të grupit
- C) Rritja e bashkëpunimit dhe përgjegjësisë për arritjen e qëllimeve
- D) Dominimi i liderit mbi anëtarët

Pyetja 20

Cili nga faktorët vijues është më i rëndësishëm për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit të një komuniteti?

- A) Disponueshmëria e burimeve financiare
- B) Strukturat sociale dhe kulturore të komunitetit
- C) Marrëdhëniet personale të punonjësit social me liderët lokalë
- D) Kërkesat e organizatës që punonjësi përfaqëson

Pyetja 21

Çfarë nënkupton termi “ndërveprimi ndërpersonal” në grupet e trajtimit?

- A) Ndihmon në ndërtimin e marrëdhënieve të ngushta dhe të mbështetura ndërmjet anëtarëve
- B) Shmangia e diskutimeve personale të anëtarëve të grupit
- C) Kufizon përfshirjen e liderit në diskutimet e grupit
- D) Përqendrimi në përfitime financiare

Pyetja 22

Cili është ndikimi i “komunikimit të hapur” në dinamikën e një grupi?

- A) Kufizon lirinë e shprehjes
- B) Rrit konfliktet ndërpersonale të grupit
- C) Nxiti ndërtimin e besimit dhe rrit efektivitetin e grupit
- D) Ul nivelin e kohezionit të grupit

Pyetja 23

Cila është mënyra më e mirë për të siguruar që vlerësimi i komunitetit të jetë gjithëpërfshirës?

- A) Përfshirja e të gjitha grupeve sociale, përfshirë ato më vulnerabël
- B) Fokusimi vetëm në çështjet që janë të rëndësishme për liderët lokalë
- C) Përdorimi i një metode të vetme për të gjithë komunitetet
- D) Mbështetja në perceptimet personale të punonjësit social

Pyetja 24

Cili është roli i liderit në respektimin e etikës në punën me grupet?

- A) Të zbatojë vetëm rregullat e agjencisë
- B) Të shpërfill mendimet e anëtarëve të grupit
- C) Të përdori pushtetin për të mbështetur dhe respektuar të drejtat dhe nevojat e anëtarëve
- D) Të dominojë plotësisht çdo anëtarë



Pyetja 25

Cila është rëndësia e ruajtjes së konfidencialitetit në një grup trajtimi?

- A) Për të inkurajuar shfaqjen e konfrontimeve
- B) Për të rritur presionin mbi anëtarët e grupit
- C) Për të përforcuar dominimin e liderit
- D) Për të siguruar që informacionet personale të mbeten private

Pyetja 26

Cili është ndikimi i “reflektimit” për anëtarët e grupit?

- A) Të shmangë analizën e vendimeve
- B) Të dominoj anëtarët e rinj
- C) Të ndihmoj në porzicionimin e liderit
- D) Të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmirësimin e ndërveprimeve

Pyetja 27

Çfarë është “vlerësimi përfundimtar” i grupit?

- A) Ndërprerja e ndërveprimeve në mes të ciklit të punës
- B) Kufizimi i diskutimeve emocionale të anëtarëve të grupit
- C) Vlerësimi i përvojës dhe arritjeve për të përmbyllur aktivitetet e grupit
- D) Zëvendësimi i anëtarëve të grupit

Pyetja 28

Cili është ndikimi i përdorimit të metodave të ndërmjetësimit në një grup trajtimi?

- A) Rrit mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve
- B) Ndihmon në zgjidhjen e konflikteve në mënyrë të drejtë dhe të ndershme
- C) Kufizon diskutimet e hapura
- D) Inkurajon përjashtimin e disa anëtarëve të grupit

Pyetja 29

Cili është roli i një punonjësi social për të ruajtur “neutralitetin” në një grup mbështetës?

- A) Mbështet vetëm mendimet e anëtarëve më të vjetër
- B) Qëndron i paanshëm për të siguruar një ambient të hapur dhe të barabartë për të gjithë
- C) Ndikon në vendimet e grupit përmes preferencave personale
- D) Anashkalon mendimet e anëtarëve më të rinj

Pyetja 30

Në çfarë mënyre “empatia” ndikon në procesin e grupit?

- A) Ndihmon anëtarët të ndihen të kuptuar dhe të mbështetur në ndarjen e përvojave të tyre
- B) Ndihmon liderin të ruajë distancën nga anëtarët e grupit
- C) Shkurton kohën e diskutimeve në grup
- D) Zvogëlon mundësitë për ndërveprime efektive

Pyetja 31

Cili është ndikimi i rritjes së “besimit” në fazën fillestare të grupit?

- A) Zvogëlon kohën e komunikimit mes anëtarëve të grupit

- B) Ndhmon anëtarët të ndihen të sigurt për të ndarë përvojat e tyre pa frikë nga gjykimi
- C) Kufizon diskutimet e hapura të grupit
- D) Inkurajon përjashtimin e disa anëtarëve të grupit

Pyetja 32

Cili është qëllimi i përdorimit të “praktikës reflektuese” nga një punonjës social në një grup?

- A) Shmangia e analizës së vendimeve të kaluara
- B) Përmirësimi i ndërveprimeve dhe strategjive përmes vetë-analizës dhe reflektimit të vazhdueshëm
- C) Kufizimi i diskutimeve për anëtarët e rinj
- D) Ndërprerja e komunikimit ndërmjet anëtarëve

Pyetja 33

Cila nga këto teori përqendrohet në marrëdhëniet dhe shkëmbimet sociale midis anëtarëve të grupit?

- A) Teoria e shkëmbimit social
- B) Teoria psikodinamike
- C) Teoria e fushës
- D) Teoria konstruktiviste

Pyetja 34

Çfarë bën një punonjës social kur një komunitet ka nevojë për shërbime por ka mungesë të burimeve?

- A) Kërkon mundësi për të mobilizuar burime të tjera, duke përfshirë partneritete dhe donatorë
- B) Pret deri sa burimet të bëhen të disponueshme
- C) Ndhmon vetëm individët që janë më të ndjeshëm
- D) Injoron nevojat e komunitetit derisa të sigurohen burimet

Pyetja 35

Cili është një nga avantazhet kryesore të grupeve të trajtimit?

- A) Mbështetja minimale emocionale e anëtarëve të grupit
- B) Fokusimi i ngushtë në detyra specifike të grupit
- C) Shkëmbimi i përvojave dhe ndihma reciproke e anëtarëve të grupit
- D) Shmangia e ndërveprimit personal midis anëtarëve të grupit

Pyetja 36

Cila nga këto metoda përdoret për të rritur kohezionin dhe përfshirjen në grup?

- A) Përdorimi i aktiviteteve interaktive
- B) Analiza statistikore
- C) Ndryshimi i anëtarëve të grupit
- D) Implementimi i vendimeve autoritare

Pyetja 37

Cili është qëllimi i përdorimit të “teknikave të reflektimit” në një grup?

- A) Kufizon shprehjen e ndjenjave të anëtarëve të grupit
- B) Ndhmon në krijimin e raporteve financiare
- C) Rrit fokusin vetëm te lideri i grupit

D) Ndhomon anëtarët të analizojnë dhe përmirësojnë sjelljet e tyre në mënyrë të vazhdueshme

Pyetja 38

Cili është një “tipar i rëndësishëm” i një grupi të suksesshëm?

- A) Komunikimi minimal ndërmjet anëtarëve
- B) Ndryshimi i vazhdueshëm i strukturës së grupit
- C) Balancimi midis përmbajtjes dhe proceseve ndërpersonale
- D) Përdorimi i vetëm metodave formale të ndërveprimit

Pyetja 39

Cili është ndikimi i “konfliktit konstruktiv” në një grup?

- A) Shkatërron dinamikën e grupit
- B) Redukton besimin midis anëtarëve të grupit
- C) Mund të nxisë rritjen dhe zhvillimin e grupit
- D) Shmang përmirësimin e marrëdhënieve midis anëtarëve të grupit

Pyetja 40

Çfarë përcaktojnë “normat e grupit”?

- A) Vetëm numrin e takimeve në grup
- B) Sjelljet dhe pritshmëritë që rregullojnë ndërveprimet midis anëtarëve
- C) Strukturën hierarkike të grupit
- D) Përbërjen demografike të anëtarëve të grupit

Pyetja 41

Cili është një faktor i rëndësishëm për të zhvilluar një dinamikë të suksesshme të grupit?

- A) Kufizimi i komunikimit joformal
- B) Anashkalimi i ndjenjave personale të anëtarëve të grupit
- C) Përcaktimi i vetëm një drejtuesi të grupit
- D) Zhvillimi i rolit të qartë për secilin anëtar

Pyetja 42

Cili është përfitimi kryesor i “grupeve të socializimit” për anëtarët e rinj në komunitete?

- A) Mbështetja financiare
- B) Zhvillimi i marrëdhënieve sociale dhe adaptimi në një mjedis të ri
- C) Krijimi i projekteve teknike
- D) Ndhurma në përgatitjen për testet akademike

Pyetja 43

Cila është karaktersitika dalluese e “grupeve të vetë-ndihmës”?

- A) Janë të drejtuara nga vetë anëtarët që ndajnë përvoja të përbashkëta
- B) Udhëhiqen nga profesionistë të licencuar
- C) Fokusohen vetëm në zgjidhjen e problemeve financiare
- D) Janë pjesë e organizatave qeveritare

Pyetja 44

Cili nga këto lloje grupesh është më i përshtatshëm për individët që kanë përjetuar përvoja të ngjashme dhe kërkojnë mbështetje të ndërsjellë?

- A) Grupet e vetë-ndihmës
- B) Grupet arsimore
- C) Grupet e rritjes personale
- D) Grupet e detyrave

Pyetja 45

Cili është funksioni kryesor i “grupeve të rritjes personale”?

- A) Të ndihmojnë anëtarët të gjejnë punë
- B) Të ofrojnë trajtim mjekësor
- C) Të ndihmojnë individët të zhvillojnë aftësi dhe të arrijnë potencialin e tyre
- D) Të menaxhojnë burimet financiare

Pyetja 46

Cila nga këto teori fokusohet më shumë në përdorimin e rrëfimeve personale për të kuptuar përvojën individuale?

- A) Teoria psikodinamike
- B) Teoria e shkëmbimit social
- C) Teoria narrative
- D) Teoria e sistemeve

Pyetja 47

Çfarë sugjeron “teoria e shkëmbimit social” për marrëdhëniet pozitive brenda një grupi?

- A) Nuk kanë ndikim në performancën e grupit
- B) Janë të pavarura nga ndjenjat e anëtarëve
- C) Duhet të jenë gjithmonë të balancuara
- D) Forcohen kur anëtarët marrin më shumë përfitime se sa kosto

Pyetja 48

Çfarë sugjeron “teoria e fuqizimit”, për punonjësin social?

- A) Punonjësi social zgjidhë të gjitha problemet për klientin
- B) Punonjësi social ndihmojë individët dhe grupet të marrin kontroll mbi jetën e tyre
- C) Punonjësi social fokusohet vetëm te problemet ekonomike
- D) Punonjësi social injorjnë ndikimin e mjedisit shoqëror

Pyetja 49

Çfarë theksojnë “teoritë konstruktiviste” në punën sociale?

- A) Realiteti ndërtohet nga përvojat dhe perceptimet e individit
- B) Të gjitha realitetet janë të fiksuara dhe të pandryshueshme
- C) Problemet sociale janë të pavarura nga përvoja individuale
- D) Nuk është e rëndësishme të kuptohet perspektiva e individit

Pyetja 50

Çfarë thekson Kurt Leëin në “teorinë e fushës”si faktorë për përcaktimin e sjelljes së individit?

- A) Vlerat dhe zakonet kulturore
- B) Ndikimin e mësuesve
- C) Ndërveprimin midis individit dhe mjedisit

D) Zgjedhjet personale të pavarura nga mjedisi

Pyetja 51

Çfarë nënvizon më shumë “Teoria e të mësuarit”?

- A) Përforcimin dhe modelimin e sjelljes
- B) Konfliktet ndërpersonale
- C) Strukturën e grupit
- D) Ndikimin e faktorëve ekonomikë

Pyetja 52

Cila është alternativa që zgjedhin punonjësit social për ndryshimin e mentaliteteve negative dhe sjelljeve destruktive në një komunitet?

- A) Të përdorin metodat tradicionale pa përpjekur të ndryshojë mentalitetet
- B) Të organizojnë aktivitete edukative dhe trajnime që ndërgjegjësojnë mbi rëndësinë e vlerave pozitive dhe respektit
- C) Të injorojnë çështjet sociale dhe të fokusohet në individë të caktuar
- D) Të mbështesin vetëm individët që nuk kanë sjellje destruktive

Pyetja 53

Cili është faktori kryesor që ndikon në sjelljen e individit sipas “teorisë psikodinamike”?

- A) Rrjetet sociale
- B) Vendndodhja gjeografike
- C) Përvojat e fëmijërisë dhe konfliktet e pavetëdijshme
- D) Arsimitimi formal

Pyetja 54

Cila është qasja kryesore e “teorisë së sistemeve” në punën sociale?

- A) Të analizojë ndërveprimet dhe lidhjet midis individit dhe mjedisit
- B) Të trajtojë çdo individ në mënyrë të izoluar
- C) Të injorojnë ndikimin e faktorëve të jashtëm
- D) Të fokusohet vetëm në marrëdhëniet familjare

Pyetja 55

Cili prej pohimeve të mëposhtme është veprimi që do ta çonte një lider në përmirësimin e efektivitetit të tij referuar “modelit ndërveprues”?

- A) Duke ndjekur një stil udhëheqjeje të pandryshueshëm
- B) Duke kufizuar ndërveprimet me grupin
- C) Duke zbatuar vetëm politikën organizative
- D) Duke vlerësuar vazhdimisht marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve, grupit dhe mjedisit

Pyetja 56

Cili është qëllimi i “reflektimit të ndërsjellë” në punën e grupit?

- A) Rritja e numrit të anëtarëve në grup
- B) Shmangia e ndjenjave të humbjes tek anëtarët e grupit
- C) Zhvillimi i një grupi të ri paralel
- D) Përforcimi i mësimave dhe përvojave të fituara

Pyetja 57

Cila është strategjia për të ndihmuar një grup për të ruajtur ndryshimet pozitive pas përfundimit?

- A) Përcaktimi i rolit të liderit të ri
- B) Ofrimi i lidhjeve me burimet e komunitetit
- C) Organizimi i një seance të fundit pa diskutim
- D) Reduktimi i komunikimit ndërmjet anëtarëve

Pyetja 58

Cili është një veprim i rëndësishëm që duhet ndërmarrë nga lideri i grupit gjatë përfundimit?

- A) Të rekrutojë anëtarë të rinj për grupin
- B) Të ndihmojë anëtarët të përgatiten për tranzicionin pas përfundimit
- C) Të ndryshojë formatin e grupit në mënyrë virtuale
- D) Të ndërpresë komunikimin me anëtarët

Pyetja 59

Cili është një tregues që tregon se grupi është i gatshëm për të përfunduar?

- A) Arritja e qëllimeve dhe objektivave të grupit
- B) Rritja e mosmarrëveshjeve në grup
- C) Zvogëlimi i angazhimit të liderit
- D) Ndryshimi i lokacionit të grupit

Pyetja 60

Cila teknikë është vendimtare për të ndihmuar anëtarët e grupit të përballen me fazën e përfundimit?

- A) Reflektimi mbi arritjet personale dhe të grupit
- B) Rritja e numrit të detyrave për anëtarët
- C) Kufizimi i ndërveprimeve sociale
- D) Reduktimi i seancave përpara përfundimit

Pyetja 61

Cili hap është thelbësor në përfundimin e një grupi të trajtimit?

- A) Zhvillimi i një plani të marketingut
- B) Shqyrtimi i përmbushjes së objektivave të grupit
- C) Përzgjedhja e një lokacioni të ri për takimet
- D) Ristrukturimi i orarit të seancave

Pyetja 62

Cili është një qëllim i rëndësishëm në përfundim të punës së një grupi në punë sociale?

- A) Konsolidimi i rezultateve dhe përvojave të arritura
- B) Ndryshimi i misionit të grupit
- C) Ndryshimi i strukturës organizative
- D) Përcaktimi i një lideri të ri

Pyetja 63

Cila është sfida kryesore gjatë fazës së përfundimit të një grupi?

- A) Adresimi i ndjenjave të humbjes dhe shpërndarjes tek anëtarët

- B) Përzgjedhja e një lideri të ri
- C) Rekrutimi i anëtarëve të rinj
- D) Hartimi i kontratës së re për grupin

Pyetja 64

Cili është qëllimi kryesor i përdorimit të vlerësimit me një sistem të vetëm (single-system design) në një grup?

- A) Rritja e numrit të anëtarëve të grupit
- B) Monitorimi i progresit të një anëtari të vetëm në kohë
- C) Përmirësimi i komunikimit ndërmjet anëtarëve
- D) Reduktimi i kostove të administrimit të grupit

Pyetja 65

Cili prej këtyre metodave përdoret më shpesh për të mbledhur të dhëna gjatë procesit të vlerësimit të grupit?

- A) Raportet financiare
- B) Analiza statistikore e demografisë
- C) Pyetësorët dhe intervistat
- D) Planifikimi i aktiviteteve të jashtme

Pyetja 66

Cili nga këta tregues vlerësimi është më i përshtatshëm për të matur efektivitetin e një grupi?

- A) Arritja e objektivave të përcaktuara në fillim
- B) Koha e kaluar në seancat e grupit
- C) Ndryshimet në përbërjen e grupit
- D) Niveli i edukimit të liderit

Pyetja 67

Cila është sfida kryesore e përdorimit të metodave cilësore në vlerësimin e grupeve?

- A) Subjektiviteti në interpretimin e të dhënave
- B) Sigurimi i burimeve financiare
- C) Kufizimet teknologjike
- D) Kohëzgjatja e gjatë e procesit të vlerësimit

Pyetja 68

Cili është qëllimi kryesor i vlerësimit paraprak në një grup në punë sociale?

- A) Ndryshimi i strukturës së grupit
- B) Mbledhja e të dhënave për të identifikuar nevojat dhe burimet
- C) Organizimi i aktiviteteve sociale
- D) Vlerësimi i performancës së liderit të grupit

Pyetja 69

Cila nga këto sjellje konsiderohet si pjesë e praktikës profesionale etike në punën në grup?

- A) Mbështetja vetëm në burimet individuale
- B) Përdorimi i teknologjisë pa kufizime
- C) Konsultimi dhe mbikëqyrja profesionale
- D) Neglizhimi i rregullave organizative

Pyetja 70

Çfarë nënkupton "diferencimi" në fazat e zhvillimit të grupit?

- A) Zhvillimin e një ndarjeje të qartë të roleve dhe përgjegjësiive ndërmjet anëtarëve të grupit
- B) Kufizimin e bashkëpunimit të anëtarëve
- C) Shmangien e ndërveprimeve personale
- D) Fokusimin vetëm te anëtarët e rinj të grupit

Pyetja 71

Cili është roli i liderit në menaxhimin e konflikteve të fazës fillestare?

- A) Ndihma për anëtarët në përballimin e konflikteve si pjesë normale e zhvillimit të grupit
- B) Injorimi i konflikteve për të inkurajuar pavarësinë
- C) Kufizimi i diskutimeve për të parandaluar mosmarrëveshjet
- D) Ndërmjetësimi vetëm kur ka konflikte të mëdha

Pyetja 72

Cila është rëndësia e "ndërgjegjësimit për kufijtë etike" në një grup trajtimi?

- A) Siguron që ndërveprimet të jenë etike dhe respektojnë të drejtat e të gjithë anëtarëve
- B) Ndihmon liderin të imponojë pikëpamjet personale mbi grupin
- C) Ndikon në shpërndarjen e përgjegjësiive
- D) Kufizon ndërveprimet ndërmjet anëtarëve

Pyetja 73

Si ndikon "ndërhyrja etike" e liderit në suksesin e grupit?

- A) Siguron që ndërhyrjet të jenë të drejta dhe të barabarta për të gjithë anëtarët
- B) Zvogëlon përparësitë e disa anëtarëve
- C) Fokuson vëmendjen vetëm te lideri
- D) Kufizon lirinë e anëtarëve për të folur

Pyetja 74

Cili është kuptimi i "dilema etike" në një grup trajtimi?

- A) Vendimmarrja në rastet ku ekzistojnë konflikte mes parimeve etike
- B) Konflikti midis interesave të anëtarëve dhe atyre të liderit
- C) Mosmarrëveshja mbi rregullat e grupit
- D) Shmangia e të gjitha konflikteve

Pyetja 75

Cili është roli i "konfidencialitetit" në një grup terapie?

- A) Lehtëson përhapjen e informacionit të grupit në organizatë
- B) Ndihmon në mbajtjen e informacionit privat të anëtarëve brenda grupit
- C) Shpërndan çdo të dhënë të anëtarëve jashtë grupit
- D) Injoron kërkesat e anëtarëve për privatësi

Pyetja 76

Cili është roli i "vetëdijes për etikën" për një punonjës social në një grup?

- A) Injorimi i rregullave të etikës
- B) Zbatimi i rregullave etike në mënyrë të përhershme dhe të vazhdueshme
- C) Shpërfillja e kufijve të grupit



D) Fokusi vetëm në rezultatet përfundimtare

Pyetja 77

Çfarë është “rol funksional” në një grup detyrash?

- A) Roli i një anëtari që kontribuon për arritjen e qëllimeve të grupit
- B) Roli i liderit që kufizon ndërveprimet
- C) Roli i anëtarëve që shmangin pjesëmarrjen
- D) Roli i një individi që kontrollon çdo vendim

Pyetja 78

Cila është domosdoshmëria e “kontraktimit” në fazën fillestare të grupit?

- A) Kufizimi i pjesëmarrjes vetëm për disa anëtarë
- B) Përcaktimi i qartë i qëllimeve dhe pritshmërive për anëtarët e grupit
- C) Ndryshimi i qëllimeve gjatë seancave
- D) Kufizimi i ndërveprimeve

Pyetja 79

Çfarë përfshin faza e “normimit” në grup?

- A) Krijimin e konfliktit midis anëtarëve
- B) Vendosjen e rregullave dhe strukturës së grupit
- C) Ndërprerjen e bashkëpunimit
- D) Përcaktimin e liderit si figura kryesore

Pyetja 80

Çfarë përfshin “mbështetja e liderit” në një grup të sapoformuar?

- A) Përdorimi i fuqisë për të imponuar rregulla
- B) Mbajtja e qëndrimit të distancuar
- C) Sigurimi i udhëzimeve dhe ndihma për anëtarët që të ndihen të mirëpritur
- D) Kufizimi i diskutimeve ndërmjet anëtarëve

Pyetja 81

Cili është përfitimi kryesor i vendosjes së rregullave në fazën fillestare të grupit?

- A) Kufizon pjesëmarrjen e anëtarëve
- B) Rrit numrin e konflikteve
- C) Ndihmon në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të strukturuar për bashkëpunim
- D) Përforcon dominimin e liderit

Pyetja 82

Cili është qëllimi i "analizës së nevojave" në punën me grupet?

- A) Vlerësimi i nevojave dhe qëllimeve të anëtarëve për të krijuar një plan të përshtatshëm të grupit
- B) Kufizimi i qëllimeve të grupit
- C) Zgjidhja e problemeve individuale
- D) Ndërprerja e përparimit të grupit

Pyetja 83

Cili është parimi themelor i “reflektimit” për një punonjës social në grup?

- A) Shmangia e analizës së vendimeve të marra
- B) Vlerësimi dhe përmirësimi i ndërveprimeve dhe strategjive përmes analizës së vazhdueshme
- C) Dominimi mbi anëtarët e tjerë të grupit
- D) Përdorimi i mendimeve të njëanshme

Pyetja 84

Cili është ndikimi i “mbështetjes reciproke” në një grup të trajtimit?

- A) Përfshihet anëtarët që nuk bashkëpunojnë
- B) Ndihmon anëtarët të ndihen të sigurt dhe të mbështetur në ndarjen e përvajave
- D) Kufizon shprehjen e ndjenjave
- C) Redukton angazhimin emocional

Pyetja 85

Cila është rëndësia e “analizës së përparimit” në fazën e mesme të punës në grup?

- A) Ndihmon në vlerësimin e progresit drejt qëllimeve
- B) Kufizon përparimin e grupit
- C) Redukton motivimin e anëtarëve
- D) Kufizon ndërveprimet midis anëtarëve

Pyetja 86

Cili është qëllimi i fazës së orientimit në një grup të detyrave?

- A) Krijimi i përplasjes midis anëtarëve
- B) Përcaktimi i qëllimeve dhe strukturës së grupit
- C) Shpërbërja e grupit
- D) Marrja e vendimeve pa diskutim

Pyetja 87

Çfarë është “mbikëqyrja profesionale” në grupet e trajtimit?

- A) Mbështetja profesionale e liderit për të ofruar shërbime më të mira
- B) Kufizimi i ndërhyrjeve nga jashtë
- C) Ndihma e grupit vetëm në rast nevojë urgjente
- D) Shpërndarja e informacionit të grupit në agjencitë e tjera

Pyetja 88

Cili është roli i “ndërveprimit ndërpersonal” në një grup mbështetës?

- A) Ndërprerja e ndërveprimeve
- B) Inkurajimi i ndarjes së përvajave dhe mbështetjes ndërmjet anëtarëve
- C) Dominimi i liderit
- D) Kufizimi i pjesëmarrjes

Pyetja 89

Si mund të kontribuojë një lider në kohezionin e grupit gjatë fazës fillestare të krijimit të tij?

- A) Duke injoruar nevojat e anëtarëve të grupit
- B) Duke inkurajuar ndarjen e eksperiencave dhe mbështetjen reciproke
- C) Duke shpërfillur opinionet e ndryshme të anëtarëve të grupit
- D) Duke përjashtuar anëtarët pasive nga grupi

Pyetja 90

Cili është ndikimi i “rolit të anëtarit” në përmbushjen e qëllimeve të grupit?

- A) Rrit ndjenjën e përgjegjësisë dhe angazhimit për arritjen e objektivave
- B) Ndhmon në rritjen e konkurrencës mes anëtarëve
- C) Shmang bashkëpunimin mes anëtarëve
- D) Rrit dominimin e liderit

Pyetja 91

Cila është alternativa që zgjedhin punonjësit socialë për të kontribuar në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike të një komuniteti të marginalizuar?

- A) Nëpërmjet ofrimit të ndihmës financiare të përkohshme
- B) Nëpërmjet ndihmës në krijimin e mundësive për punësim dhe zhvillimin e aftësive profesionale
- C) Nëpërmjet inkurajimit të përfshirjes vetëm në aktivitete jo-formale
- D) Nëpërmjet ofrimit të vetëm shërbime urgjente

Pyetja 92

Cila prej alternativave përfaqëson ndihmën që punonjësit socialë ofrojnë në zgjidhjen e problemeve të përkohshme në një komunitet, si për shembull: katastrofat natyrore?

- A) Të injorojnë situatën dhe të presin që qeveria të reagojë
- B) Të fokusohen vetëm në nevojat e individëve
- C) Të koordinojnë ndihmën emergjente dhe të sigurojnë një plan afatgjatë për rindërtimin dhe rehabilitimin
- D) Të ndihmojnë vetëm me shpërndarjen e ndihmave materiale

Pyetja 93

Cili është një faktor kyç për të siguruar që shërbimet sociale në një komunitet të jenë të pranueshme dhe të përputhshme me nevojat e tij?

- A) Të përdoren shërbime të standardizuara nga jashtë pa u marrë parasysh karakteristikat lokale
- B) Të ndiqen vetëm praktikrat e zakonshme që përdoren në qytete të tjera
- C) Të shmanget çdo formë e pjesëmarrjes aktive të komunitetit
- D) Të respektohen dhe të ndërtohen shërbimet në bazë të kulturës dhe vlerave të komunitetit

Pyetja 94

Cili është roli i punonjësve socialë në përmirësimin e marrëdhënieve ndër-komunitare dhe bashkëpunimit ndërkufitar?

- A) Të ndihmojnë vetëm komunitetin e tyre pa bashkëpunuar me të tjerë
- B) Të kufizojnë ndërveprimet me komunitetet që nuk kanë nevojë urgjente
- C) Të ruajnë një qëndrim të ndarë nga komunitetet e tjera për të shmangur ndërhyrjet
- D) Të krijojnë mundësi për bashkëpunim, ndarjen e burimeve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetet fqinjë

Pyetja 95

Cili është një aspekt i rëndësishëm i punës sociale që fokusohet në fuqizimin e grupit komunitar?

- A) Mbështetja e individëve pa krijuar mundësi për bashkëpunim grupor

- B) Fokusimi vetëm në mbështetje financiare për individët
- C) Ndhimja për krijimin e strukturave dhe grupeve të fuqishme që mund të mbështesin njëri-tjetrin dhe të përmirësojnë kushtet jetësore
- D) Inkurajimi i varësisë nga ndihma e jashtme

Pyetja 96

Cili është qëllimi kryesor i punonjësit social në punën me komunitetin?

- A) Të ndërhyjë vetëm në çështje individuale
- B) Të ndihmojë individët të gjejnë punë
- C) Të përmirësojë mirëqenien e individëve dhe të grupit përmes përfshirjes sociale
- D) Të krijojë një qendër shërbimesh pa ndihmuar në përfshirjen e komunitetit

Pyetja 97

Cila është mënyra më efektive për të identifikuar nevojat dhe burimet e një komuniteti?

- A) Të realizosh takime dhe sondazhe me anëtarët e komunitetit për të kuptuar nevojat dhe burimet e tyre
- B) Të mbledhësh informacion vetëm nga autoritetet lokale
- C) Të ndjekësh vetëm vlerësimet e ekspertëve të jashtëm
- D) Të përdorësh një qasje pasive dhe të presësh që individët të kërkojnë ndihmë

Pyetja 98

Cila prej pohimeve të mëposhtme është strategjia që zgjedh një punonjës social për të adresuar tensionet dhe ndasitë sociale brenda një komuniteti?

- A) Injorimi i tensioneve dhe shmangia e ndërhyrjeve
- B) Krijimi i mundësive për dialog dhe ndihmë profesionale për të menaxhuar dhe zgjidhur konfliktet
- C) Mbështetja vetëm e një grupi të caktuar të komunitetit
- D) Shmangia e ndërhyrjeve për të ruajtur paqen sociale

Pyetja 99

Cili është qëllimi i punonjësve socialë kur punojnë për zhvillimin e kapaciteteve të komunitetit?

- A) Të krijojnë varësi nga shërbimet sociale
- B) Të mbështesin vetëm individët me nevoja emergjente
- C) Të ofrojnë ndihmë financiare pa pasur strategji afatgjata
- D) Të fuqizojnë anëtarët e komunitetit për të zgjidhur vetë problemet dhe për të përdorur burimet e tyre

## **Kapitulli 6. Probleme Sociale**

Pyetja 1

Cili është përkufizimi i një problemi social?

- A) Një fenomen që dëmton një numër të madh individësh në një shoqëri
- B) Një çështje që prek vetëm individët në zonat rurale
- C) Një situatë që përmirëson mirëqenien sociale
- D) Një ngjarje që ndikon vetëm në nivelin personal

Pyetja 2

Sipas analizës së viteve 1920–1930, cilat procese shoqërore kontribuan në shfaqjen e problemeve sociale?

- A) Migrimi, urbanizimi dhe industrializimi
- B) Industrializimi dhe zhvillimi rural
- C) Reduktimi i popullsisë dhe ndotja e ajrit
- D) Mungesa e arsimit dhe përparimet teknologjik

Pyetja 3

Sipas sociologëve të hershëm amerikanë, cili ishte shkaku kryesor i problemeve sociale?

- A) Mospërshtatja e individëve me shoqërinë për shkak të mungesës së shoqërizimit
- B) Konkurenca ekonomike ndërmjet grupeve shoqërore
- C) Ndryshimet politike dhe ligjet e reja
- D) Rritja e çmimit të pasurive të patundshme në qytete

Pyetja 4

Çfarë roli kanë sociologët në studimin e problemeve sociale?

- A) Ata krijojnë teori për të mbështetur institucionet politike
- B) Ata studiojnë marrëdhëniet sociale dhe ndikimet e tyre mbi problemet sociale
- C) Ata analizojnë vetëm devijimet individuale
- D) Ata japin zgjidhje të drejtpërdrejta për të gjitha problemet

Pyetja 5

Çfarë ndikimi kishte industrializimi në përkufizimin e problemeve sociale në shekullin XIX?

- A) Industrializimi zgjidhi shumicën e problemeve sociale
- B) Ai solli përmirësime të mëdha në cilësinë e jetesës
- C) Ai shkaktoi tronditje në shoqëri dhe shtoi problemet sociale
- D) Industrializimi pati ndikim të papërfillshëm në jetën shoqërore

Pyetja 6

Cili është përkufizimi bazë i patologjisë sociale?

- A) Sjellje që mbështet stabilitetin dhe rritjen sociale
- B) Mospërshtatja e individëve ose institucioneve me marrëdhëniet sociale
- C) Përpjekjet për të përmirësuar kushtet e jetesës në shoqëri
- D) Studimi i mënyrave për të forcuar marrëdhëniet institucionale

Pyetja 7

Cilat janë tri tiparet kryesore të çorganizimit social?

- A) Konflikti i kulturës, mungesa e normave dhe kolapsi
- B) Urbanizimi, industrializimi dhe rritja e popullsisë
- C) Ndryshimet teknologjike, migrimi dhe lufta
- D) Përshtatja e normave, rregullimi dhe zhvillimi ekonomik

Pyetja 8

Sipas perspektivës së patologjisë sociale, cili është shkaku kryesor i problemeve sociale?

- A) Edukimi i pamjaftueshëm
- B) Dështimi në procesin e shoqërizimit
- C) Ndryshimet teknologjike dhe sociale
- D) Mungesa e bashkëpunimit ndërkombëtar

Pyetja 9

Si e interpretonte Ogburn fenomenin e çorganizimit social?

- A) Si mungesë e normave morale
- B) Si rezultat të vonësës kulturore midis ndryshimeve teknologjike dhe sociale
- C) Si pasojë të mungesës së bashkëpunimit ndërkulturor
- D) Si rezultat të dështimit të politikave qeveritare

Pyetja 10

Cila është një karakteristikë themelore e perspektivës së konfliktit të vlerave?

- A) Besimi se të gjitha shoqëritë janë homogjene në vlera
- B) Përqendrimi në mënyrën si ndryshojnë pritshmëritë dhe normat sociale
- C) Promovimi i një sistemi të centralizuar të organizimit social
- D) Përkufizimi i çështjeve ekonomike si të vetmet probleme sociale

Pyetja 11

Sipas teorisë së çorganizimit social, çfarë përfshin çorganizimi?

- A) Rritja e lidhjeve ndërmjet grupeve sociale
- B) Mungesa e rregullit ose koordinimit mes pjesëve të sistemit social
- C) Forcimi i marrëdhënieve kulturore
- D) Përdorimi i teknologjisë për të adresuar sfidat sociale

Pyetja 12

Çfarë roli kanë mitet në perceptimin e problemeve sociale?

- A) Ato ndihmojnë në shpjegimin objektiv të problemeve sociale
- B) Ato ndikojnë në krijimin e keqkuptimeve rreth shkaqeve të problemeve sociale
- C) Ato bazohen vetëm në të dhëna shkencore
- D) Ato promovojnë zgjidhje praktike për problemet sociale

Pyetja 13

Si ndikon konstruksionizmi social në perceptimin e problemeve sociale?

- A) E përkufizon problemin social bazuar në ndikimin ekonomik
- B) Vendos theksin te mënyra si grupet sociale e përkufizojnë problemin
- C) Analizon vetëm normat e imponuara nga institucionet
- D) Përcakton problemet sociale si të pandryshueshme ndër vite

Pyetja 14

Cila është një sfidë kryesore në studimin e miteve dhe fakteve?

- A) Mungesa e interesit publik ndaj problemeve sociale
- B) Ndarja midis informacionit të vërtetë dhe perceptimeve të gabuara
- C) Analiza e shkaqeve historike të problemeve sociale
- D) Qasja në të dhënat sociologjike bashkëkohore

Pyetja 15

Si e përkufizon perspektiva e çorganizimit social rolin e normave?

- A) Normat janë gjithmonë të paqarta dhe të pavlefshme
- B) Normat përcaktojnë mënyrën e bashkëveprimit social dhe ruajnë stabilitetin
- C) Normat nuk kanë rëndësi në shoqëri të zhvilluara
- D) Normat mund të zëvendësohen lehtësisht nga teknologjia

Pyetja 16

Cilat janë dallimet kryesore midis homoseksualëve meshkuj dhe lezbikeve sipas studimeve?

- A) Homoseksualët meshkuj janë më të prirur për marrëdhënie jashtë partnerit sesa lezbiket
- B) Lezbiket kanë më shumë probleme sociale sesa homoseksualët meshkuj
- C) Homoseksualët meshkuj kanë më pak ndikim social se lezbiket
- D) Nuk ka dallime të rëndësishme ndërmjet tyre

Pyetja 17

Cila është një karakteristikë e çifteve aseksuale?

- A) Kanë shumë shokë dhe janë të hapur për orientimin seksual
- B) Janë të rezervuar dhe kanë pak miq
- C) Kanë një jetë seksuale shumë aktive
- D) Organizojnë jetën rreth aktiviteteve sociale

Pyetja 18

Çfarë është alkoolizmi?

- A) Konsumimi i alkoolit në evente të veçanta
- B) Varësia fizike dhe psikologjike nga alkooli
- C) Përdorimi i alkoolit për relaksim
- D) Pirja vetëm e pijeve me përmbajtje të ulët alkooli

Pyetja 19

Cilat janë simptomat fizike të abuzimit me alkoolin?

- A) Përmirësim i gjumit dhe relaksim
- B) Dridhje në mëngjes dhe humbje të kujtesës
- C) Zvogëlim i dhimbjeve dhe qetësi mendore
- D) Rritje të humorit dhe koncentrimin

Pyetja 20

Cilat janë disa nga problemet emocionale të zakonshme?

- A) Përmirësimi i marrëdhënieve prind-fëmijë
- B) Depresioni, ndjenja e fajësisë, dhe agresiviteti
- C) Rritje e vetëbesimit dhe sigurisë
- D) Mungesa e konflikteve sociale

Pyetja 21

Cilat janë simptomat e sindromës alkoolike të të porsalindurit?

- A) Fytyrë e gjerë, hiperaktivitet dhe paaftësi në të mësuar
- B) Rritje në peshë dhe aftësi të avancuara mendore
- C) Ndjenjë sigurie dhe relaksimi
- D) Të folur të qartë dhe lëvizje precize

Pyetja 22

Cili është përkufizimi i krimin sipas normave sociale?

- A) Sjellje që përputhet me normat dhe ligjet e shoqërisë
- B) Veprim që shkel normat dhe ligjet sociale
- C) Përpjekje për të përmirësuar ligjet ekzistuese
- D) Sjellje që respekton autoritetet publike

Pyetja 23

Cila teori thekson ndikimin e llojit të kafkës në sjelljen kriminale?

- A) Teoria e konfliktit të klasës
- B) Teoria fenomenologjike
- C) Teoria lombroziane
- D) Teoria sociologjike e krimit

Pyetja 24

Kur u trajtua për herë të parë dhuna ndaj grave si shkelje e të drejtave të njeriut?

- A) Në vitin 1990
- B) Në korrik 1993
- C) Në vitin 2000
- D) Në dhjetor 1995

Pyetja 25

Çfarë përfshin diskriminimi i grave në shoqëri?

- A) Tolerim të roleve sociale të barabarta
- B) Praktika kulturore që përforcojnë shtëpiakëzimin e grave
- C) Barazi gjinore në të gjitha sferat e jetës
- D) Trajtim i njëjtë në arsim dhe punësim

Pyetja 26

Çfarë përfshin neglizhimi emocional i fëmijëve?

- A) Mosofrimi i ushqimit dhe strehimit
- B) Mungesë mbështetjeje dhe inkurajimi
- C) Mungesë e veshjeve dhe kujdesit mjekësor
- D) Trajtim i barabartë me të gjithë fëmijët

Pyetja 27

Cilat janë format kryesore të abuzimit të fëmijëve?

- A) Ushqim i pamjaftueshëm dhe edukim i ulët
- B) Keqtrajtimi fizik, emocional, dhe abuzimi seksual
- C) Diskriminim në shkollë dhe komunitet
- D) Mbështetje e vazhdueshme dhe kujdesi mjekësor

Pyetja 28

Cila është një nga të drejtat bazë të njeriut sipas Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut?

- A) E drejta për arsim falas
- B) E drejta për të poseduar armë
- C) E drejta për një mjedis të pastër
- D) E drejta për të zgjedhur dhe për të qenë i zgjedhur

Pyetja 29

Çfarë nënkupton e drejta për barazi gjinore?

- A) Gratë kanë përparësi ndaj burrave në vendimmartje
- B) Trajtim të barabartë për të gjithë, pa marrë parasysh gjininë
- C) Kufizim i roleve tradicionale gjinore
- D) Dominimi i burrave në pozita drejtuese



Pyetja 30

Cila është një nga arsyt kryesore të varfërisë në botë?

- A) Përhapja e teknologjisë moderne
- B) Mungesa e arsimimit dhe pabarazia ekonomike
- C) Ndhimat ndërkombëtare të pakontrolluara
- D) Organizimi i mirë i burimeve natyrore

Pyetja 31

Çfarë është varfëria absolute?

- A) Kur individët kanë të ardhura nën nivelin e varfërisë relative
- B) Mungesa e burimeve për të përmbushur nevojat themelore
- C) Pasja e më shumë borxheve sesa të ardhurave
- D) Jetesa me më pak të ardhura se pjesa tjetër e shoqërisë

Pyetja 32

Cila është një nga sfidat kryesore që lidhen me plakjen e popullsisë?

- A) Zvogëlimi i mundësive për arsimim
- B) Rritja e shpenzimeve për kujdesin shëndetësor
- C) Ulja e punësimit të të rinjve
- D) Mungesa e përfshirjes së teknologjisë

Pyetja 33

Si mund të përmirësohet cilësia e jetës për të moshuarit?

- A) Kufizimi i qasjes në shërbimet publike
- B) Rritja e përkrahjes sociale dhe qasja në shërbime mjekësore
- C) Inkurajimi i izolimit social
- D) Zvogëlimi i pensioneve për të moshuarit

Pyetja 34

Çfarë synon feminizmi si një lëvizje sociale?

- A) Shkatërrimin e strukturave tradicionale të familjes
- B) Barazinë gjinore në të gjitha sferat e jetës
- C) Dominimin e grave ndaj burrave
- D) Rritjen e privilegjeve për një grup të caktuar shoqëror

Pyetja 35

Si ka ndikuar feminizmi në ndryshimet ligjore?

- A) Ka kufizuar rolet e grave në tregun e punës
- B) Ka promovuar të drejta të barabarta për burrat dhe gratë
- C) Ka krijuar pabarazi të reja gjinore
- D) Ka eliminuar ligjet për mbrojtjen e grave

Pyetja 36

Cili është një nga faktorët kryesorë që ndihmon trafikimin njerëzor?

- A) Rritja e ndihmave ndërkombëtare
- B) Mungesa e zbatimit të ligjeve
- C) Liria e plotë për të udhëtuar
- D) Edukimi i përhapur në masë

Pyetja 37

Cili është një nga ndikimet e trafikimit të viktimat?

- A) Përmirësimi i jetës sociale dhe ekonomike
- B) Trauma psikologjike dhe shëndetësore
- C) Mundësi për të udhëtuar dhe zhvilluar karrierën
- D) Integrim i lehtë në shoqëri

Pyetja 38

Çfarë nënkupton diskriminimi i grupit?

- A) Trajtimi i barabartë i të gjitha grupeve
- B) Vendosja e privilegjeve për një grup specifik
- C) Një sistem i ndarjes së burimeve në mënyrë të drejtë
- D) Zvogëlimi i tensioneve midis grupeve sociale

Pyetja 39

Si ndikon paragjykimi ndaj grupeve në shoqëri?

- A) Forcon lidhjet ndërmjet komuniteteve
- B) Rrit harmoninë dhe barazinë sociale
- C) Thellon ndarjet dhe kufizon mundësitë për bashkëpunim
- D) Zhvillon praktika të drejta dhe të qëndrueshme sociale

Pyetja 40

Cila është një nga format kryesore të papunësisë?

- A) Papunësia ciklike
- B) Papunësia e përhershme
- C) Papunësia e kapitalizmit
- D) Papunësia e përkohshme për studentë

Pyetja 41

Cili është ndikimi kryesor i papunësisë së zgjatur tek individët?

- A) Rritja e produktivitetit personal
- B) Përmirësimi i mirëqenies sociale
- C) Ulja e vetëvlerësimit dhe shfaqja e depresionit
- D) Krijimi i lidhjeve të reja sociale

Pyetja 42

Si ndikon papunësia në kapitalin human?

- A) E rrit vlerën e kapitalit njerëzor
- B) Zhvlerëson aftësitë dhe arsimimin e fituar kur nuk përdoren për një kohë të gjatë
- C) Nuk ka ndikim në kapitalin njerëzor
- D) Nxiti investime të reja në arsimim

Pyetja 43

Cila formë papunësie ndodh për shkak të rënies së kërkesës për prodhim?

- A) Papunësia friksionale
- B) Papunësia strukturore
- C) Papunësia ciklike
- D) Papunësia sezonale

Pyetja 44

Cili është një efekt kryesor i urbanizimit në familjen tradicionale?

- A) Përforcimi i roleve tradicionale familjare
- B) Dobësimi i marrëdhënieve të fqinjësisë dhe kontrollit social

- C) Zhvillimi i komuniteteve të reja rurale
- D) Konsolidimi i zakoneve tradicionale

Pyetja 45

Cilat janë disa nga arsyet përse ndodh urbanizimi në vendet në zhvillim?

- A) Shkatërrimi i infrastrukturës urbane
- B) Mungesa e kushteve të jetesës në fshatra
- C) Stabiliteti politik në zonat rurale
- D) Rritja e prodhimit bujqësor

Pyetja 46

Si lidhet çorganizimi social me urbanizimin?

- A) Urbanizimi nxit ndërtimin e komuniteteve të forta tradicionale
- B) Urbanizimi çon në dobësimin e traditave dhe normave që kontrollojnë individët
- C) Urbanizimi rrit solidaritetin ndërmjet individëve
- D) Urbanizimi nuk ndikon në strukturën sociale

Pyetja 47

Cili është një faktor negativ i urbanizimit të shpejtë?

- A) Zhvillimi i shërbimeve publike
- B) Kriza e mbipopullimit dhe ndotjes
- C) Diversiteti kulturor
- D) Përmirësimi i kushteve të jetesës në qytete

Pyetja 48

Si ndikon imigrimi në çorganizimin social të qyteteve?

- A) Rrit numrin e institucioneve mbështetëse
- B) Dobëson lidhjet familjare dhe fqinjësore tradicionale
- C) Nuk ndikon në marrëdhëniet sociale
- D) Përmirëson integrimin social

Pyetja 49

Çfarë është obeziteti sipas përkufizimit mjekësor?

- A) Një problem psikologjik i lidhur me vetëvlerësimin
- B) Gjendje e trupit me përmbajtje të tepruar yndyrash ose dhjami
- C) Një problem i metabolizmit të ulët gjenetikisht
- D) Një formë ushtrimi që çon në përmirësim të shëndetit

Pyetja 50

Cilat janë disa nga pasojat kryesore shëndetësore të obezitetit?

- A) Diabeti, hipertensioni dhe sëmundjet kardiovaskulare
- B) Përmirësimi i metabolizmit dhe rritja e energjisë
- C) Ulja e stresit dhe shtimi i masës muskulore
- D) Rritja e përqendrimit dhe shëndetit mendor

Pyetja 51

Çfarë e shkakton HIV/AIDS-in?

- A) Infeksion bakterial që prek mëlçinë
- B) Virus që dëmton sistemin imunitar njerëzor
- C) Mungesë e ushqimeve me proteina
- D) Një infeksion që shërohet lehtësisht me antibiotikë

Pyetja 52

Cilat janë rrugët më të zakonshme të transmetimit të HIV/AIDS-it?

- A) Përmes kontaktit të përditshëm si përqaftimi dhe shtrëngimi i duarve
- B) Përdorimi i pajisjeve të ndara të injektimit dhe marrëdhëniet seksuale të pambrojtura
- C) Të folurit afër dikujt që është i infektuar
- D) Konsumimi i ushqimit të kontaminuar

Pyetja 53

Cilat janë pasojat sociale dhe ekonomike të luftës?

- A) Rritja e punësimit dhe stabilitetit ekonomik
- B) Shkatërrimi i infrastrukturës dhe migrimi i detyruar
- C) Përmirësimi i marrëdhënieve ndërkombëtare
- D) Stabilizimi i rajoneve të prekura nga konflikti

Pyetja 54

Si ndikon lufta në shëndetin e popullatës?

- A) Përmirëson cilësinë e shërbimeve shëndetësore
- B) Shton përhapjen e sëmundjeve infektive dhe plagëve të luftës
- C) Redukton stresin dhe përmirëson shëndetin mendor
- D) Nuk ka ndikim në shëndetin e përgjithshëm

Pyetja 55

Cilat janë disa aspekte sociale që ndihmojnë në formimin e dallimeve seksuale?

- A) Gjenetika dhe biologjia
- B) Traditat dhe pritshmëritë kulturore
- C) Ushqimi dhe aktiviteti fizik
- D) Gjeografia dhe klima

Pyetja 56

Cili është një mit i zakonshëm për rolet gjinore?

- A) Gratë janë biologjikisht më të mira në kujdesin për fëmijët
- B) Gratë kanë aftësi të barabarta në çdo aspekt të jetës
- C) Roli gjinor nuk ndikon në jetën sociale
- D) Roli gjinor përcaktohet vetëm nga zgjedhjet personale

Pyetja 57

Çfarë nënkupton seksualiteti fluid?

- A) Një seksualitet i përcaktuar qartë gjatë gjithë jetës
- B) Ndryshime në tërheqjen seksuale gjatë jetës
- C) Kufizime nga rregullat shoqërore
- D) Një zgjedhje vetëm për individët e rinj

Pyetja 58

Si ndikon shoqëria në perceptimin e orientimit seksual?

- A) Shoqëria gjithmonë e mbështet orientimin seksual
- B) Normat shoqërore shpesh stigmatizojnë orientimin seksual
- C) Nuk ka ndikim të dukshëm
- D) Shoqëria ndihmon në diversitetin seksual

Pyetja 59

Cila është një nga pasojat e diskriminimit gjinor?

- A) Trajtim i barabartë në vendin e punës
- B) Rritje e vetëbesimit të gratë
- C) Pabarazi në arsim dhe punësim
- D) Zhvillim ekonomik më i shpejtë

Pyetja 60

Cila substancë konsiderohet drogë e lehtë?

- A) Heroina
- B) Kanabisi
- C) Alkooli
- D) Kokaina

Pyetja 61

Cili është një faktor kryesor që ndikon në varësinë nga alkooli?

- A) Mungesa e ujit të pijshëm
- B) Gjendja emocionale dhe faktorët socialë
- C) Dieta vegjetariane
- D) Ndërprerja e konsumit të kafesë

Pyetja 62

Cila është një pasojë shëndetësore e përdorimit të gjatë të drogës?

- A) Përmirësimi i përqendrimit
- B) Dëmtime të organeve jetësore si mëlçia dhe zemra
- C) Reduktimi i stresit afatgjatë
- D) Jetëgjatësi më e madhe

Pyetja 63

Çfarë nënkupton varësia psikologjike?

- A) Nevojën e vazhdueshme fizike për një substancë.
- B) Përdorimin e drogës për të ndjerë kënaqësi emocionale.
- C) Tolerancën ndaj substancave.
- D) Ndikimin e gjenetikës në varësi

Pyetja 64

Cili është një hap i rëndësishëm për të trajtuar varësinë nga alkooli?

- A) Izolimi total nga shoqëria
- B) Mbështetja në terapi dhe grupe mbështetëse
- C) Konsumi i rregullt i alkoolit
- D) Ignorimi i problemeve emocionale

Pyetja 65

Si ndikon stigma ndaj orientimit seksual në mirëqenien emocionale të individëve?

- A) E përmirëson aftësinë për t'u përballur me sfida
- B) Rrit nivelet e stresit dhe ankthit
- C) Nuk ka ndikim të rëndësishëm
- D) Redukton ndjenjën e izolimit social

Pyetja 66

Çfarë do të thotë "diskriminimi sistematik ndaj grupeve LGBTQ+?"

- A) Mungesa e mundësive për grupet LGBTQ+ për të formuar komunitete
- B) Përjashtimi ose kufizimi në institucione shoqërore dhe ekonomike
- C) Mbështetje e barabartë për të gjitha grupet sociale
- D) Përfshirja aktive e grupeve LGBTQ+ në çdo sektor

Pyetja 67

Cili është roli i edukimit seksual në reduktimin e dallimeve seksuale?

- A) Zhvillimi i stereotipeve të reja
- B) Përmirësimi i mirëkuptimit dhe respektit për dallimet
- C) Përforsimi i roleve tradicionale gjinore
- D) Shmangia e diskutimit mbi orientimin seksual

Pyetja 68

Cili është ndikimi i përdorimit të alkoolit në sjelljen kriminale?

- A) Ul rrezikun e konflikteve sociale
- B) Përmirëson vetëkontrollin
- C) Rrit sjelljet impulsive dhe agresive
- D) Nuk ka asnjë ndikim

Pyetja 69

Cili është një faktor që kontribuon në abuzimin me substanca nga të rinjtë?

- A) Mbështetja e fortë familjare
- B) Presioni i grupit dhe mungesa e mbështetjes sociale
- C) Përfshirja në aktivitete sportive
- D) Njohuritë e mira për efektet e drogës

Pyetja 70

Çfarë është varësia e dyfishtë?

- A) Abuzimi me dy ose më shumë substanca njëkohësisht
- B) Varësia ndaj ushqimit dhe alkoolit
- C) Një kombinim i varësisë fizike dhe psikologjike
- D) Përdorimi i substancave vetëm në evente sociale

Pyetja 71

Cili është ndikimi i mungesës së qasjes në kujdesin shëndetësor?

- A) Përmirësim i shëndetit publik
- B) Rritje e rasteve të sëmundjeve të parandalueshme
- C) Përmirësim i shëndetit të individëve me të ardhura të ulëta
- D) Zvogëlim i stresit emocional

Pyetja 72

Cilat janë faktorët kryesorë që kontribuojnë në sëmundjet mendore?

- A) Ushqimi i shëndetshëm dhe aktivitetet fizike
- B) Stresi, faktorët biologjikë dhe mjedisorë
- C) Përkrahja e vazhdueshme sociale
- D) Qasja e lehtë në kujdes shëndetësor

Pyetja 73

Cili është një nga faktorët kryesorë që ndikon në shkallën e kriminalitetit?

- A) Stabiliteti ekonomik
- B) Mungesa e arsimit dhe mundësive ekonomike

- C) Qasja në shërbime sociale
- D) Të ardhurat e larta

Pyetja 74

Çfarë nënkupton "teoria e tensionit" në kriminologji?

- A) Krimi ndodh për shkak të stresit të jashtëm të tepërt
- B) Krimi është i lidhur me mungesën e qasjes në mjetet legjitime për të arritur qëllime
- C) Krimi është një fenomen biologjik
- D) Krimi ndodh vetëm në zona urbane

Pyetja 75

Cila është një nga arsyet kryesore për diskriminimin gjinor në punësim?

- A) Mungesa e arsimimit për burrat
- B) Stereotipet dhe pritshmëritë kulturore ndaj grave
- C) Dominimi i grave në sektorin privat
- D) Mungesa e barazisë në nivel të arsimit të lartë

Pyetja 76

Cilat janë përfitimet e arritjes së barazisë gjinore?

- A) Zvogëlimi i mundësive për gratë
- B) Rritja e produktivitetit dhe inovacionit
- C) Kufizimi i rolit të burrave në shoqëri
- D) Shkatërrimi i traditave kulturore

Pyetja 77

Çfarë përfshin abuzimi emocional i fëmijëve?

- A) Shprehje dashurie dhe përkrahjeje
- B) Kritika e vazhdueshme dhe poshtërimi
- C) Kujdesi i shtuar ndaj fëmijëve
- D) Mbështetja e tyre në të gjitha aspektet

Pyetja 78

Cilat janë disa nga shenjat e abuzimit fizik të fëmijët?

- A) Lëvizje të shpejta dhe të qëndrueshme
- B) Mungesa e shenjave të jashtme
- C) Shfaqja e mavijosjeve, plagëve ose frakturave
- D) Vetëbesim i shtuar

Pyetja 79

Cila është një nga të drejtat e garantuara nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut?

- A) E drejta për të zotëruar armë
- B) E drejta për të jetuar dhe për të qenë i lirë
- C) E drejta për të përjashtuar të tjerët nga prona publike
- D) E drejta për t'i mohuar të tjerëve lirinë e mendimit

Pyetja 80

Cilat janë përgjegjësitë e një shteti për të drejtat e njeriut?

- A) Të promovojë dhe mbrojnë të drejtat për të gjithë individët
- B) Të përqendrohet vetëm në të drejtat e minoriteteve
- C) Të sigurojë privilegje për një grup specifik

D) Të kufizojë lirinë e fjalës për të parandaluar konfliktet

Pyetja 81

Çfarë nënkupton e drejta për liri nga tortura?

- A) Të jesh i mbrojtur nga trajtimi çnjerëzor
- B) Të jesh i lirë nga çdo lloj detyrimi financiar
- C) Të kesh akses në pronën publike
- D) Të kesh liri të plotë për të përdorur forcat shtetërore

Pyetja 82

Çfarë është varfëria relative?

- A) Kur individët nuk mund të përmbushin nevojat bazë
- B) Kur të ardhurat janë më të ulëta krahasuar me standardet e shoqërisë
- C) Kur një person ka akses të kufizuar në arsim
- D) Kur varfëria ndikon vetëm në zonat rurale

Pyetja 83

Cili është ndikimi i pabarazisë ekonomike në shoqëri?

- A) Rritje e stabilitetit shoqëror
- B) Rritje e tensioneve sociale dhe konflikteve
- C) Përmirësim i shanseve të barabarta
- D) Rritje e mundësive për punësim

Pyetja 84

Cili është një faktor kryesor që kontribuon në pabarazinë ekonomike globale?

- A) Politikat e barazisë gjinore
- B) Globalizimi dhe shpërndarja e pabarabartë e burimeve
- C) Përmirësimi i arsimit në vendet e varfra
- D) Qasja e barabartë në teknologji

Pyetja 85

Cila është një nga sfidat kryesore të plakes së popullsisë?

- A) Rritja e përfshirjes së teknologjisë
- B) Rritja e barrës mbi sistemet e kujdesit shëndetësor dhe pensioneve
- C) Ulja e nivelit të arsimit për të moshuarit
- D) Rritja e të rinjve në tregun e punës

Pyetja 86

Cili është një faktor që ndihmon në përmirësimin e cilësisë së jetës për të moshuarit?

- A) Mbështetja sociale dhe shërbimet shëndetësore cilësore
- B) Izolimi nga komuniteti
- C) Kufizimi i aktiviteteve sociale
- D) Reduktimi i pensioneve

Pyetja 87

Çfarë synon lëvizja feministe?

- A) Barazinë gjinore në të gjitha aspektet e jetës



- B) Përjashtimin e burrave nga fuqia punëtore
- C) Kufizimin e të drejtave të grave
- D) Krijimin e privilegjeve për një grup specifik gjinor

Pyetja 88

Cili është një faktor kryesor që ndihmon në trafikimin e njerëzve?

- A) Politikat strikte për emigracionin
- B) Mungesa e ligjeve dhe zbatimit të tyre
- C) Qasja në arsim falas
- D) Konsolidimi i familjeve tradicionale

Pyetja 89

Cili është një ndikim psikologjik i zakonshëm i trafikimit?

- A) Ndjenja e sigurisë dhe stabilitetit
- B) Trauma, ankthi dhe depresioni
- C) Përmirësim i marrëdhënieve ndërpersonale
- D) Rritje e shanseve për punësim

Pyetja 90

Cila është një nga pasojat e paragjyqimit ndaj grupeve shoqërore?

- A) Harmonizimi i marrëdhënieve ndërmjet grupeve
- B) Përkeqësimi i mundësive për arsim dhe punësim
- C) Përmirësimi i lidhjeve komunitare
- D) Reduktimi i konfliktit social

Pyetja 91

Cili është një faktor që përforcon diskriminimin ndaj grupeve?

- A) Edukimi i mirëfilltë mbi diversitetin
- B) Përdorimi i stereotipeve dhe normave shoqërore
- C) Zhvillimi i programeve të barazisë
- D) Mbështetja për politika gjithëpërfshirëse

Pyetja 92

Cili faktor kontribuon më shumë në dallimet gjinore në vendin e punës?

- A) Diskriminimi sistematik dhe stereotipet gjinore
- B) Mungesa e arsimimit për burrat
- C) Toleranca sociale ndaj grave
- D) Kufizimi i punësimit për të rinjtë

Pyetja 93

Si ndikon mungesa e qasjes në kujdesin shëndetësor në varfërinë?

- A) Përmirëson cilësinë e jetës së varfërve
- B) Rrit sëmundjet dhe ndikon në pabarazinë sociale
- C) Zvogëlon shpenzimet qeveritare
- D) Eliminon ndihmat ndërkombëtare

Pyetja 94

Cila është një nga shkaqet kryesore të kriminalitetit urban?

- A) Përhapja e edukimit dhe teknologjisë
- B) Mungesa e mundësive ekonomike dhe shërbimeve sociale
- C) Rritja e nivelit të arsimit
- D) Rritja e ndihmave sociale

Pyetja 95

Cilat janë pasojat kryesore të trafikimit të grave?

- A) Përmirësim i kushteve të jetesës së viktimave
- B) Trauma psikologjike, dhunë dhe izolim shoqëror
- C) Rritje e mundësive për karrierë
- D) Qasja e lehtë në shërbimet shëndetësore

Pyetja 96

Si ndikon diskriminimi gjinor në arsim?

- A) Përmirëson shanset për edukim cilësor për të gjithë
- B) Kufizon qasjen e grave dhe vajzave në arsim
- C) Zvogëlon nevojën për reforma arsimore
- D) Nuk ka ndikim në arsimimin e vajzave

Pyetja 97

Cili është një faktor kryesor në abuzimin e fëmijëve?

- A) Mbështetja e fortë familjare
- B) Mungesa e stabilitetit ekonomik dhe prindërimi abuziv
- C) Qasja në arsim cilësor
- D) Angazhimi në aktivitete shoqërore

Pyetja 98

Cili është ndikimi i urbanizimit të shpejtë në strukturat familjare?

- A) Forcon lidhjet ndërmjet brezave
- B) Dobëson marrëdhëniet tradicionale familjare dhe rrit presionin ekonomik
- C) Nuk ndikon në strukturat familjare
- D) Krijon një jetë më të thjeshtë për familjet rurale

Pyetja 99

Si ndikon varfëria në përhapjen e sëmundjeve kronike?

- A) Ul numrin e rasteve me sëmundje
- B) Rrit rrezikun e aksesit të kufizuar në kujdes shëndetësor dhe ushqim cilësor
- C) Nuk ka ndikim në përhapjen e sëmundjeve
- D) Redukton nevojën për kujdes mjekësor

Pyetja 100

Cili është një nga qëllimet e barazisë gjinore?

- A) Promovimi i rolit të grave si shtëpiake
- B) Krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë pa dallim gjinie
- C) Kufizimi i pjesëmarrjes së burrave në arsim

D) Rritja e dominimit ekonomik të një grupi gjinor

## **Kapitulli 7. Puna Sociale me Fëmijët**

Pyetja 1

Cila teori e lidhjes së fëmijës me nënën thekson se kjo lidhje ka një bazë biologjike, pasi nëna "kënaq si nevojat biologjike, ashtu edhe nevojën për t'u lidhur me njerëzit e tjerë" ?

- A) Teoria psikoanalitike e Frojdit
- B) Teoria e të mësuarit social
- C) Teoria e Harlow
- D) Teoria e Bowlby

Pyetja 2

Çfarë theksojnë disa teori psikologjike rreth foshnjave dhe marrëdhënieve sociale?

- A) Foshnjat lindin me një aftësi të lindur për të pëlqyer të tjerët.
- B) Foshnjat janë të lindura pa ndonjë prirje të veçantë për t'i pëlqyer ose jo të tjerët.
- C) Foshnjat nuk kanë nevojë për marrëdhënie sociale.
- D) Marrëdhëniet sociale janë të njëjta për të gjithë fëmijët.

Pyetja 3

Cila është rëndësia e veprimeve si gudulisja dhe përkëdhelja ndaj foshnjave?

- A) Krijojnë lidhje sociale të forta mes foshnjës dhe prindit.
- B) Rrisin frikën e foshnjës ndaj të panjohurve.
- C) I bëjnë foshnjat të pavarura.
- D) Nuk kanë ndikim të rëndësishëm në marrëdhëniet sociale.

Pyetja 4

Si ndikon lidhja bidireksionale midis nënës dhe foshnjës në zhvillimin social?

- A) Ndhmon foshnjën të rrisë aftësitë për të përpunuar informacionin.
- B) Shkakton izolim social.
- C) Nuk ka ndikim në marrëdhëniet sociale.
- D) E bën foshnjën të shmangë të tjerët jashtë familjes.

Pyetja 5

Çfarë roli luan dashuria në krijimin e lidhjes bidireksionale?

- A) Është e rëndësishme vetëm në fillim të jetës
- B) Ndhmon në zhvillimin e perceptimit dhe motorikës së fëmijës
- C) Ul gradualisht intensitetin e lidhjes me nënën
- D) Ndhmon fëmijën të shmangë frikën ndaj të panjohurve

Pyetja 6

Cilat janë dy momentet kryesore të jetës sociale të fëmijës?

- A) Frika nga të panjohurit dhe ankthi i ndarjes.
- B) Pavarësia nga prindërit dhe socializimi me të panjohurit.
- C) Fillimi i të folurit dhe përmirësimi i aftësive motorike.
- D) Krijimi i marrëdhënieve me familjarët dhe të huajt.

Pyetja 7

Çfarë përjeton një foshnjë gjatë frikës nga të panjohurit?

- A) Ndjenja qetësie dhe rehatie.

- B) Nervozizëm dhe ankth.
- C) Interes të shtuar ndaj të panjohurve.
- D) Shmangie totale të të afërmeve.

Pyetja 8

Kur shfaqet ankthi i ndarjes tek foshnjat?

- A) Kur janë të ndara nga nëna për një kohë të gjatë.
- B) Kur janë të panjohur në mjedisin e tyre.
- C) Kur i ndahen një lodre të preferuar.
- D) Kur janë në praninë e njerëzve të huaj.

Pyetja 9

Si mund të lehtësohet ankthi i ndarjes tek fëmijët?

- A) Duke shmangur plotësisht ndarjen nga nëna.
- B) Duke i siguruar fëmijës një ndjenjë të vazhdueshme sigurie.
- C) Duke e lënë fëmijën të përballet vetëm me ankthin.
- D) Duke kufizuar ndërveprimin e tij me të tjerët.

Pyetja 10

Çfarë ndodh kur një foshnjë fillon të përpunojë informacionin dhe të ndërveprojë me të tjerët?

- A) Ai/ajo bëhet më i/e izoluar.
- B) Ai/ajo zhvillon më shumë kontakte sociale.
- C) Ai/ajo e shmang ndërveprimin.
- D) Ai/ajo ndalon zhvillimin social.

Pyetja 11

Cila është lidhja mes eksperiencave sociale të hershme dhe aftësisë së fëmijës për të komunikuar?

- A) Ato nuk ndikojnë në aftësinë e komunikimit.
- B) Ato vendosin nëse fëmija do të komunikojë normalisht apo me vështirësi.
- C) Ato gjithmonë çojnë në izolim.
- D) Ato kufizojnë zhvillimin e lidhjeve të mëvonshme sociale.

Pyetja 12

Pse procesi i socializimit i fëmijës konsiderohet kompleks?

- A) Për shkak të përfshirjes vetëm të nënës.
- B) Për shkak të periudhave të zgjerimit dhe tkurrjes.
- C) Sepse fëmijët nuk përjetojnë asnjë ndryshim social.
- D) Sepse marrëdhëniet sociale janë të thjeshta

Pyetja 13

Cila teori thekson rëndësinë e ushqimit dhe kujdesit në lidhjen e fëmijës me nënën?

- A) Teoria psikoanalitike
- B) Teoria e të mësuarit social
- C) Teoria e Harlow
- D) Teoria konjektiviste

Pyetja 14

Cili studiuues thekson "vallëzimin e përbashkët" midis nënës dhe fëmijës si bazë për lidhjen e tyre?

- A) Freud
- B) Schaffer
- C) Bowlby
- D) Harlow

Pyetja 15

Cili është thelbi i teorisë së Harlow në lidhjen e fëmijës me nënën?

- A) Ushqyerja është faktori kryesor
- B) Prekja dhe ngrohtësia janë elemente kyçe
- C) Kapaciteti mendor i fëmijës është thelbësor
- D) Qarja dhe sinjalet janë të mjaftueshme

Pyetja 16

Sipas teorisë psikoanalitike, cili është motivi kryesor i lidhjes së fëmijës me nënën?

- A) Nevoja për siguri emocionale
- B) Predispozita biologjike për të plotësuar nevojat jetike dhe sociale
- C) Zhvillimi i kuriozitetit
- D) Ndikimi i kujdestarit të parë

Pyetja 17

Sipas teorisë psikoanalitike të Frojdit, cilat janë arsyet përse fëmija lidhet me nënën:

- A) Për shkak të aftësive të saj për të ulur ankthin
- B) Për të plotësuar nevojat biologjike dhe sociale
- C) Për shkak të përkëdheljes dhe ngrohtësisë
- D) Për shkak të kapacitetit mendor të fëmijës

Pyetja 18

Cila teori shpjegon se lidhja krijohet pasi fëmija zhvillon aftësinë për të njohur nënën edhe kur ajo mungon?

- A) Teoria psikoanalitike
- B) Teoria konjektiviste
- C) Teoria e Harlow
- D) Teoria e Bowlby

Pyetja 19

Cila është një karakteristikë që Bowlby përmend si e rëndësishme për të tërhequr vëmendjen e fëmijës?

- A) Ushqyerja e vazhdueshme
- B) Prekja dhe përkëdhelja
- C) Zëri, aroma dhe shikimi i nënës
- D) Prania e kontakteve të ndryshme sociale

Pyetja 20

Cili faktor shpjegon pse disa fëmijë tremben nga të panjohurit?

- A) Nivelet e ulëta të socializimit
- B) Ndryshimet në rutinën e tyre të përditshme
- C) Diferencat në tiparet e të panjohurit krahasuar me modelin e njohur
- D) Shumë kontakte me njerëz të tjerë

Pyetja 21

Çfarë ndodh kur fëmija ka frikë nga të panjohurit?

- A) Shfaq më shumë interes për babanë
- B) Kërkon afërsinë e nënës
- C) Ndërpret lidhjen me kujdestarin
- D) Tërhiqet nga çdo marrëdhënie sociale

Pyetja 22

Çfarë justifikon gradualisht largimin e fëmijës nga lidhja me nënën sipas Bowlby?

- A) Rritja e fëmijës dhe zhvillimi i kuriozitetit
- B) Ndryshimet në rutinën e kujdestarisë
- C) Rritja e numrit të të panjohurve rreth fëmijës
- D) Përbushja e plotë e nevojave biologjike

Pyetja 23

Cili është mesazhi kryesor i "teorisë së dashurisë" në lidhjen e fëmijës me nënën?

- A) Kujdesi fizik është i mjaftueshëm për zhvillimin emocional
- B) Dashuria dhe shprehja e afeksionit janë thelbësore
- C) Distanca emocionale ndihmon pavarësinë
- D) Ndryshimi i shpeshtë i kujdestarëve është normal

Pyetja 24

Cili është roli kryesor i dashurisë në krijimin e lidhjes së fëmijës me nënën?

- A) Krijon ndjenja sigurie dhe besimi
- B) Nxiti zhvillimin e aftësive njohëse
- C) Ndihmon në reduktimin e ankthit ndaj të panjohurve
- D) Lidh fëmijën vetëm me ushqimin

Pyetja 25

Cili është përfitimi social i lidhjes së fëmijës me nënën?

- A) Mësimi i ndarjes dhe pavarësisë nga një moshë e hershme
- B) Zhvillimi i aftësive motorike pa ndihmë
- C) Sigurimi i bazës për lidhjet me njerëz të tjerë
- D) Reduktimi i frikës nga të panjohurit

Pyetja 26

Cila teori shpjegon se lidhja krijohet pasi fëmija zhvillon aftësinë për të njohur nënën edhe kur ajo mungon?

- A) Teoria psikoanalitike
- B) Teoria konjektiviste
- C) Teoria e Harlow
- D) Teoria e Bowlby

Pyetja 27

Çfarë thekson Bowlby si bazë për lidhjen bidireksionale midis fëmijës dhe nënës?

- A) Evolucionin dhe sjellja për mbijetesë
- B) Ushqyerja dhe përkujdesja
- C) Dashuria dhe përkëdhelja
- D) Kapaciteti njohës i fëmijës

Pyetja 28

Cili faktor shpjegon pse disa fëmijë tremben nga të panjohurit?

- A) Nivelet e ulëta të socializimit

- B) Ndryshimet në rutinën e tyre të përditshme
- C) Diferencat në tiparet e të panjohurit krahasuar me modelin e njohur
- D) Shumë kontakte me njerëz të tjerë

Pyetja 29

Çfarë justifikon gradualisht largimin e fëmijës nga lidhja me nënën sipas Bowlby?

- A) Rritja e fëmijës dhe zhvillimi i kuriozitetit
- B) Ndryshimet në rutinën e kujdestarisë
- C) Rritja e numrit të të panjohurve rreth fëmijës
- D) Përmbushja e plotë e nevojave biologjike

Pyetja 30

Cili është përfitimi social i lidhjes së fëmijës me nënën?

- A) Mësimi i ndarjes dhe pavarësisë nga një moshë e hershme
- B) Zhvillimi i aftësive motorike pa ndihmë
- C) Sigurimi i bazës për lidhjet me njerëz të tjerë
- D) Reduktimi i frikës nga të panjohurit

Pyetja 31

Sipas Harlow, cilat janë elementet kryesore që forcojnë lidhjen e fëmijës me kujdestarin?

- A) Ushqimi dhe ulja e ankthit
- B) Prekja, ngrohtësia dhe përkëdhelja
- C) Sinjalet e fëmijës si qarja dhe buzëqeshja
- D) Zhvillimi i aftësive njohëse

Pyetja 32

Çfarë sugjeron teoria konjitiviste për lidhjen e fëmijës me nënën?

- A) Lidhja zhvillohet kur fëmija ndjen ngrohtësi emocionale
- B) Fëmija lidhet kur arrin të njohë nënën edhe kur ajo nuk është e pranishme
- C) Lidhja është rezultat i ndërveprimeve të sinjaleve dhe reagimeve
- D) Evolucioni është baza e lidhjes

Pyetja 33

Cili aspekt i lidhjes së fëmijës me nënën ka një ndikim të madh në marrëdhëniet me të tjerët?

- A) ushqyerja dhe përkujdesja
- B) dashuria dhe shprehja e afeksionit
- C) frika nga të panjohurit
- D) sinjalet që përdor fëmija për të tërhequr vëmendjen

Pyetja 34

Përse lidhja e fëmijës me babanë studiohet më pak se ajo me nënën?

- A) Sepse është më pak e rëndësishme
- B) Sepse kujdestaria zakonisht fokusohet tek nëna
- C) Sepse lidhja me babanë krijohet më vonë
- D) Sepse është e vështirë të studiohet e matet

Pyetja 35

Çfarë roli luan ekzistenca e familjes në zhvillimin social të fëmijës?

- A) Siguron vetëm kujdesin fizik
- B) Ndikon në natyrën e marrëdhënieve të fëmijës me të tjerët

- C) Ndalon fëmijën të ketë kontakt me shoqërinë
- D) Ka ndikim të njëjtë për të gjithë fëmijët pavarësisht atmosferës familjare

Pyetja 36

Si ndikon atmosfera familjare në zhvillimin e fëmijës?

- A) Familjet e mëdha gjithmonë ndihmojnë në zhvillimin e shpejtë të fëmijës
- B) Familjet me marrëdhënie të ngrohta krijojnë një proces të lehtë socializimi
- C) Familjet strikte ndihmojnë fëmijët të bëhen më të pavarur
- D) Familjet e vogla janë më të favorshme për zhvillimin social

Pyetja 37

Çfarë karakteristikash kanë fëmijët e familjeve me natyrë të hapur dhe pjesëmarrëse?

- A) Janë të pavarur dhe të aftë të debatojnë
- B) Janë të urtë dhe të varur nga të rriturit
- C) Janë të prirur për të shmangur komunikimin
- D) Janë pasivë dhe të tërhequr

Pyetja 38

Çfarë ndodh zakonisht me fëmijët në familjet me natyrë strikte dhe të ngurtë?

- A) Bëhen më të pavarur dhe të sigurt
- B) Shfaqin vështirësi në shprehjen e mendimeve të tyre
- C) Kanë zhvillim më të shpejtë social për shkak të rregullave
- D) Ndërtojnë lidhje më të forta me të tjerët jashtë familjes

Pyetja 39

Cili faktor lidhet me pasivitetin dhe mungesën e iniciativës te fëmijët e parë?

- A) Kujdesi dhe vëmendja e shtuar nga prindërit
- B) Presioni nga prindërit për të qenë liderë
- C) Ndikimi i fëmijëve më të vegjël në familje
- D) Mungesa e një shembulli për t'u ndjekur

Pyetja 40

Pse fëmijët e dytë dhe më tej, raportohet se shfaqin më shumë iniciativë dhe krijimtari?

- A) Marrin më shumë kujdes dhe vëmendje nga prindërit
- B) Imitojnë sjelljet e fëmijëve më të rritur dhe mësojnë më shpejt
- C) Kanë më shumë mbështetje nga të tjerët në familje
- D) Prindërit fokusohen vetëm te zhvillimi i tyre social

Pyetja 41

Cili është një avantazh i fëmijëve të vetëm në procesin e socializimit?

- A) Marrin më shumë kohë për t'u mësuar me modele sociale
- B) Kanë më pak sfida në ndërtimin e marrëdhënieve me të tjerët
- C) Prindërit fokusohen në pasurimin e marrëdhënieve të tyre familjare
- D) Kanë aftësi të natyrshme për t'u përshtatur me grupet shoqërore

Pyetja 42

Kur fëmijët fillojnë të kuptojnë njëri-tjetrin si qenie sociale?

- A) Pas moshës njëvjeçare
- B) Pas moshës dyvjeçare
- C) Para moshës dyvjeçare



D) Pas moshës katërvjeçare

Pyetja 43

Çfarë përmirëson kontakti me fëmijët e tjerë në fazat e hershme të jetës?

- A) Egocentrizmin dhe agresionin
- B) Prirjen për varësi ndaj të rriturve
- C) Sjelljet prosociale dhe mirëpritjen mes shokëve
- D) Vështirësitë në ndërtimin e marrëdhënieve sociale

Pyetja 44

Çfarë është tipike për fëmijët që rriten në mjedise familjare të ngrohta?

- A) Kanë vështirësi në adaptim jashtë familjes
- B) Shfaqin sjellje prosociale dhe janë të prirur për të ndikuar tek të tjerët
- C) Janë të tërhequr dhe të pasigurt në mjedise të reja
- D) Nuk krijojnë marrëdhënie të ngushta jashtë familjes

Pyetja 45

Cili është postulati kryesor i përmendur në tekst për përgjegjësinë e prindërve ndaj fëmijëve të tyre?

- A) Fëmijët janë përgjegjës për veprimet e prindërve të tyre
- B) Prindërit janë plotësisht përgjegjës për atë që bëhen fëmijët e tyre
- C) Fëmijët zhvillohen më mirë pa ndërhyrje të prindërve
- D) Librat dhe manualët zëvendësojnë rolin e prindërve

Pyetja 46

Sipas Benjamin Spock, cilat janë disa nga arsyet pse prindërit mund të mos krijojnë lidhje të forta afektive me fëmijët e tyre?

- A) Mungesa e literaturës për edukimin e fëmijëve
- B) Femija është i dobët ose më pak i adaptueshëm
- C) Ardhja e fëmijës ka qenë e padëshiruar ose aksidentale
- D) Prindërit janë gjithmonë emocionalisht të gatshëm për fëmijët e tyre

Pyetja 47

Çfarë sugjeron Haim Ginnot për mënyrën e komunikimit me fëmijët?

- A) Duhet kritikuar sjellja dhe jo personaliteti i fëmijës
- B) Prindërit duhet të shmangin çdo lloj kritike ndaj fëmijës
- C) Duhet përdorur një qasje e ashpër për të korrigjuar gabimet
- D) Duhet të vlerësohet çdo veprim i fëmijës si një arritje e madhe

Pyetja 48

Sipas Lee Salk, çfarë ndihmon në krijimin e një zhvillimi emocional të shëndetshëm?

- A) Përdorimi i disziplines si një formë ndëshkimi
- B) Zhvillimi i marrëdhënieve të besimit midis fëmijës dhe prindit
- C) Krijimi i një ambienti të kufizuar për fëmijën
- D) Ignorimi i pyetjeve të fëmijëve për të shmangur përgjigje të vështira

Pyetja 49

Sipas Burton White, cili është një nga faktorët kyç për zhvillimin intelektual të fëmijës?

- A) Disiplina e rreptë dhe ndëshkimi i shpeshtë
- B) Eksplorimi i ambientit rrethues dhe krijimi i kushteve të sigurta
- C) Mosndërhyrja në vendimet e fëmijës
- D) Limitimi i kontakteve sociale të fëmijës për të shmangur ndikimet e jashtme

Pyetja 50

Çfarë do të thotë fleksibiliteti i fëmijëve sipas autorëve Benjamin Spock, Lee Salk, Haim Ginnot, Burton White?

- A) Ata përshtaten vetëm me rregulla strikte
- B) Nuk ka vetëm një mënyrë të duhur për t'i rritur ata
- C) Fëmijët gjithmonë reagojnë pozitivisht ndaj kornizave strikte
- D) Prindërit nuk mund të ndikojnë në përshtatshmërinë e tyre

Pyetja 51

Cili është fokusi kryesor i një vlerësimi gjithëpërfshirës në mbrojtjen e fëmijëve?

- A) Stabiliteti financiar i familjes
- B) Nevojat e fëmijës, të familjes dhe të sigurisë
- C) Performanca akademike e fëmijës
- D) Ndjekja e shkollës së fëmijës

Pyetja 52

Cili faktor ndikon më shumë në frikën e fëmijëve gjatë hospitalizimit?

- A) Trajtimet mjekësore të panjohura
- B) Prania e mungaur e nënës së tyre
- C) Moshja e fëmijëve të tjerë në spital
- D) Temperatura e dhomës së spitalit

Pyetja 53

Çfarë sugjerohet në kontekstin teorik, për edukimin në grup të fëmijëve?

- A) Është mënyra më e mirë për fëmijët që kanë pak kontakte me të tjerët
- B) Duhet të shmanget për shkak të ndikimeve negative të grupit
- C) Nuk ka ndikim në zhvillimin social të fëmijës
- D) Është efektive vetëm për fëmijët mbi 10 vjeç

Pyetja 54

Cila është rëndësia e krijimit të një ambienti interesant për fëmijët?

- A) Ndihmon në kufizimin e sjelljeve problematike
- B) Stimulon rritjen intelektuale të fëmijëve
- C) Shërben për të zbutur ankthin e prindërve
- D) Nuk ka ndikim në zhvillimin mendor të fëmijës.

Pyetja 55

Çfarë përfshinte e drejta absolute e prindit sipas ligjit romak?

- A) Të kujdesej për edukimin e fëmijës
- B) Të vepronte mbi fëmijën me çdo mjet
- C) Të lejonte fëmijën të rritej i pavarur
- D) Të ndihmonte fëmijën të ndihmonte të tjerët

Pyetja 56

Cila epokë njihet për ndëshkimin e fëmijëve me probleme mendore, duke i djegur në turrën e druve?

- A) Antikiteti
- B) Mesjeta
- C) Epoka e Rilindjes
- D) Modernizmi

Pyetja 57

Çfarë solli mendimi psikologjik në shekullin tonë për zhvillimin e fëmijëve?

- A) Theksoi rëndësinë e disiplinës së rreptë
- B) Injoroi fëmijërinë si fazë e rëndësishme e zhvillimit
- C) Nënvizoi rëndësinë kritike të moshës së fëmijërisë në zhvillimin e personalitetit dhe karakterit
- D) Propozoi dhunën si metodë për edukim

Pyetja 58

Sipas autorëve të ndryshëm, cili është problemi kryesor në diskutimin për dhunën ndaj fëmijëve?

- A) Mungesa e interesit publik për këtë temë
- B) Pamundësia për të ndaluar dhunën plotësisht
- C) Përkufizimi i asaj që konsiderohet dhunë dhe disiplinim
- D) Refuzimi i shoqërisë për të trajtuar këtë çështje

Pyetja 59

Sipas perspektivave teorike, cili është një nga aspektet kryesore të keqtrajtimit të fëmijëve?

- A) Kujdes i tepruar nga prindërit
- B) Shëndeti i mirë emocional i fëmijës
- C) Dëmtimi emocional si pasojë e dhunës fizike apo neglizhimit
- D) Marrëdhëniet e shëndetshme në familje

Pyetja 60

Çfarë përjetojnë shpesh fëmijët e dhunuar seksualisht?

- A) Mbështetje nga të rriturit
- B) Frikë nga dhunimet e ardhshme dhe neglizhimi emocional
- C) Vetëbesim të lartë
- D) Zhvillim normal emocional

Pyetja 61

Cila është një nga pasojat më të zakonshme ndër fëmijët e keqtrajtuar?

- A) Zhvillimi normal gjuhësor
- B) Prirja për të kërkuar ndihmë të vazhdueshme
- C) Probleme serioze psikologjike ose të zhvillimit nervor
- D) Performancë më e mirë në shkollë

Pyetja 62

Si karakterizohet universi nga perspektiva e fëmijëve të keqtrajtuar?

- A) Konsidrohet si një vend i sigurtë
- B) Si një hapësirë e qartë me rregulla të mirëvendosura
- C) Si një vend frikësues dhe pa rregulla të qarta
- D) Si një mjedis i mbushur me mbështetje prindërore

Pyetja 63

Cila është arsyeja kryesore pse neglizhimi është një nga format më të vështira të keqtrajtimit për t'u identifikuar?

- A) Sepse është gjithmonë i dukshëm
- B) Sepse kërkon vëzhgim të kujdesshëm dhe raportim për t'u zbuluar
- C) Sepse ndodh vetëm në familjet me probleme financiare
- D) Sepse është gjithmonë i lidhur me abuzimin fizik

Pyetja 64

Si përkufizohet "neglizhimi i edukimit"?

- A) Pamundësia për të plotësuar dëshirën e fëmijës për arsim dhe tolerimi i largimit nga shkolla
- B) Ofrimi i pamjaftueshëm i ushqimit për fëmijën
- C) Injorimi i nevojës për veshje të përshtatshme sipas stinës
- D) Pamundësia për të siguruar një ambient të pastër dhe të sigurt për jetesë

Pyetja 65

Në cilin rast një fëmijë konsiderohet i keqtrajtuar për shkak të mungesës së higjienës?

- A) Kur është i palarë për shkak të varfërisë ekonomike të prindërve
- B) Kur ka parazitë dhe është i palarë, për arsye të mosvlerësimit nga prindërit
- C) Kur luan jashtë dhe ndotet gjatë lojës
- D) Kur nuk ka veshur rroba të kushtueshme

Pyetja 66

Cili nga këto shembuj tregon një formë të qartë të keqtrajtimit fizik?

- A) Një prind tërheq një fëmijë zvarrë dhe e lëshon me forcë në divan
- B) Një prind i jep një ndëshkim të butë, duke e ndaluar të dalë jashtë
- C) Një fëmijë rrëzohet aksidentalisht duke luajtur
- D) Një fëmijë nuk pranon të hajë ushqimin që i serviret

Pyetja 67

Cili faktor është më shpesh i lidhur me neglizhimin e fëmijës?

- A) Varfëria dhe streset financiare.
- B) Shkalla e arsimimit të lartë e prindërve.
- C) Tendenca për të udhëtuar shpesh.
- D) Mbikëqyrja intensive e prindërve.

Pyetja 68

Çfarë konsiderohet një shembull i "neglizhimit mjekësor"?

- A) Mosplotësimi i dëshirës së fëmijës për të luajtur me lodra
- B) Moskryerja e vaksinimeve të domosdoshme për fëmijën
- C) Pamundësia për të blerë rroba të shtrenjta për fëmijën
- D) Mbajtja e fëmijës në një ambient të pastër

Pyetja 69

Cila është një arsye kryesore pse prindërit mund të jenë të prirur për të keqtrajtuar fëmijët e tyre?

- A) Përvoja e tyre e mëparshme në një mjedis të dashur dhe të kujdesshëm
- B) Ide të gabuara për zhvillimin dhe aftësitë e fëmijës
- C) Mbështetje e fortë nga sistemet sociale dhe ekonomike
- D) Njohuri të plota për nevojat e fëmijës

Pyetja 70

Cila nga teoritë më poshtë, shpjegon sjelljen abuzive të prindërve si një mekanizëm për të ruajtur ekuilibrin familjar?

- A) Teoria e evoluimit
- B) Teoria e lidhjes sociale
- C) Teoria e Frojdit mbi zhvendosjen (displacement)
- D) Teoria e zhvillimit moral

Pyetja 71

Cili nga faktorët ndikon më shumë në punën e punonjësit social, për të identifikuar dhe ndihmuar fëmijët e keqtrajtuar?

- A) Aftësia e punonjësit social për të ndjekur protokollet
- B) Qëndrimi i shoqërisë ndaj sjelljeve të tilla
- C) Burimet financiare të familjes
- D) Përdorimi i teknologjisë në identifikimin e rasteve

Pyetja 72

Pse është e rëndësishme që punonjësi social të ndërtojë marrëdhënie besimi me klientët?

- A) Sepse fëmijët ndihmohen vetëm nga anëtarët e familjes
- B) Sepse puna nuk mund të jetë e suksesshme pa fituar besimin e tyre
- C) Sepse kjo është pjesë e trajnimit standard të punonjësve socialë
- D) Sepse besimi i ndihmon klientët të shmangin problemet ligjore

Pyetja 73

Si kërkojnë ndihmë fëmijët e keqtrajtuar zakonisht?

- A) Duke përdorur mjete teknologjike
- B) Duke folur hapur me punonjës social
- C) Duke përdorur forma indirekte dhe joverbale
- D) Duke i kërkuar ndihmë drejtpërdrejt autoriteteve

Pyetja 74

Çfarë duhet të bëjë punonjësi social gjatë intervistimit të një fëmije të keqtrajtuar?

- A) T'i bëjë pyetje direkte që të nxjerrë të vërtetën
- B) Të përdorë mjete joverbale dhe t'i lërë fëmijës hapësirë për të reaguar
- C) Të përpiqet të përfundojë intervistën sa më shpejt
- D) Të përqendrohet vetëm te sjelljet negative të fëmijës

Pyetja 75

Pse fëmijët e keqtrajtuar shpesh nuk flasin për situatën e tyre?

- A) Sepse nuk kanë kohë të mjaftueshme
- B) Sepse nuk ndihen të interesuar për ndihmën e punonjësit social
- C) Sepse kanë frikë nga ndëshkimi ose ndarja nga prindërit
- D) Sepse nuk e kuptojnë që janë duke u keqtrajtuar

Pyetja 76

Çfarë mund të ndihmojë një punonjës social të kuptojë më mirë përvojat e një fëmije të abuzuar?

- A) Ndjekja e fëmijës pa ndërhyrje në lojën e tij
- B) Pyetjet e vazhdueshme dhe të drejtpërdrejta
- C) Sugjerimi i skenarëve për të nxitur përgjigje
- D) Kërkimi i të dhënave nga mësuesit e fëmijës

Pyetja 77

Cila është një arsye pse fëmijët e abuzuar fajësojnë veten për situatën?

- A) Sepse ata ndihen fajtorë për shkak të edukimit të prindërve
- B) Sepse shpresojnë të ruajnë familjen dhe të rikthejnë dashurinë prindërore
- C) Sepse kanë mësuar këtë qëndrim nga shoqëria
- D) Sepse janë të pavetëdijshëm për abuzimin

Pyetja 78

Çfarë duhet të shmangë punonjësi social gjatë komunikimit me një fëmijë të traumatizuar?

- A) Përdorimin e mjeteve kreative si lodra ose vizatime
- B) Vëzhgimin e sjelljeve joverbale të fëmijës
- C) Pyetjet e drejtpërdrejta që mund ta emocionojnë fëmijën
- D) T'i japë fëmijës kohë dhe hapësirë për të shprehur veten

Pyetja 79

Pse fëmijët e neglizhuar emocionalisht kanë vështirësi të besojnë punonjësit socialë?

- A) Sepse ata janë mësuar të mos u besojnë të rriturve
- B) Sepse ata kanë mungesë aftësie për të njohur emocionet
- C) Sepse ata nuk janë të bindur për interesin, kujdesin dhe përkushtimin e punonjësit social
- D) Sepse ata nuk kanë përvojë të mëparshme me institucione ndihmëse

Pyetja 80

Cila nga sa vijon theksohet nga Kushtetuta shqiptare në lidhje me të drejtat e fëmijëve?

- A) E drejta e fëmijës për punësim në moshën 16 vjeç
- B) Mbrojtja e veçantë e fëmijëve nga shteti
- C) E drejta e fëmijës për të zgjedhur kujdestarin e tij
- D) E drejta e fëmijës për të trashëguar pasurinë

Pyetja 81

Çfarë qëllimi ka "Harta e Marrëdhënieve" në intervistimin e adoleshentëve?

- A) Për të mësuar historinë familjare të adoleshentit
- B) Për të zbuluar sfidat e adoleshentit në shkollë
- C) Për të kuptuar llojin dhe forcën e marrëdhënieve të adoleshentit me individë të ndryshëm
- D) Për të vlerësuar aftësitë akademike të adoleshentit

Pyetja 82

Çfarë tregojnë vijat e dobëta në "Hartën e Marrëdhënieve"?

- A) Marrëdhënie të forta dhe të qëndrueshme
- B) Marrëdhënie të dobëta ose distancë emocionale
- C) Marrëdhënie stresuese dhe konfliktuale
- D) Nuk tregojnë asnjë lloj marrëdhënieje

Pyetja 83

Cila është qasja e duhur e një këshilluesi kur punon me prindërit dhunues?

- A) Të fillojë me analizimin e sjelljes së fëmijës
- B) Të fokusohet vetëm te pasojat e keqtrajtimit të fëmijës
- C) Të ndihmojë prindërit duke adresuar nevojat dhe deficitet e tyre emocionale
- D) Të përdorë masa ndëshkuese për prindërit

Pyetja 84

Cila nga këto shenja është një tregues i abuzimit fizik të fëmijët?

- A) Apatia dhe mungesa e energjisë për të mësuar
- B) Njohuri seksuale mbi kufijtë e moshës
- C) Hipervigjilenca ndaj reagimeve të të rriturve
- D) Vështirësi në formimin e marrëdhënieve me moshatarët

Pyetja 85

Cili është një tregues i abuzimit emocional të fëmijët?

- A) Shenja të dhunës në trup
- B) Mungesa e aftësisë për të komunikuar ndjenjat
- C) Vizatime që tregojnë organe seksuale
- D) Dhunim i fëmijëve të tjerë

Pyetja 86

Cili grup prindërisht bashkëpunon më shumë me këshilluesin?

- A) Prindërit që nuk e kuptojnë që kanë problem
- B) Prindërit që dëshirojnë të ndryshojnë situatën dhe kanë vetëdije për problematikën
- C) Prindërit që janë agresivë dhe kundërshtues
- D) Prindërit që kanë mungesë aftësish shprehëse

Pyetja 87

Cila nga këto është një nga karakteristikat e prindërve dhunues për shkak të neglizhimit?

- A) Varfëria dhe deprivimi material
- B) Perceptimi negativ i fëmijës
- C) Ideja se dhuna është e domosdoshme
- D) Izolimi social

Pyetja 88

Një nga tiparet e prindërve që abuzojnë fizikisht është:

- A) Paaftësia për të shprehur ndjenjat
- B) Perceptimi i fëmijës si "i keq"
- C) Neglizhimi i fëmijës
- D) Mungesa e nënës për një kohë të gjatë

Pyetja 89

Çfarë është një tregues i prindërve që abuzojnë emocionalisht?

- A) Kontrolli mbi fëmijën dhe kufizimi i fjalës së tij
- B) Histori abuzimi në fëmijëri
- C) Mendimi se dhuna është e domosdoshme
- D) Prindi abuzon me alkoolin

Pyetja 90

Cili nga faktorët e mëposhtëm është një shenjë e abuzimit seksualreferuar literaturës?

- A) Konflikte martesore
- B) Kriza pas lindjes së fëmijës
- C) Perceptimi negativ i fëmijës
- D) Fëmija përjeton mungesë të vëmendjes

Pyetja 91

Cili nga këto përshkrime është më i përshtatshëm për një fëmijë hiperaktiv?

- A) Kryen detyrat me përpikëri dhe pa gabime
- B) Është agresiv dhe shpesh nuk përmbush detyrat
- C) Shfaq interes të lartë për aktivitetet e planifikuara
- D) Ka një sjellje të qetë dhe të qëndrueshme

Pyetja 92

Një nga sjelljet tipike të një fëmije hiperaktiv në shkollë është:

- A) Përqendrimi i lartë në mësim
- B) Kryerja e detyrave me kujdes të madh
- C) Ndryshimi i interesave në mënyrë të shpejtë dhe të vazhdueshme
- D) Mosmarrja pjesë në aktivitetet fizike

Pyetja 93

Prindërit e fëmijëve hiperaktivë shpesh shfaqin:

- A) Tendencë për të marrë përgjegjësi të lartë për sjelljen e fëmijës
- B) Pasivitet dhe mungesë përfshirjeje në edukimin e fëmijës
- C) Tolerancë të lartë ndaj sjelljes së fëmijës
- D) Përdorim të vazhdueshëm të metodave të buta edukative

Pyetja 94

Cili nga faktorët është më i rëndësishëm për diagnostikimin e hiperaktivitetit?

- A) Sjellje impulsive që shfaqen vetëm në rrethana specifike
- B) Sjellje që ndryshojnë në mënyrë të papritur për një periudhë të shkurtër
- C) Sjellje të pakontrolluara të vazhdueshme për të paktën një vit
- D) Mungesë vëmendjeje që ndodh herë pas here

Pyetja 95

Cili nga këto përshkrime është i saktë për periudhën e fëmijërisë së hershme të një fëmije hiperaktiv?

- A) Fëmija përqendrohet gjatë lojërave dhe aktiviteteve të planifikuara
- B) Fëmija shpesh shmang pengesat me lehtësi dhe vetëkontroll
- C) Fëmija ka tendencë të bëjë veprime të nxituara që mund të rrezikojnë jetën
- D) Fëmija tregon qetësi dhe pjekuri për moshën

Pyetja 96

Cili nga këto faktorë mund të ndikojë në hiperaktivitetin e fëmijës?

- A) Mungesa e plotë e sjelljeve impulsive në shtëpi
- B) Prindër që shfaqin disiplinë të buta dhe të vazhdueshme
- C) Probleme të prindërve me sjellje impulsive ose hiperaktivitet në fëmijërinë e tyre
- D) Prindër që kanë marrë trajnim të veçantë për edukimin e fëmijëve



Pyetja 97

Cili është përkufizimi kryesor i një adoleshenti hiperaktiv?

- A) Një adoleshent që është shumë i qetë dhe i vetëpërmbajtur
- B) Një adoleshent që shfaq sjellje brutale dhe kalon nga gjendje depresive në shpërthime të pakontrollueshme
- C) Një adoleshent me performancë të lartë akademike
- D) Një adoleshent që i shmanget konflikteve sociale

Pyetja 98

Sa është koha maksimale brenda së cilës Drejtori i strukturës së shërbimeve sociale duhet të miratojë masën e mbrojtjes emergjente pas identifikimit të nevojës së fëmijës për mbrojtje?

- A) 72 orë
- B) 48 orë
- C) 24 orë
- D) 5 ditë

Pyetja 99

Cila është qasja më e mirë për të ndihmuar një fëmijë të kuptojë sëmundjen e tij?

- A) Të mos i thuhet asgjë për sëmundjen
- B) T'i shpjegohet sëmundja në mënyrë të qartë dhe të ndjeshme
- C) Të injorohet çdo pyetje e fëmijës për sëmundjen
- D) Të pritët që fëmija ta kuptojë vetë me kohë

Pyetja 100

Cili është roli i ekipit të shërbimit të urgjencës kur një fëmijë është në rrezik të menjëhershëm?

- A) Për të vlerësuar opsionet e rehabilitimit afatgjatë
- B) Të sigurojë mbrojtje dhe kujdes të menjëhershëm
- C) Të identifikojë performancën shkollore të fëmijës
- D) T'ia referojë çështjen një gjyqtari për veprime të menjëhershme

Pyetja 101

Cila është mënyra më efektive për t'u komunikuar me një fëmijë hiperaktiv?

- A) Duke bërë titur për të tërhequr vëmendjen
- B) Duke e prekur dhe udhëzuar me qetësi
- C) Duke dhënë urdhra të përsëritur disa herë
- D) Duke shmangur komunikimin direkt

Pyetja 102

Cili nga këta faktorë nuk është shkak i hiperaktivitetit?

- A) Prapambetja mendore
- B) Ushtrimi i rregullt fizik
- C) Abuzimi dhe privimi
- D) Vështirësitë në dëgjim

Pyetja 103

Sipas Wiilllcott, cili është një element shpresëdhënës te adoleshentët me tendenca antisociale?

- A) Tendenca për të izoluar të tjerët
- B) Kapaciteti për të ndryshuar sjelljen me ndërhyrjen e duhur

- C) Aftësia për të krijuar tension në grup
- D) Sjellja delikvente si një tipar i përhershëm

Pyetja 104

Si këshillohen prindërit të veprojnë kur japin këshilla për fëmijët hiperaktivë?

- A) Të përsërisin këshillën disa herë për ta përforcuar
- B) Të japin këshillën qartë dhe vetëm një herë
- C) Të përdorin kërcënime të forta dhe të përsëritura
- D) Të shmangin dhënien e këshillave për sjellje

Pyetja 105

Cili është qëllimi kryesor i përdorimit të teknikave të modifikimit të sjelljes?

- A) Të ndëshkojnë sjelljen e papërshtatshme
- B) Të krijojnë një situatë të lumtur dhe harmonike në familje
- C) Të kontrollojnë çdo veprim të fëmijës
- D) Të shmangin plotësisht kontaktin me fëmijën

Pyetja 106

Cili është përkufizimi i "fëmijëve të rrugës"?

- A) Fëmijë që punojnë vetëm gjatë sezonit të verës
- B) Fëmijë që flenë në rrugë sepse nuk kanë shtëpi dhe nuk kanë përkujdesje nga të rriturit
- C) Fëmijë që studiojnë dhe jetojnë me familjen e tyre
- D) Fëmijë që punojnë për të financuar shkollimin e tyre

Pyetja 107

Cila është përgjegjësia kryesore e ekipeve në terren (Skuadrat e Terrenit) në identifikimin e fëmijëve në situatë rruge?

- A) Kryerja e hetimeve ligjore
- B) Identifikimin e fëmijëve, dhënien e ndihmës së menjëhershme dhe referimin e tyre tek autoritetet përkatëse
- C) Mësimi i fëmijëve në situatë rruge
- D) Zbatimi i ligjeve në lidhje me mirëqenien e fëmijëve

Pyetja 108

Cili faktor kryesor ndikon në mungesën e regjistrimit në shkollë të fëmijëve në situatë rruge?

- A) Interesimi i ulët për arsimim.
- B) Diskriminimi dhe mungesa e qëndrueshmërisë
- C) Refuzimi nga prindërit për t'i çuar në shkollë
- D) Puna sezonale në bujqësi.

Pyetja 109

Pse është e rëndësishme që prindërit dhe punonjësit socialë të bashkëpunojnë për diagnozat mjekësore të fëmijëve?

- A) Për të shmangur shpenzimet e larta financiare
- B) Për të siguruar kuptimin e saktë të trajtimeve dhe menaxhimit të tyre
- C) Për të zvogëluar shqetësimin e mjekëve
- D) Për të siguruar privatësinë maksimale të familjes

Pyetja 110

Cila nga këto nuk përfshihet në faktorët ekonomikë që ndikojnë në punësimin e fëmijëve?

- A) Varfëria ekstreme
- B) Niveli i ulët i pagave
- C) Mungesa e infrastrukturës
- D) Papunësia e të rriturve

Pyetja 111

Në rastin e masës së mbrojtjes emergjente, kush nuk është i informuar për vendndodhjen e fëmijës?

- A) Punonjësi social
- B) Prindërit e fëmijës
- C) Autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve
- D) Familja e zgjeruar e fëmijës

Pyetja 112

Cili nga faktorët kontribuon në largimin e fëmijëve nga shkolla në zonat rurale?

- A) Pagat e ulëta të prindërve
- B) Varfëria monetare dhe mungesa e infrastrukturës
- C) Ndryshimi i sistemit ekonomik
- D) Mungesa e tregut të punës

Pyetja 113

Çfarë përfshin koordinimi i kujdesit në punën sociale pediatrike?

- A) Vetëm lehtësimin e lidhjeve me burimet e kujdesit mjekësor
- B) Vlerësimin, identifikimin dhe zgjidhjen e barrierave, dhe komunikimin
- C) Trajtimin e pavarur të çështjeve të shëndetit mendor nga punonjësit socialë
- D) Organizimin e vetëm takimeve me familjet në krizë

Pyetja 114

Cila është qasja kryesore e kujdesit dhe praktikës së informuar nga trauma (TICP)?

- A) Të përqendrohet vetëm tek simptomat e traumës
- B) Të ndihmojë individët të trajtojnë problemet e tyre pa marrë parasysh ndikimin e traumës
- C) Të njohë dhe të punojë me ndikimet e traumës në jetën e individit dhe organizatën e shërbimeve
- D) Të përjashtojë ndërhyrjet në nivel organizativ.

Pyetja 115

Çfarë përfshin vlerësimi biopsikosocial i një punonjësi social?

- A) Vetëm analizimin e dinamikës së familjes
- B) Të dhënat demografike, strukturën familjare, dhe dinamikat biopsikosociale të sistemit familjar
- C) Vlerësimin e vetëm simptomave mjekësore
- D) Përqendrim ekskluziv në marrëdhëniet e punës në komunitet

Pyetja 116

Sipas paradigmës së shëndetit të familjes, familja konceptohet si:

- A) Një grup individësh të pavarur që ndajnë hapësirë të përbashkët
- B) Një sistem dinamik që ruan shëndetin dhe mbështet anëtarët individualë

- C) Një entitet pa ndikim në vendimet shëndetësore të individëve
- D) Një organizëm biologjik pa ndërveprime shoqërore

Pyetja 117

Çfarë përfshin koordinimi i kujdesit në punën sociale pediatrike?

- A) Vetëm lehtësimin e lidhjeve me burimet e kujdesit mjekësor
- B) Vlerësimin, identifikimin dhe zgjidhjen e barrierave, dhe komunikimin
- C) Trajtimin e pavarur të çështjeve të shëndetit mendor nga punonjësit socialë
- D) Organizimin e vetëm takimeve me familjet në krizë

Pyetja 118

Cila është një mënyrë që një punonjës social mund të ndihmojë një fëmijë të krijojë një vend të sigurt imagjinar?

- A) Duke i dhënë fëmijës një lodër të preferuar
- B) Duke i kërkuar të vizatojë vendin imagjinar
- C) Duke vendosur muzikë relaksuese
- D) Duke përdorur një teknikë të meditimit të drejtuar

Pyetja 119

Si mund të përfitojë një fëmijë nga metoda "Unë jam shefi i vetes"?

- A) Duke zhvilluar aftësi për të kontrolluar mendimet e tyre negative
- B) Duke mësuar të meditojë për orë të tëra
- C) Duke shmangur plotësisht mendimet shqetësuese
- D) Duke përmirësuar aftësitë në vizatim

Pyetja 120

Cila është arsyeja kryesore përse metodat e vetëkontrollit përdoren në terapinë me fëmijë?

- A) Për të larguar plotësisht frikën nga mendimet e tyre
- B) Për të ndihmuar në ripërtëritjen e aftësisë së tyre për të menaxhuar ndjenjat negative
- C) Për të zëvendësuar terapinë tradicionale të frymëmarrjes
- D) Për të shmangur diskutimin e frikës me fëmijët

## **Kapitulli 8. Politika Sociale, Mirëqenia Sociale dhe Shteti i Mirëqenies Sociale**

Pyetja 1

Rrethoni përgjigjen e saktë: Termi "politikë sociale" ka të bëjë me:

- A) Kategori të veçanta
- B) Grupet në nevojë
- C) Politikat qeveritare për të rritur mirëqenien e qytetarëve
- D) Pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrje

Pyetja 2

Termi "politikë sociale" ka të bëjë me:

- A) Mënyrat e zhvillimit të mirëqenies në shoqëri të ndryshme
- B) Menaxhimin e burimeve njerëzore në sektorët e shërbimeve sociale
- C) Veprimtarinë sociale në institucionet e shërbimeve sociale
- D) Një degë të veçantë të shkencave sociale

Pyetja 3

Kuptimi i parë i politikës sociale lidhet me :

- A) Shërbimet sociale dhe shtetin e mirëqenies sociale
- B) Shërbimet sociale të dedikuara
- C) Shërbimet sociale për të moshuarit
- D) Nevojën e zhvillimit të saj si kurrikul

Pyetja 4

Politika sociale në kontekstin e subjektit të studimit:

- A) Është pjesë e shkencave sociale
- B) Nuk ka lidhje metodologjike me shkencat e tjera
- C) Kufijtë e politikës sociale janë të ndara me shkencat e tjera
- D) Përfshin vetëm ekspertë të studimit të shkencave sociale

Pyetja 5

Një kërkues në fushën e shkencave sociale:

- A) Është tërësisht i pavarur në punën që kryen
- B) I duhet të bashkëpunojë me profesionistë të disa fushave
- C) Është tërësisht i varur nga profesionistët e fushave të tjera
- D) Shqyrton vetëm fakte të politikës

Pyetja 6

Në kontekstin teorik zhvillimi i politikës sociale:

- A) Konsiderohet si një fushë ndërdisiplinore
- B) Është gjithnjë një disiplinë e pavarur shkencore
- C) Nuk zhvillohet nga akademikët si pjesë e sistemit të edukimit
- D) Ka kufij të palëvizshëm në raport me shkencat e tjera sociale

Pyetja 7

Në kontekstin metodologjik, studimi i politikës sociale:

- A) Përfshin studime dhe argumenta në planin teorik dhe praktik të aplikimit
- B) Nuk vëmendëson përdorimin e metodologjive të veçanta në studime
- C) Metodologjia përfshin thjesht dakordësinë mbi politikat
- D) Bazohet vetëm në debate politike

Pyetja 8

Filozofia e Kejnshit në vitet `50-`60, ndikoi tek qeveritë perëndimore që ato:

- A) Të rrisnin kompensimin për të varfrit
- B) Të mos zbatonin riflacionin
- C) Të rrisnin punësimin përmes fiskalitetit
- D) Të mos përdornin pushtetin monetar për të rritur investimet

Pyetja 9

Mirëqenia sociale:

- A) Është një fushë e veçantë e politikave sociale
- B) Është thjesht një term specifik
- C) Është një nocion filozofik i përshtatur
- D) Është një fushë studimi e pavarur nga politikat sociale

#### Pyetja 10

Objekti i studimit të politikës sociale lidhet me:

- A) Mjediset ku mirëqenia është prodhuar, shpërndarë dhe konsumuar
- B) Vendosi e kornizave normative për të kuptuar politikat
- C) Qasjet tradicionale të hartimit të politikave sociale
- D) Ecurinë e zhvillimit të shkencave sociale

#### Pyetja 11

Politika sociale zhvillon interes të posaçëm për:

- A) Çështje të tilla si demografia, divorcet, moshimi
- B) Strategjitë që hartohen nga qeveritë
- C) Çështje të drejtësisë
- D) Interesat kulturore të individëve

#### Pyetja 12

Politika sociale e trajton papunësinë:

- A) Nga këndvështrime të ndryshme për çështjen
- B) Të lidhur kryesisht me statistikat
- C) Nisur nga nevoja për të prodhuar politika
- D) Si detyrim për profesionistët

#### Pyetja 13

Shteti i mirëqenies sociale është:

- A) Unifikim i shteteve të Bashkuara të Amerikës
- B) Produkti i filozofisë idealist marksiste
- C) Mënyra që individët përdorin për të shprehur kënaqësitë e tyre
- D) Përgjegjësia e qeverisë për sigurinë sociale dhe ekonomike të qytetarëve

#### Pyetja 14

Çfarë është mirëqenia komerciale (tregtare)

- A) Lidhet me organizatat jofitimprurëse
- B) Blerja e shërbimeve sociale
- C) Shitja dhe blerja e shërbimeve për mirëqenien
- D) Mirëqenie e financuar nga shteti

#### Pyetja 15

Kristiandemokracia që u konsiderua ngjarja më e rëndësishme politike e pas luftës, përfaqësohet, në lidhje me politikat sociale:

- A) Një mendim të pastër katolik
- B) Konservatorizmin, por në një formë të re
- C) Vazhdim i frymës së filozofisë kejnsonianiste
- D) Elemente liberale

#### Pyetja 16

Termi ekonomi e përzierë ka të bëjë me:

- A) Gërshetimin e politikave sociale me ato ekonomike
- B) Ndërhyrjen e shtetit në ekonomi
- C) Uljen e investimeve, për të ndikuar politikat sociale

D) Happësira të reja për shoqërinë civile

Pyetja 17

Pas Luftës II Botërore shndërrime rrënjësore ndodhën në:

- A) Arritjen dhe ruajtjen e punësimit të plotë
- B) Këmbimet e programeve të ndihmës mes shteteve
- C) Fuqizimin e sektorit të biznesit
- D) Realizimet e planeve Marshall

Pyetja 18

Cilat janë modelet e realizimit të komponentëve të Shtetit të Mirëqenies Sociale:

- A) Modeli Thecer-Regan
- B) Beveridxi-Bismark-skandinav
- C) Modeli liberal- neoliberal
- D) Modeli radikal-marksist

Pyetja 19

Cili është kuptimi i saktë për termin “riflacion”:

- A) Shtimi i taksave për qytetarët
- B) Rritja e numrit të të papunëve
- C) Shtimi i parave në qarkullim
- D) Ulja e blerjeve dhe konsumit qytetar

Pyetja 20

Kujt i përket autorësia e teorisë sipas së cilës shteti i mirëqenies duhet të luftojë “5 të këqijat e njerëzimit”:

- A) Otto Von Bismark
- B) Ēinston Çërcill
- C) Frenklin Rusvelt
- D) Ulliam Beverixh

Pyetja 21

Një rrugë për të studiuar politikat sociale është:

- A) Përmes shqyrtimit të shërbimeve sociale të ofruara
- B) Lidhshipi i shërbimeve sociale
- C) Rekrutimi i profesionistëve të shërbimeve sociale
- D) Promovimi i mirëqenies

Pyetja 22

Për analistët e politikave sociale është primare:

- A) Konsiderimi i përvojave të drejtpërdrejta
- B) Pozicionimi i grupeve të individëve ndërmejt tyre
- C) Strategjitë kombëtare
- D) Politikat sociale të së shkuarës

Pyetja 23

Lidhur me tranzicionin e mirëqenies sociale:

- A) Çdo vend ka ofruar këndvështrimin e vet mbi çështjen
- B) Nevojat për mirëqenie janë vlerësuar njëjloj në të gjithë botën

- C) Politikat e vendeve të fuqishme kanë vendosur gjithnjë
- D) Mirëqenia është atribut vetëm i shoqërive të mëdha

Pyetja 24

Burimet parësore të mbështetjes sociale në vitet 1890 ishin:

- A) Bizneset e vogla
- B) Organizatat fetare dhe vullnetare
- C) Mobiliteti social
- D) Politikanët e kohës

Pyetja 25

Praktikat për mirëqenies sociale në vitet 1890:

- A) Bazoheshin në thelbin e individualizmit me fokus familjen
- B) Ishin kulturalisht të kushtëzuara
- C) Vareshin nga koncepti për varfërinë
- D) Vareshin nga prezenca e shoqërive të sigurimit

Pyetja 26

Në Francën e dy dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit të njëzetë programi i pensioneve u përqëndrua:

- A) Tek punonjësit
- B) Tek sigurimi i papunësisë
- C) Tek mobitieti social
- D) Kontributi i sindikatave

Pyetja 27

Në vitet 1930 programet e mirëqenies sociale fokusonin:

- A) Gjerësisht mjerimin dhe skamjen
- B) Varfërinë në dimensione të gjera
- C) Nismat e individëve aktivë në shoqëri
- D) Punonjësit aktivë të industrive

Pyetja 28

Përfshirja e grave të veja, të papunëve dhe fëmijëve në përfitimin e kompensimeve ishte pjesë e politikave të mirëqenies në:

- A) Australi
- B) Suedi
- C) SHBA
- D) Francë

Pyetja 29

Çfarë është mirëqenia vullnetare:

- A) Organizatat që dhurojnë nga koha e tyre në mbështetje të njerëzve në nevojë për mirëqenie
- B) Mirëqenia e paguar nga shteti përmes kontratave të caktuara
- C) Punëtorët e paguar që ofrojnë mirëqenie
- D) pagesa ekstra të sigurimeve për çdo individ



Pyetja 30

Çfarë është shoqëria e madhe në raport me mirëqenien?

- A) Shoqëria ku të gjithë bashkohen për të sjellë ndryshime shoqërore
- B) Shoqëria ku të gjithë mbështeten tek shteti për ndihmë
- C) Shoqëria ku vullnetarë nga komuniteti ose familja, ndërhyjnë për të ndihmuar
- D) Shoqëria që vëmendëson personat me nevoja ndryshe

Pyetja 31

Cilët janë ofruesit më të mëdhenj të mirëqenies falas në lidhje me kujdesin?

- A) Burrat
- B) Gratë
- C) Fëmijët
- D) Të rinjtë

Pyetja 32

Përcaktoni termat “krahasim” dhe “kontrast” lidhur me mirëqenien:

- A) Tregojnë në detaje ngjashmëritë dhe dallimet
- B) Shpjegojnë kufizimet e një lënde
- C) Bëjnë një gjykim për një temë
- D) Japin një pasqyrë të çështjes mbi mirëqenien

Pyetja 33

Çfarë kuptoni me “përshkrim” në kontekstin e politikave sociale:

- A) Shpjegim në detaje i çështjeve
- B) Shpjegim i bazave të çështjeve
- C) Organizim i pikave kryesore dhe marrje e dëshmime
- D) Dhënia e një pasqyre të përgjithshme të çështjeve

Pyetja 34

Një grup idesh për jetën dhe shoqërinë janë përcaktimi i:

- A) Ideologjisë
- B) Politikave publike
- C) Sistemit të një shteti
- D) Të drejtave natyrore

Pyetja 35

Qëndrimi që merr qeveria për çështjen sociale quhet:

- A) Sfera sociale
- B) Politika sociale
- C) Opinioni social
- D) Punë sociale

Pyetja 36

Skema e “detyrimit të përbashkët” kishte të bënte me:

- A) Trajnime të detyruara, për të përfituar mbështetjen nga qeveria
- B) Tërheqja e asistencës kryesisht për të rinjtë
- C) Kontrata të përbashkëta partneriteti publik-privat

D) Përfitim për fëmijët nën moshën 3 vjeçare nga gratë

Pyetja 37

Karakteristikë e periudhës së viteve `90 në lëmin e politikave sociale:

- A) U bënë strategjitë e shkurtimit të shpenzimeve për mirëqenien
- B) U bë rritja e marzhit të shpenzimeve për të varfrit, në shtetet perëndimore
- C) U bë rritja e numrit të përfituesve nga grupet vulnerabel
- D) U bë dalja masive e popullatës në pension

Pyetja 38

Çështje themelore të agjendës së mirëqenies sociale të shekullit të kaluar :

- A) Janë të përcaktuara si standard të detyrueshme për të gjitha shtetet
- B) Janë pak a shumë të vendosura nga konsensusi popullor dhe janë ende në diskutim
- C) Nuk kanë lidhje me politika përgjithësuese
- D) Nuk mund të ndikohen nga politikat globale

Pyetja 39

Tregoni cili grup konceptesh i përket thelbit të debateve mbi politikat sociale dhe shtetin e mirëqenies sociale:

- A) Drejtësi sociale, altruizëm, vetëmbrojtje
- B) Ideologji, propagandë, vendimarrje
- C) Sigurime dhe menaxhim
- D) Pavarësi institucionale, system taksash

Pyetja 40

Cilat janë mekanizmat e mundshëm socialë që i sigurojnë një shumicë individësh mirëqenien sociale:

- A) Familja, miqtë, tregu, ojf-të
- B) Shkolla, punësimi, trajnimi
- C) Emigrimi dhe mobilitetet, sidomos për të rinjtë
- D) Lobimi për më shumë fonde kundrejt qeverisë

Pyetja 41

Institucioni më i vjetër tradicional i sigurimit të mirëqenies është:

- A) Tregu
- B) Organizatat bamirëse
- C) Familja
- D) Shkolla

Pyetja 42

Tregu dhe ojf-të, në kontekstin e mirëqenies, janë aktualisht subjekte:

- A) Tërësisht të pavarura nga shteti
- B) Të rregulluara nga shteti dhe garantojnë mbështetje financiare përmes shërbimeve shtetërore për mirëqenien
- C) Luftojnë njëri-tjetrën dhe nuk interesohen për mirëqenien
- D) Bashkojnë gjithnjë interesat e tyre pavarësisht individit

Pyetja 43

Nevoja sociale nënkupton:

- A) Dëshirat dhe preferencat
- B) Kënaqësinë kundrejt pakënaqësisë
- C) Interesat personale të individëve
- D) Problemet sociale që has individi

Pyetja 44

Tregoni përcaktimin e saktë klasifikues për nevojat sociale:

- A) Nevojat për pushim
- B) Nevoja të krahasuara
- C) Nevoja standarde
- D) Nevoja për promovim

Pyetja 45

Në përcaktimin e problemeve sociale ndikojnë:

- A) Gjykimet mbi to dhe vlerat që sjellin risk
- B) Politikat e përgjithshme
- C) Ideologjia e vendimarrjes
- D) Niveli arsimor i profesionistit

Pyetja 46

Barazia në kontekstin e politikave sociale nënkupton:

- A) Grupime dhe çështje të marra në vlera absolute të barabarta
- B) Formula matematikore të zbatuara për llogari të shërbimeve
- C) Hartim të platformave politike të bazuara në mundësi të barabarta
- D) Financim të barabartë për grupet në nevojë

Pyetja 47

Të drejtat civile, në kontekstin e politikave sociale, u zhvilluan në:

- A) Shekullin e 17-të
- B) Shekullin e 18-të
- C) Shekullin e 19-të
- D) Shekullin e 21-të

Pyetja 48

Të drejtat politike në kontekstin e politikave sociale, u zhvilluan në:

- A) Shekullin e 18-të
- B) Shekullin e 19-të
- C) Shekullin e 20-të
- D) Shekullin e 21-të

Pyetja 49

Të drejtat sociale në kontekstin e politikave sociale, u zhvilluan në:

- A) Shekullin e 18-të
- B) Shekullin e 19-të
- C) Shekullin e 20-të

D) Shekullin e 21-të

Pyetja 50

Teoria e Nozick mbi drejtësinë sociale bazohet tek:

- A) Puna
- B) Edukimi
- C) Të drejtat politike
- D) Kontributet në familje

Pyetja 51

Nocioni i Raëls për drejtësinë sociale bazohet tek:

- A) Veli i injorancës
- B) Klasa dhe gjinia
- C) Rrethanat e jetës
- D) Të drejtat civile

Pyetja 52

Përfitimi social neto mund të rritet kur:

- A) Përfitimi social marginal barazohet me kostot sociale marginale
- B) Kur kosto marginale sociale është më e madhe
- C) Niveli i prodhimit të produktit mbetet konstant
- D) Ulet shpërndarja e produktit

Pyetja 53

Në politikat sociale termi eficiencë ka të bëjë me:

- A) Raportin e kostove me shpërndarjen
- B) Kontrollin e raportit kosto-përfitim
- C) Raportin kosto-zgjedhje
- D) Raportin kosto-sjellje konsumatore

Pyetja 54

Një rezultat eficient:

- A) Nuk është patjetër i drejtë dhe i barabartë për të gjithë
- B) Përfshin shpërndarjen e drejtë të burimeve
- C) Nuk përfshin gjykime vlerash për të përfituar nga politikat sociale
- D) Është një vlerë që përcaktohet vetëm nga ekonomistët

Pyetja 55

Altruizmi i grave në familje konsiderohet si:

- A) Detyrim
- B) E drejtë
- C) Burim fitimi
- D) Motivim për punë

Pyetja 56

Richard Titmuss, në vitet `50-60` argumentonte se mirëqenia sociale është mekanizëm:

- A) I kompensimit të dëmeve ekonomike të individëve dhe familjeve

- B) I ndarjes së kontributeve mes përfituesve të grupeve të ndryshme
- C) Fitimprurës që shfrytëzohet nga qeveria e çdo shteti
- D) Taksimi për grupe të caktuara për ndryshimin e sjelljes

Pyetja 57

Liberalët modernë për rolin e qeverisë dhe shtetit në ekonomi, përdoren termin:

- A) Shteti minimal
- B) Qeverisja e madhe
- C) Ekonomi e tregut të lirë
- D) Filozofia e tyre nuk kishte të bënte direkt me mirëqenien sociale.

Pyetja 58

Sipas everidge, sistemi i sigurimit social bazohej në:

- A) Kontratën mes punëdhënësit, punëmarrësit dhe shtetit
- B) Politikat e instituteve të sigurimit
- C) Rendin dhe qetësinë publike
- D) Numrin e të papunëve të regjistruar

Pyetja 59

Sipas Alcock (2003), ideologjia nënkupton:

- A) Një besim kulturor individual të një grupi social referent
- B) Sistem besimesh ku individët përceptojnë të gjitha fenomenet sociale
- C) Një vijë politike të shtresave në nevojë në një vend të caktuar
- D) Një mundësi për t'u përshtatur në një mjedis social specifik

Pyetja 60

Perspektiva neoliberales orienton drejt:

- A) Ekonomisë jo konkurruese dhe planifikimit shtetëror
- B) Ekonomisë së tregut të bazuar në ligj dhe konkurrencë
- C) Ekonomisë së centralizuar
- D) Të drejtës së pronës të shpërndarë në mënyrë kaotike

Pyetja 61

Perspektiva konservatore prezanton qëndrime:

- A) Skeptike ndaj zhvillimit të lirë të forcave të tregut
- B) Të njëjta me neoliberalët lidhur me ekonominë e tregut
- C) Protective për të ardhmen e ndritur ekonomike
- D) Që nxitin ndryshimet e shpejta drejt progresit

Pyetja 62

Perspektiva social-demokrate prezanton qëndrime që lidhen me:

- A) Shpërndarjen e barabartë të të mirave, të drejtave dhe mundësive tek individët
- B) Revolucionin si mundësi për vendosjen e barazisë në shoqëri
- C) Shërbime shtetërore të mirëqenies të diferencuara
- D) Theksimin e diferencave në të ardhura dhe pasuri dhe shërbime

Pyetja 63

Argumentet e Titmuss, bazuar në perspektivën social-demokrate, lidheshin me:

- A) Kufizimin e shpenzimeve për mirëqenie
- B) Universalizimin e të mirave dhe shërbimeve për të gjithë
- C) Shmangien e skemave të rishpërndarjes për të varfërit
- D) Testimin e mjeteve të jetesës

Pyetja 64

Tipologjitë e regjimeve të mirëqenies kanë rëndësi sepse:

- A) Praktikat globale e kërkojnë këtë
- B) Shmangjet gjenerimi dhe testimi i hipotezave të ndryshme mbi mirëqenien
- C) Na lejon të shohim incidencën e rasteve dhe të krahasojmë praktikat
- D) Kemi nevojë për analiza të gjata

Pyetja 65

Modeli residual për mirëqenien ka të bëjë me:

- A) Shpenzimet për shërbime sociale për frymë
- B) Renditjen e institucioneve sociale sipas rëndësisë
- C) Shpeshhtësinë e shpërndarjes së shërbimeve
- D) Dy rrugët e plotësimit të nevojave: tregu dhe familja

Pyetja 66

Modeli i arritjeve në performancën industriale ka të bëjë me:

- A) Barazinë e meritave dhe vlerave të punës së individit
- B) Atribuimin e rëndësisë së veçantë kundrejt bizneseve
- C) Mirëqenien e merituar prej atyre që kanë kontribuar për të
- D) Politikën në fushën e ekonomisë dhe industrisë

Pyetja 67

Modeli industrial rishpërndarës ka të bëjë me:

- A) Politikën e zhvillimit industrial kundrejt mirëqenies
- B) Të drejtën e përfitimit të individëve të përfshirë në skema sigurimi
- C) Sistemin e taksimit që përdorin shtetet kapitaliste
- D) Logjikën se e drejta për mirëqenie lind bashkë me individin

Pyetja 68

Gosta Esping-Andersen, në vitet `90 integroi elementet e mëposhtme në përcaktimin e tipologjive për mirëqenien sociale:

- A) Shpenzime-përfitime-sigurime
- B) Të drejta sociale-ekonomi-individ
- C) Dekomodifikim-shteti si sistem shtresëzimi-raporti shtet-treg
- D) Shërbime për të moshuarit-e drejta për sigurim jete-përkushtim ndaj mirëqenies

Pyetja 69

Rrethoni alternativën e gabuar në përcaktimin e shkallës së dekomodifikimit:

- A) Gama e përfitimeve
- B) E drejta qytetare për të përfituar shërbime
- C) Niveli i zëvendësimit të të ardhurave
- D) Rregullat e përfitueshmërisë dhe kufizimet në përfitime

Pyetja 70

Roli i shtetit të mirëqenies sociale në shtresëzimin social lidhet me:

- A) Kapacitetit të programeve të tij për të qenë ndëshkuese dhe stigmatizuese
- B) Mundësisë për të krijuar pavarësi në menaxhimin e programeve sociale
- C) Tendencën për të punësuar punonjës socialë në programe sociale
- D) Tendencën për të evidentuar shtresën e mesme përmes programeve

Pyetja 71

Kriteri Epsing-Andersen për plotësimin e nevojave sociale lidhet me tipologjinë:

- A) Tregu-shteti-familja
- B) Individu-shërbimet-shteti
- C) Grupi social-sigurimet shëndetësore-mosha
- D) Gjinia-etnia-statusi ekonomik

Pyetja 72

Cilit regjim të mirëqenies sociale i përgjigjet karakteristika se tregu është mbështetësi kryesor në sigurimin e shërbimeve sociale:

- A) Regjimit konservativ
- B) Regjimit liberal
- C) Regjimit social-demokrat
- D) Regjimit neoliberal

Pyetja 73

Në themel të regjimit konservativ qëndrojnë:

- A) Të drejtat sociale kundrejt klasës dhe statusit të individit
- B) Kategoritë sociale të përcaktuara nga niveli kulturor
- C) Familjet konservatore që përcaktonte monarkia
- D) Ideologjia e besimit kundrejt politikave qeveritare

Pyetja 74

Kur shteti ka rolin parësor në politikat për mirëqenien, kemi të bëjmë me regjimin:

- A) Korporatist
- B) Liberal
- C) Neoliberal
- D) Social-demokratik

Pyetja 75

Cilit model të regjimit të shtetit të mirëqenies I përkasin Australia dhe Zelanda e Re:

- A) Modelit korporatist
- B) Modelit liberal
- C) Modelit nordik
- D) Modelit radikal

Pyetja 76

Cilat janë tipet e modeleve të identifikuara nga Bonoli (1997) kur kombinon modelet e Beveridge-s dhe Bismarck-ut:

- A) Britanik-europian kontinental-nordik-jugor

- B) Mesdhetar- britanik-radikal-nordik
- C) European-nordik-mesdhetar-latin
- D) Amerikan-europian-jugor-nordik

Pyetja 77

Bazuar në modelin e mashkullit-sigurues të bukës së përditshme, Jane Leëis(1992) klasifikon vendet në:

- A) Vende të fuqishme, të moderuara,të dobëta
- B) Vende të botës së dytë dhe të tretë
- C) Vende të industrializuara dhe vende të varuara
- D) Vende me politika për gratë dhe vende që nxitin punësimin e burrave

Pyetja 78

Mendimi kritik i Ann Orloff (1993,1996) kundrejt dekomodifikimit të Esping-Andersen fokuson:

- A) Burrat
- B) Gratë
- C) Të moshuarit
- D) Fëmijët

Pyetja 79

Roli i shtetit për të menaxhuar prodhimin e mirëqenies realizohet nga:

- A) Strukturat e biznesit që nxitin nivelin e zhvillimit në vend
- B) Strukturat e shoqërisë civile që nxitin progresin kulturor të grupeve
- C) Qeveria dhe agjencitë shtetërore ekzekutive të pavarura dhe ojftë
- D) Srukturat shtetërore në bashkepunim me faktorin ndërkombëtar

Pyetja 80

Cilat janë disa nga rrugët përmes të cilave realizohet roli i përfshirjes së shtetit në mirëqenie:

- A) Politikat për shërbimet individuale, planifikimi, supervizimi në shpërndarjen e mirëqenies
- B) Politikat për shërbime ndaj familjes dhe kujdesin shëndetësor
- C) Proceset politike rregullatore që balancojnë shpenzimet me të ardhurat
- D) Përmes politikave fiskale dhe të taksimit të biznesit dhe qytetarëve

Pyetja 81

Në një ekonomi mikse, kundrejt mirëqenies sociale:

- A) Shteti lehtësisht siguron barazi dhe drejtësi krahasuar me tregun
- B) Është tregu që siguron drejtësinë sociale
- C) Tregu siguron mirëqenien sociale për konsumatorët
- D) Shteti i përgjigjet më pak nevojave në raport me kërkesat

Pyetja 82

Në konceptet teorike mbi shtetin dhe sektorin vullnetar, si burimet potenciale të sigurimit të mirëqenies trajtohet se:

- A) Sektori vullnetar nuk ka asnjë përgjegjësi në financimin për shpërndarjen e shërbimeve



- B) Organizatat lokale që ofrojnë shërbime kanë prioritet në planifikimin e shërbimeve
- C) Shteti kundrejt sektorit vullnetar bën shpërndarje të barabartë të shërbimeve
- D) Sektori vullnetar është më i centralizuar dhe kjo i jep avantazhe për shërbime uniforme

Pyetja 83

Në çfarë raporti qëndron mirëqenia dhe burokracia në zhvillimin e shtetit të mirëqenies:

- A) Burokracia shkon kundër politikave për mirëqenie
- B) Administrata burokratike nuk mendohet se ka lidhje direkte me vendimarrjen
- C) Srukturat hierarkike shprehin totalitarizëm dhe nuk prodhojnë mirëqenie
- D) Administrata burokratike është e rëndësishme për zhvillimin e shtetit të mirëqenies

Pyetja 84

Për të zhvilluar shtetin e mirëqenies nevojitet:

- A) Plane zhvillimi dhe piketa politike
- B) Struktura burokratike menaxhese dhe ekspertë neutralë
- C) Përkatësi politike dhe ideologjike
- D) Kritikë nga grupimet politike opozitare

Pyetja 85

Proceset e centralizimit dhe decentralizimit në lidhje me shtetin e mirëqenies rezultojnë se:

- A) Krijojnë një klimë bashkëpunimi me të gjithë aktorët
- B) Krijojnë tensione midis pushtetit qendror dhe atij lokal për shërbimet
- C) Përcaktohen nga politika e përgjithshme e një vendi, pa prekur shtetin e mirëqenies
- D) Janë thjesht trajtime teorike dhe nuk përfshihen në zhvillimin e shtetit të mirëqenies

Pyetja 86

Thelbi i përkufizimit të globalizimit ka të bëjë me:

- A) Hapjen e ekonomisë
- B) Kontrata për më të varfërit
- C) Politika kombëtare sociale
- D) Fuqizimin e mëtejshëm të shteteve të mëdha

Pyetja 87

Koncepti teorik i damping-ut social në kontekstin e globalizimit, nënkupton:

- A) Rritjen e mundësisë për politika të mbrojtjes sociale efikase
- B) Uljen e standardeve sociale nga presioni i ekonomisë globale
- C) Balancimin e nevojës për shërbime
- D) Shpërndarje e kontrolluar e shërbimeve për kategoritë në nevojë

Pyetja 88

Dampingu i shkaktuar nga globalizimi reflektohet në:

- A) Kalimin nga selektivizmi në universalizëm
- B) Standardizimin e konkurrencës
- C) Heqjen e taksimit për grupet aktive të tregut
- D) Tregje, qeverisje dhe standarde sociale

Pyetja 89

Perspektiva teorike “gara drejt fundit” mbi globalizimin dhe politikat sociale, nënkupton:

- A) Garimin e vendeve në zhvillim duke rritur konkurrencën
- B) Garimin e shteteve të mirëqenies për të rritur shpenzimet për mirëqenien
- C) Garimin e shteteve të mirëqenies drejt minimumit të mundshëm të sigurisë sociale
- D) Garimin e individëve si të barabartë për të përfituar shërbime sociale

Pyetja 90

“Gara drejt majës” është një koncept teorik në kontekstin e globalizimit që nënkupton:

- A) Pamundësinë e shteteve të mirëqenies për të përballuar ndryshimet demografike
- B) Pamundësinë për respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurinë sociale
- C) Që shtetet e mirëqenies do të vazhdojnë t'i sigurojnë qytetarët ndaj rreziqeve sociale
- D) Se garojnë ato shtete që nuk vuajnë nga plakja e popullsisë

Pyetja 91

Koncepti teorik “grupimi” në kontekstin e globalizimit që nënkupton:

- A) Unifromitet në reagimet e shteteve të mirëqenies për sigurinë sociale
- B) Grupimin e shteteve të mirëqenies sipas mënyrave të adresimit të problemeve
- C) Grupimin e shteteve të mirëqenies sipas rajoneve gjeografike
- D) Grupimin e shteteve të fuqishme ekonomikisht veç shteteve të tjera

Pyetja 92

Koncepti teorik “asgjë” në kontekstin e globalizimit që nënkupton:

- A) Ekonomia globale nuk do të lejojë asnjë shtet të zhvillohet jashtë strukturave të saj
- B) Ekonomia globale nuk lejon asnjë politikë të ndërhyjë në shtetin e mirëqenies
- C) Globalizimi nuk do të ketë asnjë ndikim në tjetërsimin e shteteve të mirëqenies sociale
- D) Ekonominë globale nuk e ndal asgjë për të detyruar politikat e shtetit të mirëqenies

Pyetja 93

Politikat për fëmijët bazohen në:

- A) Ndihmën financiare të familjes që ka kujdestarinë e tyre
- B) Gjykimet dhe paragjykimet rreth fëmijëve dhe fëmijërisë
- C) Kompromis të paqëndrueshëm midis vlerave për fëmijët, prindërit dhe rolit të qeverisë
- D) Edukimin social dhe shërbimet rezidenciale për fëmijët

Pyetja 94

Një arsye pse fëmijët që thyejnë ligjin trajtohen ndryshe nga të rriturit lidhet me:

- A) Shifrat e ulëta të kriminalitetit të të miturve
- B) Faktin se veprimet e tyre pasqyrojnë nevojat e tyre
- C) Mungesën e burgjeve për të mitur
- D) Rrezikshmërinë e lartë në institucionet e vuajtjes së dënimit

Pyetja 95

Rrethoni përgjigjen e gabuar: Drejtimit kryesore të liberalizmit modern dhe kejnsonianizmit përfshijnë:

- A) Pronësia shtetërore krahas asaj publike
- B) Zhvillimin e korporatave dhe bashkëpunimin qeveri-kapital
- C) Uljen e shpenzimeve publike në sferat speciale e të mirëqenies

D) Forcimin e rolit të shtetit si kontrollues

Pyetja 96

Pjesa më e madhe e kujdesit për fëmijët :

- A) Nuk merr parasysh besimet dhe sfondin kulturor të fëmijës
- B) Nuk ka lidhje direkte me fëmijët, por me kujdestarët e tyre
- C) Ka në fokus familjet e varfra dhe të paqëndrueshme
- D) Fokuset në menaxhimin e episoodeve të dhunës

Pyetja 97

Grupet e fëmijëve të përjashtuar në këndvështrimin e mirëqenies janë:

- A) Fëmijët e familjeve më të varfra
- B) Fëmijët e lindur nga martesat e dyta
- C) Fëmijët që banojnë në zonat rurale
- D) Fëmijë që nuk shkojnë mirë më mësim

Pyetja 98

Tipologjia e shërbimeve të reja sociale po realizohet përmes:

- A) Rritjes së numrit të nxënësve që frekuentojnë shkollën
- B) Akomodimit të fëmijëve në spitale
- C) Ngritjes dhe funksionimit të qendrave të shërbimeve sociale komunitare
- D) Financimit të tyre nga ana e qeverisë

Pyetja 99

Adoptimi konsiderohet

- A) Një alternativë funksionale për fëmijët e braktisur me prindër të panjohur
- B) Një mundësi që institucionet të matin arritjet e tyre
- C) I papërshtatshëm në vendet në tranzicion
- D) I lidhur me shumë probleme financiare për aktorët e përfshirë

Pyetja 100

Politikat dhe programet e reja të kujdesit social për fëmijët nuk përfshijnë:

- A) Parandalimin dhe identifikimin e problemit
- B) Trajtimin përmes programeve dhe vlerësimin e rezultateve
- C) Integrimin dhe sistemin e institucioneve për pozicionimin e përshtatshëm të individëve
- D) Shpërblime të caktuara për karakteristika të caktuara

Pyetja 101

Kuadri ligjor për politikën ndaj fëmijëve duhet të garantojë:

- A) Financime të sigurta për fëmijët në nevojë
- B) Të drejtat për të gjithë individët në nevojë
- C) Centralizimin e shërbimeve nga ana e shtetit
- D) Cilësinë e stafëve të profesionistëve ofrues të shërbimeve

Pyetja 102

Qeveritë e pas luftës së II botërore i dhanë përparësi:

- A) Konceptimit të demokracisë liberale të shtetit
- B) Zhdukjes së dallimeve klasore

- C) Rishpërndarjes së pasurisë dhe të të ardhurave përmes taksave progresive
- D) Rritjes së shpenzimeve qeveritare

Pyetja 103

Si ripërkufizohen individët e moshuar në kushtet e shtimit të rasteve të pensionimit të parakohshme:

- A) Moshë e tretë mbi 65 vjeç
- B) Moshë e tretë mbi 70 vjeç
- C) Moshë e tretë 50-74 vjeç dhe moshë e katërt mbi 75 vjeç
- D) Moshë e tretë mbi 68 vjeç

Pyetja 104

Stereotipet diskriminuese për moshën e tretë në tregun e punës vërrehen në:

- A) Kufizimet e moshës në lajmërimet për punësim
- B) Nevojën e punëdhënësve për t'i patur ata sa më gjatë në punë
- C) Nevojën për eksperiencën e tyre të gjatë në profesion
- D) Politikat shtetërore të zhvillimit të biznesit

Pyetja 105

Sistemi (PAYG) "Pay as you go" nënkupton:

- A) Një detyrim që të pensionuarit të deklarojnë të ardhurat
- B) Një marrëveshje që përjashton të pensionuarit nga taksat
- C) Që kontributet e pensioneve të të punësuarve shkojnë për pagesat e të pensionuarve
- D) Një detyrim që të pensionuarit të mos punojnë më

Pyetja 106

Termi "tranzicion i krisur" përcakton të rinjtë që:

- A) Krijojnë gjithnjë debate në vendet e tyre të punës dhe largohen
- B) Largohen përkohësisht dhe rikthehen të vijojnë studimet
- C) Krijojnë një lidhje familjare të tyre dhe e shkëputin atë
- D) Largohen nga edukimi, trajnimi dhe profesioni

Pyetja 107

Ndryshimet në modelin e sotëm për aftësinë e kufizuar kanë kaluar :

- A) Nga modeli tradicional në atë modern
- B) Nga modeli individual i paaftësisë në atë social të aftësisë së kufizuar
- C) Nga modeli me barriera ekonomike në atë liberal
- D) Nga modeli që thekson traumën fizike në atë që fokuson individualizmin

Pyetja 108

Cili nga pohimet nuk është parim themelor i strategjisë për PAK:

- A) Parimi i vetëvendosjes
- B) Parimi i rehabilitimit
- C) Parimi i qëllimshmërisë
- D) Parimi i shmangies së mjedisit të lirë

Pyetja 109

Diskriminimi në punësimin e personave me PAK ndalohet nga:

- A) Kodi i punës dhe ligjet për punësimin dhe arsimimin e PAK
- B) Punëdhënësit
- C) Organet e qeverisjes lokale
- D) Nga vetë PAK

Pyetja 110

Cili nga pokimet nuk hyn tek objektivat e mundshme të politikës për familjet me një prind:

- A) Të mundësojnë që prindi i munguar të kontribuojë në familje
- B) Të tregojnë barazinë mes çifteve që bashkëjetojnë
- C) Të rforcojnë institucionin e martesës
- D) Të rrisin varësinë në të ardhura

## **Kapitulli 9. Përkatësia Gjinore dhe Puna Sociale**

Pyetja 1

Çfarë është përkatësia gjinore?

- A) Dallimi biologjik midis burrave dhe grave
- B) Koncepti i roleve shoqërore që u caktohen burrave dhe grave
- C) Përkushtimi ndaj familjes
- D) Vendi i lindjes së një personi

Pyetja 2

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, a ka ndonjë kufizim mbi të drejtën e arsimimit për shkak të gjinisë?

- A) Po, vetëm për vajzat
- B) Po, vetëm për djemtë
- C) Jo, të gjithë janë të barabartë përpara ligjit
- D) Vetëm për të rriturit

Pyetja 3

Cili ligj parashikon mbledhjen e statistikave gjinore nga institucionet publike në Shqipëri?

- A) Ligji për menaxhimin e sistemit buxhetor
- B) Ligji nr. 9970 "Për barazinë gjinore në shoqëri"
- C) Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- D) Ligji për vetëqeverisjen vendore

Pyetja 4

Çfarë synon të arrijë strategjia e integrimit gjinor?

- A) Përdorimin e perspektivës gjinore në zhvillimin e të gjitha politikave
- B) Kufizimin e roleve gjinore në institucione publike
- C) Heqjen e barazisë gjinore
- D) Mbështetjen vetëm të grave në sektorë të veçantë

Pyetja 5

Çfarë synon të arrijë strategjia WID (Gruaja në Zhvillim)?

- A) Të përfshijë gratë në aktivitete tradicionale shtëpiake
- B) Të rrisë përfshirjen e burrave në aktivitetet familjare
- C) Të zhvillojë politika vetëm për burrat
- D) Të promovojë barazinë gjinore përmes përfshirjes ekonomike të grave

Pyetja 6

Cili është roli kryesor i “socializimit gjinor”?

- A) Përcaktimi i roleve gjinore përmes ndërveprimeve në familje dhe shoqëri
- B) Edukimi i burrave dhe grave në të njëjtën mënyrë
- C) Ndarja e burimeve në mënyrë të barabartë mes gjinive
- D) Rritja e konkurrencës gjinore

Pyetja 7

Cili është përkufizimi i “politikave të ndjeshme ndaj gjinisë”?

- A) Politikat që përqendrohen vetëm në përmirësimin e pagës për gratë
- B) Politikat që kufizojnë mundësitë për burrat dhe gratë
- C) Politikat që synojnë të ndryshojnë strukturat ekzistuese gjinore për një shoqëri më të drejtë
- D) Politikat që mbështesin vetëm gratë në sektorin publik

Pyetja 8

Çfarë rëndësie kanë “politikave të ndjeshme gjinore” në organizatat publike?

- A) Përshtatin politikave për të adresuar nevojat e veçanta të burrave dhe grave
- B) Kufizojnë pjesëmarrjen e grave në pozita udhëheqëse
- C) Përqendrohen në arsimimin e grave
- D) Mbështesin vetëm burrat në politikë

Pyetja 9

Cili nga këta faktorë ndikon në ndarjen gjinore të punës?

- A) Preferencat individuale të punonjësve
- B) Rolet dhe pritshmëritë shoqërore mbi gjininë
- C) Rregullat strikte të vendosura nga qeveria
- D) Diferencat në aftësitë e komunikimit

Pyetja 10

Cili është qëllimi i përfshirjes së perspektivës gjinore në sistemin arsimor?

- A) Të sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë studentët
- B) Të ndihmojë vetëm studentët e suksesshëm
- C) Të kufizojë pjesëmarrjen e burrave në arsim
- D) Të ofrojë fonde për shkollat private

Pyetja 11

Cila është një nga sfidat kryesore në zbatimin e kuotave gjinore në politikë?

- A) Mungesa e kandidatëve burra
- B) Stigmatizimi i grave si përfituese të përparësive, duke nënvlerësuar aftësitë e tyre reale

- C) Mbështetja pa kushte e votuesve për kuotat
- D) Reduktimi i diversitetit gjinor

Pyetja 12

Cila është rëndësia e “analizës gjinore” në politikë-bërje?

- A) Të përcaktojë mënyrat për të mbështetur burrat në arsim
- B) Të rrisë numrin e grave në pozita drejtuese
- C) Të shqyrtojë ndikimin e politikave në jetën e grave dhe burrave për të siguruar trajtim të barabartë
- D) Të përjashtojë ndikimin e grave në politikë

Pyetja 13

Si ndikon “faktori i shumësisë së roleve” në mirëqenien psikologjike të grave?

- A) Ul presionin e tyre social
- B) Ndihmon në fuqizimin e tyre ekonomik
- C) Shkakton stres dhe mund të rrisë rrezikun e lodhjes kronike
- D) Përmirëson cilësinë e jetës së tyre familjare

Pyetja 14

Çfarë synon të arrijë qasja GAD (Zhvillimi i Ndjeshëm Gjinor)?

- A) Të përfshijë vetëm gratë në procesin e zhvillimit
- B) Të trajtojë marrëdhëniet gjinore dhe të promovojë barazinë duke sfiduar strukturat ekzistuese sociale
- C) Të promovojë punësimin e burrave në pozita udhëheqëse
- D) Të mbështesë vetëm zhvillimin ekonomik të burrave

Pyetja 15

Çfarë përfshin “zhvillimi i ndjeshëm gjinor” në kontekstin e integritetit gjinor?

- A) Përdorimi i kuotave për gratë në sektorin privat
- B) Ndërhyrja vetëm në rastet e diskriminimit direkt
- C) Kufizimi i rolit të grave në sektorin public
- D) Promovimi i përfshirjes së perspektivës gjinore në çdo fazë të zhvillimit të politikave dhe programeve

Pyetja 16

Cili është qëllimi kryesor i strategjive të bazuara në barazinë gjinore në fushën e edukimit?

- A) Të rrisë përqindjen e burrave në pozita drejtuese në arsim
- B) Të promovojë mundësi të barabarta edukative për të gjitha gjinitë dhe të eliminojë stereotipet gjinore
- C) Të përmirësojë vetëm kushtet ekonomike të grave
- D) Të zvogëlojë përqindjen e grave në sistemin arsimor

Pyetja 17

Cili grup përfshihet në mënyrë specifike në fokusin e Strategjisë si grup i cenueshëm?

- A) Studentët e universiteteve private
- B) Gratë dhe vajzat nga zonat rurale dhe minoritetet etnike
- C) Burrat në profesionet e kujdesit shëndetësor

D) Të rinjtë me aftësi të shkëlqyera teknologjike

Pyetja 18

Çfarë përfshin ndarja gjinore e punës?

- A) Shpërndarjen e barabartë të detyrave
- B) Caktimin e roleve për burrat dhe gratë bazuar në aftësitë personale
- C) Ndarjen e roleve sipas normave shoqërore për burra dhe gratë
- D) Punën e përbashkët të burrave dhe grave në çdo sector

Pyetja 19

Cili është qëllimi kryesor i mekanizmit të koordinuar të referimit për dhunën në familje?

- A) Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të dhunës në familje.
- B) Mbështetja ekskluzive për dhunuesit.
- C) Kufizimi i ndërhyrjeve nga institucione të ndryshme.
- D) Dhënia e ndihmës vetëm për raste emergjente.

Pyetja 20

Çfarë përfshin “shporta e shërbimeve” për viktimat e dhunës?

- A) Lista e ndihmave financiare për dhunuesit.
- B) Tërësia e shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave.
- C) Vetëm ndihma psikologjike për viktimat.
- D) Programe arsimore për fëmijët e viktimave.

Pyetja 21

Cili është roli i koordinatorëve vendorë në trajtimin e dhunës në familje?

- A) Administrimi i dokumentacionit financiar të bashkisë.
- B) Referimi dhe menaxhimi i rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.
- C) Kufizimi i bashkëpunimit me institucionet tjera.
- D) Ndjekja ligjore e dhunuesve.

Pyetja 22

Cili është roli i ekipeve teknike ndërdisiplinore (ETN) në trajtimin e rasteve të dhunës?

- A) Mbështetja me fonde për viktimat.
- B) Përcaktimi i masave ligjore ndaj dhunuesve.
- C) Koordinimi dhe zbatimi i planeve të ndihmës individuale për viktimat.
- D) Kufizimi i bashkëpunimit me autoritetet lokale.

Pyetja 23

Çfarë është sistemi REVALB?

- A) Një platformë për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për rastet e dhunës.
- B) Një organizatë për mbështetjen e grave.
- C) Një shoqatë për të drejtat e fëmijëve.
- D) Një qendër rehabilitimi për dhunuesit.

Pyetja 24

Si mund të ndihmojnë mekanizmat lokalë në zvogëlimin e riviktimizimit?



- A) Duke trajtuar viktimat me respekt dhe duke siguruar mbështetje të individualizuar.
- B) Duke ndaluar ndjekjen ligjore të dhunuesve.
- C) Duke kufizuar të drejtat e viktimave për të raportuar dhunën.
- D) Duke siguruar vetëm ndihmë ekonomike për viktimat.

#### Pyetja 25

Cila është rëndësia e shërbimeve psikosociale për viktimat e dhunës?

- A) Ndhimjnë në rikuperimin emocional dhe përmirësimin e mirëqenies mendore.
- B) Kufizojnë ndërveprimet sociale të viktimës.
- C) Përqendrohen vetëm në dhënien e ndihmës materiale.
- D) Janë të destinuara vetëm për raste të rënda dhune.

#### Pyetja 26

Cili është funksioni kryesor i pikave të referimit në nivel lokal?

- A) Monitorimi i dhunuesve në komunitet.
- B) Regjistrimi dhe referimi i rasteve të dhunës për trajtim të mëtejshëm.
- C) Zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat.
- D) Mbështetja vetëm për viktimat që kërkojnë ndihmë ekonomike.

#### Pyetja 27

Cili është qëllimi i planeve individuale të mbështetjes për viktimat e dhunës?

- A) Sigurimi i një qasjeje të personalizuar për rikuperimin e viktimës dhe përmbushjen e nevojave të saj.
- B) Përmirësimi i marrëdhënieve midis viktimës dhe dhunuesit.
- C) Reduktimi i përfshirjes së autoriteteve lokale.
- D) Kufizimi i ndihmës për viktimat me burime të kufizuara financiare.

#### Pyetja 28

Cili është ndikimi i një sistemi të fortë referimi në trajtimin e dhunës në familje?

- A) Redukton efektivitetin e bashkëpunimit institucional.
- B) Përmirëson qasjen në shërbime dhe siguron mbështetje gjithëpërfshirëse për viktimat.
- C) Kufizon përfshirjen e viktimave në vendimmarrje.
- D) Përqendrohet vetëm në ofrimin e ndihmës emergjente.

#### Pyetja 29

Cili është roli i mbështetjes psikologjike në procesin e rikuperimit të viktimave?

- A) Ndhimon viktimat të përballojnë traumën dhe të zhvillojnë aftësi për të rimarrë kontrollin e jetës së tyre.
- B) Redukton nevojën për ndihmën ligjore.
- C) Kufizon përfshirjen e viktimave në procesin e vendimmarrjes.
- D) Përqendrohet vetëm në identifikimin e dhunuesve.

#### Pyetja 30

Cila është qasja e duhur për të trajtuar fëmijët si viktimat e dhunës në familje?

- A) Injorimi i përvojave të tyre për të mbrojtur dhunuesin.
- B) Kufizimi i aksesit në shërbime për fëmijët pa kujdestarë.
- C) Sigurimi i mbështetjes emocionale, mjekësore dhe edukative për rikuperimin e tyre.

D) Trajtimi i tyre vetëm si dëshmitarë të dhunës.

Pyetja 31

Cili është ndikimi i qasjes me bazë të drejtat e njeriut në trajtimin e dhunës në familje?

- A) Kufizon mbrojtjen e viktimave që janë në proces gjyqësor.
- B) Fokuson ndihmën vetëm në aspektet financiare.
- C) Promovon barazinë, respektin për dinjitetin dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave.
- D) Përcakton mbështetjen vetëm për viktimat që janë gra.

Pyetja 32

Çfarë përfaqëson "riviktimizimi dytësor" në trajtimin e rasteve të dhunës?

- A) Dëmtimi fizik i viktimës nga një tjetër dhunues.
- B) Përkeqësimi i traumës përmes proceseve burokratike dhe trajtimeve joadekuate.
- C) Rritja e presionit psikologjik nga anëtarët e familjes.
- D) Mungesa e ndihmës financiare për viktimat.

Pyetja 33

Çfarë rëndësie ka një plan individual në mbështetje të viktimave të dhunës në familje?

- A) Lehtëson rikuperimin duke adresuar nevojat specifike të çdo viktime.
- B) Kufizon mbështetjen vetëm për viktimat që raportojnë dhunën.
- C) Përcakton ndihmë vetëm në nivel ekonomik.
- D) Fokuson trajtimin vetëm në aspektet psikologjike.

Pyetja 34

Cili është roli i policisë në referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje?

- A) Mbështet vetëm viktimat që kërkojnë ndihmë financiare.
- B) Ofron mbrojtje emergjente dhe bashkëpunon me mekanizmat lokalë për trajtim.
- C) Përcakton ndihmë vetëm në nivel ligjor.
- D) Kufizon ndërhyrjet për shkak të mungesës së burimeve.

Pyetja 35

Si ndikon përdorimi i protokolleve standarde në trajtimin e dhunës në familje?

- A) Siguron qasje të unifikuar dhe mbrojtje efektive për viktimat.
- B) Kufizon fleksibilitetin në menaxhimin e rasteve.
- C) Zvogëlon mundësitë për ndërhyrje të personalizuar.
- D) Përqendrohet vetëm në trajtime psikologjike.

Pyetja 36

Cili është funksioni i ekipeve ndërdisiplinore në trajtimin e dhunës në familje?

- A) Mbledhja e të dhënave statistikore për viktimat.
- B) Hartimi dhe zbatimi i planit të mbështetjes për viktimat në mënyrë të koordinuar.
- C) Kufizimi i qasjes së viktimave në shërbime të tjera.
- D) Ndjekja ligjore e dhunuesve pa përfshirjen e viktimës.

Pyetja 37

Cila është rëndësia e trajnimeve të vazhdueshme për profesionistët që punojnë me viktimat e dhunës?

- A) Redukton nevojën për koordinim ndërinstytucional.
- B) Kufizon ndërveprimet me sektorin joqeveritar.
- C) Përmirëson aftësitë e tyre për të trajtuar raste komplekse dhe për të zbatuar qasjen etike.
- D) Përqendrohet vetëm në ndihmën financiare për viktimat.

Pyetja 38

Si ndikon “analiza gjinore” në projektet ndërkombëtare të zhvillimit?

- A) Përmirëson efektivitetin e projekteve duke adresuar nevojat specifike të grave dhe burrave
- B) Kufizon qasjen për burrat
- C) Zvogëlon përfshirjen e grave
- D) Përqendrohet vetëm në zhvillimin ekonomik

Pyetja 39

Cila është rëndësia e “sensibilizimit gjinor” në institucionet publike?

- A) Redukton përfaqësimin e grave
- B) Nuk ndikon në qasjen ndaj barazisë
- C) Mbështet vetëm përfitimet financiare
- D) Ndhmon në zvogëlimin e paragjykimeve gjinore dhe promovimin e një mjedisi të barabartë

Pyetja 40

Cili është përfitimi kryesor i “planifikimit të ndjeshëm gjinor” në projekte sociale?

- A) Kufizon përfshirjen e grave
- B) Zvogëlon burimet për projekte të tjera
- C) Siguron që të dy gjinitë të përfitojnë në mënyrë të barabartë
- D) Rrit pabarazitë gjinore

Pyetja 41

Si ndikon "diversiteti gjinor" në zhvillimin dhe efektivitetin e organizatave?

- A) Ul efektivitetin për shkak të dallimeve
- B) Përmirëson kulturën e organizatës dhe sjell ide të reja për zgjidhje të problemeve
- C) Kufizon mundësitë për përparim
- D) Përkeqëson marrëdhëniet në punë

Pyetja 42

Cila është rëndësia e “barazisë në vendimmarrje” për promovimin e drejtësisë sociale?

- A) Rrit barazinë dhe përfaqësimin, duke ndihmuar në krijimin e një mjedisi më gjithëpërfshirës
- B) Zvogëlon përfaqësimin e grupeve minoritare
- C) Kufizon rolin e grave në vendimmarrje
- D) Ndhmon burrat të kenë përparësi në vendimmarrje

Pyetja 43

Cili është një nga ndikimet e pabarazisë gjinore në tregun global të punës?

- A) Zvogëlimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik për shkak të humbjes së potencialit të grave

- B) Promovimi i përparësive të grave në punë
- C) Eliminimi i sfidave gjinore në tregun e punës
- D) Përqendrimi i grave vetëm në sektorin public

Pyetja 44

Cili është qëllimi i kryesor i strategjive të orientuara drejt “fuqizimit gjinor”?

- A) Të përmirësojë përfshirjen e burrave në proceset sociale
- B) Të sigurojë që të dy gjinitë të kenë akses të barabartë ndaj burimeve dhe mundësive
- C) Të eliminojë rolin e grave në sektorin publik
- D) Të rrisë pabarazinë gjinore

Pyetja 45

Çfarë është “gjinia” në kontekstin shoqëror?

- A) Vetëm dallimi biologjik midis burrave dhe grave
- B) Roli dhe pritshmëritë që shoqëria ka ndaj burrave dhe grave
- C) Vetëm përzgjedhja e profesionit në bazë të preferencave
- D) Përkujdesja e barabartë ndaj familjes

Pyetja 46

Çfarë përfshin riprodhimi social?

- A) Kujdesin dhe përkujdesjen për fëmijët dhe mirëmbajtjen e familjes
- B) Vetëm aktivitetet e mirëqenies ekonomike
- C) Prodhimin e të mirave materiale për treg
- D) Pjesëmarrjen në aktivitete komunitare

Pyetja 47

Cila prej këtyre nismave konsiderohet si mbështetje për barazinë gjinore?

- A) Vendosja e kuotave gjinore në parlament
- B) Kufizimi i punësimit për gratë
- C) Puna e pandërprerë e burrave në sektorin publik
- D) Promovimi i konkurrencës gjinore në arsim

Pyetja 48

Çfarë nënkupton diskriminimi në bazë të gjinisë?

- A) Trajtim i barabartë për të gjitha gjinitë
- B) Përdorimi i kuotave gjinore në punësim
- C) Trajtim i pabarabartë dhe me përjashtim për shkak të gjinisë
- D) Promovimi i barazisë gjinore në arsim

Pyetja 49

Cili nga këto përshkrime përmban një shembull të rolit tradicional gjinor?

- A) Një grua që punon në sektorin e teknologjisë
- B) Një burrë që kujdeset për fëmijët në shtëpi
- C) Një grua që merret me përkujdesje për familjen dhe shtëpinë
- D) Një burrë që ndihmon në punët e pastrimit në shtëpi

Pyetja 50

Cili është roli i mediave në formësimin e qëndrimeve gjinore?

- A) Pasqyron dhe promovon normat gjinore të shoqërisë
- B) Shmang përfshirjen e stereotipeve gjinore
- C) Shmang çdo lloj portretizimi gjinor
- D) Ndihmon në rritjen e konkurrencës gjinore

Pyetja 51

Çfarë nënkupton koncepti “përkatësi gjinore”?

- A) Ndikim biologjik në sjelljen e individit
- B) Ndikim socio-kulturor në ndarjen e roleve gjinore
- C) Diferencim racor në shoqëri
- D) Klasifikim fetar i roleve gjinore

Pyetja 52

Çfarë është gjinizimi në kontekstin social?

- A) Procesi i përcaktimit të roleve gjinore nga shoqëria
- B) Procesi i ndarjes së detyrave të bazuara në aftësitë e individit
- C) Ndarja e përgjegjësive vetëm për burrat
- D) Kufizimi i pjesëmarrjes së grave në tregun e punës

Pyetja 53

Çfarë nënkupton diskriminimi gjinor në vendin e punës?

- A) Përzgjedhja e personelit pa dallime gjinore
- B) Trajtimi i pabarabartë bazuar në gjininë e individit
- C) Puna e përbashkët midis burrave dhe grave
- D) Zhvillimi i politikave gjinore në kompani

Pyetja 54

Çfarë është socializimi gjinor?

- A) Procesi i mësimin të roleve gjinore që nga fëmijëria
- B) Procesi i përcaktimit të gjinisë
- C) Zhvillimi i stereotipeve për një gjini specifike
- D) Procesi i përzgjedhjes së profesionit bazuar në gjininë

Pyetja 55

Si mund të kontribuojnë punonjësit socialë në uljen e diskriminimit gjinor?

- A) Duke promovuar ruajtjen e roleve tradicionale gjinore.
- B) Duke kufizuar shërbimet për gratë që nuk kanë fëmijë.
- C) Duke ofruar trajnime për ndërgjegjësimin mbi barazinë gjinore dhe duke mbështetur politika gjithëpërfshirëse.
- D) Duke ndaluar bashkëpunimin me organizatat jofitimprurëse.

Pyetja 56

Cili është prioriteti kryesor në menaxhimin e rasteve të dhunës gjinore?

- A) Parandalimi i riviktimizimit dhe garantimi i sigurisë së viktimës.
- B) Rehabilitimi i dhunuesit.

- C) Raportimi i të gjitha rasteve në median lokale.
- D) Vendosija e një sistemi të rreptë gjobash për dhunuesit.

Pyetja 57

Cili është roli i barazisë gjinore në politikat për trajtimin e dhunës në familje?

- A) Për të përforcuar ndarjen tradicionale të roleve gjinore.
- B) Për të siguruar që të gjitha masat të jenë neutrale gjinore.
- D) Për të përjashtuar dhunuesit nga shërbimet sociale.
- C) Për të promovuar trajtim të barabartë dhe adresimin e diskriminimit gjinor.

Pyetja 58

Cila nga këto alternativa është detyrë e punonjësit social për të promovuar barazinë gjinore në komunitet?

- A) Mbikëqyrja e projekteve që kufizojnë pjesëmarrjen e burrave
- B) Krijimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese për të gjithë komunitetin për të eliminuar diskriminimin gjinor
- C) Sigurimi që vetëm gratë të përfitojnë nga programet sociale
- D) Ndihma në krijimin e organizatave të ndara për burrat dhe gratë

Pyetja 59

Çfarë nënkupton koncepti i “diskriminimit të shumëfishtë” në kontekstin e barazisë gjinore?

- A) Diskriminimi i burrave në të gjitha sektorët e punës
- B) Diskriminimi i grave vetëm në sektorin privat
- C) Diskriminimi që ndodh për shkak të kombinimit të disa faktorëve, si gjinia, etnia dhe aftësia fizike
- D) Diskriminimi i burrave dhe grave që jetojnë në qytete të mëdha

Pyetja 60

Cila nga këto alternativa është praktikë e punës sociale në ndihmë të eliminimit të stereotipeve gjinore?

- A) Nxitja e pjesëmarrjes së grave dhe burrave në profesione jo tradicionale për gjininë e tyre
- B) Organizimi i aktiviteteve që promovojnë role tradicionale gjinore
- C) Kufizimi i burrave nga përfshirja në edukimin e hershëm të fëmijëve
- D) Mbështetja vetëm e grave për të hyrë në tregun e punës

Pyetja 61

Cila është detyra kryesore e punonjësit social në promovimin e barazisë gjinore?

- A) Të ndihmojë vetëm gratë e dhunuara
- B) Të sigurojë strehim për të gjithë viktimat e dhunës familjare
- C) Të organizojë trajnime vetëm për punëdhënësit meshkuj
- D) Të mbështesë të gjithë individët pavarësisht gjinisë për të pasur akses të barabartë në shërbime dhe të drejta

Pyetja 62

Cili është roli kryesor i koordinatorit vendor në trajtimin e dhunës në familje?

- A) Shpërndarja e ndihmave financiare për viktimat.
- B) Koordinimi i masave mbrojtëse dhe referimi i rasteve.

- C) Hartimi i ligjeve të reja për barazi gjinore.
- D) Monitorimi i fushatave mediatike.

Pyetja 63

Cili është përkufizimi kryesor i barazisë gjinore?

- A) Trajtim i barabartë i burrave dhe grave në të gjitha fushat e jetës
- B) Të njëjtën sasi të ardhurash për burrat dhe gratë
- C) Eliminimi i roleve gjinore në familje
- D) Pjesëmarrje e barabartë në të gjitha profesionet

Pyetja 64

Cila nga këto masa është përfshirë në Strategjinë për adresimin e dhunës me bazë gjinore?

- A) Krijimi i një buxheti të posaçëm për nënat e reja
- B) Zvogëlimi i fondeve për shërbimet e viktimave
- C) Kriminalizimi i dhunës psikologjike dhe mbrojtja e viktimave
- D) Kufizimi i qasjes së grave në vendet e punës tradicionale

Pyetja 65

Çfarë është sistemi REVALB?

- A) Një platformë për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për rastet e dhunës.
- B) Një organizatë për mbështetjen e grave.
- C) Një shoqatë për të drejtat e fëmijëve.
- D) Një qendër rehabilitimi për dhunuesit.

Pyetja 66

Çfarë përfshin "plani i përbashkët i ndërhyrjes" (PPN)?

- A) Strategjitë për rehabilitimin e viktimës dhe dhunuesit, përfshirë nevojat për punësim dhe ndihmë ligjore.
- B) Marrjen e vendimeve të përbashkëta nga bashkia dhe gjykata.
- C) Vetëm strategjitë për ndëshkimin e dhunuesit.
- D) Planifikimin financiar të shpenzimeve të qeverisë për dhunën në familje.

Pyetja 67

Si duhet të trajtohet një viktimë nga komuniteti LGBTI+ nga një punonjës social?

- A) Me procedura standarde që janë të njëjta për të gjithë.
- B) Me ndjeshmëri për karakteristikat specifike të grupit të saj/tij.
- C) Referimi ekskluzivisht në organizata të shoqërisë civile.
- D) Duke injoruar orientimin seksual gjatë trajtimit.

Pyetja 68

Cila është sfida kryesore në adresimin e dhunës në marrëdhëniet intime?

- A) Perceptimi i dhunës si çështje private dhe jo publike.
- B) Moshja e lartë e viktimave.
- C) Mbështetja e lartë ligjore për viktimat.
- D) Vetëdija e lartë në komunitet për këto raste.

Pyetja 69

Cili është qëllimi kryesor i Protokollit të Menaxhimit të Rasteve të Dhunës Seksuale?

- A) Trajtimi vetëm i rasteve të dhunës së lehtë.
- B) Sigurimi i shërbimeve të menjëhershme dhe gjithëpërfshirëse për viktimën.
- C) Monitorimi i medias për raportime të sakta.
- D) Penalizimi i dhunuesit.

Pyetja 70

Çfarë duhet të bëjë një punonjës social për të promovuar ndryshimin social mbi barazinë gjinore?

- A) Të injorohet diskriminimin gjinor për të shmangur konflikte.
- B) Të përqendrohet vetëm te nevojat financiare të individëve.
- C) Të punohet vetëm me gratë për të rritur fuqizimin e tyre.
- D) Të angazhohet në fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi komunitar.

Pyetja 71

Cili faktor mund të jetë një barrierë kryesore për viktimat e dhunës me bazë gjinore në kërkimin e ndihmës?

- A) Përdorimi i mekanizmave të referimit në nivel vendor.
- B) Akses i lirë në shërbime sociale.
- C) Ndjenja e turpit dhe stigma sociale.
- D) Mbështetja e fortë nga rrjeti familjar.

Pyetja 72

Cili është ndikimi i dhunës me bazë gjinore në mirëqenien sociale të viktimave?

- A) Përmirëson vetëbesimin për shkak të përballimit të sfidave.
- B) Shkakton izolim social, humbje të vetëbesimit dhe trauma të thella.
- C) Rrit lidhjen me anëtarët e familjes për shkak të mbështetjes.
- D) Nuk ndikon në marrëdhëniet shoqërore.

Pyetja 73

Cili dokument ndërkombëtar është më i rëndësishmi për të drejtat gjinore në punën sociale?

- A) Konventa për të Drejtat e Fëmijëve.
- B) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.
- C) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).
- D) Marrëveshja e Parisit për Klimën.

Pyetja 74

Cila është qasja më e përshtatshme për një punonjës social në trajtimin e dhunës me bazë gjinore?

- A) Përfshirja e perspektivës gjinore në të gjitha fazat e trajtimit të rastit.
- B) Ofrimi i një shërbimi të standardizuar për të gjitha rastet.
- C) Referimi vetëm te policia pa ndjekje të mëtejshme.
- D) Këshillimi për rikthim në marrëdhënien e dhunshme për qëndrueshmëri familjare.



Pyetja 75

Çfarë duhet të marrë në konsideratë një punonjës social gjatë trajtimit të rasteve të dhunës seksuale?

- A) Të fokusohet vetëm te shërbimet mjekësore.
- B) Të sigurojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj gjinisë.
- C) Të mos përfshijë familjen e viktimës në trajtim.
- D) Të marrë vendime pa konsultuar viktimën.

Pyetja 76

Çfarë përfshin termi "ngacmim seksual" sipas legjislacionit shqiptar?

- A) Çdo kontakt fizik i padëshiruar.
- B) Çdo sjellje verbale, fizike ose jo-verbale me natyrë seksuale që cenon dinjitetin.
- C) Vetëm kërcënimet e hapura me dhunë seksuale.
- D) Sjellje që ndodh vetëm në mjedisin e punës.

Pyetja 77

Cili është një shembull i dhunës ekonomike?

- A) Kufizimi i burimeve financiare të partnerit për të kontrolluar sjelljen e tij.
- B) Mosdhënia e një dhurate për një rast festiv.
- C) Planifikimi i buxhetit familjar së bashku.
- D) Shpenzimi i përbashkët për nevojat e familjes.

Pyetja 78

Cili është një shembull i dhunës me bazë gjinore?

- A) Një debat verbal midis miqve.
- B) Një mosmarrëveshje për ndarjen e detyrave shtëpiake.
- C) Përdorimi i forcës për të kontrolluar një partner për shkak të gjinisë së tij.
- D) Ndarja e punëve në bazë të aftësive të secilit.

Pyetja 79

Cili është parimi kryesor në trajtimin e dhunës me bazë gjinore sipas Protokollit të Menaxhimit?

- A) Trajtimi i menjëhershëm dhe gjithëpërfshirës i viktimës.
- B) Hetimi penal i rastit brenda 24 orëve.
- C) Kërkimi i pëlqimit të familjes për trajtim.
- D) Ndjekja e rastit vetëm për viktimat gra.

Pyetja 80

Cili është kuadri ligjor kryesor që rregullon dhunën në marrëdhëniet familjare në Shqipëri?

- A) Kodi Penal.
- B) Ligji nr. 9669/2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".
- C) Ligji për të Drejtat e Fëmijëve.
- D) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).

Pyetja 81

Çfarë nënkupton termi "dhunë me bazë gjinore"?

- A) Çdo akt dhune ndaj grave, pavarësisht motivit.

- B) Dhuna që ndikon tek gratë dhe burrat në mënyrë të njëjtë.
- C) Dhuna që ndodh për shkak të përkatësisë gjinore të viktimës.
- D) Vetëm dhuna fizike ndaj grave.

Pyetja 82

Cili është koncepti kryesor i barazisë gjinore në punën sociale?

- A) Trajtimi i të gjithëve njësoj pa marrë parasysh rrethanat e tyre.
- B) Ofrimi i shërbimeve të ndryshme bazuar vetëm te nevojat financiare.
- C) Eliminimi i barrierave sociale dhe kulturore për akses të barabartë.
- D) Trajtimi më i mirë i grave dhe vajzave në krahasim me burrat.

Pyetja 83

Cili është roli i Koordinatorit Vendor Kundër Dhunës në Familje (KVDHF)?

- A) Përgatitja e dosjeve penale për dhunuesit.
- B) Koordinimi i shërbimeve për viktimat dhe ndjekja e zbatimit të urdhrave të mbrojtjes.
- C) Monitorimi i situatave financiare të familjeve.
- D) Zëvendësimi i punonjësve socialë në rast emergjence.

Pyetja 84

Cili nga këto dokumente ndërkombëtare mbështet barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës?

- A) Konventa e Stambollit.
- B) Marrëveshja e Parisit për Klimën.
- C) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.
- D) Traktati i NATO-s.

Pyetja 85

Çfarë përfshin menaxhimi i një rasti emergjent sipas MKR-së?

- A) Vetëm referimin e rastit të policia.
- B) Një reagim të menjëhershëm për sigurinë dhe ndalimin e dhunës përmes një ekipi bërthamë.
- C) Referimin te organizatat e shoqërisë civile për trajtim afatgjatë.
- D) Një analizë statistikore mbi dhunën në atë zonë.

Pyetja 86

Çfarë përfshin avokimi për barazinë gjinore në punën sociale?

- A) Përqendrimin vetëm te problemet e grave në shoqëri.
- B) Edukimin e burrave për të ndihmuar gratë në përmbushjen e roleve tradicionale.
- C) Krijimin e mundësive të barabarta dhe ndërgjegjësimin për çështjet gjinore.
- D) Përrjashtimin e gjinive të caktuara nga programet sociale.

Pyetja 87

Cila prej alternativave paraqet një shembull të punës sociale për të reduktuar stereotipet gjinore?

- A) Organizimi i trajnimeve për të promovuar role të barabarta gjinore në komunitet.
- B) Inkurajimi i grave që të përqendrohen vetëm në detyrat shtëpiake.
- C) Përfshirja e grave dhe burrave në programe të ndara sipas roleve tradicionale.
- D) Promovimi i politikave që mbështesin dominimin e një gjinie mbi tjetrën.

Pyetja 88

Çfarë përfshin një plan ndërhyrjeje i bazuar në përkatësinë gjinore?

- A) Fokusi vetëm në gratë që përballen me sfida financiare.
- B) Krijimi i një programi gjithëpërfshirës që adreson nevojat specifike të burrave dhe grave.
- C) Trajtimi i viktimave pa u përfshirë në zgjidhje afatgjata.
- D) Injorimi i aspektit gjinor për të shmangur konflikte.

Pyetja 89

Si trajtohen rastet e dhunës seksuale në mungesë të ekipeve të specializuara në Shqipëri?

- A) Vetëm nga Policia e Shtetit.
- B) Nga ETN bërthamë të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR).
- C) Nga grupet vullnetare të komunitetit.
- D) Vetëm nga organizatat joqeveritare.

Pyetja 90

Cili është një nga faktorët kryesorë të riskut për dhunë me bazë gjinore?

- A) Moshë e re dhe mungesa e arsimit.
- B) Të ardhurat e larta.
- C) Vendbanimi në zona urbane.
- B) Barazia gjinore në familje.

Pyetja 91

Çfarë përfshin puna sociale në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje?

- A) Ndjekjen vetëm të procedurave ligjore.
- B) Ofrimin e mbështetjes emocionale dhe ndihmës për riintegrim.
- C) Këshillimin për qëndrimin në marrëdhënien e dhunshme.
- D) Referimin e rasteve vetëm në polici.

Pyetja 92

Si sigurohet ndihma mjekësore emergjente për viktimat e dhunës?

- A) Përmes ambulancave private.
- B) Me njoftimin e Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor ose spitalit rajonal.
- C) Vetëm nëse viktimat paraqet dokumente identifikimi.
- D) Vetëm për viktimat me dëmtime të rënda.

Pyetja 93

Çfarë përfshin vlerësimi i riskut në rastet e dhunës?

- A) Identifikimin e dhunuesit dhe viktimës për statistikë.
- B) Vendosijen e dhunuesit në qendër të mbrojtjes.
- C) Analizën e nivelit të rrezikut për jetën dhe mirëqenien e viktimës dhe ndjekjen e masave mbrojtëse.
- D) Referimin te gjykata për një vendim përfundimtar.

Pyetja 94

Si trajtohen rastet e fëmijëve që janë dëshmitarë të dhunës në familje?

- A) Referimi i tyre në shërbimet psikologjike dhe hartimi i planeve të mbrojtjes për fëmijët.
- B) Vendosija e tyre në një qendër rezidenciale afatgjatë pa prindërit.

- C) Trajtimi vetëm i nënës për të siguruar stabilitet.
- D) Lënia e tyre në shtëpi për të ruajtur normalitetin.

#### Pyetja 95

Si monitorohet progresi i rasteve të trajtuara nga ETN?

- A) Me raporte periodike të përgatitura nga policia dhe shërbimet sociale.
- B) Vetëm përmes statistikave të gjykatave.
- B) Në bazë të feedback-ut të dhunuesve.
- D) Nëpërmjet raporteve të OJF-ve.

#### Pyetja 96

Cili është një shembull i qasjes me bazë gjinore në ofrimin e shërbimeve sociale?

- A) Të gjitha shërbimet janë të njëjta për të gjithë klientët.
- B) Adaptimi i shërbimeve për të adresuar nevojat specifike të grave, burrave dhe grupeve të tjera gjinore.
- C) Prioritetizimi i burrave në programet sociale.
- D) Ignorimi i përkatësisë gjinore në analizën e nevojave.

#### Pyetja 97

Cila është një sfidë kryesore që hasin punonjësit socialë në promovimin e barazisë gjinore?

- A) Mbështetja e komunitetit në çështjet gjinore.
- B) Rezistenca kulturore dhe stereotipet gjinore në shoqëri.
- C) Ndryshimet e shpejta në politikat sociale.
- D) Mungesa e fondeve për fushatat ndërgjegjësuere.

#### Pyetja 98

Cili është qëllimi kryesor i një qasjeje me bazë gjinore në punën sociale?

- A) Promovimi i roleve tradicionale gjinore.
- B) Edukimi i grave për të përmbushur detyrat tradicionale familjare.
- D) Zgjidhja e çështjeve financiare të burrave në shoqëri.

#### Pyetja 99

Cili është roli i edukimit gjinor në punën sociale?

- A) Rritja e ndërgjegjësimit për barazinë gjinore dhe adresimi i stereotipeve gjinore.
- B) Fokusi vetëm te gratë për të fuqizuar rolin e tyre në familje.
- C) Përshtatja e programeve arsimore për të ruajtur rolet tradicionale gjinore.
- D) Zbatimi i politikave gjinore pa përfshirë komunitetin.

#### Pyetja 100

Cili nga këto parime theksohet në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore?

- A) Përparësia e grupeve me të ardhura të larta
- B) Përforcimi i stereotipeve gjinore tradicionale
- C) Fuqizimi i grupeve të cenueshme dhe eliminimi i diskriminimit të shumëfishtë
- D) Zvogëlimi i përgjegjësisë të institucioneve lokale

#### Pyetja 101

Çfarë nënkupton roli riprodhues sipas konceptit gjinor?

- A) Puna që kryhet jashtë shtëpisë
- B) Puna që përfshin aktivitete të larta të teknologjisë
- C) Puna për kujdesin dhe mirëqenien e familjes
- D) Puna që përfshin bujqësinë dhe prodhimin

## **Kapitulli 10. Metoda Kërkimi në Punë Sociale**

### Pyetja 1

Cili është qëllimi kryesor i kërkimit shkencor?

- A) Të krijojë njohuri të reja dhe të zgjerojë teoritë ekzistuese
- B) Të përdorë vetëm të dhëna numerike
- C) Të refuzojë qasjet e bazuara në teori
- D) Të shmangë analizën e rezultateve

### Pyetja 2

Cili është një nga dallimet kryesore midis kërkimit bazë dhe aplikativ?

- A) Kërkimi aplikativ shmang përdorimin e metodave shkencore
- B) Kërkimi bazë fokusohet në zhvillimin e teorisë, ndërsa ai aplikativ zbaton njohuritë për të zgjidhur probleme praktike
- C) Kërkimi bazë përdor vetëm statistika
- D) Nuk ka asnjë dallim midis tyre

### Pyetja 3

Cili është roli i një pyetjeje kërkimore në një projekt kërkimor?

- A) Shmang formulimin e hipotezave
- B) Kufizon numrin e të dhënave të mbledhura
- C) Përcakton drejtimin dhe fokusin e studimit
- D) Eliminohet pas mbledhjes së të dhënave

### Pyetja 4

Cila është një veçori kryesore e kërkimit sasior?

- A) Fokusohet në matjen dhe analizën statistikore të të dhënave
- B) Refuzon analizën numerike
- C) Përqendrohet vetëm në përvojat subjektive të pjesëmarrësve
- D) Përdor vetëm metoda cilësore

### Pyetja 5

Cila është një veçori kryesore e kërkimit cilësor?

- A) Nuk lejon fleksibilitet në mbledhjen e të dhënave
- B) Përdor vetëm metoda statistikore
- C) Eliminon interpretimin e të dhënave
- D) Përqendrohet në kuptimin e përvojave dhe perceptimeve njerëzore

### Pyetja 6

Cili është një përfitim i përdorimit të një qasjeje teorike në kërkim?

- A) Siguron një kornizë për të drejtuar mbledhjen dhe analizën e të dhënave
- B) Kufizon interpretimin e të dhënave cilësore
- C) Refuzon zhvillimin e teorisë të reja
- D) Përdoret vetëm në kërkimin aplikativ

Pyetja 7

Cila është rëndësia e rishikimit të literaturës në një projekt kërkimor?

- A) Eliminohet pas formulimit të hipotezave
- B) Shërben vetëm për të justifikuar metodat e zgjedhura
- C) Identifikon boshllëqet dhe mundësitë për kërkime të mëtejshme
- D) Kufizon përdorimin e burimeve të reja

Pyetja 8

Cila është një nga karakteristikat e një studimi eksplorues?

- A) Përqendrohet vetëm në testimin e hipotezave
- B) Përdor vetëm të dhëna numerike
- C) Nuk kërkon planifikim paraprak
- D) Fokusetohet në eksplorimin e çështjeve të panjohura ose pak të studiuara më parë

Pyetja 9

Cila është një nga format e studimeve përshkruese?

- A) Testimi i marrëdhënieve midis variablave
- B) Vëzhgimi dhe mbledhja e të dhënave për të përshkruar karakteristikat e një popullate
- C) Fokusimi vetëm në analizën statistikore
- D) Shmangia e analizës së marrëdhënieve midis variablave

Pyetja 10

Cili është një shembull i një qëllimi kërkimor në një projekt shkencor?

- A) Të eliminojë përdorimin e teorive ekzistuese
- B) Të kufizojë analizën në të dhëna numerike
- C) Të eksplorojë ndikimin e ndryshimeve shoqërore në sjelljen e individëve
- D) Të shmangë mbledhjen e të dhënave parësore

Pyetja 11

Cili është qëllimi kryesor i kërkimit sasior?

- A) Të kuptojë ndjenjat dhe përvojat personale
- B) Të krijojë art grafik bazuar në të dhëna
- C) Të shmangë analizën e të dhënave
- D) Të përshkruajë fenomenet në mënyrë numerike dhe statistikore

Pyetja 12

Çfarë nënkupton matja në kërkimin sasior?

- A) Përkthimin e koncepteve abstrakte në variabla të matshëm
- B) Refuzimin e të dhënave numerike
- C) Mbështetjen vetëm të intervistat e gjata
- D) Fokusimin në përvoja subjektive

Pyetja 13

Cili është dallimi mes vlefshmërisë dhe besueshmërisë në matje?

- A) Besueshmëria është më e rëndësishme se vlefshmëria
- B) Vlefshmëria mat saktësinë e një mjeti, ndërsa besueshmëria mat qëndrueshmërinë e tij
- C) Vlefshmëria dhe besueshmëria janë terma të njëjtë
- D) Besueshmëria mat ndikimin e të dhënave në shoqëri

Pyetja 14

Cili është një shembull i një koncepti të matshëm në kërkimin sasior?

- A) Mendimet personale për një temë
- B) Ndjenjat subjektive për natyrën
- C) Të gjitha përgjigjet janë të sakta
- D) Qëndrimet e njerëzve ndaj politikës

Pyetja 15

Cila është rëndësia e operacionalizimit në kërkimin sasior?

- A) Transformon konceptet abstrakte në indikatorë konkretë
- B) E bën kërkimin të pamundur për t'u realizuar
- C) Shmang përdorimin e metodave statistikore
- D) Ngre hipoteza pa i testuar ato

Pyetja 16

Cili është një nga hapat kryesorë të kërkimit sasior?

- A) Refuzimi i përdorimit të të dhënave numerike
- B) Grumbullimi i të dhënave numerike përmes pyetësorëve ose sondazheve
- C) Fokusimi vetëm te interpretimi subjektiv
- D) Shmangia e analizës statistikore

Pyetja 17

Cili është një nga qëllimet kryesore të studuesve sasiorë?

- A) Të analizojnë gjuhën dhe kontekstin kulturor
- B) Të shmangin matjen numerike
- C) Të mos përfshijnë statistika në raportet e tyre
- D) Të testojnë hipoteza dhe të shpjegojnë marrëdhëniet midis variablave

Pyetja 18

Çfarë nënkupton termi “standardizim” në kërkimin sasior?

- A) Përdorimi i të njëjtave procedura dhe instrumente matjeje për të gjithë pjesëmarrësit
- B) Përshtatja e pyetjeve sipas nevojave të secilit pjesëmarrës
- C) Shmangia e pyetësorëve të strukturuar
- D) Refuzimi i të dhënave numerike

Pyetja 19

Cila nga pohimet e mëposhtme është një kufizim i kërkimit sasior?

- A) Nuk ofron rezultate statistikore
- B) Nuk eksploron në thellësi përvojat dhe mendimet personale
- C) Nuk është i standardizuar
- D) Nuk siguron përgjithësime për popullatën

Pyetja 20

Çfarë përfaqëson dizajni kërkimor?

- A) Një metodë për analizimin e të dhënave numerike
- B) Një mjet për të mbledhur të dhëna vetëm nga burimet dytësore
- C) Një fazë e jodomethënëse në procesin kërkimor
- D) Një plan për mënyrën se si do të kryhet studimi kërkimor

Pyetja 21

Cila është rëndësia e dizajnit kërkimor?

- A) Shmang formulimin e pyetjeve kërkimore
- B) Kufizon fleksibilitetin në metodologji

- C) Siguron që kërkimi të jetë i organizuar dhe i orientuar drejt qëllimeve specifike
- D) Eliminon nevojën për analizë të rezultateve

Pyetja 22

Cili është dallimi midis dizajnit eksperimental dhe atij joseksperimental?

- A) Dizajni joseksperimental përfshin vetëm statistika
- B) Dizajni eksperimental shmang përdorimin e variablave
- C) Dizajni eksperimental teston marrëdhëniet shkak-pasojë, ndërsa ai joseksperimental përshkruan dhe eksploron fenomenet.
- D) Nuk ka dallim midis tyre

Pyetja 23

Cili është roli i variablave në një dizajn kërkimor?

- A) Variablat janë elemente që maten ose manipulohen për të testuar një hipotezë
- B) Variablat janë gjithmonë të njëjta në çdo kërkim
- C) Variablat eliminohen në kërkimet cilësore
- D) Nuk kanë rëndësi në procesin e kërkimit

Pyetja 24

Çfarë është një variabël i pavarur?

- A) Një variabël që matet për të përcaktuar rezultatet
- B) Një variabël që shpjegon ose ndikon mbi variablën e varur
- C) Një variabël që nuk përfshihet në analizë
- D) Një variabël që nuk mund të ndryshojë

Pyetja 25

Cila është arsyeja kryesore për përdorimin e një dizajni eksplorues në kërkime shkencore?

- A) Për të testuar hipoteza të avancuara shkencore
- B) Për të kuptuar më mirë një fenomen të panjohur ose të pak hulumtuar
- C) Për të mbledhur vetëm të dhëna statistikore të sakta
- D) Për të vendosur marrëdhënie shkak-pasojë midis variablave

Pyetja 26

Cila është rëndësia e operacionalizimit në një dizajn kërkimor?

- A) Ndihmon në përkthimin e koncepteve teorike në variabla të matshëm
- B) Refuzon formulimin e hipotezave
- C) Shmang përdorimin e statistikave
- D) Kufizon metodologjinë kërkimore

Pyetja 27

Cili është qëllimi kryesor i një studimi të rastit??

- A) Fokusimi në një individ, grup ose fenomen specifik për një analizë të thelluar
- B) Përdorimi ekskluziv i metodave sasiore për mbledhjen e të dhënave
- C) Testimi i marrëdhënieve shkak-pasojë midis variablave
- D) Zbatimi i të dhënave të përgjithshme për popullata të mëdha

Pyetja 28

Cili është një përfitim i një dizajni të mirë kërkimor?

- A) Eliminohen fazat e mbledhjes së të dhënave
- B) Siguron qartësi dhe strukturë për të gjitha fazat e procesit kërkimor
- C) Kufizohet fleksibiliteti në analizë



D) Përjashtohet përdorimi i metodave të integruara

Pyetja 29

Cili është qëllimi kryesor i etikës në kërkim?

- A) Të shmangë përdorimin e teorive në analizë
- B) Të reduktojë kohën e nevojshme për analizë
- C) Të mbrojë të drejtat dhe mirëqenien e pjesëmarrësve në kërkim
- D) Të lejojë manipulimin e të dhënave

Pyetja 30

Cila është një kërkesë e rëndësishme etike në kërkim?

- A) Kryerja e studimeve pa njoftuar pjesëmarrësit
- B) Përdorimi i të dhënave pa autorizim
- C) Eliminimi i privatësisë së pjesëmarrësve
- D) Sigurimi i pëlqimit/miratimit të informuar nga pjesëmarrësit

Pyetja 31

Cila është rëndësia e anonimitetit në kërkim?

- A) Mbron identitetin e pjesëmarrësve dhe siguron konfidencialitet
- B) Shmang përfshirjen e pjesëmarrësve në analizë
- C) Kufizon mbledhjen e të dhënave cilësore
- D) Përjashton përdorimin e burimeve dytësore

Pyetja 32

Cila është një veprim joetik në kërkim?

- A) Manipulimi i rezultateve për të arritur përfundime të dëshiruara
- B) Sigurimi i një procesi transparent të mbledhjes së të dhënave.
- C) Respektimi i të drejtave të pjesëmarrësve
- D) Mbajtja e të dhënave të sigurta dhe të mbrojtura

Pyetja 33

Cili është roli i komitetit të etikës në kërkim?

- A) Të rishikojë dhe aprovojë projektet kërkimore për të siguruar përputhshmërinë me standardet etike.
- B) Të shmangë monitorimin e projekteve kërkimore
- C) Të eliminojë raportimin e rezultateve
- D) Të sigurojë që kërkimi të jetë plotësisht numerik

Pyetja 34

Cila është rëndësia e raportimit të rezultateve në mënyrë transparente?

- A) Lejon manipulimin e të dhënave për përfitime personale
- B) Eliminon nevojën për raportim të detajuar
- C) Kufizon shpërndarjen e rezultateve në komunitetin shkencor
- D) Siguron që gjetjet të jenë të besueshme dhe të vlefshme

Pyetja 35

Cili është një shembull i konfliktit të interesit në kërkim?

- A) Kur të dhënat mbledhen nga burime të sigurta
- B) Kur studiuesi ka interesa personale që mund të ndikojnë në rezultatet e studimit
- C) Kur studiuesi përdor metodologji të standardizuar
- D) Kur rezultatet shpërndahen në mënyrë etike

Pyetja 36

Pse është e rëndësishme të shmangen plagjiatura dhe manipulimi në kërkim?

- A) Për të përshpejtuar procesin e publikimit
- B) Për të zvogëluar kohën e kërkimit
- C) Për të ruajtur integritetin dhe besueshmërinë e hulumtimit shkencor
- D) Për të shmangur raportimin e gjetjeve të reja

Pyetja 37

Cila është një nga avantazhet kryesore të sondazhit?

- A) Lejon standardizimin e pyetjeve dhe krahasimin e përgjigjeve
- B) Përqendrohet vetëm te përvojat individuale
- C) Përdor vetëm metoda cilësore
- D) Eliminon nevojën për pyetje të strukturuar

Pyetja 38

Cila është një veçori e pyetjeve të hapura në sondazhe?

- A) Ofrojnë vetëm një listë të mbyllur alternativash
- B) Pjesëmarrësit mund të japin përgjigje të lira dhe të pa-strukturuar
- C) Janë gjithmonë më të sakta se pyetjet e mbyllura
- D) Nuk përdoren kurrë në sondazhe

Pyetja 39

Cila është një praktikë e mirë për hartimin e pyetjeve në pyetësorë?

- A) Përdorimi i termave të ndërlikuar dhe teknikë
- B) Përdorimi i gjuhës së thjeshtë dhe të qartë
- C) Kombinimi i pyetjeve të hapura dhe të mbyllura në të njëjtën pyetje
- D) Injorimi i testimit paraprak të pyetjeve

Pyetja 40

Cili është qëllimi i testimit paraprak të pyetësorëve?

- A) Të sigurojë që vetëm pjesëmarrësit të kenë akses në pyetjet
- B) Të shmangë përmirësimin e pyetësorit
- C) Të krahasojë përgjigjet e një grupi të madh
- D) Të identifikojë problemet me pyetjet dhe renditjen e tyre

Pyetja 41

Cili është një problem i mundshëm gjatë intervistave në sondazhe?

- A) Ndikimi i intervistuesit në përgjigjet e të intervistuarve
- B) Refuzimi për të përdorur pyetje të mbyllura
- C) Fokusimi vetëm në statistika dhe jo në përgjigje
- D) Përdorimi i shumë metodave për mbledhjen e të dhënave

Pyetja 42

Cili është një nga avantazhet e përdorimit të pyetjeve të mbyllura në sondazhe?

- A) Janë gjithmonë më të mira se pyetjet e hapura
- B) Sigurojnë lehtësi në analizimin dhe krahasimin e përgjigjeve
- C) Nuk kanë nevojë për përgatitje paraprake
- D) Përmbajnë gjithmonë vetëm një opsion të saktë

Pyetja 43

Cili është një nga kufizimet e pyetjeve të mbyllura?

- A) Kërkojnë shumë kohë për t'u përpunuar
- B) Nuk mund të analizohen në mënyrë statistikore
- C) Përdoren vetëm për grupe të vogla
- D) Mund të kufizojnë shprehjen e mendimeve komplekse të pjesëmarrësve

Pyetja 44

Cila është arsyeja kryesore për përdorimin e vëzhgimit të strukturuar?

- A) Fokusimi te ndjenjat dhe përvojat personale
- B) Sigurimi i të dhënave objektive dhe të standardizuara për sjelljen
- C) Ndryshimi i sjelljes së pjesëmarrësve
- D) Refuzimi i të dhënave numerike

Pyetja 45

Cili është dallimi kryesor midis sondazhit dhe vëzhgimit të strukturuar?

- A) Vëzhgimi është gjithmonë më subjektiv
- B) Sondazhi është i pastrukturuar
- C) Sondazhi përdor pyetësorë, ndërsa vëzhgimi përqendrohet te sjellja reale
- D) Nuk ka dallim midis tyre

Pyetja 46

Cili është një kufizim i vëzhgimit të strukturuar?

- A) Siguron gjithmonë të dhëna të pasakta
- B) Nuk mund të përdoret në kërkimet shkencore
- C) Sjellja e pjesëmarrësve mund të ndikohet nga fakti që janë duke u vëzhguar
- D) Nuk ka asnjë kufizim

Pyetja 47

Cila është një strategji e zakonshme për të rritur besueshmërinë në vëzhgimin e strukturuar?

- A) Kryerja e vetëm një vëzhgimi
- B) Përdorimi i më shumë se një vëzhguesi për të regjistruar sjelljen
- C) Refuzimi i standardizimit të procesit
- D) Përdorimi i metodave cilësore

Pyetja 48

Cili është qëllimi i eksperimenteve të terrenit në vëzhgimin e strukturuar?

- A) Eliminimi i ndikimit të mjedisit në sjelljen e pjesëmarrësve
- B) Përdorimi i metodave cilësore për të eksploruar sjelljen
- C) Testimi i sjelljes në një mjedis natyror dhe të kontrolluar
- D) Shmangia e mbledhjes së të dhënave numerike

Pyetja 49

Cila është një arsye për të përdorur eksperimente të terrenit në vend të vëzhgimit të strukturuar tradicional?

- A) Lejon studimin e sjelljes në kushte të ngjashme me jetën reale
- B) Siguron rezultate më subjektive dhe personale
- C) Nuk kërkon mbledhjen e të dhënave të standardizuara
- D) Refuzon analizën e sjelljes

Pyetja 50

Çfarë nënkuptohet me termin “kampionim”?

- A) Mbledhja e të gjitha të dhënave nga një popullatë e caktuar

- B) Përdorimi i intervistave të strukturuar për të mbledhur të dhëna
- C) Procesi i zgjedhjes së një grupi individësh për të përfaqësuar një popullatë më të gjerë
- D) Shmangia e mbledhjes së të dhënave nga popullata e përgjithshme

Pyetja 51

Cili është një avantazh i kampionimit me probabilitet?

- A) Eliminon nevojën për të përdorur statistika
- B) Siguron që çdo anëtar i popullatës ka një shans të barabartë për të qenë pjesë e kampionit
- C) Përqendrohet vetëm te individët më të lehtë për t'u kontaktuar
- D) Shmang përdorimin e një plani paraprak

Pyetja 52

Çfarë është kampionimi pa probabilitet?

- A) Përdorimi i teknikave statistikore komplekse
- B) Përzgjedhja e rastësishme e pjesëmarrësve
- C) Zgjedhja e kampionit bazuar në lehtësinë e aksesit te pjesëmarrësit
- D) Përfshirja e gjithë popullatës në studim

Pyetja 53

Cili nga pohimet e mëposhtme është një shembull i kampionimit me probabilitet?

- A) Kampionimi sistematik
- B) Kampionimi i volitshëm (convenience sampling)
- C) Kampionimi i qëllimshëm (purposive sampling)
- D) Kampionimi i grupeve të homogjenizuara

Pyetja 54

Cila është rëndësia e madhësisë së kampionit?

- A) Kampionet më të vogla janë gjithmonë më të sakta
- B) Kampionet e mëdha nuk kanë nevojë për planifikim
- C) Madhësia e kampionit nuk ndikon në rezultatet përfundimtare
- D) Madhësia e kampionit ndikon në saktësinë dhe përgjithësueshmërinë e rezultateve

Pyetja 55

Çfarë është një kampion rastësor i thjeshtë?

- A) Kampion i përzgjedhur bazuar në ndjeshmërinë e hulumtuesit
- B) Kampion i përzgjedhur ku secili anëtar i popullatës ka një shans të barabartë për t'u përfshirë.
- C) Një grup i zgjedhur rastësisht nga një nënpopullatë specifike
- D) Kampion i mbledhur përmes intervistave të strukturuar

Pyetja 56

Cili është një shembull i kampionimit pa probabilitet?

- A) Kampionimi i volitshëm (convenience sampling)
- B) Kampionimi i rastësor i thjeshtë
- C) Kampionimi i stratifikimit
- D) Kampionimi sistematik

Pyetja 57

Çfarë nënkupton kampionimi i stratifikuar?

- A) Përdorimi i vetëm një grupi të homogjenizuar për të përfaqësuar popullatën

- B) Ndarja e popullatës në grupe homogjene dhe përzgjedhja rastësore nga çdo grup
- C) Përzgjedhja e rastësishme e të gjithë anëtarëve të popullatës
- D) Mbledhja e të dhënave pa ndonjë plan paraprak

Pyetja 58

Cili nga pohimet e mëposhtme është një mjet i zakonshëm për analizën sasiore?

- A) Softueri SPSS
- B) Intervistat e hapura
- C) Teknikat e analizës së përmbajtjes
- D) Etnografia

Pyetja 59

Çfarë nënkupton termi "variabla të pavarura"?

- A) Variabla që varen nga faktorë të jashtëm
- B) Variabla që nuk kanë ndikim në analizë
- C) Variabla që shpjegojnë ose parashikojnë variablat e varura
- D) Variabla që nuk mund të maten

Pyetja 60

Cila është një nga fazat kryesore të analizës sasiore?

- A) Kodimi dhe kategorizimi i të dhënave
- B) Kryerja e intervistave gjysmë të strukturuar
- C) Shmangia e statistikave
- D) Refuzimi i përdorimit të softuerëve analitikë

Pyetja 61

Çfarë nënkupton termi "korrelacion"?

- A) Matja e saktësisë së një instrumenti
- B) Një lidhje midis dy ose më shumë variablave
- C) Shpjegimi i një fenomeni pa të dhëna numerike
- D) Shmangia e interpretimit të rezultateve

Pyetja 62

Cili është roli i tabelave dhe grafikëve në analizën sasiore?

- A) Fokusimi te të dhënat cilësore
- B) Eliminimi i detajeve numerike
- C) Zëvendësimi i analizës statistikore
- D) Paraqitja vizuale e të dhënave dhe gjetjeve për të lehtësuar interpretimin

Pyetja 63

Cili është një shembull i matje e tendencës qëndrore në analizën sasiore?

- A) Intervistat e hapura
- B) Përshkrimi narrativ
- C) Mesatarja aritmetike
- D) Studimi i rastit

Pyetja 64

Cili është qëllimi kryesor i etnografisë?

- A) Të kuptojë sjelljet dhe kulturën e një grupi shoqëror përmes pjesëmarrjes dhe vëzhgimit
- B) Të analizojë vetëm të dhëna statistikore
- C) Të mbledhë të dhëna numerike në një kohë të shkurtër

D) Të shmangë përfshirjen në mjedisin e studiuar

Pyetja 65

Cila është një nga veçoritë e vëzhgimit pjesëmarrës?

- A) Studiuesi qëndron plotësisht i distancuar nga grupi
- B) Përdorimi vetëm i mjeteve statistikore për analizë
- C) Shmangia e ndërveprimeve me pjesëmarrësit
- D) Studiuesi merr pjesë aktivisht në aktivitetet e grupit që studion

Pyetja 66

Cila është një nga sfidat kryesore të vëzhgimit pjesëmarrës?

- A) Eliminimi i të dhënave cilësore nga analizat
- B) Përdorimi vetëm i statistikave për interpretim
- C) Mbajtja e balancës midis rolit të studiuesit dhe pjesëmarrësit
- D) Shmangia e përfshirjes në situata reale

Pyetja 67

Cili është një nga rolet që studiuesi mund të marrë në etnografi?

- A) Vëzhgues i distancuar
- B) Analist i të dhënave numerike
- C) Përrjashtues i ndërveprimeve me grupin
- D) Vëzhgues pjesëmarrës

Pyetja 68

Cili është një avantazh i etnografisë?

- A) Ofron një kuptim të thellë të dinamikave dhe praktikave të grupit
- B) Fokuset vetëm te të dhënat statistikore
- C) Redukton nevojën për interpretim
- D) Eliminohet konteksti kulturor

Pyetja 69

Cili është një kufizim i etnografisë?

- A) Eliminon të dhënat cilësore
- B) Procesi kërkon kohë të gjatë dhe përfshirje të thellë
- C) Fokuset vetëm te përgjithësimi i rezultateve
- D) Nuk përfshin ndërveprimin me pjesëmarrësit

Pyetja 70

Cila është rëndësia e shënimeve të terrenit në etnografi?

- A) Fokuset vetëm në përfundimet numerike
- B) Eliminon nevojën për interpretim
- C) Përrjashton kontekstin kulturor
- D) Siguron dokumentimin e detajuar të vëzhgimeve dhe ndërveprimeve

Pyetja 71

Çfarë nënkupton "qasje" (akses) në etnografi?

- A) Fokusimi te distancimi nga grupi
- B) Përdorimi vetëm i mjeteve statistikore
- C) Përdorimi i metodave për të hyrë dhe studiuar një grup ose komunitet
- D) Eliminimi i ndërveprimeve sociale

Pyetja 72

Cili është një nga rolet e informatorëve kryesorë/kyç në etnografi?

- A) Ndihmojnë studiuesin për të kuptuar kulturën dhe dinamikat e grupit
- B) Eliminimi i ndërveprimit me studiuesin
- C) Sigurimi i të dhënave numerike për analizë
- D) Fokusimi vetëm në statistika

Pyetja 73

Cili është një nga dallimet kryesore midis etnografisë dhe vëzhgimit pjesëmarrës?

- A) Vëzhgimi i pjesëmarrës përdor vetëm statistika
- B) Etnografia përfshin analiza më të thella të kulturës dhe kontekstit social
- C) Etnografia shmang ndërveprimet sociale
- D) Nuk ka dallim midis tyre

Pyetja 74

Cila është një nga karakteristikat kryesore të intervistave në studimin cilësor?

- A) Përdorin vetëm pyetje të mbyllura
- B) Nuk kërkojnë ndërveprim me pjesëmarrësit
- C) Janë gjithmonë të standardizuara
- D) Fokusohen në përvojat dhe perceptimet personale të pjesëmarrësve

Pyetja 75

Cili është dallimi midis intervistës së strukturuar dhe asaj gjysmë të strukturuar?

- A) Intervista e strukturuar nuk përfshin pyetje të parapërgatitura
- B) Intervista e gjysmë e strukturuar lejon më shumë fleksibilitet në pyetje dhe përgjigje
- C) Intervista e gjysmë e strukturuar përdor vetëm statistika për analizë
- D) Nuk ka asnjë dallim midis tyre

Pyetja 76

Cili është roli i një intervistuesi në një intervistë cilësore?

- A) Të krijojë një mjedis të hapur dhe mbështetës për pjesëmarrësin
- B) Të shmangë ndërveprimet me pjesëmarrësin
- C) Të drejtojë bisedën vetëm përmes pyetjeve të mbyllura
- D) Të interpretojë përgjigjet pa i dokumentuar ato

Pyetja 77

Cili është dallimi kryesor midis intervistave të strukturuar dhe atyre të pastrukturuar?

- A) Intervistat e strukturuar ndjekin një model të strikt pyetjesh, ndërsa ato të pastrukturuar janë më fleksibile.
- B) Intervistat e pastrukturuar përdorin vetëm pyetësorë të shkruar
- C) Intervistat e strukturuar janë më subjektive se ato të pastrukturuar
- D) Nuk ka dallim midis tyre

Pyetja 78

Çfarë është një intervistë gjysmë e strukturuar?

- A) Një intervistë që ndjek vetëm pyetjet e parapërgatitura
- B) Një intervistë pa asnjë plan paraprak
- C) Një intervistë që përdor vetëm teknika numerike për analizë
- D) Një intervistë që kombinon pyetje të strukturuar dhe hapësira për eksplorim të mëtejshëm.

Pyetja 79

Cili është roli i moderatorit në një fokus grup?

- A) Të japë mendimin e tij personal për temën
- B) Të shmangë përfshirjen aktive në bisedë
- C) Të lehtësojë diskutimet dhe të nxisë ndërveprimin midis pjesëmarrësve
- D) Të drejtojë diskutimin me një sërë pyetjesh të standardizuara

Pyetja 80

Cila është një nga kufizimet e intervistave cilësore?

- A) Mund të jenë të ndikuara nga paragjykimet e intervistuesit
- B) Nuk mund të përdoren për mbledhjen e të dhënave cilësore
- C) Nuk lejojnë ndërveprimin midis intervistuesit dhe pjesëmarrësit
- D) Janë gjithmonë më të shpejta se metodat sasore

Pyetja 81

Cila është rëndësia e krijimit të një marrëdhënieje besimi në një intervistë cilësore?

- A) Eliminon nevojën për pyetje të parapërgatitura
- B) Shmang përdorimin e metodave të tjera të mbledhjes së të dhënave
- C) Ndihmon pjesëmarrësit të ndihen të sigurt dhe të ndajnë informacione personale
- D) Bën të panevojshme dokumentimin e intervistës

Pyetja 82

Cila është madhësia optimale e një fokus grupi?

- A) Vetëm 2 persona
- B) 6-10 persona
- C) 15-20 persona
- D) Më shumë se 25 persona

Pyetja 83

Cili është një avantazh i intervistave cilësore online?

- A) Janë më të shpejta se intervistat ballë për ballë
- B) Nuk kërkojnë asnjë planifikim paraprak
- C) Janë gjithmonë më të sakta
- D) Lejojnë pjesëmarrjen nga lokacione të ndryshme gjeografike

Pyetja 84

Çfarë është analiza e përmbajtjes?

- A) Një metodë për të krahasuar rezultatet statistikore në kërkimet sasore
- B) Një qasje cilësore për analizën e dokumenteve dhe materialeve të shkruara
- C) Një teknikë për të zhvilluar intervista strukturore
- D) Një metodë për të interpretuar eksperimente laboratorike

Pyetja 85

Cili është hapi i parë në analizën e përmbajtjes?

- A) Zbatimi i një skeme të gatshme kodimi
- B) Përcaktimi i qëllimeve të kërkimit dhe pyetjeve kërkimore
- C) Interpretimi i të dhënave përmes analizës statistikore
- D) Përfundimi i raportit kërkimor

Pyetja 86

Cila nga këto përshkruan një avantazh të analizës së përmbajtjes?



- A) Kufizohet në interpretimin e rezultateve statistikore
- B) Siguron të dhëna të sakta për eksperimentet laboratorike
- C) Është fleksibile dhe mund të zbatohet në materiale të ndryshme
- D) Përdoret vetëm në kërkimet sasiore

Pyetja 87

Në cilin rast përdoret analiza e përmbajtjes pa një skemë kodimi të paracaktuar?

- A) Kur analizohen vetëm të dhënat statistikore
- B) Kur qëllimi është eksplorimi i koncepteve të reja
- C) Kur dokumentet janë të standardizuara
- D) Kur ka një sasi të madhe të dhënash numerike

Pyetja 88

Çfarë nënkupton termi “kodim” në analizën cilësore?

- A) Përdorimin e statistikave për interpretimin e të dhënave
- B) Eliminimin e të dhënave të paqarta
- C) Shmangien e analizës tematike
- D) Identifikimin dhe kategorizimin e fragmenteve të të dhënave për tema dhe modele

Pyetja 89

Cili është qëllimi kryesor i analizës tematike?

- A) Të identifikojë dhe interpretojë temat dhe modelet kryesore në të dhëna
- B) Të analizojë vetëm statistikën numerike
- C) Të shmangë kategorizimin e të dhënave
- D) Të krijojë të dhëna të reja nga burimet cilësore

Pyetja 90

Çfarë nënkupton triagulum (treëndëzimi) në kërkim?

- A) Shmangien e përdorimit të metodave të ndryshme
- B) Përdorimin e një burimi të vetëm të të dhënave
- C) Refuzimin e analizës statistikore
- D) Kombinimin e metodave dhe burimeve të ndryshme për të rritur vlefshmërinë dhe besueshmërinë e gjetjeve.

Pyetja 91

Cili është hapi i parë për të kryer një projekt kërkimor?

- A) Mbledhja e të dhënave pa një plan paraprak
- B) Kryerja e analizës statistikore para mbledhjes së të dhënave
- C) Përcaktimi i qëllimit dhe pyetjes kërkimore
- D) Publikimi i rezultateve pa analizë

Pyetja 92

Cili është roli i një hipoteze në kërkimin shkencor?

- A) Për të eliminuar qëllimet e studimit
- B) Për të ofruar një shpjegim të mundshëm që testohet me të dhëna
- C) Për të garantuar suksesin financiar të studimit
- D) Për të minimizuar përdorimin e literaturës ekzistuese

Pyetja 93

Çfarë është teoria e bazuar në kërkimin shkencor?

- A) Një metodë për të testuar teorinë ekzistuese përmes të dhënave statistikore

- B) Një qasje që zhvillon teori duke u bazuar drejtpërdrejt në të dhënat e mbledhura nga terreni
- C) Një metodë për të zhvilluar hipoteza përmes eksperimenteve laboratorike
- D) Një teknikë për të analizuar vetëm literaturën ekzistuese

Pyetja 94

Cili është një hap i rëndësishëm në procesin e teorisë së bazuar?

- A) Formulimi i një hipoteze para mbledhjes së të dhënave
- B) Përdorimi i statistikave për të testuar një model teorik
- C) Kodimi i hapur për të identifikuar temat dhe kategoritë nga të dhënat
- D) Përdorimi i vetëm i burimeve sekondare për të zhvilluar një teori

Pyetja 95

Çfarë është kampionimi me kuota?

- A) Një metodë rastësore për përzgjedhjen e pjesëmarrësve
- B) Një metodë ku përzgjedhja e pjesëmarrësve bazohet në arritjen e kuotave të përcaktuara për grupe specifike
- C) Një teknikë për të mbledhur të dhëna vetëm nga burime sekondare
- D) Një mënyrë për të garantuar pjesëmarrjen e të gjithë popullsisë

Pyetja 96

Çfarë janë kërkimet longitudinale?

- A) Studime që analizojnë një fenomen vetëm në një pikë specifike në kohë
- B) Studime që analizojnë të njëjtin grup individësh ose fenomen gjatë një periudhe kohe të zgjatur
- C) Eksperimente laboratorike të kryera në kushte të kontrolluara
- D) Metoda të mbledhjes së të dhënave që bazohen në analiza të menjëhershme

Pyetja 97

Çfarë është ngopja teorike?

- A) Momenti kur studiuesi ka mbledhur një sasi të madhe të dhënash statistikore
- B) Pikë në të cilën të dhënat shtesë nuk ofrojnë më informacion të ri për të zhvilluar teorinë
- C) Përfundimi i procesit të analizës statistikore
- D) Momenti kur të gjitha intervistat janë përfunduar

Pyetja 98

Çfarë është vlefshmëria e konstruktit?

- A) Përcakton nëse rezultatet e një studimi mund të përgjithësohen në popullsinë më të gjerë
- B) Mat masën në të cilën një mjet mat në të vërtetë konstruktin që synon të masë
- C) Teston saktësinë e të dhënave statistikore në një eksperiment
- D) Vlerëson ndërlidhjen mes dy variablave të një studimi

Pyetja 99

Çfarë është testi Chi-katror?

- A) Një test për të matur korrelacionin midis dy variablave intervale
- B) Një test statistikor që përdoret për të analizuar lidhjen midis dy variablave kategorike
- C) Një metodë për të krahasuar mesataret e dy grupeve
- D) Një teknikë për të analizuar të dhëna cilësore përmes statistikave deskriptive

Pyetja 100

Çfarë është metoda e historisë së jetës?

- A) Një teknikë eksperimentale për matjen e të dhënave statistikore
- B) Një metodë kërkimore që fokusohet në përvojat personale të individëve për të kuptuar kontekstin e tyre social
- C) Një qasje për të krahasuar rezultatet e studimeve statistikore
- D) Një proces për të hartuar pyetësorë të strukturuar

Pyetja 101

Cila është një metodë e zakonshme për të kryer vëzhgimin e strukturuar?

- A) Përdorimi i një liste të koduar për të regjistruar sjelljen
- B) Kryerja e intervistave gjysmë të strukturuar
- C) Leximi i literaturës shkencore
- D) Përdorimi i të dhënave cilësore

Pyetja 102

Cili është një kufizim i kampionimit pa probabilitet?

- A) Kërkon më shumë kohë dhe burime sesa kampionimi me probabilitet
- B) Nuk mund të përdoret për kërkim sasior
- C) Nuk mund të përgjithësojë rezultatet për popullatën më të gjerë
- D) Nuk kërkon ndonjë planifikim paraprak

## **Kapitulli 11. Probleme dhe Politika të Shëndetit Mendor**

Pyetja 1

Cila është një nga detyrat kryesore të punonjësit social në shërbimin e shëndetit mendor?

- A) Përcaktimi i diagnozës përfundimtare të çrregullimit mendor
- B) Ofrimi i këshillimit social dhe ndihma në lidhje me punësimin dhe strehimin
- C) Kryerja e procedurave kirurgjikale
- D) Përshkrimi i terapive medikamentoze

Pyetja 2

Cili është qëllimi kryesor i shërbimeve ditore në shëndetin mendor?

- A) Trajtimi kirurgjikal i pacientëve
- B) Zhvillimi i aftësive sociale dhe rehabilitimi i pacientëve në komunitet
- C) Ofrimi i kujdesit spitalor për pacientët kronikë
- D) Hartimi i politikave shtetërore për shëndetin mendor

Pyetja 3

Cili nga këta çrregullime klasifikohet si çrregullim psikotik?

- A) Çrregullimi obsesiv-kompulsiv
- B) Skizofrenia
- C) Fobia specifike
- D) Ankthi i përgjithësuar

Pyetja 4

Cili ka të drejtë të referojë një pacient në Qendrën Komunitare të Shëndetit Mendor?

- A) Vetëm mjeku i familjes

- B) Vetëm specialistët psikiatrikë
- C) Mjeku i familjes, specialistët, familjarët ose vetë individi
- D) Vetëm institucionet qeveritare

Pyetja 5

Cili është roli i punonjësit social në Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor?

- A) Hartimi i planeve individuale të ndërhyrjes dhe ndihma në integrimin social të pacientëve
- B) Vetëm diagnostikimi i çrregullimeve mendore
- C) Përqendrimi vetëm në ofrimin e medikamenteve
- D) Mbikëqyrja e personelit mjekësor

Pyetja 6

Cili është ndikimi i deinstitutionalizimit në sistemin e shëndetit mendor?

- A) Forcimi i mbështetjes komunitare dhe reduktimi i stigmatizimi
- B) Reduktimi i aksesit në shërbimet komunitare
- C) Përqendrimi i trajtimeve në institucionet e specializuara
- D) Kufizimi i shërbimeve për grupet e prekshme.

Pyetja 7

Cila është rëndësia e forcimit të rrjeteve të referimit në shëndetin mendor?

- A) Kufizimi i bashkëpunimit midis profesionistëve.
- B) Përqendrimi i shërbimeve vetëm në zonat urbane.
- C) Ulja e mundësive për trajtim të integruar.
- D) Sigurimi i vazhdimësisë dhe koordinimit të kujdesit për pacientët.

Pyetja 8

Cili është ndikimi i analizës së situatës në planifikimin strategjik të shërbimeve të shëndetit mendor?

- A) Siguron të dhëna për të reduktuar kostot e shërbimeve shëndetësore.
- B) Kufizon përfshirjen e komunitetit në trajtime.
- C) Identifikon nevojat prioritare dhe përcakton objektivat specifike për ndërhyrje.
- D) Fokuson planifikimin vetëm te grupet vulnerabël.

Pyetja 9

Cili profesionist është përgjegjës për menaxhimin e rastit në Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor?

- A) Infermieri
- B) Mjeku kirurg
- C) Menaxheri i rastit, që mund të jetë punonjësi social ose një tjetër profesionist i përcaktuar
- D) Administratori financiar

Pyetja 10

Çfarë përfshin vlerësimi global i funksionimit (GAF)?

- A) Vlerësimin e aftësive fizike të pacientit
- B) Një shkallë që mat funksionimin psikologjik dhe social të pacientit
- C) Një test për diagnozën e depresionit
- D) Një pyetësor për historinë familjare të pacientit

#### Pyetja 11

Cili është hapi i parë që duhet të ndërmerret një punonjës social kur përballet me një situatë emergjente?

- A) Të vlerësojë situatën dhe rreziqet e mundshme
- B) Të kontaktojë menjëherë autoritetet përkatëse
- C) Të presë deri sa të ketë më shumë informacion
- D) Të ndërhyjë pa ndonjë plan specifik

#### Pyetja 12

Cila nga këto konsiderata etike është më e rëndësishme kur punoni me klientë vulnerabël?

- A) Të përfshini klientin në marrëdhënie personale
- B) Të shmangni marrjen e vendimeve pa aprovimin e kolegëve
- C) Të ruani konfidencialitetin dhe të siguronin autonominë e tyre
- D) Të ndiqni vetëm udhëzimet e shkruara të agjencisë

#### Pyetja 13

Cili është roli i bashkëpunimit ndërmjet agjencive në menaxhimin e rasteve?

- A) Të shmanget ndarja e burimeve të agjencisë
- B) Të sigurohet që klienti të marrë shërbimet më të përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse
- C) Të reduktohet përgjegjësia e punonjësve socialë për klientin
- D) Të minimizohen kostot e shërbimeve për agjencinë

#### Pyetja 14

Cila alternativë përdoret për menaxhimin e drejtë të një situatë në të cilën klienti përjeton zemërim gjatë një ndërveprimi?

- A) Ndërprerja e menjëherëshme e komunikimit
- B) Kalimi i bisedave në një tjetër punonjës social
- C) Dëgjimi i klientit me durim dhe përdorja e teknikave për zbutjen e tensionit
- D) Injorimi i emocioneve të klientit për të vazhduar me planin

#### Pyetja 15

Cili është roli i punonjësve socialë në adresimin e dhunës dhe traumave në shëndetin mendor?

- A) Kufizojnë ndërhyrjet në kontekstet komunitare.
- B) Përcaktojnë ndërhyrje psikosociale të personalizuar për viktimat e dhunës dhe traumave.
- C) Fokusohen vetëm në aspekte administrative të rasteve.
- D) Përqendrohen vetëm në sigurimin e ndihmës financiare.

#### Pyetja 16

Si ndikon mbështetja psikosociale në rikuperimin e individëve me çrregullime mendore?

- A) Përmirëson mirëqenien dhe lehtëson reintegrimin në komunitet.
- B) Kufizon autonominë dhe përparimin e tyre social.
- C) Nuk ka ndikim të madh në procesin e rikuperimit.
- D) Zvogëlon efektivitetin e trajtimeve medikamentoze.

#### Pyetja 17

Cili është një nga përfitimet kryesore të qasjes multidisiplinare në trajtimin e shëndetit mendor?

- A) Kufizon personalizimin e trajtimeve.
- B) Fokuson trajtimin vetëm te pacientët me diagnoza të rënda.
- C) Redukton ndërveprimet midis profesionistëve dhe pacientëve.
- D) Siguron kujdes gjithëpërfshirës duke adresuar aspekte mjekësore, psikologjike dhe sociale

#### Pyetja 18

Si ndikon qasja e bazuar në të drejtat e pacientëve në shërbimet e shëndetit mendor?

- A) Kufizon pjesëmarrjen e pacientëve në procesin e trajtimit.
- B) Fokuson trajtimin vetëm te aspektet mjekësore.
- C) Promovon respektimin e dinjitetit dhe përmirëson rezultatet e trajtimit.
- D) Redukton përfshirjen e familjarëve në vendimmarrje.

#### Pyetja 19

Çrregullimi i stresit post-traumatik (PTSD) shpesh shfaqet te?

- A) Fëmijët me vështirësi në të nxënë
- B) Viktimat e dhunës fizike ose seksuale
- C) Personat me probleme të mbipeshës
- D) Individët me çrregullime të personalitetit

#### Pyetja 20

Cili është roli i rrjetit të referimit në shërbimet e shëndetit mendor?

- A) Kufizon kalimin e rasteve midis niveleve të ndryshme të kujdesit.
- B) Siguron koordinim dhe vazhdimësi në ofrimin e trajtimit për pacientët.
- C) Fokuson trajtimet vetëm në nivel spitalor.
- D) Redukton përfshirjen e familjes në procesin e trajtimit.

#### Pyetja 21

Cili profesionist ka përgjegjësinë për të dhënë një diagnozë përfundimtare të një çrregullimi mendor?

- A) Punonjësi social
- B) Psikologu
- C) Profesionistët e autorizuar të shëndetit mendor
- D) Familja e klientit

#### Pyetja 22

Cili është përfitimi i përdorimit të protokolleve të trajtimit në shërbimet e shëndetit mendor?

- A) Kufizon personalizimin e trajtimit për pacientët.
- B) Siguron standardizim dhe përmirësim të cilësisë së kujdesit.
- C) Përqendron trajtimin vetëm në diagnoza të rënda.
- D) Redukton përfshirjen e pacientëve në vendimmarrje.

#### Pyetja 23

Si ndikon deinstitutionalizimi në uljen e stigmës ndaj individëve me çrregullime mendore?

- A) Rrit izolimin social të pacientëve.

- B) Kufizon ndërveprimet e pacientëve me komunitetin.
- C) Zvogëlon aksesin në trajtimet komunitare.
- D) Promovon integrimin social dhe ul stigmatizimin.

Pyetja 24

Cili është ndikimi i dhunës në familje në shëndetin mendor të grave dhe fëmijëve?

- A) Nuk ndikon në mirëqenien mendore.
- B) Rrit prevalencën e depresionit, ankthit dhe çrregullimeve të stresit post-traumatik.
- C) Përmirëson aftësitë për përballimin e stresit.
- D) Zvogëlon nevojën për trajtime profesionale.

Pyetja 25

Cili është funksioni i kodit numerik në diagnozat DSM?

- A) Të klasifikojë diagnozat sipas moshës
- B) Të mundësojë komunikimin ndërkombëtar dhe faturimin e saktë
- C) Të tregojë progresin e çrregullimit
- D) Të përcaktojë trajtimin më të përshtatshëm

Pyetja 26

Cila është rëndësia e trajtimeve të personalizuar për pacientët me çrregullime mendore?

- A) Sigurojnë kujdes të përshtatur me nevojat specifike të çdo individi.
- B) Kufizojnë përfshirjen e pacientëve në trajtime të integruara.
- C) Fokusohen vetëm në trajtime të përgjithshme për të gjithë pacientët.
- D) Reduktojnë cilësinë e kujdesit për shkak të kompleksitetit.

Pyetja 27

Cili është roli i strategjive parandaluese në uljen e prevalencës së çrregullimeve mendore?

- A) Fokusimi në trajtimet afatgjata.
- B) Kufizimi i aksesit në shërbimet parandaluese.
- C) Identifikimi i hershëm i faktorëve të rrezikut dhe ndërhyrjet proaktive.
- D) Përqendrimi vetëm në trajtime medikamentoze.

Pyetja 28

Cili nga faktorët e mëposhtëm mund të ndikojë në diagnozën e një çrregullimi mendor?

- A) Vetëm simptomat fizike
- B) Vetëm rezultatet laboratorike
- C) Simptomat, konteksti kulturor dhe faktorët socialë
- D) Vetëm sjellja e pacientit në një takim të vetëm

Pyetja 29

Cili nga këta çrregullime klasifikohet si një çrregullim depresiv në DSM-5?

- A) Çrregullimi i ankthit të përgjithësuar
- B) Çrregullimi obsesiv-kompulsiv
- C) Distimia (çrregullimi depresiv i vazhdueshëm)
- D) Skizofrenia

Pyetja 30

Cili është qëllimi kryesor i Qendrave Komunitare të Shëndetit Mendor (QKSHM)?

- A) Ofrimi i shërbimeve kirurgjikale të specializuara
- B) Identifikimi, trajtimi dhe rehabilitimi i personave me çrregullime mendore në nivel komunitar
- C) Hartimi i politikave kombëtare të shëndetit publik
- D) Menaxhimi i institucioneve të kujdesit parësor

Pyetja 31

Çrregullimi i ankthit social karakterizohet nga ?

- A) Frika e vazhdueshme nga hapësirat e mbyllura
- B) Frika e tepruar nga situatat shoqërore ose performanca para të tjerëve
- C) Frika nga lartësitë
- D) Frika e pakontrolluar nga objektet e caktuara

Pyetja 32

Cili është një nga rolet kryesore të punonjësve socialë në shërbimet e shëndetit mendor?

- A) Ndihma për integrimin social dhe koordinimi i shërbimeve për klientët.
- B) Përqendrimi në diagnostikimin mjekësor të pacientëve.
- C) Kufizimi i aksesit në shërbime për grupet vulnerabël.
- D) Përcaktimi i trajtimeve farmaceutike për pacientët.

Pyetja 33

Në rastet kur pacienti shfaq simptoma që nuk përputhen plotësisht me ndonjë çrregullim specifik, cila kategori përdoret në DSM-5?

- A) Çrregullimet psikotike
- B) Çrregullimet e personalitetit
- C) Çrregullimet të paspecifikuara
- D) Çrregullimet zhvillimore

Pyetja 34

Cili çrregullim është më i zakonshëm tek fëmijët?

- A) Skizofrenia
- B) Çrregullimi i vëmendjes dhe hiperaktivitetit (ADHD)
- C) Çrregullimi obsesiv-kompulsiv
- D) Depresioni madhor

Pyetja 35

Cili çrregullim është i lidhur ngushtë me trauma të përjetuara gjatë fëmijërisë?

- A) Çrregullimi i personalitetit kufitar
- B) Çrregullimi i stresit post-traumatik (PTSD)
- C) Skizofrenia
- D) Distimia

Pyetja 36

Një person që konsumon substanca dhe ka përjetuar tolerancë të rritur dhe simptoma tërheqjeje mund të diagnostikohet me?



- A) Çrregullimi i ankthit
- B) Skizofrenia
- C) Çrregullimi i përdorimit të substancave
- D) Fobia specifike

Pyetja 37

Cili është roli i punonjësve socialë në parandalimin e çrregullimeve mendore?

- A) Përqendrimi në trajtime të bazuara në medikamente.
- B) Edukimi, ndërjegjësimi dhe ndërhyrjet në fazat e hershme.
- C) Kufizimi i ndërveprimeve me klientët.
- D) Fokusimi vetëm në zbatimin e procedurave administrative.

Pyetja 38

Çfarë mund të përfshijë diagnoza diferenciale e çrregullimeve të ankthit?

- A) Çrregullimet e personalitetit
- B) Çrregullimet e zhvillimit motorik
- C) Çrregullimet psikotike
- D) Çrregullimet e mësimit

Pyetja 39

Çfarë është DSM?

- A) Një manual për trajtimin farmaceutik të sëmundjeve
- B) Një manual diagnostikues dhe statistikor për çrregullimet mendore
- C) Një manual për edukimin në klasat fillore
- D) Një udhëzues për testet laboratorike

Pyetja 40

Çfarë përfshin çrregullimi obsesiv-kompulsiv (OCD)?

- A) Halucinacione dhe deluzione
- B) Ankth dhe mendime të përsëritura që çojnë në sjellje të përsëritura
- C) Mungesë të plotë emocioni
- D) Lodhje dhe letargji

Pyetja 41

Cili është një nga rolet kryesore të punonjësve socialë në trajtimin e klientëve me çrregullime mendore?

- A) Të ndjekin vetëm aspektet juridike të rastit.
- B) Të sigurojnë mbështetje emocionale dhe praktike për pacientët dhe familjarët e tyre.
- C) Të kryejnë trajtime medikamentoze.
- D) Të kufizojnë ndërveprimet sociale të klientëve.

Pyetja 42

Cili është një nga simptomat kryesore të depresionit madhor?

- A) Humbja e interesit ose kënaqësisë në aktivitete të përditshme
- B) Hallucinacione vizuale
- C) Ankth ekstrem në situata sociale
- D) Episodet maniake të përsëritura

Pyetja 43

Cila nga këto është një shenjë e çrregullimit të të ngrënit bulimia nervore?

- A) Humbja e kontrollit mbi ushqimin dhe përdorimi i metodave për të shmangur shtimin në peshë
- B) Ndjenja e frikës nga ujërat e thella
- C) Humbja e të folurit dhe të dëgjuarit
- D) Kujdesi i tepruar për higjienën personale

Pyetja 44

Cili është funksioni kryesor i një punonjësi social në përdorimin e DSM?

- A) Të përshkruajë medikamente për pacientët
- B) Të ndihmojë në kuptimin dhe referimin e klientëve për trajtim të përshtatshëm
- C) Të kryejë analiza laboratorike
- D) Të operojë pajisje mjekësore

Pyetja 45

Cila është një nga kompetencat kryesore të punonjësit social në një ekip multidisiplinar të shëndetit mendor?

- A) Njohuri të thelluara mbi farmakologjinë
- B) Aftësi për të kryer terapi artit në mënyrë të pavarur
- C) Vlerësimi i nevojave psikosociale të pacientit në nivel individual dhe familjar
- D) Menaxhimi i pajisjeve mjekësore

Pyetja 46

Cili është një nga rolet specifike të punonjësit social në ndërhyrjet e krizës?

- A) Administrimi i ilaçeve kundër ankthit
- B) Kryerja e testeve neuropsikologjike
- C) Ngritja e diagnozës diferenciale të çrregullimeve mendore
- D) Stabilizimi i situatës në bashkëpunim me komunitetin dhe familjen

Pyetja 47

Cili është objektivi kryesor i menaxhimit të rastit nga punonjësi social?

- A) Diagnostikimi i çrregullimeve mendore komplekse
- B) Kryerja e ndërhyrjeve kirurgjikale të urgjencës
- C) Koordinimi i burimeve dhe shërbimeve për të përmirësuar gjendjen psikosociale të pacientit
- D) Shkrimi i recetave për terapi medikamentoze

Pyetja 48

Cili është një nga qëllimet kryesore të ndërhyrjes psikoedukuese nga punonjësi social?

- A) Trajtimi kirurgjikal i problemeve shëndetësore
- B) Zhvillimi i protokolleve të reja mjekësore
- C) Përshkrimi i terapi medikamentoze për depresionin
- D) Informimi dhe edukimi i pacientëve dhe familjarëve për çrregullimet mendore

Pyetja 49

Cili është një aspekt i rëndësishëm i punës së punonjësit social në rolin e tij advokues?

- A) Përshkrimi i barnave të kontrolluara
- B) Monitorimi i respektimit të të drejtave të pacientëve në përputhje me ligjin
- C) Hartimi i raporteve mjekësore për qëllime të hulumtimit
- D) Vlerësimi i gjendjes fiziologjike të pacientit

Pyetja 50

Në cilën fushë punonjësi social kryen ndërhyrje rehabilituese?

- A) Diagnoza laboratorike
- B) Terapia fizike intensive
- C) Mbështetja për rikthimin në funksionimin social dhe emocional pas daljes nga kriza
- D) Operacionet kirurgjikale

Pyetja 51

Cili është një nga hapat që duhet të ndjekë punonjësi social gjatë një vlerësimi psikosocial?

- A) Përcaktimi i burimeve të brendshme dhe të jashtme që ndihmojnë pacientin
- B) Diagnostikimi mjekësor i çrregullimeve të personalitetit
- C) Administrimi i barnave kundër depresionit
- D) Kryerja e testeve laboratorike

Pyetja 52

Cili është funksioni kryesor i një raporti profesional të hartuar nga punonjësi social?

- A) Përcaktimi i diagnozës klinike përfundimtare
- B) Ofrimi i mjekimeve urgjente
- C) Dokumentimi i shërbimeve të ofruara dhe referimi për institucione të tjera
- D) Hartimi i protokolleve kirurgjikale

Pyetja 53

Cili është një nga elementët kryesorë të një vlerësimi multidisiplinar të pacientit nga punonjësi social?

- A) Përcaktimi i dozës së terapisë medikamentoze
- B) Vlerësimi i burimeve psikosociale të pacientit dhe familjes
- C) Interpretimi i testeve laboratorike
- D) Kryerja e ndërhyrjeve kirurgjikale

Pyetja 54

Cili është një nga indikatorët që punonjësi social përdor për të vlerësuar suksesin e një ndërhyrjeje?

- A) Përmirësimi i funksionimit social dhe emocional të pacientit
- B) Niveli i hemoglobinës së pacientit
- C) Efikasiteti i pajisjeve mjekësore të përdorura
- D) Rezultatet e analizave kimike

Pyetja 55

Cili është një nga elementët që përfshihet në hartimin e një plani individual të kujdesit nga punonjësi social?

- A) Përshkrimi i ilaçeve të specializuara
- B) Përcaktimi i burimeve të brendshme dhe të jashtme për mbështetje

- C) Kryerja e procedurave kirurgjikale
- D) Vlerësimi i gjendjes fiziologjike të pacientit

Pyetja 56

Cila nga këto është një simptomë tipike e çrregullimit të ankthit të përgjithësuar (GAD)?

- A) Hallucinacione
- B) Tensioni i vazhdueshëm dhe shqetësimi i tepruar
- C) Humbja e kujtesës
- D) Sjellja e dhunshme

Pyetja 57

Çfarë ndihme ofron punonjësi social në trajtimin e pacientëve me trauma të rënda (trauma të përsëritura)?

- A) Trajton traumat fizike që kanë ndodhur
- B) Ofron mbështetje emocionale dhe krijon një plan ndërhyrjeje që ndihmon në përballimin e traumave
- C) Ofron ilaçe për menaxhimin e dhimbjeve të trupit
- D) Kryen ndërhyrje kirurgjikale për rikuperimin e pacientit

Pyetja 58

Cili është një nga rolet kryesore të punonjësit social në planifikimin e rikthimit të pacientëve në punë pas trajtimit mjekësor?

- A) Ofrimi i një vendi pune të re për pacientin
- B) Vendosja e kufizimeve ligjore për pacientin
- C) Mbikëqyrja e pacientëve në kushte spitalore gjatë periudhës së punës
- D) Ofrimi i mbështetjes psikosociale dhe ndihma për të rindërtuar aftësitë e punës dhe përfshirjen sociale

Pyetja 59

Çfarë është çrregullimi i panikut?

- A) Një çrregullim që përfshin frikë irracionale nga hapësirat e mbyllura
- B) Një çrregullim që përfshin sulme të papritura ankthi të fortë dhe të shpeshta
- C) Një çrregullim që përfshin ndjenjën e izolimit social
- D) Një çrregullim që përfshin lodhje kronike

Pyetja 60

Cili është aspekti i rëndësishëm i roli të punonjësit social në ndërhyrjen e krizës për individët me çrregullime të sjelljes?

- A) Të ofrojë këshillim dhe mbështetje të menjëhershme për pacientët dhe familjet e tyre
- B) Të japë diagnoza përfundimtare për çrregullimin e sjelljes
- C) Të kryejë operacione kirurgjikale për të stabilizuar pacientin
- D) Të ndihmojë pacientët të bëjnë një analizë të hollësishme të simptomave

Pyetja 61

Cili është një nga përgjegjësitë e punonjësit social kur punon me individë me çrregullime të varësisë ndaj substancave?

- A) Përcaktimi i përdorimit të substancave dhe administrimi i barnave të duhur

- B) Trajtimi i varësisë me metadone
- C) Ofrimi i mbështetjes psikosociale dhe ndihma për rehabilitim dhe rikthim në shoqëri
- D) Përcaktimi i një plani për qëndrimin në spitalin psikiatrik

#### Pyetja 62

Cila prej pohimeve paraqet ndihmën që punonjësi social ofrojnë për rikthimin e pacientëve të shëndetit mendor në jetën familjare dhe sociale?

- A) Ofron mbështetje emocionale dhe krijon mundësi për zhvillimin e aftësive sociale të pacientëve
- B) Rekomandon që pacienti të qëndrojë në spital gjatë gjithë jetës
- C) Ofron terapi të intensifikuara për pacientët që nuk janë të aftë të bashkëpunojnë
- D) Përcakton ndryshime në strukturën e familjes për të menaxhuar problemet

#### Pyetja 63

Cili është roli i punonjësit social në vlerësimin e ndikimeve sociale dhe mjedisore në shëndetin mendor të pacientëve?

- A) Të ndihmojë pacientët të zhvillojnë aftësitë për t'u mbrojtur nga sëmundjet
- B) Të zbatojë medikamente të reja që mund të ndihmojnë pacientët
- C) Të vlerësojë dhe identifikojë faktorët e jashtëm që mund të kontribuojnë në çrregullimet mendore dhe të sigurojë mbështetje për ndryshimin e këtyre faktorëve
- D) Të organizojë ngjarje dhe aktivitete për pacientët

#### Pyetja 64

Cili është funksioni i punonjësit social në procesin e mbrojtjes ligjore për pacientët me çrregullime mendore?

- A) Ofrimi i mbështetjes juridike për pacientët gjatë gjykimeve
- B) Përcaktimi i statusit ligjor të pacientëve përmes ekspertizës mjekësore
- C) Ndihma për pacientët të kuptojnë të drejtat e tyre ligjore sidhe të ndihmojë në mbrojtjen e këtyre të drejtave
- D) Përcaktimi i dënimeve për pacientët që kryejnë vepra të paligjshme

#### Pyetja 65

Cili është një nga qëllimet e punonjësit social në ofrimin e mbështetjes psikosociale pas një krize të rëndë (siç është një aksident apo traumë)?

- A) Të trajtojë simptomat fizike të pacientit
- B) Të ndihmojë pacientët të krijojnë dhe zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të menaxhuar emocione të vështira dhe për të rifilluar aktivitetet e jetës së përditshme
- C) Të administrojë ilaçe për pacientët
- D) Të organizojë terapi mjekësore për pacientët

#### Pyetja 66

Cili është një nga aspektet kryesore të ndërhyrjes së punonjësve socialë për pacientët që janë në procesin e daljes nga spitali dhe kalimit në një shërbim më të lehtë?

- A) Ndihma për të gjetur një vend strehimi dhe mundësi punësimi në komunitet
- B) Rekomandimi i rregullimeve të dietës për pacientin
- C) Ofrimi i terapi psikoterapie të avancuar
- D) Vlerësimi i nevojave për ilaçe

Pyetja 67

Cili është roli i punonjësit social në vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut për vetëvrasje tek pacientët me çrregullime mendore?

- A) Të sigurojë mbështetje psikosociale dhe të bashkëpunojë me ekipin multidisciplinar për të zhvilluar një plan sigurie
- B) Të diagnostikojë shkakun e vetëvrasjes
- C) Të japë terapi psikologjike individuale
- D) Të mbledhë vetëm të dhëna për diagnozën psikiatrike

Pyetja 68

Cili është një aspekt i rëndësishëm i roli të punonjësit social në mbështetje të pacientëve me çrregullime të personalitetit?

- A) Ofrimi i mbështetjes psikosociale dhe ndihma në zhvillimin e aftësive për të menaxhuar marrëdhëniet ndërpersonale
- B) Ofrimi i terapisë mjekësore për të ndryshuar personalitetin
- C) Vlerësimi i aspekteve fizike të pacientit
- D) Përcaktimi i barnave për trajtimin e çrregullimeve të personalitetit

Pyetja 69

Cili është një nga qëllimet kryesore të punonjësit social në procesin e psikoedukimit?

- A) Të edukojë pacientët mbi mundësitë për trajtim kirurgjik
- B) Të edukojë pacientët dhe familjet për çrregullimet mendore dhe strategjitë e menaxhimit të tyre
- C) Të përshkruajë medikamente për trajtimin e simptomave
- D) Të kryejë analizat laboratorike për pacientët

Pyetja 70

Çfarë bën një punonjësi social për të ndihmuar një pacient të ri të dalë nga spitali për të rifilluar jetën e tij?

- A) Të ofrojë ndihmë për të siguruar një vend pune dhe mbështetje sociale për integrimin në komunitet
- B) Të rregullojë medikamentet për pacientin
- C) Të japë këshilla për dieta dhe ushqim të shëndetshëm
- D) Të përshkruajë terapi intensive për pacientin

Pyetja 71

Cili është roli i punonjësit social në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të pacientëve?

- A) Të regjistrojë pacientët në spitale
- B) Të sigurojë që të drejtat e pacientëve të respektohen dhe të ofrojë mbështetje nëse ato shkelhen
- C) Të vendosë politika të reja shëndetësore
- D) Të bëjë mbikëqyrjen e shpenzimeve për shërbimet shëndetësore

Pyetja 72

Cili është një detyrë e rëndësishme e punonjësit social gjatë vlerësimit të një rasti?

- A) Të ndihmojë në përcaktimin e dozave të ilaçeve
- B) Të bëjë mbikëqyrjen e rezultateve të analizave laboratorike

- C) Të organizojë trajtime kirurgjikale
- D) Të sigurojë informacion për nevojat dhe shqetësimet psikosociale të pacientit dhe të familjes

Pyetja 73

Cili është një nga funksionet kryesore të punonjësit social në shërbimet e specializuara të shëndetit mendor?

- A) Vlerësimi dhe menaxhimi i situatës ekonomike dhe sociale të pacientit
- B) Trajtimi kirurgjikal i çrregullimeve mendore
- C) Kryerja e analizave biokimike
- D) Përcaktimi i diagnozës mjekësore

Pyetja 74

Cili është roli i punonjësit social në mbështetjen e pacientëve që kalojnë nga spitali në komunitet?

- A) Të menaxhojë vetëm terapinë farmakologjike
- B) Të ndihmojë në integrimin e tyre në shoqëri dhe të sigurojë vazhdimësinë e kujdesit
- C) Të ofrojë vetëm këshillim familjar
- D) Të trajtojë vetëm simptomat fizike të pacientit

Pyetja 75

Cili është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e rregulloreve të brendshme të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor?

- A) Ministri i Financave
- B) Drejtori i spitalit lokal
- C) Sektori i Shëndetit Mendor dhe Adiktologjisë në Ministrinë e Shëndetësisë
- D) Kryetari i Bashkisë

Pyetja 76

Cili është një nga parimet kryesore të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor?

- A) Trajtimi në një mjedis sa më pak kufizues, me fokus në integrimin social
- B) Trajtimi i pacientëve vetëm në spitale psikiatrike
- C) Detyrimi i pacientëve për trajtim të pavullnetshëm në çdo rast
- D) Kujdesi vetëm për pacientët që kanë mbështetje familjare

Pyetja 77

Cili çrregullim i lidhur me çrregullimet e të ngrënit përfshin mospranimin e nevojës për të ngrënë?

- A) Anoreksia nervore
- B) Bulimia nervore
- C) Çrregullimi i ankthit social
- D) Depresioni i butë

Pyetja 78

Çfarë bën një punonjësi social kur ka një mosmarrëveshje etike në ekipin multidisiplinar?

- A) Injoron mosmarrëveshjen për të shmangur konfliktin
- B) Largohet nga ekipi pa diskutim

- C) Ndjek procedurat e përcaktuara për zgjidhjen e çështjeve etike
- D) Merr vendime vetëm për klientin e tij

Pyetja 79

Cili është roli kryesor i liderit në një “grup të trajtimit terapeutik”?

- A) Të japë detyra teknike
- B) Të administrojë burimet financiare
- C) Të lehtësojë procesin terapeutik dhe të mbështesë mirëqenien emocionale të anëtarëve
- D) Të përzgjedhë anëtarët e grupit

Pyetja 80

Cili prej këtyre elementëve është karakteristik për “grupet e terapisë”?

- A) Ofronë vetëm informacion bazik
- B) Kryesohen nga një profesionist i trajnuar në shëndetin mendor
- C) Nuk kërkojnë strukturë të caktuar
- D) Përqendrohen vetëm në zhvillimin akademik

Pyetja 81

Cili prej pohimeve të mëposhtme përfaqëson kontributin profesional të punonjësve socialë për rritjen, ndërgjegjësimin dhe angazhimin e komunitetit në çështjet e shëndetit mendor?

- A) Mbështetja vetëm për individët që kërkojnë ndihmë mjekësore
- B) Organizimi i fushatave edukative dhe trajnimet për të promovuar shëndetin mendor dhe eliminimin e stigmatizimit
- C) Injorimi i çështjeve të shëndetit mendor për të shmangur ndërlikimet
- D) Ndihma vetëm për ata individ që kanë çështje serioze të shëndetit mendor

Pyetja 82

Cila është qasja më e mirë për punonjës social kur një klient me aftësi të kufizuara nuk është në gjendje të shprehë dëshirat e tij?

- A) Të veprojnë në interesin më të mirë të klientit duke respektuar dëshirat e familjes së klientit
- B) Të ndalojnë çdo ndërveprim me klientin
- C) Të ndjekë vetëm udhëzimet e mbikëqyrësit
- D) Të shmangë çdo ndërhyrje derisa klienti të japë pëlqimin

Pyetja 83

Çfarë bën një punonjës social kur klienti nuk mund të kuptojë asnjë informacion të dhënë mbi shërbimin?

- A) Ndalon ofrimin e shërbimeve
- B) Vazhdon shërbimin pa miratim të mëtejshëm
- C) Përdor ndihmën e një përfaqësuesi ligjor të klientit për vendimmarrje
- D) Injoron situatën dhe të vazhdojë procesin

Pyetja 84

Cili është dallimi kryesor midis punës sociale dhe psikiatrisë?

- A) Psikiatria trajton sëmundjet mendore, ndërsa puna sociale adreson problemet dhe marrëdhëniet njerëzore.



- B) Psikiatria fokusohet vetëm në trajtimin me ilaçe, ndërsa puna sociale përdor vetëm terapi alternative.
- C) Psikiatria adreson çështjet sociale, ndërsa puna sociale fokusohet tek aspektet mjekësore.
- D) Psikiatria është profesioni i vetëm që trajton probleme emocionale.

Pyetja 85

Cili faktor social përmendet si mbrojtës për shëndetin mendor te të rinjtë?

- A) Neglizhimi nga bashkëmoshatarët.
- B) Atmosfera mbështetëse në shkollë dhe lidhjet pozitive sociale.
- C) Presioni i lartë akademik.
- D) Mungesa e ndërveprimeve shoqërore

Pyetja 86

Çfarë bën një punonjës social kur vëren një vendim të ekipit që dëmton mirëqenien e klientit?

- A) Pranon vendimin pa diskutim
- B) Raporton direkt tek klienti pa konsultim me ekipin
- C) Sugjeron dhe kërkon rishikim të vendimit
- D) Ndalon çdo bashkëpunim me ekipin

Pyetja 87

Cili është një nga sfidat kryesore të punës në një ekip multidisiplinar?

- A) Mosmarrëveshjet për shkak të qasjeve të ndryshme profesionale
- B) Mungesa e mundësive për ndarjen e informacionit
- C) Përfitimi i përbashkët nga përvoja e profesionistëve të tjerë
- D) Ndhurma e tepërt nga anëtarët e ekipit

Pyetja 88

Çfarë bën një punonjës social për të menaxhuar situatën e një klient me probleme mendore e cila përbën rrezik për individët e tjerë?

- A) Ruan konfidencialitetin në çdo rrethanë
- B) Injoron situatat deri në një kërcënim real
- C) Ndërmerr masa për të mbrojtur individët e tjerë të rrezikuar
- D) Transferon rastin tek një agjenci tjetër

Pyetja 89

Çfarë bën një punonjës social kur një klient me probleme mendore refuzon shërbimin?

- A) Raporton refuzimin tek autoritetet pa u konsultuar me klientin
- B) Detyron klientin të pranojë shërbimin
- C) Respekton refuzimin dhe eksploron alternativa të tjera për ndihmë
- D) Ndalon çdo ndërveprim me klientin

Pyetja 90

Cili është momenti që e bën të nevojshëm ndërhyjen e një palë të tretë në vendimet e një klienti?

- A) Kur klienti ka humbur aftësinë për të kuptuar ose për të marrë vendime të informuara
- B) Kur klienti kërkon një takim të dytë
- C) Kur klienti ka marrë ndihmë nga një agjenci tjetër

D) Kur klienti refuzon ndihmën për një çështje të vogël

Pyetja 91

Cila prej situatave kërkon që punonjësi social të kufizojë të drejtën e klientit për vetëvendosje?

- A) Kur klienti ka nevojë për më shumë se një takim
- B) Kur klienti ka vështirësi financiare
- C) Kur klienti kërkon shërbime nga një agjenci tjetër
- D) Kur klienti kërcënon seriozisht veten ose të tjerët

Pyetja 92

Cili është detyrimi kryesor i punonjësit social kur një klient ka aftësi të kufizuara mendore për të marrë vendime?

- A) Të respektojë plotësisht vetëvendosjen e klientit
- B) Të konsultohet me një mbikëqyrës për udhëzime të mëtejshme
- C) Të veprojë në interesin më të mirë të klientit duke respektuar ligjin
- D) Të ndalojë çdo ndërveprim profesional

Pyetja 93

Çfarë duhet të bëjë punonjësi social kur klienti nuk është i aftë të japë miratimin e informuar për shërbimin?

- A) Të ofrojë shërbimin pa marrë miratimin
- B) Të ndalojë ofrimin e shërbimit
- C) Të kërkojë miratimin nga një palë e tretë e autorizuar
- D) Të lërë klientin të vendosë pa ndërhyrje

Pyetja 94

Si ndikon pjesëmarrja aktive e familjes në procesin e trajtimit të çrregullimeve mendore?

- A) Kufizon përparimin e pacientit në trajtim.
- B) Redukton efektivitetin e trajtimeve psikosociale.
- C) Përmirëson mirëqenien emocionale dhe rrit përkushtimin ndaj trajtimit.
- D) Zvogëlon autonominë e profesionistëve të kujdesit.

Pyetja 95

Cila është lidhja midis edukimit shëndetësor dhe parandalimit të problemeve të shëndetit mendor?

- A) Edukimi shëndetësor ndihmon në identifikimin e hershëm dhe reduktimin e faktorëve të rrezikut.
- B) Edukimi nuk ka ndikim në parandalimin e çrregullimeve mendore.
- C) Kufizon pjesëmarrjen e komunitetit në programet parandaluese.
- D) Fokuson edukimin vetëm te profesionistët mjekësorë.

Pyetja 96

Cili është ndikimi i ndërgjegjësimit në uljen e stigmës për shëndetin mendor?

- A) Reduktimi i qasjes së pacientëve në trajtime komunitare.
- B) Ndihmon në promovimin e një qëndrimi pozitiv ndaj problemeve mendore dhe rritjen e mbështetjes sociale.

- C) Kufizimi i ndërveprimeve me profesionistët e kujdesit.
- D) Përqendrimi vetëm te trajtimet medikamentoze.

Pyetja 97

Cili është një nga faktorët mbrojtës për fëmijët me rrezik për çrregullime mendore?

- A) Prindërimi mbështetës dhe atmosfera e sigurt në shkollë.
- B) Dhuna në familje dhe presioni akademik.
- C) Përrjashtimi social nga bashkëmoshatarët.
- D) Varfëria në zonat rurale.

Pyetja 98

Cili është ndikimi i shërbimeve të shëndetit mendor të bazuara në komunitet?

- A) Përmirëson qasjen, redukton stigmat dhe lehtëson integrimin social të pacientëve.
- B) Kufizon mbështetjen për pacientët me probleme kronike.
- C) Fokuson trajtimet vetëm në aspektet medikamentoze.
- D) Zvogëlon mundësitë për ndërhyrje psikosociale.

Pyetja 99

Cili është roli i standardeve etike në kujdesin e shëndetit mendor?

- A) Përqendrimi vetëm në aspektet administrative të trajtimeve.
- B) Kufizimi i autonomisë së pacientëve.
- C) Sigurimi i respektimit të të drejtave dhe dinjitetit të pacientëve.
- D) Reduktimi i përgjegjësive të profesionistëve.

## **Kapitulli 12. Etika në Praktikën e Punës Sociale**

Pyetja 1

Çfarë nënkupton vlera e “respektit për dinjitetin e personit” në punën sociale?

- A) Shprehjen e respektit për të gjitha vendimet e klientit
- B) Dhënien e ndihmës pa asnjë limit
- C) Respektimin e dinjitetit të çdo klienti
- D) Pranimin e të gjitha kërkesave të klientit

Pyetja 2

Cili është roli i punonjësve socialë në promovimin e drejtësisë sociale?

- A) Të krijojnë struktura për të mbështetur klientët me status të lartë
- B) Të sigurojnë mbështetje për grupet vulnerabël dhe të shtypura
- C) Të zbatojnë ligje vetëm për komunitetin lokal
- D) Të ndjekin prioritetet e agjencive të tyre

Pyetja 3

Cili është parimi themelor i etikës profesionale për punonjësit socialë?

- A) Promovimi i interesave personale.
- B) Mbështetja e individëve vulnerabël dhe mbrojtja nga shfrytëzimi.
- C) Fokusimi në përfitimet ekonomike të shërbimit.
- D) Kufizimi i ndihmës ndaj klientëve që mund të paguajnë për shërbime.

Pyetja 4

Cili është koncepti kryesor i periudhës së vlerave në punën sociale?

- A) Ndikimi i fortë i besimeve fetare
- B) Ndihma e klientëve për vetëveten
- C) Krijimi i strukturave ligjore për shërbimet sociale
- D) Përmirësimi i jetës sociale përmes drejtësisë sociale

Pyetja 5

Çfarë nënkupton vetëvendosja e klientit?

- A) Punonjësi social merr vendime për klientin
- B) E drejta e klientit për të marrë vendime të pavarura
- C) Punonjësi social kufizon zgjedhjet e klientit
- D) Mbështetja e të gjitha vendimeve të klientit

Pyetja 6

Cila është një nga pasojat e shkeljeve të kodit etik nga punonjësit socialë?

- A) Zhvillimi i marrëdhënieve më të afërta me klientët.
- B) Masa disiplinore ose humbja e licencës profesionale.
- C) Përmirësimi i trajtimeve për klientët.
- D) Lehtësimi i procedurave administrative.

Pyetja 7

Cili është roli i integritetit në punën sociale?

- A) Shmangia e ndihmës për klientët e varfër
- B) Përfitimi personal i punonjësit social
- C) Veprimi me ndershmëri dhe besueshmëri
- D) Pranimi i të gjitha kërkesave të klientit

Pyetja 8

Cili është përkufizimi i konfidencialitetit në punën sociale?

- A) Shpërndarja e informacionit të klientit
- B) Ruajtja e informacionit të klientit në fshehtësi
- C) Zbulimi i të dhënave vetëm për kolegët
- D) Ndjekja e të gjitha kërkesave të klientit

Pyetja 9

Si duhet të reagojë një punonjës social kur klienti i tij përfshihet në sjellje që dëmton të tjerët?

- A) Të respektojë vendimet e klientit pa ndërhyrë
- B) Të raportojë sjelljen tek autoritetet përkatëse, duke ruajtur etikën profesionale
- C) Të ndërpresë marrëdhënien profesionale me klientin
- D) Të inkurajojë klientin për të vazhduar me sjelljen

Pyetja 10

Në cilat raste mund të tejkalohej konfidencialiteti i informacionit të klientit?

- A) Kur klienti shfaq shenja të rrezikimit të vetes ose të të tjerëve
- B) Kur informacioni është kërkuar nga një koleg

- C) Kur informacioni mund të përfitojë agjencinë
- D) Kur klienti kërkon ndryshimin e vendimeve të tij

Pyetja 11

Çfarë përfshin koncepti i sjelljes etike?

- A) Vetëm ndjekjen e ligjeve të vendosura nga shteti.
- B) Kufizimin e ndihmës vetëm te klientët vulnerabël.
- C) Ndryshimin e parimeve etike sipas nevojave të klientëve.
- D) Ndjekjen e kodeve etike, ligjeve dhe normave morale.

Pyetja 12

Si duhet të reagojë një punonjës social kur klienti i tij përfshihet në sjellje që dëmtojnë të tjerët?

- A) Të respektojë vendimet e klientit pa ndërhyrë
- B) Të ndërpresë marrëdhënien profesionale me klientin
- C) Të inkurajojë klientin për të vazhduar me sjelljen
- D) Të raportojë sjelljen tek autoritetet përkatëse, duke ruajtur etikën profesionale

Pyetja 13

Cila situatë përfaqëson një marrëdhënie të dyfishtë në shërbimet sociale?

- A) Dhënia e shërbimeve për një grup klientësh.
- B) Referimi i klientëve në institucione të tjera për trajtim.
- C) Të qenit njëkohësisht menaxher rasti dhe miku personal i një klienti.
- D) Zbatimi i planit të trajtimit në mënyrë të personalizuar.

Pyetja 14

Cila prej veprimeve përfshin përgjegjësinë sociale të punonjësve socialë?

- A) Ndihma për të përmirësuar vetëvlerësimin e klientit
- B) Kufizimi i shërbimeve për grupet vulnerabël
- C) Ndihma për të përmirësuar statusin financiar të agjencisë
- D) Përshtatja me kërkesat e klientëve të privilegjuar

Pyetja 15

Në kontekstin e etikës së punës sociale, çfarë nënkupton “vetëvendosja”?

- A) E drejta e klientit për të marrë vendime mbi jetën e tij
- B) Pranimi i ndihmës vetëm nga familjarët e klientit
- C) Kufizimi i vendimeve nga autoritetet lokale
- D) Detyrimi për të ndjekur udhëzimet e punonjësit social

Pyetja 16

Si trajtohet konfidencialiteti në punën sociale gjatë epokës dixhitale?

- A) Mbajtja e informacionit për klientin vetëm në dosje fizike
- B) Publikimi i të dhënave të klientit në mënyrë të përmbledhur
- C) Ndarja e informacionit me institucione të tjera
- D) Sigurimi i aksesit të kufizuar në informacionin elektronik të klientit

Pyetja 17

Çfarë nënkupton termi “dilemë etike” në kontekstin e punës sociale?

- A) Konfliktet ndërmjet interesave personale dhe profesionale të punonjësit social
- B) Ndhima për klientët vulnerabël në situata emergjente
- C) Vendimet që përfshijnë ndihmë për klientët
- D) Zbatimi i rregullave institucionale

Pyetja 18

Cila është rëndësia e të përdorurit “grykimin e ndjeshëm etik” në marrjen e vendimeve të ndërlikuara?

- A) Të ruajë qëllimet personale të punonjësit social
- B) Të sigurohet që vendimi është moral dhe përfiton klientin pa dëmtuar të tjerët
- C) Të shmangë ndërhyrjen e palëve të treta
- D) Të lehtësojë vendimet e klientit bazuar në interesat e tij

Pyetja 19

Cila është qasja më e përshtatshme për trajtimin e konflikteve të interesit në punën sociale?

- A) Përcaktimi i kufijve të qartë për të shmangur ndikimin personal
- B) Përfshirja e të gjitha palëve në vendimmarrje
- C) Përqendrimi vetëm në interesat e punonjësit social
- D) Kërkesa për mbështetje financiare nga klienti

Pyetja 20

Cili është koncepti “informimi i pjesshëm” dhe pse mund të jetë një dilemë etike?

- A) Informimi i klientit vetëm për çështje të rëndësishme që mund të ndikojnë jetën e tij
- B) Përfshirja e të gjitha informacioneve të mundshme për klientin
- C) Kufizimi i informacionit për të ruajtur privatësinë
- D) Informimi i plotë i klientit pa përjashtime

Pyetja 21

Pse duhet të shmangen marrëdhëniet intime me klientët në shërbimet sociale?

- A) Për të shmangur ndërlikimet administrative në agjenci.
- B) Për të ndihmuar klientët të përqendrohen më shumë te trajtimi.
- C) Për të ruajtur kufijtë profesionalë dhe për të parandaluar shfrytëzimin e klientëve.
- D) Për të mbrojtur reputacionin personal të punonjësit social.

Pyetja 22

Cila është rëndësia e kompetencës profesionale në punën sociale?

- A) Përfshirja e klientëve në çdo proces vendimmarrës
- B) Zhvillimi dhe aplikimi i aftësive për të ofruar shërbime cilësore
- C) Kufizimi i ndihmës për klientët vulnerabël
- D) Përfshirja e vendimeve vetëm për grupet elitare

Pyetja 23

Cili është përkufizimi i “paternalizmit profesional” në kontekstin e punës sociale?

- A) Ndhima e klientit për të përmirësuar statusin social

- B) Ndërhyrja e punonjësit social për të mbrojtur interesat e klientit, ndonjëherë kundër vullnetit të tij
- C) Marrja e vendimeve bazuar në interesin personal të punonjësit social
- D) Ndhurma vetëm për fëmijët në nevojë

Pyetja 24

Cili është përkufizimi i termit “pëlqimi i informuar” në punën sociale?

- A) Kufizimi i vendimeve të klientit
- B) E drejta e klientit për të marrë vendime pas marrjes së informacionit të plotë
- C) Shpërndarja e informacionit të klientit pa miratim
- D) Vendimet e marra nga punonjësi social

Pyetja 25

Çfarë përfshin përdorimi i “aftësisë dalluese” në punën sociale?

- A) Përshtatja me kërkesat e klientëve elitare
- B) Përzgjedhja e qasjeve të përshtatshme për situatat e ndryshme të klientëve
- C) Ndjekja e vetëm standardeve të institucionit
- D) Ndryshimi i qëllimeve të klientëve

Pyetja 26

Në cilin rast është e ligjshme të ndërhyhet në vetëvendosjen e klientit?

- A) Kur vendimi i klientit mund të shkaktojë dëm ndaj vetes ose të tjerëve
- B) Kur punonjësi social nuk është dakord me qëllimet e tij
- C) Kur klienti nuk ka përvojë të mjaftueshme
- D) Kur klienti kërkon këshillim për vendimet personale

Pyetja 27

Në cilën situatë pranimi i dhuratave nga klientët mund të konsiderohet i pranueshëm?

- A) Nëse dhurata është me vlerë të lartë dhe përmirëson marrëdhënien me klientin.
- B) Nëse klienti këmbëngul për dhënien e dhuratës.
- C) Nëse dhurata është simbolike dhe nuk ndikon në marrëdhënien profesionale.
- D) Nëse dhurata përdoret për qëllime personale të punonjësit social.

Pyetja 28

Çfarë është "menaxhimi i rrezikut etik" në punën sociale?

- A) Marrëdhëniet e vazhdueshme me klientët vulnerabël
- B) Përfshirja e të gjithë klientëve në vendimmarrje
- C) Mbështetja vetëm e grupeve elitare
- D) Praktikrat që minimizojnë ekspozimin ndaj pasojave të padëshiruara për punonjësit socialë

Pyetja 29

Cila është përgjegjësia e punonjësit social kur has një konflikt vlerash me klientin?

- A) Imponimi i vlerave personale mbi klientin.
- B) Ndryshimi i vlerave personale për t'u përshtatur me klientin.
- C) Transferimi i klientit te një menaxher tjetër rasti nëse konflikti është i rëndë.
- D) Injorimi i konfliktit dhe vazhdimi i trajtimit si zakonisht.

Pyetja 30

Çfarë përfshin parimi i "mirësjelljes" në punën sociale?

- A) Trajtimi i klientëve pa respekt
- B) Trajtimi i klientëve me ndershmëri dhe dinjitet
- C) Ndërhyrja në jetën private të klientëve
- D) Reduktimi i ndihmës për klientët vulnerabël

Pyetja 31

Cila është një nga detyrat kryesore të punonjësit social?

- A) Të promovojë drejtësinë sociale
- B) Të ruajë të gjitha informacionet për vete
- C) Të përfitojë nga klientët
- D) Të ndryshojë qëllimet e klientëve

Pyetja 32

Cila është periudha e fundit e zhvillimit të etikës në punën sociale?

- A) Periudha e menaxhimit të rrezikut
- B) Periudha dixhitale
- C) Periudha e moralit
- D) Periudha e vlerave

Pyetja 33

Cila nga këto është një vlerë themelore e punës sociale?

- A) Konkurenca
- B) Diskriminimi
- C) Pavarësia e klientit
- D) Përfitimi personal

Pyetja 34

Çfarë duhet të bëjë një punonjës social kur ka një "marrëdhënie të dyfishtë" me klientin?

- A) Të shmangë marrëdhëniet personale që mund të krijojnë konflikte interesi
- B) Të përfshihet vetëm në aspektin personal të marrëdhënies
- C) Të inkurajojë klientin për të ruajtur marrëdhënien
- D) Të përdorë marrëdhënien për përfitim financiar

Pyetja 35

Në cilin rast i cënohet privatësia klientit nga punonjësi social?

- A) Kur klienti refuzon ndihmën e tij
- B) Kur informacioni kërkohet nga familjarët
- C) Kur klienti kërkon të largohet nga shërbimi
- D) Kur klienti është në rrezik të dëmtojë të tjerët

Pyetja 36

Si ndikon konfidencialiteti në marrëdhënien mes punonjësit social dhe klientit?

- A) Kufizon të drejtën e klientit për të ndarë informacione personale.
- B) Lejon që informacionet e klientit të ndahen lirshëm me të tretët.
- C) Ndihmon në krijimin e një mjedisi besimi dhe sigurie për klientin.



D) Kufizon përfshirjen e klientit në vendimmarrje.

Pyetja 37

Çfarë është përkufizimi i "marrëdhënies së mirëbesimit"?

- A) Marrëdhënia profesionale ku punonjësi social vepron në interesin më të mirë të klientit
- B) Marrëdhënia e cila përqendrohet vetëm në kërkesat institucionale
- C) Një marrëdhënie e përkohshme me klientin
- D) Ndjekja e vetëm preferencave të klientit

Pyetja 38

Çfarë përfshin "menaxhimi i sfidave etike" në rastet komplekse?

- A) Ndryshimin e përparësive në varësi të interesave të institucionit
- B) Ndjekjen e vetëm procedurave administrative
- C) Kufizimin e aksesit për klientët vulnerable
- D) Përdorimin e qasjeve që ndihmojnë në zgjidhjen e dilemave etike pa dëmtuar palët e përfshira

Pyetja 39

Si ndihmon "transparenca" në ruajtjen e një marrëdhënieje etike?

- A) Duke fshehur vendimet për të mbrojtur klientin
- B) Duke përdorur informacionin vetëm për përfitime institucionale
- C) Duke siguruar që klienti është plotësisht i informuar për vendimet që kanë ndikim mbi të
- D) Duke anashkaluar vendimet e klientit

Pyetja 40

Si përfitojnë punonjësit socialë nga "reflektimi etik" në punën e tyre të përditshme?

- A) Duke analizuar veprimet dhe vendimet e tyre për të përmirësuar cilësinë e shërbimit
- B) Duke ndjekur vetëm përfitimet e institucioneve
- C) Duke ruajtur informacionin e klientëve vetëm për interes personal
- D) Duke zvogëluar ndërveprimet me klientët

Pyetja 41

Cili është kuptimi i "dashmirësisë" në punën sociale?

- A) Veprime për të përfituar nga klientët vulnerabël
- B) Ndihma për përmirësimin e mirëqenies së klientëve
- C) Ndryshimi i të gjitha vendimeve të klientëve
- D) Kufizimi i qasjes së klientëve në informacione

Pyetja 42

Çfarë nënkupton respekti për "autonominë e klientit" në punën sociale?

- A) Ndihmën për klientët në marrjen e vendimeve për veten e tyre
- B) Ndryshimin e vendimeve të klientit për të ruajtur statusin e tij
- C) Kufizimin e vendimeve bazuar në besimet e punonjësit
- D) Mbështetjen vetëm për vendimet e familjarëve

Pyetja 43

Cila është rëndësia e integritetit në marrëdhëniet profesionale?

- A) Veprimi në përputhje me standardet dhe vlerat etike
- B) Veprimi i drejtuar vetëm në respektimin e ligjit
- C) Ndihma për klientët për të marrë vendime të pavarura
- D) Kufizimi i klientit për të ndërmarrë vendimeve financiare

Pyetja 44

Çfarë përfaqëson e drejta për vetëvendosje për klientët në shërbimet sociale?

- A) Kufizimin e përfshirjes së klientëve në planifikimin e trajtimit.
- B) Detyrimin e klientëve për të ndjekur këshillat e profesionistëve.
- C) Lejimin e klientëve për të marrë vendime të pavarura mbi shërbimet e tyre.
- D) Refuzimin e të drejtës së klientëve për të ndryshuar planin e trajtimit.

Pyetja 45

Çfarë përfshin parimi i “drejtësisë” në punën sociale?

- A) Mbështetja për grupet elitare
- B) Ndjekja e vetëm ligjeve vendore
- C) Kufizimi i ndihmës për klientët vulnerable
- D) Trajtimi i barabartë i të gjithë klientëve, pavarësisht nga statusi social

Pyetja 46

Cili është përkufizimi i “konfliktit të interesit” në punën sociale?

- A) Ndihma për klientët e privilegjuar
- B) Situata ku interesat personale të punonjësit mund të ndikojnë shërbimin ndaj klientit
- C) Kufizimi i vendimeve të klientëve vulnerabël
- D) Mbështetja e vetëm disa klientëve të caktuar

Pyetja 47

Cili është roli i “dhembshurisë” në marrëdhëniet profesionale?

- A) Nxitja e një qëndrimi të ndjeshëm dhe kujdesi ndaj klientëve
- B) Ndryshimi i të gjitha vendimeve të klientëve
- C) Përfshirja e vetëm klientëve me përfitime të larta
- D) Kufizimi i qasjes së klientëve në ndihmë

Pyetja 48

Si ndikon “përdorimi i teknologjisë” në etikën profesionale të punës sociale?

- A) Kufizon aksesin në shërbime për klientët
- B) Mundëson menaxhimin e informacionit, por kërkon masa për mbrojtjen e privatësisë
- C) Ndihmon vetëm në zbatimin e rregullave institucionale
- D) Përfshijon ndërveprimet etike

Pyetja 49

Çfarë përfshin parimi i “bashkëpunimit” në vendimmarrjen profesionale?

- A) Kufizimin e vendimeve për klientët vulnerabël
- B) Ndjekjen e vetëm rregullave të institucionit
- C) Zbatimin e vetëm udhëzimeve të klientëve
- D) Përfshirjen e klientëve dhe kolegëve për të marrë vendime më të qëndrueshme

Pyetja 50

Si ndikon “aftësia e menaxhimit të stresit” në marrëdhëniet profesionale?

- A) Ndhmon punonjësit socialë të ruajnë cilësinë e shërbimit ndaj klientëve
- B) Kufizon ndërveprimet me klientët
- C) Përqendrohet vetëm në menaxhimin personal të punonjësit
- D) Shmang ndërveprimet me klientët vulnerable

Pyetja 51

Cila është domosdoshmëria e “faturimit të ndershëm” në shërbimet sociale?

- A) Siguron që klientët të mos paguajnë për shërbime të panevojshme
- B) Kufizon ndihmën për klientët vulnerabël
- C) Mbështet përfitimet institucionale
- D) Siguron të ardhura të larta për punonjësit

Pyetja 52

Si përfshihet “menaxhimi i emocioneve” në kontekstin e ndërveprimit me klientët?

- A) Ndhmon në ruajtjen e marrëdhënieve profesionale dhe të besueshme
- B) Kufizon ndihmën për klientët vulnerabël
- C) Mbështet vetëm interesat e punonjësit
- D) Ndërpret komunikimin kur klienti shfaq ndjenja të forta

Pyetja 53

Çfarë përfshin parimi i "mosbërjes keq" në punën sociale?

- A) Detyrimin për të ndihmuar të tjerët
- B) Detyrimin për të mos shkaktuar dëm
- C) Detyrimin për të ndihmuar vetëm të afërmit
- D) Përfitimi nga klientët vulnerabël

Pyetja 54

Çfarë përfshin vlera e "përgjegjesisë sociale"?

- A) Përfitimin nga klientët
- B) Ndhmën për shoqërinë
- C) Mbajtjen e sekretit të klientit
- D) Përfitimin financiar të punonjësit

Pyetja 55

Cila është një nga përgjegjësitë më të rëndësishme që duhet të respektojë punonjësi social?

- A) Mbikëqyrja e klientit në çdo vendim
- B) Përpjekja për të përkrahur përdoruesit e shërbimeve
- C) Kufizimi i aksesit të klientëve vulnerable
- D) Mbështetja e të drejtës së klientit për vendimmarrje të lirë

Pyetja 56

Cili është kuptimi i të “menduarit kritik” në punë sociale?

- A) Ofrimi i shërbime të vlefshme për njerëzit
- B) Mbrojtja e klientëve që nuk janë në gjendje të mbrohen vetë
- C) Ndhma e klientëve vulnerabël

D) Aftësia për të analizuar, sintetizuar, vlerësuar dhe aplikuar informacionet e reja

Pyetja 57

Çfarë është “pranimi” në punë sociale?

- A) Ofrimi i shërbime vetëm ndaj klientëve të privilegjuar
- B) Aftësia për të qëndruar indiferent
- C) Përpjekja për të mos e ndryshuar klientin dhe për t'u përshtatur me nevojat e tij
- D) Aftësia për tu përqëndruar në nevojën për ndryshim

Pyetja 58

Cili rast përbën përjashtim për ruajtjen e privatësisë nga punonjësi social?

- A) Kur klienti refuzon ndihmën e tij
- B) Kur informacioni kërkohet nga familjarët
- C) Kur klienti është në rrezik të dëmtojë të tjerët
- D) Kur klienti kërkon të largohet nga shërbimi

Pyetja 59

Çfarë do të thotë “Përkushtim ndaj klientëve” në punë sociale?

- A) Përgjegjësi e punonjësve socialë ndaj shoqërisë në tërësi
- B) Kufizimi i të drejtës së klientëve për vetëvendosje
- C) Konsiderimi i Interesit të klientit si parësore
- D) Zbulimi i të gjitha informacioneve për klientin

Pyetja 60

Çfarë përfshin “Miratimi i Informuar” në Kodin Etik

- A) Rritjen e kompetencën së klientëve për të ndryshuar
- B) Zgjidhjen e konflikteve në interesave të klientit
- C) Sigurimin e promovimit të praktikave etike
- D) Ofrimin e shërbimit në kontekstin e një marrëdhënieje profesionale, ku ekziston konsensusi.

Pyetja 61

Në cilin prej rasteve punonjësit social mund të bëjnë publik informacionin konfidencial të klientit?

- A) Pas ndërprerjes së shërbimit
- B) Kur ka mosmarrëveshje me klientin
- C) Kur duhet të parandalojë një dëmtimi serioz të vetë klientit apo të personave të tjerë të identifikueshëm
- D) Kur flasin për klientët e tyre për qëllime mësimi apo trajnimi

Pyetja 62

Cili është hapi i parë që duhet të ndërmarrë punonjësi social kur një klient nuk është në gjendje të kuptojë informacionin mbi shërbimin?

- A) Të ndërpresë komunikimin me klientin
- B) Të sigurojë një përkthim ose shpjegim të qartë të informacionit
- C) Të ofrojë shërbimin pa asnjë miratim
- D) Të marrë vendimet e veta për shërbimin

Pyetja 63

Si ndikon “mbikëqyrja” në zhvillimin profesional të punonjësve socialë?

- A) Kufizon ndërveprimet me klientët vulnerable
- B) Ndihmon në analizën e punës dhe përmirësimin e praktikave profesionale
- C) Ndikon vetëm në interesat personale të profesionistit
- D) Ndërpret mbështetjen për klientët

Pyetja 64

Cili është roli i supervisorit në sigurimin e sjelljes etike të punonjësve socialë?

- A) Të zbatojë masa disiplinore pa ofruar mbështetje.
- B) Të ofrojë udhëzime dhe mbështetje për respektimin e kodeve etike dhe zhvillimin profesional.
- C) Të mbikëqyrë vetëm performancën administrative.
- D) Të imponojë vlerat e veta mbi punonjësit socialë.

Pyetja 65

Cili është parim etike në punën sociale?

- A) Pranimi i të gjitha vendimeve të klientëve
- B) Kufizimi i informacionit të klientëve
- C) Përfitimi personal i punonjësit social
- D) Respektimi i privatësisë dhe konfidencialitetit të klientit

Pyetja 66

Cila është një nga vlerat bazë të punës sociale?

- A) Kufizimi i të drejtave të klientëve
- B) Përfitimi nga klientët
- C) Integriteti
- D) Interesi personal i profesionistit

Pyetja 67

Çfarë nënkupton fjala “etikë”?

- A) Kufizimi i ndihmës për klientët vulnerabël
- B) Përfitimi financiar i punonjësit social
- C) Vendimet e pavarura të punonjësit social
- D) Rregulla të sjelljes së drejtë dhe korrekte

Pyetja 68

Si duhet të veprojë një punonjës social në rastet kur klienti refuzon shërbimin e ofruar?

- A) Të injorojë refuzimin dhe të vazhdojë me trajtimin.
- B) Të respektojë të drejtën e klientit për vetëvendosje dhe të ofrojë informacion mbi alternativat.
- C) Të ndalojë menjëherë çdo lloj komunikimi me klientin.
- D) Të imponojë shërbimin duke mos marrë parasysh dëshirën e klientit.

Pyetja 69

Cila është rëndësia e përmbushjes së detyrimeve profesionale nga punonjësit socialë?

- A) Rrit reputacionin e organizatës dhe të klientëve.
- B) Zvogëlon përfshirjen e klientëve në vendimmarrje.
- C) Lehtëson procedurat administrative për punonjësit socialë.
- D) Siguron cilësi të lartë të shërbimeve dhe mbron të drejtat e klientëve.

Pyetja 70

Cili është detyrimi i punonjësve socialë për të ndjekur edukimin e vazhdueshëm profesional?

- A) Të refuzojnë çdo formë trajnimi të ri
- B) Të përqendrohen vetëm në përvojën e kaluar
- C) Të ndjekin edukimin e vazhdueshëm për të përmirësuar kompetencat profesionale
- D) Të shmangin çdo zhvillim të ri profesional

Pyetja 71

Cili është përfitimi i një komunikimi të qartë dhe profesional me klientët?

- A) Redukton nevojën për ndjekje të planit të trajtimit.
- B) Kufizon të drejtën e klientëve për të bërë pyetje.
- C) Ndhmon në krijimin e një marrëdhënieje besimi dhe bashkëpunimi.
- D) Përcakton kufij të rreptë ndërmjet punonjësve dhe klientëve.

Pyetja 72

Çfarë nënkupton përdorimi i fuqisë në mënyrë etike në marrëdhënien mes punonjësit social dhe klientit?

- A) Përdorimin e fuqisë për të imponuar vendimet mbi klientët.
- B) Përdorimin e fuqisë për të ndihmuar klientët të marrin vendime të informuara dhe të pavarura.
- C) Kufizimin e autonomisë së klientëve.
- D) Përdorimin e fuqisë për të përmirësuar reputacionin e organizatës.

Pyetja 73

Cila është rëndësia e dokumentimit të qartë dhe të saktë të rasteve nga punonjësit socialë?

- A) Siguron bazë për vlerësim profesional dhe mbron të drejtat e klientëve
- B) Redukton nevojën për përfshirje të klientëve në vendimmarrje
- C) Kufizon përfshirjen e klientëve në procesin e trajtimit
- D) Lehtëson vetëm procedurat administrative për organizatën

Pyetja 74

Cila është detyra kryesore e punonjësit social në situata emergjente?

- A) Të ndihmojë vetëm ata klientë që përmbushin kushtet administrative.
- B) Të përqendrohet në përmbushjen e dokumentacionit të rastit.
- C) Të sigurojë mbrojtje dhe ndihmë të menjëhershme për klientët në rrezik.
- D) Të diskutojë situatën me supervisorin para se të veprojë.

Pyetja 75

Çfarë është "empatia" në kontekstin e ndërveprimit me klientët?

- A) Kufizimi i aksesit të klientëve në informacione
- B) Mbështetja vetëm e interesit të institucionit
- C) Kuptimi dhe ndjeshmëria ndaj përvojave dhe ndjenjave të klientëve

D) Ndërprerja e komunikimit të vazhdueshëm me klientët

Pyetja 76

Si ndikon “vendosmëria etike” në përmbushjen e përgjegjësive profesionale?

- A) Mbështet vetëm klientin
- B) Zbaton vetëm rregullave të ngurta
- C) Rrit konkurrencën në shoqëri
- D) Ndhmon punonjësit të marrin vendime të ndershme dhe të përgjegjshme

Pyetja 77

Çfarë është një “shkelje etike” në kontekstin e punës sociale?

- A) Ndhma për të gjithë klientët vulnerable
- B) Mosrespektimi i standardeve të sjelljes profesionale
- C) Ndjekja e udhëzimeve për ofrimin e shërbimit ndaj klientëve
- D) Zbatimi i rregullave të institucionit

Pyetja 78

Çfarë duhet të bëjë një punonjës social kur vëren sjellje të pandershme nga një koleg?

- A) Të diskutojë situatën me kolegun dhe, nëse është e nevojshme, të raportojë tek organet kompetente
- B) Të injorojë situatën për të shmangur konfliktet
- C) Të njoftojë klientët për sjelljen e kolegut
- D) Të shmangë çdo ndërveprim me kolegun

Pyetja 79

Çfarë përfshin “vlerësimi etik” në punën sociale?

- A) Analizën e pasojave të mundshme etike të veprimeve të punonjësit social
- B) Ndhmën vetëm për klientët me përfitime të larta
- C) Ndjekjen e vetëm disa udhëzimeve
- D) Mbështetjen e vetëm disa klientëve

Pyetja 80

Cilat raste diktojnë kufizimin e të drejtës së klientit ndaj dosjes personale në Kodin Etik?

- A) Kur klienti nuk ka formimin e duhur arsimorë
- B) Kur ka evidenca të qarta që një gjë e tillë do t'i shkaktonte dëm serioz klientit
- C) Kur rregullat dhe ligjet e agjencisë e kërkojnë
- D) Kur klienti nuk e ka kërkuar këtë të drejtë që në fillim

Pyetja 81

Çfarë udhëzon Kodi Etik në përgjegjësitë etike të punonjësve socialë ndaj klientëve kur bëhet fjalë për “Marrëdhëniet Seksuale”?

- A) Kontakti konsensual është i lejuar
- B) Punonjësit socialë nuk kanë përgjegjësinë për përcaktimin e kufijve të qartë
- C) Kontaktet seksuale me klientë të mëparshëm janë të lejuara
- D) Punonjësit socialë në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshihen në aktivitete apo kontakte seksuale me klientët.

Pyetja 82

Çfarë udhëzon Kodi Etik në lidhje me përgjegjësinë për “Pagesa për Shërbimet” ndaj klientëve ?

- A) Pranimin e të mirave materiale apo të shërbimeve nga klientët
- B) Sigurimin e pagesa të ndershme, të arsyeshme, dhe të krahasueshme me shërbimet e dhëna
- C) Shkëmbimi shërbimesh
- D) Mos marrjen në konsideratë të mundësive të klientit për të paguar

Pyetja 83

Cilat janë veprimet që ndërmerren për klientët që ju “Mungon Aftësia për Vendim-marrje”?

- A) Ndërpritet shërbimi
- B) Ndiqen vetëm udhëzimet institucionale
- C) Shpërndahehet informacioni
- D) Veprohet në emër të klientit, me hapa të kujdesshëm për të ruajtur interesat dhe të drejtat e tij

Pyetja 84

Çfarë udhëzon Kodi Etik në lidhje me “Përfundimin e Shërbimeve” për klientët?

- A) Braktisjen e klientëve të cilët kanë akoma nevojë për shërbime
- B) Ndërprerjen e shërbimit menjëherë
- C) Ndërprerjen e shërbimit kur nuk shërben për përmbushjen e nevojave dhe interesave të klientëve
- D) Mos gjetjen e mundësive të tjera për vazhdimin e shërbimeve.

Pyetja 85

Cila është rëndësia e “planifikimit afatgjatë” në shërbimet e punës sociale?

- A) Kufizon ndërveprimet me grupet vulnerabël
- B) Mbështet vetëm interesat e drejtuesve
- C) Përjashton ndërveprimet ndërdisiplinore
- D) Siguron që qëllimet e klientëve të arrihen në mënyrë të qëndrueshme

Pyetja 86

Çfarë nënkupton “mbështetja pa kushte” në punën sociale?

- A) Kufizon ndërveprimet me klientët e caktuar
- B) Mbështet vetëm vendimet e ekipit
- C) Ofrojë mbështetje pa kushte, duke respektuar dhe mbrojtur mirëqenien e klientit
- D) Përjashton ndërveprimet e qëndrueshme

Pyetja 87

Cili është përfitimi kryesor i “ndërveprimit ndërdisiplinor” për punonjësit socialë?

- A) Kufizon ndërveprimet me profesionet e tjera
- B) Mbështet vetëm vendimet e ekipit
- C) Mundëson integrimin e perspektivave të ndryshme për të ofruar mbështetje më gjithëpërfshirëse për klientët
- D) Përqendrohet vetëm në zbatimin e rregullave



Pyetja 88

Çfarë nënkupton “menaxhimi etik i burimeve” për punonjësit socialë?

- A) Përdorimi i burimeve për të përmbushur nevojat e klientëve në mënyrë të ndershme dhe të drejtë
- B) Kufizimi i burimeve për klientët vulnerabël
- C) Mbështet vetëm interesat e institucionit
- D) Ndërpret përdorimin e burimeve të përbashkëta

Pyetja 89

Cila është domosdoshmëria e "kujdesit për vetveten" në punën sociale?

- A) Kufizon ndërveprimet me klientët
- B) Mbështet vetëm interesat institucionale
- C) Ndërpret ndërveprimet me klientët vulnerable
- D) Ndhmon punonjësit të ruajnë mirëqenien personale për të ofruar shërbime cilësore

Pyetja 90

Çfarë është “përgjegjësia kolektive” në një ekip ku bën pjesë edhe punonjësi social?

- A) Ndërveprim i limituar ndërmjet anëtarëve të ekipit
- B) Mbështetje vetëm e interesave të drejtuesit
- C) Ndërpreja e komunikimit të vazhdueshëm me ekipin
- D) Përgjegjësia për të punuar së bashku dhe për të përmbushur qëllimet e ekipit në mënyrë etike

Pyetja 91

Si ndihmon “etika e kujdesit” në mbështetjen e klientëve vulnerabël?

- A) Kufizon aksesin në ndihmë për grupet e tjera
- B) Siguron që nevojat e klientëve të jenë prioritet në vendimmarrje
- C) Mbështet vetëm vendimet e institucionit
- D) Përqendrohet në marrjen e përfitimeve të larta

Pyetja 92

Çfarë është “ndërgjegjësimi për vetveten” në punën sociale?

- A) Kufizimi i ndërveprimeve të punonjësve me klientët
- B) Ndërgjegjësimi për emocionet dhe reagimet personale në ndërveprimet profesionale
- C) Mbështetja vetëm e interesave personale
- D) Ndihma vetëm në menaxhimin e klientëve vulnerable

Pyetja 93

Si ndikon “integriteti” në ruajtjen e marrëdhënieve të shëndosha me kolegët?

- A) Kufizon ndërveprimet e punonjësve socialë
- B) Siguron që marrëdhëniet bazohen në respekt dhe ndershmëri
- C) Mbështet vetëm interesat personale të punonjësit
- D) Përqendrohet vetëm në komunikimin formal

Pyetja 94

Çfarë është "konflikti etik" në kontekstin e punës sociale?

- A) Ndërprerje e komunikimit kur klienti shfaq ndjenja të forta

- B) Konflikti ndërmjet vlerave personale dhe profesionale të punonjësit social
- C) Përqendrimi vetëm në menaxhimin personal të punonjësit
- D) Sigurimi i të ardhura të larta për punonjësit

Pyetja 95

Çfarë sugjeron “modeli etik” i vendimmarrjes për zgjidhjen e situatave komplekse?

- A) Përfshirjen e të gjitha palëve në vendimmarrje
- B) Identifikimin se cili është më i cenusshëm, dhe cili do të dëmtohet ose ndihmohet
- C) Informimin e klientit vetëm për çështje të rëndësishme
- D) Kufizimin e informacionit për të ruajtur privatësinë

Pyetja 96

Çfarë sugjeron McAuliffe dhe Chenoweth (2007) përmes modelit rrethor ‘përfshirës’ për vendimmarrjen?

- A) Ndryshimin e përparësive në varësi të interesave të institucionit
- B) Ndjekjen e vetëm preferencave të klientit
- C) Ndryshimin e vendimeve sipas preferencave personale
- D) Përfshirjen e përgjegjësive, konsultimit, ndjeshmërisë kulturore dhe reflektimit kritik

Pyetja 97

Cila prej pohimeve të mëposhtëme përbën një burim të vazhduara të sjelljes etike?

- A) Reflektimi i vazhduar dhe interpretimi i të dhënave
- B) Ndjekja e vetëm qëllimeve institucionale
- C) Përqendrimi vetëm në zbatimin e rregullave
- D) Shmangja e ndërveprimeve me klientët vulnerable

Pyetja 98

Cila është mënyra më e mirë për të adresuar konfliktet e vlerave midis klientit dhe punonjësit social?

- A) T’i imponohen klientit vlerat e punonjësit social
- B) Të ruhet një qasje respektuese dhe jo-gjyquese
- C) Të sugjerohet një punonjës tjetër për të marrë përsipër rastin
- D) Të injorohen këto konflikte gjatë ndërveprimeve

Pyetja 99

Cila është rëndësia e vendosjes së kufijve profesionalë në marrëdhëniet me klientët?

- A) Parandalimi i zhvillimit të lidhjeve personale dhe ruajtja e objektivitetit
- B) Për të siguruar distancën maksimale nga klienti
- C) Për të përjashtuar klientin nga vendimmarrja
- D) Për të shmangur krijimin e ndonjë marrëdhënieje afatgjatë me klientin

Pyetja 100

Çfarë përfshin termi “promovimi i mirëqenies” në punën sociale?

- A) Përfitimi personal i punonjësit social
- B) Dominimi mbi të drejtat e klientëve
- C) Kufizimi i përfshirjes së klientëve në vendimmarrje
- D) Fokusimi mbi zhvillimin personal dhe social të klientëve

Pyetja 101

Si përfshihet parimi i “integritetit” në ndërlidhjen e praktikave të përditshme?

- A) Zbatimi i të gjitha standardeve etike pa përjashtime
- B) Kufizimi i ndihmës vetëm për klientët vulnerabël
- C) Përfshirja e klientëve në vendimmarrje
- D) Ndryshimi i vendimeve sipas preferencave personale

Pyetja 102

Cili është roli i “përgjegjësisë” në menaxhimin e rasteve komplekse?

- A) Mbështetja e klientit në vendimin e tij
- B) Përgjegjësia për të minimizuar dëmin për klientin dhe të tjerët
- C) Kufizimi i vendimmarrjeve për klientët vulnerabël
- D) Përfshirja e vetëm atyre individëve që kanë influencë

### **Kapitulli 13. Praktika e Punës Sociale në Shëndetësi**

Pyetja 1

Çfarë roli ka shëndetësia në mbështetjen e sektorit social për arritjen e qëllimeve të tij?

- A) Përmirësimin e mundësive për arsimim të lartë
- B) Mbështetjen për krijimin e më shumë vendeve të punës
- C) Uljen e varfërisë dhe përjashtimit social
- D) Reduktimin e barrës fiskale të shoqërisë

Pyetja 2

Cili është objektivi kryesor i strategjisë së mbrojtjes sociale 2019-2022?

- A) Sigurimi i mbështetjes financiare për familjet në nevojë
- B) Krijimi i një sistemi funksional të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror
- C) Reduktimi i shpenzimeve të sektorit shëndetësor dhe social
- D) Rritja e numrit të qendrave komunitare në nivel lokal

Pyetja 3

Cila është një nga sfidat kryesore për arritjen e integritetit ndërsektorial të shërbimeve sociale dhe shëndetësore në Shqipëri?

- A) Mungesa e njohurive shkencore për sektorin shëndetësor
- B) Përfshirja e pamjaftueshme e sektorit të arsimit
- C) Kompleksiteti i bashkëpunimit ndërmjet organizatave dhe sektorëve të ndryshëm
- D) Mungesa e fondeve për organizatat ndërkombëtare

Pyetja 4

Çfarë synohet të përmirësohet përmes politikave gjithëpërfshirëse të mbrojtjes sociale në periudha krizash ekonomike?

- A) Rritja e investimeve në sektorin privat
- B) Përmirësimi i kushteve të punës në sektorin publik
- C) Mbrojtja e individëve dhe familjeve nga efektet e pafavorshme të krizave ekonomike
- D) Reduktimi i borxhit publik të qeverisë

Pyetja 5

Cili është një përfitim kryesor i përfshirjes aktive të individëve në jetën shoqërore?

- A) Rritja e të ardhurave financiare
- B) Përmirësimi i statusit shoqëror dhe cilësisë së jetës
- C) Ulja e barrës së kujdesit shëndetësor publik
- D) Reduktimi i pabarazive gjinore

Pyetja 6

Cila është një ndër përfitimet kryesore të integritit të shërbimeve sociale dhe shëndetësore në Shqipëri?

- A) Ulja e numrit të institucioneve publike
- B) Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të kujdesit për individët
- C) Zvogëlimi i kostove administrative për qeverinë
- D) Kufizimi i aksesit në shërbime për grupe të caktuara

Pyetja 7

Cila prej politikave më poshtë theksohet si efektive për të arritur një barazi më të madhe në rezultatet shëndetësore?

- A) Investimi në teknologjinë shëndetësore
- B) Rritja e privatizimit të kujdesit shëndetësor
- C) Sigurimi i një mbrojtjeje sociale adekuate gjatë gjithë jetës
- D) Ulja e taksave për institucionet mjekësore

Pyetja 8

Cili është qëllimi kryesor i strategjisë "Shëndetësia 2020"?

- A) Të rrisë numrin e spitaleve private në rajon
- B) Të përmirësojë ndjeshëm shëndetin dhe mirëqenien e popullatave
- C) Të krijojë sisteme të centralizuara shëndetësore
- D) Të zvogëlojë mbështetjen për individët vulnerabël

Pyetja 9

Cili prej grupeve të mëposhtme konsiderohet si prioritar për mbështetje në politikat e kujdesit të integruar?

- A) Personat që kërkojnë kujdes për shëndetin mendor
- B) Individët me të ardhura të larta
- C) Komunitetet e biznesit
- D) Punonjësit e sektorit publik

Pyetja 10

Çfarë mundëson lidhja ndërmjet shërbimeve shëndetësore dhe atyre sociale në nivel lokal?

- A) Rritjen e kostove të shërbimeve për qytetarët
- B) Trajtimin multidisiplinar për individët dhe familjet
- C) Shmangien e përdorimit të teknologjive mjekësore
- D) Rritjen e varësisë nga ndihma shtetërore

Pyetja 11

Çfarë përfshin mbrojtja sociale sipas përkufizimit të Institutit të Kërkimit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Social?

- A) Vetëm uljen e taksave për individët vulnerabël
- B) Politika dhe programe për të zvogëluar varfërinë dhe rreziqet sociale
- C) Vetëm ndihmën për të papunët
- D) Vetëm trajtimin e sëmundjeve kronike

Pyetja 12

Cila është funksioni kryesor i shërbimeve parashoqërore?

- A) Sigurimi i mbështetjes financiare për familjet në nevojë
- B) Informimi dhe ndihma për përfituesit në përcaktimin e nevojave të tyre
- C) Ofrimi i strehimit për individët vulnerabël
- D) Organizimi i programeve për trajnim profesional

Pyetja 13

Cili prej koncepteve ka të bëjë me transferimin e të drejtave dhe përgjegjësisë në nivel vendor për afrim të shërbimeve tek qytetarët?

- A) Deinstitutionalizimi
- B) Decentralizimi
- C) Diversifikimi
- D) Vlerësimi bio-psiko-social

Pyetja 14

Çfarë përfshin deinstitutionalizimi si qasje për kujdesin shoqëror?

- A) Kalimin nga institucionet rezidenciale në shërbime me bazë komunitare
- B) Shtimin e institucioneve rezidenciale publike
- C) Privatizimin e plotë të kujdesit shoqëror
- D) Uljen e numrit të shërbimeve shoqërore

Pyetja 15

Çfarë përmban shporta e shërbimeve të përkujdesit shoqëror?

- A) Vetëm shërbime rezidenciale
- B) Një shumëllojshmëri shërbimesh, përfshirë parashoqërore, komunitare dhe rezidenciale
- C) Vetëm shërbime në familje
- D) Vetëm ndihmë financiare për të papunët

Pyetja 16

Çfarë nënkupton koncepti i diversifikimit në shërbimet shoqërore?

- A) Shkrirjen e strukturave ekzistuese shoqërore
- B) Promovimin e modeleve të reja të sigurimit të shërbimeve nga ofrues qeveritarë dhe joqeveritarë
- C) Centralizimin e shërbimeve shoqërore në nivel qendror
- D) Kufizimin e shërbimeve në një model unik

Pyetja 17

Cili është funksioni kryesor i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në Bashki?

- A) Dhënia e ndihmës financiare për individët vulnerabël
- B) Identifikimi i nevojave për shërbime sociale dhe planifikimi i shportës bazë të shërbimeve
- C) Ofrimi i trajtimeve mjekësore për të sëmurët kronikë
- D) Përcaktimi i standardeve kombëtare për shërbimet sociale

Pyetja 18

Çfarë është Fondi Social?

- A) Një fond ndërkombëtar për ndihmën ekonomike të vendeve në zhvillim
- B) Një mekanizëm financiar për mbështetje të njësive të vetëqeverisjes vendore për përmirësimin e shërbimeve sociale

- C) Një fond i dedikuar vetëm për organizatat jofitimprurëse
- D) Një fond për emergjenca natyrore dhe humanitare

Pyetja 19

Cilat shërbime konsiderohen si shërbime në familje?

- A) Shërbimet e ofruara në qendra ditore komunitare
- B) Kujdesi shoqëror për individët që e kanë të pamundur të marrin shërbime komunitare dhe rezidenciale
- C) Shërbimet e strehimit për të pastrehët
- D) Këshillimi për përfituesit në internet

Pyetja 20

Cilat janë kategoritë që përfitojnë nga shërbimet e specializuara?

- A) Vetëm të moshuarit në nevojë
- B) Fëmijët me çrregullime të zhvillimit, gratë e dhunuara dhe kategori të tjera në nevojë specifike
- C) Vetëm fëmijët me aftësi të kufizuara
- D) Vetëm individët në konflikt me ligjin

Pyetja 21

Cili është roli i Administratorit Social?

- A) Kryen diagnostikimin mjekësor të përfituesve
- B) Administron procesin dhe dokumentacionin për ndihmën ekonomike dhe shërbimet sociale
- C) Organizon aktivitete rekreative për individët vulnerabël
- D) Planifikon politikat e zhvillimit ekonomik

Pyetja 22

Çfarë përfshin shërbimi i këshillimit me telefon ose online?

- A) Mbledhjen e të dhënave statistikore për përfituesit
- B) Këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje
- C) Organizimin e trajnimeve për profesionistët e kujdesit social
- D) Sigurimin e mbështetjes financiare për të papunët

Pyetja 23

Çfarë synon vlerësimi bio-psiko-social për personat me aftësi të kufizuara?

- A) Vetëm diagnostikimin mjekësor të individit
- B) Një qasje të integruar për të vlerësuar nevojat në mënyrë gjithëpërfshirëse
- C) Përfundimin e rasteve të lehta nga shërbimet sociale
- D) Kufizimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara

Pyetja 24

Cili është funksioni i Regjistrimit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror?

- A) Regjistrimi i të ardhurave të përfituesve të ndihmës ekonomike
- B) Mbajtja e të dhënave për përfituesit, institucionet dhe shërbimet sociale
- C) Shpërndarja e granteve për organizatat joqeveritare
- D) Menaxhimi i financave publike në nivel vendor

Pyetja 25

Çfarë përfaqëson kujdesi i integruar në shërbimet sociale dhe shëndetësore?

- A) Kombinimi i proceseve dhe mjeteve për të lehtësuar kujdesin e integruar

- B) Ofrimin e shërbimeve të kujdesit në një qendër të vetme pa asnjë bashkëpunim me sektorë të tjerë
- C) Organizimin e kujdesit vetëm në nivel mjekësor, pa përfshirë shërbimet sociale
- D) Fokusimi vetëm në shërbimet shëndetësore për individët me nevoja afatshkurtra

Pyetja 26

Për kë është më efektiv kujdesi i integruar?

- A) Vetëm për të rinjtë dhe adoleshentët
- B) Për individët me nevoja komplekse mjekësore, të moshuarit dhe ata që jetojnë me sëmundje kronike
- C) Vetëm për individët që kërkojnë shërbime urgjente
- D) Për ata që kërkojnë shërbime për përmirësimin e cilësisë së jetesës

Pyetja 27

Çfarë është një pengesë e mundshme për integrimin e shërbimeve të kujdesit social dhe shëndetësor?

- A) Bashkëpunimi i ngushtë midis sektorëve të shëndetësisë dhe shoqërisë
- B) Burimet financiare të mjaftueshme për shërbimet
- C) Mungesa e përgjegjësisë për integrimin e kujdesit dhe shërbimeve
- D) Përdorimi i teknologjisë moderne për menaxhimin e shërbimeve

Pyetja 28

Cili është niveli i kujdesit të integruar që ofron shërbime për grupe të caktuara njerëzish, si për shembull kujdesi për të moshuarit dhe menaxhimi i rrjeteve klinike?

- A) Niveli makro
- B) Niveli mesëm
- C) Niveli mikro
- D) Niveli kombëtar

Pyetja 29

Çfarë përfshin kujdesi i integruar në nivel mikro?

- A) Ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë popullatën
- B) Koordinimin dhe planifikimin e kujdesit për individë të caktuar
- C) Menaxhimin e fondeve të kujdesit shëndetësor
- D) Përmirësimin e legjislacionit për shërbimet sociale

Pyetja 30

Çfarë është një nga sfidat që pengon integrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe social?

- A) Legjislacioni i përbashkët dhe i integruar
- B) Sistemi i burimeve njerëzore i përditësuar
- C) Kompleksiteti i sistemit dhe ndryshimet në procedura dhe struktura
- D) Rritja e mbështetjes financiare nga agjencitë ndërkombëtare

Pyetja 31

Cili është një nga qëllimet e kujdesit të integruar?

- A) Ofrimi i kujdesit shëndetësor pa marrë parasysh nevojat e popullatës
- B) Përmirësimi i cilësisë dhe ofrimi i shërbimeve me kosto efektive
- C) Fokusimi vetëm në kujdesin mjekësor dhe largimi i shërbimeve sociale
- D) Menaxhimi i shërbimeve pa koordinim ndërmjet profesioneve të ndryshme

Pyetja 32

